

# **POLITIKA DHE IDEOLOGJIA: FENOMENI I 'DEIDEOLOGJIZIMIT' TË POLITIKËS NË SHQIPËRI**

Malvina Tema

Dorëzuar  
Universitetit Europian të Tiranës  
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në  
(Shkenca Sociale), me profil (Shkenca Politike), për marrjen e gradës  
shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Tonin Gjuraj

Numri i fjalëve: 59 900

Tiranë, Qershor 2015

## **DEKLARATA E AUTORËSISË**

Deklaroj se studimi është punë origjinale dhe nuk përmban plagjaturë.

Malvina Tema

## ABSTRAKTI

Koncepti 'ideologji' është përdorur shpesh në shkencat sociale, por ky koncept është ende tejet i paqartë. Përdorimi i tij në gjuhën e përditshme është kryesisht negativ dhe zakonisht u referohet ideve të ngurta, të devijuara apo partizane duke krijuar një dikotomi sipas së cilës: ne kemi të vërtetën dhe ata kanë ideologjitë. Ky kuptim negativ na kthen pas tek Marx-i dhe Engels-i, për të cilët ideologjitë ishin një formë e 'ndërgjegjes së rreme', pra klasa punëtore mund të kishte ide të gabuara në lidhje me kushtet e ekzistencës së saj si pasojë e indoktrinimit nga ata të cilët kontrollonin mjetet e prodhimit. Gjatë gjithë pjesës më të madhe të shekullit të XX, në politikë dhe në shkencat shoqërore më gjerësisht, nocioni i ideologjisë vazhdoi të kishte konotacion negativ dhe është përdorur shpesh në kundërshtim me njohuritë 'objektive'. Fillimisht, 'ideologjitë' nuk e kanë patur këtë kuptim negativ. Më shumë se dyqind vjet më parë, filozofi francez Destutt de Tracy e prezantoi termin në mënyrë që të emërtojë një disiplinë të re që do të studionte 'idetë': *idéologie*. Gjithashtu në shkencat politike bashkëkohore, nocioni përdoret në një kuptim më neutral e deskriptiv, p.sh., për t'iu referuar sistemeve të besimit politik.

Për të shkurtuar një studim të gjatë historik, duhet theksuar se një ideologji është një sistem mendimi i orientuar drejt veprimit dhe ideologjia nuk është në vetvete as e mirë as e ligë, as e vërtetë as e rremë, e mbyllur apo e hapur sepse në fakt mund t'i ketë të gjitha vetitë së bashku. Ideologjia është qendrore në fushën e politikës. Pozicioni qendror i saj është rrjedhojë e karakteristikave dhe funksioneve të saj. Ndër të tjera, ideologjitë janë 'forma tipike' nëpërmjet të cilave shprehet mendimi politik. '*Tipi*' nuk përfshin gjithçka që ne kemi nevojë të dimë por ofron një bazë të domosdoshme për të matur/vlerësuar parametrat politikë të një shoqërie. Së dyti, ideologjitë janë mendim politik ndikues. Ato ofrojnë struktura vendimmarrëse pa të cilat veprimi politik nuk mund të ndodhë. Nga njëra anë ideologjitë janë instrumente pushteti për udhëheqësit dhe nga ana tjetër janë instrumente që mundësojnë e fuqizojnë zgjedhjet nga pikëpamja e anëtarëve të një shoqërie të hapur. Së treti, ideologjitë janë shembuj/modele të mendimit 'krijues' dhe sipas këtij roli, nga to përftohen idetë prej të cilave konfigurohet mendimi politik. Ideologjitë kërkojnë koherencë e konsistencë dhe gëzojnë efektivitet më të madh kur shoqërohen nga forca morale. Ato janë shembuj të mendimit konstruktiv e vizionar të arritura nga gjykimi i intelektualëve të cilët ofrojnë opsione potenciale nga të cilat shoqëria mund të zgjedhë. Së katërti, ideologjitë duhet të jenë të komunikueshme. Ideologjitë që janë lehtësisht të përqafueshme nga publiku kontribuojnë më tepër në debatin e qëllimeve politike.

Në këtë kuadër, qëllimi i këtij studimi është të shqyrtojë lidhjen e politikës shqiptare me ideologjinë dhe më tej të argumentojë se politika është e lidhur 'organikisht' apo pashmangshmërisht me ideologjinë, në një konceptim neutral të

ideologjisë në rrethanat e zhveshjes së konceptit nga konotacionet pezhorative. Kështu, për aq kohë sa ajo që konsiderohet si politike do të lidhet me mosmarrëveshjet dhe konsensusin mbi vlerat e ndryshme, do të duhet t'u referohet ideologjive në mënyrë që të përballet çfarë është 'e mirë' apo 'e keqe', e dëshirueshme apo më pak e dëshirueshme, produktive apo më pak produktive e kështu me radhë. Edhe nëse gjendet marrëveshje për të njëjtën përmbajtje/natyre të politikave apo të politikës, debatet në lidhje me 'hierarkinë' e vlerave mbeten. Për më tepër, në Shqipëri pavarësisht trajtave të ndryshme të deklaratave për fundin e ideologjisë kryesisht me prejardhje nga sfera e real politikës, ajo që synoj të sqaroj është se nuk kemi të bëjmë me fund të ideologjisë, sepse debatet mbi lirinë, barazinë, detyrimet politike, drejtësinë dhe moralitetin politik janë dhe do të jenë gjithnjë të pranishme të pashterueshme. Në qoftë se nuk shihen qartësisht orientimet ideologjike, atëherë, kjo nuk do të thotë që kemi të bëjmë me fundin e ideologjisë.

Dukuria që analizohet në rastin studimor është dukuria e *De-ideologjizimit* sipas të cilit e majta nuk artikulon/ndjek politika të majta dhe e djathta nuk artikulon/ndjek politika të djathta, duke i dhënë sistemit një natyrë inkoherente e inkonsistente.

Duke u nisur si nga kuadri teorik i marrë në konsideratë, por gjithashtu edhe nga rasti studimor konkret që shqyrtohet në këtë studim, ajo që unë propozoj janë tetë 'shtresa' analize për t'i dhënë një kornizë të qëndrueshme punimit. Këto shtresa analize janë:

- Dimensioi i partive politike
- Programet politike në lidhje me politikat publike/Dekomunistizimi
- Roli i elitave
- Ndikimi ndërkombëtar
- Dimensioi i shoqërisë civile
- Personalizimi i politikës
- Niveli i i diskursit politik
- Nivelet e populizmit

Në këtë mënyrë, për të realizuar punimin synohet jo vetëm një qasje thjesht e bazuar në teoritë ekzistuese, por gjithashtu synohet edhe një kontekstualizim nëpërmjet veçanësisë së rastit studimor të zbërthyer në shtresat përkatëse të analizës.

*Nënës sime dhe për ty Jasmin!*

## **FALENDERIME**

Hartimi i kësaj teze nuk do të ishte i mundur pa kontributin dhe dedikimin e disa personave tepër të rëndësishëm për mua.

Së pari, dua të shpreh mirënjohjen dhe vlerësimin tim të thellë për udhëheqësin e tezës së doktoraturës, Profesorin Tonin Gjuraj. Pa ndihmën dhe këshillat e tij, ky punim nuk do të kishte trajtën që ka sot.

Së dyti, një falenderim i dedikohet Administratorit të Universitet European të Tiranës, Henri Çilit i cili ka inkurajuar studimet e mia në nivel doktore.

Së fundi, dua të falenderoj familjen dhe miqt e mi, të cilët më kanë dëgjuar me durim kur kam ndarë me ta pjesë nga teza e papërfunduar.

Faleminderit të gjithëve ju!

## PËRMBAJTJA E LËNDËS

|            |   |    |
|------------|---|----|
| <b>1.</b>  | <b>Hyrje</b> .....  | 1  |
| <b>2.</b>  | <b>Modeli analitik i tezës dhe Skeleti teorik</b> .....   | 9  |
| 2.1.1      | Modeli Analitik i tezës/Metodologjia.....   | 9  |
| 2.1.2      | Kufizimet kryesore të studimit.....   | 17 |
| 2.1.3      | Hipoteza kryesore.....  | 18 |
| 2.1.4      | Objektiva dhe qëllime.....  | 19 |
| <b>2.2</b> | <b>Skeleti teorik: Ideologjia dhe Politika</b> .....  | 20 |
| 2.2.1      | Politika: Përkufizime.....  | 20 |
| 2.2.2      | Ideologjia: ‘Gjenealogjia e konceptit’/ përkufizime nga kënde të ndryshme dhe funksionet e saj..... | 25 |
| 2.2.3      | Ndarja teorike: E majta dhe e djathta.....  | 32 |
| 2.2.4      | Metanarrativat totalizuese.....   | 43 |
| 2.2.5      | Kritika ndaj të majtës dhe të djathtës.....   | 47 |
| 2.2.6      | Politika, Radikalizmi, Demokracia dhe Ideologjia.....   | 49 |
| 2.2.7      | Teza mbi ‘Fundin e Ideologjisë’ .....   | 53 |
| 2.2.8      | Teza mbi ‘Fundin e Historisë’ .....   | 60 |
| 2.2.9      | ‘Rruga e tretë’ dhe ajo ‘Përtej të majtës dhe të djathtës’ .....                                    | 62 |
| 2.2.10     | Kritika të ‘Fundologjisë’ .....   | 65 |
| ❖          | <b>Rasti Studimor: Dukuria e ‘deideologjizimit’ në Shqipëri</b>                                     |    |
| <b>3.</b>  | <b>Konteksti historik: Hyrje në rastin studimor</b> .....   | 67 |

|           |  |            |
|-----------|--|------------|
| 3.1.      | Sfondi politik.....  | 67         |
| 3.2.      | Sfondi juridik.....  | 75         |
| 3.3.      | Tranzicioni demokratik.....  | 85         |
| <b>4.</b> | <b>Analiza: Brenda rrethit vicioz te politikës: Faktorët e lidhur me deideologjizimin.....</b> | <b>99</b>  |
| 4.1       | Dimensioni i partive politike.....   | 99         |
| 4.2       | Programet politike në lidhje me politikat publike/Dekomunistizimi.....                         | 118        |
| 4.3       | Roli i elitave.....  | 134        |
| 4.4       | Ndikimi ndërkombëtar.....  | 147        |
| 4.5       | Dimensioni i shoqërisë civile.....   | 166        |
| 4.6       | Personalizimi i politikës.....   | 177        |
| 4.7       | Niveli i i diskursit politik.....  | 194        |
| 4.8       | Nivelet e populizmit.....  | 208        |
| <b>5.</b> | <b>Vërejte dhe përfundime.....</b>   | <b>220</b> |
| <b>6.</b> | <b>Bibliografi.....</b>  | <b>243</b> |



## **HYRJE**

Qëllimi i këtij studimi është që të argumentojë se politika është e lidhur pashmangshmërisht me ideologjinë, në një konceptim neutral të ideologjisë, çka do të thotë se ideologjia është së pari një sistem besimi që nuk mund të jetë privat ose personal, por ndahet në mënyrë sociale midis anëtarëve të një shoqërie. Ideologjitë nuk janë detyrimisht negative, ndërgjegje të rreme dhe nuk janë detyrimisht dominante e nuk janë e njëjta gjë me praktika të tjera si diskursi që i riprodhon dhe i shfaq ato. Ideologjitë janë sisteme besimi të cialt kanë funksione specifike për shoqërinë. Kështu, për aq kohë sa ajo që konsiderohet si *politike* do të lidhet me mosmarrëveshjet dhe konsensusin mbi vlerat e ndryshme, do të duhet t'u referohet ideologjive në mënyrë që të përballet me çfarë është e mirë apo e keqe, e dëshirueshme apo më pak e dëshirueshme, produktive apo më pak produktive e kështu me radhë. Edhe nëse gjendet marrëveshje për të njëjtën përmbajtje apo natyrë të politikave apo të politikës, debatet në lidhje me 'hierarkinë' e vlerave do të jenë gjithnjë prezente. Rasti i Shqipërisë i cili është rasti studimor në këtë punim është shembull i keqfunksionimit të sistemit nga pikëpamja e filozofisë politike apo e mendimit politik të lidhur me ideologjinë, duke qenë se forcat politike të majta në vendin tonë nuk ndjekin politika të majta dhe forcat politike të djathta nuk ndjekin politika të djathta apo nuk artikulojnë si të tilla. Të dy kampet janë të shtyra drejt një pragmatizmi të sforcuar dhe janë vazhdimisht inkoherentë. Kjo nuk është rrjedhojë e ndonjë konvergjence si

fenomen kompleks i kohëve të fundit por në fakt është një anomali e politikës. Mungesa e koherencës ideologjike dhe disfunksioni ideologjik sjellin deideologjizim dhe kjo sjell më pas një sërë pasojash si: inkoherencë politikash, qeveri të paqëndrueshme e të thyeshme, luftë politike intensive, koalicione jo të natyrshme nga pikëpamja e koherencës ideologjike si dhe bashkëpunim në nivele të ulëta ndërmjet elitave politike, etj.

Arsyet e kësaj anomalie politike do të sqarohen me anë të faktorëve të paraqitur për të zbërthyer rastin studimor. Pra në vend të idesë së ndonjë konvergjence të natyrshme midis të majtës e të djathtës apo edhe ideve të fundit të ideologjisë dhe fundit të historisë kemi një rast keqfunksionimi të sistemit politik nga pikëpamja e parimeve, gjë që sjell një politikë kaotike e të pafrytshme në vend.

Koncepti dhe funksionet e ideologjisë janë qendrore për politikën dhe në të njëjtën kohë kanë një histori komplekse që ende vertitet midis konotacioneve pozitive e negative. Në fakt, të studiuarit e ideologjisë është edhe studim i mendimit politik. Për çdokënd të interesuar për studimin e politikës, një studim i këtij lloji nuk do të ishte opsional. Duke u fokusuar tek idetë me anë të të cilave aktorët politikë drejtohen në rrugën e tyre si dhe në të njëjtën kohë arrijnë të kuptojnë rrethin social, një përpjekje e tillë është përpjekje thelbësore.

Diskutimet rreth ideologjisë janë veçanërisht komplekse sepse kanë të bëjnë me - çështje që lidhen me filozofinë dhe epistemologjinë. Nga ana tjetër, në përdorimin e përditshëm ekziston tendenca për ta parë ideologjinë si një term

negativ apo të veshur me një konotacion pezhorativ që u atribuon ideve vlerë ekstreme. Shpesh, ideologjia u kundërvihet pragmatizmit dhe të vërtetës. Në përpjekje për të bërë gjenealogjinë e konceptit të ideologjisë, autorë të ndryshëm përpiqen të gjejnë gjurmët e përcaktimit të ideologjisë tek socialja dhe sidomos përpiqen ta gjejnë këtë përcaktim tek grupet e mëdha shoqërore duke lënë mënjanë grupet në minorancë e duke treguar anësi. Gjithsesi, instrument i rëndësishëm për këtë punim është mënjanimi i konotacioneve pezhorative dhe pastrimi i konceptit ideologji nga besimet e pavlera në raport me termin.

Shkrimet mbi shterrimin e ideve politike dhe fundin e ideologjisë të cilat e shohin ideologjinë në përgjithësi si një forcë të fikur, pa kapacitet për të përmbushur funksione të mëdha kanë disa mangësi. Ndër funksionet e ideologjisë, vendimtare për argumentet e shkrimtarëve të ‘fundologjisë’ janë: orientimi drejt veprimit, mobilizimi dhe funksioni ndarës i ideologjive. Në fakt, për tejkalimin e këtyre konceptimeve, në vend të orientimit ‘nominal’ për përkufizimin e ideologjisë, do të sugjeroja/mbështesja një procedurë alternative e cila fokusohet në formulimin e një përkufizimi minimal të ideologjisë me anë të një procesi që konverton funksionet, karakteristikat e të cilave janë konceptuar shpesh si elemente apriori të ideologjisë, në një mori të gjerë të variablave hipotetike të testueshëm. Një hap fillestar në formulimin e një përkufizimi minimal të ideologjisë është të marrim në konsideratë elemente që shihen si njësi përcaktuese dhe të konsiderohen si variabla hipotetike. Në rastin e gjithëpërfshirjes hipotetike, një mënyrë për shqyrtimin e anëve negative si edhe të konotacione të panevojshme përkufizuese

është që këto të shihen si variabla hipotetike dhe që të përshkruhen si attribute të përgjithshme për të paraqitur aspekte të cilësive së ndryshueshme. Më saktësisht, natyra totalistike, ngurtësia dhe dogmatizmi mund të konceptohen si ekstremet e variablave të përgjithshme hipotetike. Në këtë mënyrë ideologjitë mund të shfaqin shkallë të ndryshme të ngurtësisë apo fleksibilitet.

Ekziston një mospajtim në lidhje me atë çka ideologjia është dhe se si efektet dhe përkufizimet e saj duhen kuptuar. Gjithsesi, shpesh deliberimi vërtitet rreth dy blloqeve kryesore a) pohime përkundrejt fundit të ideologjisë dhe fundit të historisë si dhe b) pohime për ideologjinë si të lidhur në mënyrë të pashmangshme me politikën nga një pikëpamje funksionaliste dhe legjitimuese.

Shumë autorë kanë përshkruar fundin e ideologjive. Herët, rreth gjysmës së parë të shekullit XX, termi “Fund i ideologjisë” mund të gjendet në esetë e Albert Kamy-së të lidhura me kritikën që ai u bën socialistëve francezë. Më vonë Seymour Martin Lipset argumentonte se problemet e lidhura me zhvillimin industrial nuk ngrenë më debate apo konflikte ideologjike. Sidoqoftë një formulim më të qartë të këtij koncepti e prezantoi Daniel Bell në librin e tij “The End of Ideology”. Bell thotë që “pasionet e vjetra kanë vdekur” dhe radikalizmi i vjetër politik dhe ekonomik nuk ka më kuptim. Sipas tij, situata është e qartë “Koha e ideologjive ka mbaruar sepse midis intelektualëve të botës perëndimore ka konsensus të gjerë në lidhje me çështjet politike: “Pranimi i shtetit të mirëqenies sociale, fuqi e decentralizuar, një sistem i ekonomisë mikse dhe pluralizëm politik.” “Ideologjia

ka vdekur intelektualisht” dhe politika ofron shumë pak nxitje. Në artikullin që i paraprin librit “The End of History and the Last Man”, Francis Fukuyama thotë që triumfi i Perëndimit dhe ideve perëndimore shënohet nga mungesa e alternativave të mundshme ndaj liberalizmit perëndimor. Më tej, edhe Anthony Giddens beson se ideologjia duhet braktisur për një sërë arsyesh të tilla si p.sh. nevoja për ndarjen e konceptit të ideologjisë nga koncepti i shkencës por edhe për shkak se ideologjia është pa përmbajtje duke qenë se ajo që i bën sistemet e besimit ideologjike është inkorporimi i tyre me sistemet e dominimit, e në mënyrë që të kuptojmë këtë inkorporim duhet të analizojmë mënyrën se si këto modele kuptimore inkorporohen me praktikatat e përditshme e kështu me radhë. Në fakt, në Shqipëri më tepër se një debat akademik lidhur me çështjen e braktisjes së ideologjisë, ka patur në të vërtetë artikulime nga real politika, ku është deklaruar se ideologjia është e pavlerë dhe e panevojshme. Sidoqoftë në parim, çështja është më e ndërlikuar dhe kundërthënëse se kaq. Kështu në mënyrë të përgjithshme, argumentat për fundin e ideologjisë kanë ardhur nga anë të ndryshme, por kryesisht nga teoritë e konvergjencës, homogjenizimi i shoqërive, ndryshimi i rendit botëror, postmodernizmi, globalizmi, etj. Në këtë kuadër, punimi im synon të sqarojë nëse po lëvizim drejt një periudhe pragmatizmi në terma të zhvillimit politik dhe shoqëror apo kjo është një përshtypje e rreme sepse politika është e lidhur në mënyrë organike me ideologjinë (në një konceptim neutral të ideologjisë) dhe është e pamundur të mendosh përtej disa vlerave të klasifikueshme nga pikëpamja ideologjike. Për më tepër, në rastin studimor

(Shqipëri), pavarësisht deklaratave të forta që vijnë nga sfera dhe aktorët e real politikës në lidhje me fundin e ideologjisë, ajo që synoj të sqaroj është se aktualisht nuk kemi të bëjmë me fund të ideologjisë sepse debatet mbi lirinë, barazinë, detyrimet politike, drejtësinë dhe moralin politik janë dhe do të jenë gjithnjë të pranishme.

Fenomeni i ‘*Deideologjizimit*’ si alternativë ndaj fundit të ideologjisë krijon disa dinamika komplekse. Përveç të tjerash mund të shihet edhe si një manovër elektorale e cila rrit përfitimet politike afatshkurtra të aktorëve të ndryshëm por jo *outputin* e një sistemi politik nga i cili duhet të përfitojë elektorati i cili bëhet pjesë dytësore e këtij rrjeti kompleks manovrash politike. Gjithsesi, thelbi i diskutimit është se në qoftë se nuk shihen qartësisht orientimet ideologjike, atëhere, kjo nuk do të thotë që kemi të bëjmë me fundin e ideologjisë.

Sidoqoftë, Shqipëria është një rast mjaft kompleks. Më tepër sesa ndonjë fenomen “*Fundi Ideologjie*” kategoria që kam zgjedhur për të emërtuar sititatën është ‘*Deideologjizimi*’. Nën këtë emërtim shënohen disfunktionet ideologjike apo mos realizimi i funksioneve të ideologjisë.

Funksionet e ideologjisë në lidhje me politikën të tilla si ofrimi i ‘destinacioneve’ qëllimeve apo objektivave të mirëpërcaktuara nuk performohen si duhet. Idetë politike bazike nuk luajnë rolin që do të duhet të luanin. Kjo është një situatë e dëmshme sepse aktiviteti politik është në varësi të arbitraritetit të aktorëve të

ndrshëm përfshirë partitë politike. Pra ky lloj argumentimi lidhet me setin e dytë të pohimeve përkundrejt ideologjive si një motor i vazhdueshëm politik.

Duhet sqaruar paraprakisht se kufizimet e këtij punimi janë disa. Një nga kufizimet kryesore është stadi apo periudha kohore që do të merret në konsideratë për analizë. Periudha e regjimit komunist nuk do të jetë fokusi i drejtpërdrejtë i punimit por do të merret në shqyrtim për aq sa mund t'i shërbejë ndërtimit të argumentave mbi zhvillimet relativisht më aktuale (duke filluar nga rënia e regjimit diktatorial). E njëjta logjikë vlen edhe për periudhën parakomuniste. Pra, kufizimi do të jetë në kohë; -pas regjimit diktatorial (me disa pika rëndese specifike) por gjithashtu edhe në hapësirë; -në Shqipëri, duke qenë se studimi nuk synon të prodhojë përgjigje përfundimtare/shteruese për çdo çështje të veçantë që mund të ketë lidhje direkte apo indirekte me ideologjinë.

Nga ana tjetër, në varësi të kapitujve përkatës disa nga objektivat kryesore të studimit janë: Së pari, përcaktimi i qasjes ndaj politikës dhe ideologjisë dhe operacionalizimi i koncepteve. Më tej, i rëndësishëm paraqitet gjithashtu edhe klasifikimi i spektrit ideologjik të politikës. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet eksplorimit dhe shpjegimit të deklaratave për 'Fundin e Ideologjisë' dhe 'Fundin e Historisë'. Duke qenë se Shqipëria merret si rast studimor ajo që synohet është eksplorimi i ekuacioneve të ndryshme në lidhje me rastin duke vlerësuar ndërveprimin midis variablave të lidhur me politikën dhe ideologjinë. Një qëllim tjetër mjaft i rëndësishëm është ai i eksplorimit të lidhjes midis

procesit të Integritit European dhe Globalizimit në raport me politikat e majta e të djathta në nivel kombëtar duke ofruar përgjigje specifike për politikën Shqiptare. Së fundi, synohet të bëhen përgjithësime në masën që e lejon veçanësia e rastit studimor.

Për më tepër, duke u nisur si nga kuadri teorik i marrë në konsideratë, por gjithashtu edhe nga rasti studimor konkret që shqyrtohet në këtë studim, ajo që propozoj janë tetë 'shtresa' analize për t'i dhënë një kornizë të qëndrueshme punimit. Këto shtresa analize janë:

- Dimensioni i partive politike
- Programet politike në lidhje me politikat publike/Dekomunistizimi
- Roli i elitave
- Ndikimi ndërkombëtar
- Dimensioni i shoqërisë civile
- Personalizimi i politikës
- Niveli i i diskursit politik
- Nivelet e populizmit

Duhet theksuar se për të realizuar punimin synohet jo vetëm një qasje thjeshtë bazuar në teoritë ekzistuese, por gjithashtu synohet edhe një kontekstualizim nëpërmjet veçanësisë së rastit studimor të zbërthyer në shtresat përkatëse të analizës.



## **2. Kapitulli II: Modeli analitik i tezës dhe Skeleti teorik**

### **2.1.1 Modeli analitik i tezës/ Metodologjia**

Në këtë kapitull/seksion lexuesi njihet me mënyrën se si është realizuar studimi, me elementët/komponentët specifike dhe me mënyrën e kombinimit të këtyre elementëve për të përftuar rezultatet e kërkimit. Në vijim është paraqitur plani i studimit; ku, kur e si është marrë dhe trajtuar informacioni i nevojshëm; përshkruhet metoda e mbledhjes së të dhënave; problemet dhe kufizimet e ndryshme; etj.

Ky studim kalon në disa faza specifike. Në fazën e parë bëhet një shqyrtim i literaturës. Rishikimi i literaturës ka për qëllim njohjen me studimet e tjera në këtë fushë, duke parë edhe nivelin e përputhshmërisë së studimit me studimet ekzistuese. Në këtë fazë, puna është e përqendruar në përmbledhjen e gjetjeve kryesore dhe sugjerimeve të vlefshme të kërkimeve ekzistuese të cilat lidhen drejtpërsëdrejti me objektivat kërkimore të këtij studimi specifik. Shqyrtimi i literaturës shërben për të analizuar kornizat teorike të studimeve të mëparshme, të cilat ofrojnë informacione të rëndësishme në lidhje me tezën.

Në përfundim të rishikimit të literaturës, studimi kalon në fazën e tij të dytë gjatë së cilës konkretizohet qëllimi për përmbushjen e analizës, si dhe qartësohen objektivat kërkimore të studimit. Në fazën e tretë, pasi analizohet informacioni i marrë në fazat e mëparshme dhe duke u nisur nga pyetjet kërkimore që janë ngritur, realizohet analiza e rastit studimor nëpërmjet metodës cilësore të studimit.

Kështu, është përzgjedhur metoda e rishikimit të literaturës, analiza e diskursit, analiza e të dhënave parësore e dytësore si dhe metoda cilësore, konkretizuar përmes rastit studimor.

Shumë studiues kanë paraqitur arsytetime të ndryshme se çfarë përbën shkencë dhe çfarë përbën morinë e besimeve, shpeshherë edhe absurde. Pikërisht, ky është një nga problemet që duhet tejkaluar në lidhje me studimet mbi ideologjinë në Shqipëri. Duhet të bëhet i qartë demarkacioni i dijes dhe analizës shkencore dhe duhet minimizuar përqendrimi në besime popullore të paprovuara për atë sa shkencat sociale na lejojnë të vënë e dukurive sociale në hullinë e shkencës. Vlera konjitive e një teorie nuk ka të bëjë mirëfilli me ndikimin e përgjithshëm që besimet e masës kanë mbi çështjen. Në fakt ky punim synon të qartësojë mjegullimin shumëvjeçar që ekziston mbi diskutimin mbi ideologjinë si një bosht qendror i politikës, në kohë të ndryshme për arsye të ndryshme.

Përveç kërkimit shkencor teorik të bazuar në literaturë, strategjia e punës kërkimore për këtë studim lidhet me analizimin e të dhënave me baza më empirike si të dhëna ndërsektorale, dokumente zyrtare, qeveritare, programe partiake dhe qeveritare, platforma të grupeve të interesit si dhe vlerësime ndërkombëtare në lidhje me çështjet politike në Shqipëri. Shpesh vihen pikëpyetje mbi dallimin mes punës kërkimore empirike dhe asaj konceptuale teorike por duke qenë ky një punim ekstensiv, shihet i nevojshëm kombinimi i konceptuales dhe empirikes së bashku në një studim. Pra, të dhëna parësore në kuadër të

‘empirikes’ shtuar shqyrtimit metodologjik të këndeve të ndryshme teorike do të udhëheqin studimin. Gjithsesi do të ketë një kufizim në analizë kualitative përballë analizës kuantitative.

Në funksion të studimit që shqyrton gjendjen e *De-ideologjizimit* në Shqipëri, siç u theksua, analiza do të mbështet në shqyrtimin e një sërë dokumentash e burimesh parësore ku më konkretisht në kuadër ideologjik do të shqyrtohen programi politik i Qeverisë Socialiste të kryesuar nga Fatos Nano gjatë viteve 2002-2005 dhe programi i Qeverisë Demokratike i vitit 2005, të marrë në konsideratë si dy programe në pikun e tranzicionit demokratik (pas tejkalimit të krizave të viteve ’90), e që përbëjnë pika rëndese në studim.

Në këte mënyrë analizohet pozicionimi ideologjik i demokratëve (të djathë) dhe socialistëve (të majtë) në lidhje me ‘ofertën’ e tyre për të qeverisur, ku praktikisht gjatë hulumtimit, shqyrtohen njëherazi konceptime dhe zgjidhje të pastra teknike e pragmatike, ku linjat e ndarjes mes të majtës dhe të djathtës nuk janë të dukshme, ku ka kontroversialitet ideologjik ku ‘e majta’ mendon e vepron djathtas ndërsa ‘e djathta’, majtas dhe gjithashtu vihet re një konvergjencë ideologjike e cila në fakt nuk paraqitet në trajtën e konsensusit të palëve. Ky informacion në formë të dhënash që rrjedhin nga burime të shumëfishta, por në mënyrë më konkrete/të drejtpërdrejtë nga programet e shqyrtuara, mbështet hipotezën e studimit.

Qasja e bazuar tek burimet dytësore do të arrihet nëpërmjet teknikave të tilla si analizimi dhe vlerësimi i qasjeve ekzistuese mbi çështjen nëpërmjet rishikimit dhe shqyrtimit të literaturës ekzistuese në kontekstin teorik dhe me vlerën praktike të saj; duke përfshirë studime, analiza, raporte dhe vlerësime nga studiuesit më të rëndësishëm në vend. Më tej vijohet me ndërtimin e argumentave koherente të lidhura me hipotezën kryesore, duke shtuar arritjen në rezultate të analizës nëpërmjet përmbledhjes e sintezës si dhe duke vijëzuar konkluzione. Analiza e të dhënave dytësore konsiston veçanërisht në shqyrtimin e *fakteve* që ilustronë e mbështesin tezën.

Qasja ndaj rastit studimor përkon me specifika të veçanta duke qenë se analiza kryesore e punimit lidhet me rastin e Shqipërisë. Ashtu siç theksohet nga George dhe Benett ‘vijëzimi i kërkimit shkencor nëpërmjet rasteve studimore përbën një përpjekje për ta përafuar studimin me saktësinë e punës kuantitative dhe modeleve formale dhe përbën gjithashtu përpjekje për zhvillimin e tipologjive’ (Benett dhe George 2005, f. 130).

Rastet studimore heuristike, në mënyrë induktive identifikojnë variablat e reja, mekanizmat e ndryshëm ndërveprues si dhe shtigjet sipas rastit. Rastet devijante, deri në një farë mase si rasti që kam zgjedhur të shqyrtoj në këtë punim, nuk janë në të njëjtën linjë me atë çka teoritë tradicionale paraprijnë. Kjo në vetvete i jep trajta konfigurative dhe *ideografike*, gjë që ndikon në ndërtimin teorik duke u dhënë elementeve të studimit formën e ‘bllloqeve ndërtuese’. Këto ‘bllloqe

ndërtuese' janë të nevojshme për testimin e hipotezës dhe shërbejnë si shtigje drejt teorizimit. Sidoqoftë, rasti nuk mund të konsiderohet endemik, duke patur parasysh natyrën dhe paralelet e zhvillimeve politike në vendet fqinjë të Shqipërisë.

Pika e fortë e një rasti studimor është se mund të merret një shembull i një fenomeni dhe duke përdorur metoda të shumëfishta mund të hulumtohet dhe eksplorohet. Rasti studimor është i veçantë, përshkrues dhe induktiv për të përgjithshmen. Pika e dobët e një rasti studimor është ajo e përgjithësimin të gjetjeve. Gjithsesi gjetjet mund të vijëzohjnë analogji me dinamika apo raste të tjera që përshkohen nga i njëjti proces.

Analiza e diskursit do të jetë gjithashtu pjesë e rëndësishme e studimit. Në kuadër të shkencave politike duhet theksuar se politika, ideologjia dhe diskursi janë fortësisht të lidhura midis tyre. Politika është një nga sferat, praktikave të cilës janë thellësisht diskursive. Konjicioni politik bazohet tek ideologjia dhe ideologjitë politike riprodhohen nga diskursi.

Në të vërtetë, ideologjitë politike jo vetëm që janë të përfshira në prodhimin ose të kuptuarit e diskurseve politike dhe praktikave të tjera politike, por janë edhe të (ri)prodhuara prej tyre. Në një farë mënyre diskurset i bëjnë ideologjitë të 'vrojtueshme' në kuptimin që vetëm nëpërmjet ligjëritimit ato mund të shprehen dhe formulohen. Kështu, është kryesisht përmes diskursit që ideologjitë politike përftohen, shprehen, mësohen dhe kontestohen.

Marrëdhëniet midis diskursit dhe ideologjive politike janë studiuar zakonisht në terma të strukturave të diskursit politik, të tilla si përdorimi i termave ‘të anshme’ leksikore, struktura sintaksore aktive dhe pasive, përemra të tillë si ne dhe ata, metafora, argumente, implikime dhe të dhëna të tjera të diskursit. Duhet theksuar se diskursi duhet të konceptohet edhe në aspektin e strukturave të konteksteve përkatëse (Duranti dhe Goodwin, 1992). Modele të caktuara mendore përcaktojnë se si pjesëmarrësit në një situatë përjetojnë, interpretojnë dhe përfaqësojnë aspektet e situatës politike. Këto modele të veçanta mendore quhen kontekste. Me fjalë të tjera, kontekstet janë përkufizimet subjektive të pjesëmarrësve në lidhje me situatat komunikative. Kontekstet kontrollojnë aspektet e prodhimit dhe të kuptuarit të diskursit. Kështu, diskursi politik nuk përkufizohet vetëm në terma të strukturave të diskursit, por edhe në aspektin e konteksteve politike. Aktorët politikë natyrisht që nuk marrin pjesë në mënyrë të pavetëdijshme në situata politike të caktuara por në fakt ato ndajnë njohuritë politike dhe vlerat kulturore, si dhe ideologjitë politike përkatëse. Në të vërtetë, është nëpërmjet kësaj forme të kontekstualizimit që ne jemi në gjendje të lidhim ideologjitë e pjesëmarrësve me diskurset e tyre (Gumperz, 1982). Qendror për diskutimin në këtë rast është edhe fakti se është veçanërisht ideologjia politike e pjesëmarrësve në diskutim e cila jo vetëm kontrollon shumë prej asaj çka thonë diskutuesit, por gjithashtu ndikon edhe në mënyrën se si ata kuptojnë folësit e tjerë.

Një analizë më e hollësishme e strukturave të diskursit jo/ideologjik do të shqyrtohet nëpërmjet kategorive konkrete.

*Përshkrimi i Aktorëve.* Mënyra se si aktorët përshkruhen në ligjërime të ndryshme varet edhe nga ideologjitë. Zakonisht ne priremi që të përshkruajmë anëtarë të grupit tonë në një mënyrë neutrale ose pozitive, dhe anëtarët e grupeve të tjera në një mënyrë negative.

*Autoriteti.* Shumë folës në diskutime të ndryshme, si p.sh në parlament, përdorin thirrjen ndaj autoriteteve për të mbështetur rastin e tyre, autoritete këto të cilat zakonisht janë organizata apo njerëz që qëndrojnë më lart politikës partiake, apo të cilët janë të njohur përgjithësisht si ekspertë ose liderë moralë.

*Kategorizimi.* Siç dihet nga psikologjia sociale, njerëzit kanë tendencë për të kategorizuar njerëzit. Kjo ndodh sidomos kur bëhet fjalë për kundërshtarët politikë.

*Mbështetja në evidenca.* Pretendimet apo qëndrimet e shprehura me anë të argumentit janë më të besueshme kur folësit paraqesin disa prova ose dëshmi për njohuritë ose opinionet e tyre. Kjo mund të ndodhë nga përdorimi i referencave dhe shifrave të autoriteteve apo institucioneve, ose nga forma të ndryshme të qartësimit si dhe ku merret informacioni.

*Shembull/Ilustrim.* Një veprim që fuqizon argumentimin është dhënia e shembujve konkrete, shpesh në formën e një historie të shkurtër. Ilustrimet e bëjnë më të mundur krijimin e pikave të përgjithshme me të cilat mbrohen folësit. Tregimet konkrete zakonisht memorizohen më mirë se sa argumentet abstrakte

dhe kanë më shumë ndikim emocional, kështu që ata që argumentojnë me anë të shembujve dhe ilustrimeve krijojnë atmosfere më bindëse.

*Përgjithësim.* Në vend që të tregohen histori konkrete, folësit mund të bëjnë përgjithësime. Në mënyrë të ngjashme, në lidhje me strategjitë populiste, folësit mund ta përdorin shpesh këtë teknikë.

*Hiperbola.* Hiperbolat janë mjete semantike retorike për rritjen e kuptimit. Ndonjëherë forma të hiperbolës janë të shoqëruara nga përdorimi i metaforave të veçanta.

*Implikimi.* Për shumë arsye pragmatike e kontekstuale, folësit nuk duhet të thonë gjithçka që ata dinë apo besojnë. Në të vërtetë, një pjesë e madhe e diskursit mbetet i nënkuptuar, dhe informacione të tilla të nënkuptuara mund të nxirren nga dëgjuesit nëpërmjet njohurive që ndahen me grupin apo qëndrimeve të përbashkëta duke qenë kështu pjesë e modeleve të tyre mendore në lidhje me ngjarjet ose veprimet e përfaqësuara në diskurs.

*Metafora.* Metaforat janë abstrakte, komplekse, të panjohura, të reja apo emocionale dhe shërbejnë për të sjellë informacion, i cili më pas mund të bëhet më i njohur dhe më konkret.

*Paqartësia.* Praktikisht në të gjitha kontekstet, folësit mund të përdorin shprehje të mjegullta të cilat tregojnë se ata nuk kanë referenca të mirëpërcaktuara.



Përcaktime të paqarta si 'pak', 'shumë' dhe mbiemra si 'i ulët', 'i lartë', mund të jenë shprehje tipike në diskursin me tipare të papërcaktuara.

Kategoritë kornizë dhe shembujt e treguar më lart nuk janë shterrues por shërbejnë si model apo si konturim për përkufizimin e veçorive të diskursit për analizën që ndërmerr ky punim.

Duhet qartësuar se fokusi *postmodern* në pushtetin e gjuhës/diskursit në një farë mënyre zbeh fokusin e dhunës/shtypjes/balancave në kuptim esencial në jetën reale, në jetën e përditshme. Është e nevojshme të theksohet se jo vetëm 'dhuna/pushteti' i gjuhës është i rëndësishëm. Mund të harxhohet shumë kohë duke trajtuar çështjet e relativizimit të gjuhës e duke shqyrtuar pushtetin, historinë dhe ideologjinë në këtë kontekst, por në fakt duhet patur kujdes që të mos kthejmë pretendimet për *të vërtetën* dhe vetë konceptet specifike në *shënues bosh*. Relativizmi themelor është një nga sfidat e postmodernizmit dhe në kuadër të kësaj analize, kjo sfidë merr trajtesë specifike duke parashtruar përpjekjen që termat të mos shtrihen/bashkështrihen deri sa të humbin përcaktimin e të zbrazen prej forcës së tyre.

### **2.1.2 Kufizimet kryesore të studimit**

Ky punim doktore do të synojë të sjellë një kornizë analitike specifike në mënyrë që të hedhë dritë mbi zhvillimet politike kaotike në Shqipëri të cilat rrjedhin nga raportet e komplikua të politikës me ideologjinë. Sidoqoftë

kufizimet janë të larmishme. Një nga më kryesoret është stadi apo periudha kohore që do analizohet. Kështu, periudha e regjimit komunist nuk do të jetë fokusi i drejtpërdrejtë i punimit por do të merret në konsideratë për aq sa mund t'i shërbejë ndërtimit të argumentave mbi zhvillimet më aktuale. E njëta logjikë vlen edhe për periudhën parakomuniste. Pra, siç u theksua që në parathënie, kufizimi do të jetë në kohë; -pas regjimit diktatorial me disa pika rëndese kryesisht pas vitit 2000 ku politika shqiptare nis të jetë më e stabilizuar nga ngjarjet e lidhura me kriza specifike -deri rreth vitit 2012 (pa përfshirë zhvillimet politike të vitit zgjedhor 2013 si nevojë për reflektim objektiv të cilin e lehtëson distanca kohore) dhe në hapësirë; -në Shqipëri duke qenë se nuk synon të prodhojë përgjigje përfundimtare për çdo çështje të veçantë që mund të ketë lidhje direkte apo indirekte me ideologjinë. Çdo element i kërkimit cilësor ka pikat e veta të forta por edhe ato të dobëta. Kjo në fakt, varet nga qëllimet fillestare. Një kritikë të cilës përpiqem t'i paraprij në këtë pikë është se rezultatet e studimit mund të mos jenë të përgjithësueshme në rang të gjerë totalizues. Gjithsesi kjo sqarohet me paraqitjen e objektivave kërkimore të cilët i japin trajtë studimit duke mos ia lënë rrugëtimin rastësisë.

### **2.1.3 Hipoteza Kryesore**

Qëllimi i këtij studimi është të shqyrtojë lidhjen e politikës shqiptare me ideologjinë dhe më tej të argumentojë se pavarësisht procesit të *deideologjizimit* që ka ndodhur në vend, *politika* është e lidhur '*organikisht*' apo pashmangshmërisht

me *ideologjinë*, në një konceptim neutral të ideologjisë në rrethanat e zhveshjes së konceptit nga konotacionet pezhorative. Kështu, për aq kohë sa ajo që konsiderohet si politike, do të lidhet me mosmarrëveshjet dhe konsensusin mbi vlerat e ndryshme, do të duhet t'u bëjë referencë ideologjive në mënyrë që të përballlet me çfarë është e mirë apo e keqe, e dëshirueshme apo më pak e dëshirueshme, produktive apo më pak produktive e kështu me radhë. Edhe nëse gjendet marrëveshje për të njëjtën përmbajtje/natyre të politikave apo të politikës, debatet në lidhje me '*hierarkinë*' e vlerave do të jenë gjithnjë prezente. Për më tepër, në Shqipëri pavarësisht trajtave të ndryshme të deklaratave për fundin e ideologjisë kryesisht me prejardhje nga sfera e real politikës, ajo që synoj të sqaroj është se nuk kemi të bëjmë me fund të ideologjisë sepse debatet mbi lirinë, barazinë, obligimet politike, drejtësinë dhe moralitetin politik janë dhe do të jenë gjithnjë të pranishme (janë të pashterueshme). Në qoftë se nuk shihen qartësisht orientimet ideologjike atëherë kjo nuk do të thotë që kemi të bëjmë me fundin e ideologjisë. Në fakt, përmbushja e funksioneve të ideologjive do të shërbente si rregullator i politikës në vend. Fenomeni që analizohet në rastin studimor është fenomeni i *De-Ideologjizimit* sipas të cilit e majta nuk artikulon/ndjek politika të majta dhe e djathta nuk artikulon/ndjek politika të djathta, duke i dhënë sistemit një natyrë inkoherente e inkonsistente.

#### **2.1.4 Objektiva dhe Qëllime:**

Në kuadër të përcaktimit të modelit analitik të tezës, e rëndësishme është të theksohen objektivat specifike të lidhura me studimin. Disa nga objektivat

kryesore si dhe qëllimet që përkojnë me kapitujt përkatës si dhe nën-ndarjet specifike për secilin kapitull janë: Së pari, të shpjegohet qasja ndaj politikës dhe ideologjisë dhe të operacionalizohen konceptet. Së dyti, të shpjegohet klasifikimi i spektrit ideologjik të politikës. Së treti, të eksplorohet dhe shpjegohen deklaratat për ‘Fundin e Ideologjisë’ dhe ‘Fundin e Historisë’. Së katërti, të eksplorohen ekuacionet e ndryshme në lidhje me rastin studimor; – Shqipëria si rast studimor. Së pesti, të vlerësohet ndërveprimi midis variablave të lidhur me politikën dhe ideologjinë. Së gjashti, të ofrohen përgjigje specifike për politikën Shqiptare dhe së fundi, të bëhen përgjithësime në masën që e lejon veçanësia e rastit studimor.

Përmbledhtazi, pra mund të thuhet se ky punim synon të qartësojë mjegullimin që ekziston mbi ideologjinë duke e zhveshur nga konotacionet pezhorative, synon të sjellë një kornizë të qëndrueshme analitike për rastin studimor si dhe sugjeron se orientimi në boshtin ideologjik prodhon ‘politikë frytdhënëse’, qasja për të cilën operacionalizohet e shpjegohet gjatë analizës së rastit konkret.

## **2.2 Skeleti teorik: Ideologjia dhe Politika**

### **2.2.1 Politika**

Vite më parë Harold Lasswell publikoi: ‘Politika, kush merr çfarë, kur, si?’. Ky titull përfshin një të vërtetë të rëndësishme në politikë, duke qenë se tregon se politika lidhet me fitim dhe humbje, me të fituar dhe të humbur. Asnjë sistem politik, sado demokratik qoftë, nuk mund të sigurojë gjithçka për çdokënd, kështuqë politika favorizon disa më tepër se disa të tjerë. Kjo është kaq e

rëndësishme saqë një subjekt themelor i shkencave politike është të zbulojë e të studiojë se cilat grupe përfitojnë më shumë e cilat më pak si dhe arsyet e kësaj dinamike. Përpyekjet për të analizuar politikën dhe rrjedhojat e politikës kanë marrë trajta të ndryshme. Sipas një sinteze të Heywood, politika mund të shihet nga katër kënde të ndryshme: **a.** Politika si art i qeverisjes **b.** Politika si çështje publike **c.** Politika si kompromis dhe konsensus **d.** Politika si fuqi.

Në një sens më të përgjithshëm politika mund të kuptohet si aktiviteti me anë të të cilit njerëzit vendosin rregullat që bëjnë të mundur jetesën e tyre. Përveç vlerës reale në praktikë, politika përbën edhe një subjekt akademik studimi dhe sigurisht që ka në qendër studimin e aktiviteteve të sipërpërmendura të konfliktit dhe bashkëpunimit. Pra, politika është e lidhur me elementin e konfliktit dhe elementin e bashkëpunimit, me opinione dhe synime konkurruese, me nevoja dhe dëshira që mbivendosen. Kjo i bën njerëzit të kuptojnë se duhet të konkurojnë brenda një sistemi të caktuar në mënyrë që të sigurohen prioritetet e tyre. Politika është një term i sofistikuar dhe mbart një ngarkesë të madhe në shumë dimensione. Politika mund të shihet edhe si ushtrimi i fuqisë dhe autoritetit, ndërmarrja e vendimeve kolektive, procesi i alokimit të burimeve e madje, në mënyrë të rëndomtë, edhe si një praktikë manipulimi.

“Sipas Kancelarit Gjerman, Bismark, politika nuk është shkencë por është art. Me art Bismark-u kishte në mendje artin e qeverisjes, ushtrimin e kontrollit në shoqëri

me anë të realizimit dhe përforcimit të vendimeve kolektive” (Heywood, 2005, f. 5).

Shpeshherë, nocioni i politikës lidhet me nocionin e qeverisjes dhe tendenca e studiuesve është që të fokusohen tek makineria qeverisëse. Për shumë akademikë, të studiosh politikën do të thotë të analizosh makinerinë qeverisëse. Në mënyrë më të zgjeruar nga kjo pikëpamje studimi i politikës mund të konsiderohet edhe si një analizë e ushtrimit të autoritetit. ‘Ky këndvështrim u mpreh nga studiuesi David Easton (1979, 1981), i cili e përkufizoi politikën si ‘shpërndarje autoritare të vlerave’. Me këtë ai nënkuptonte që politika përfshin procese të ndryshme me anë të të cilave qeveria i përgjigjet presionit të shoqërisë. Kjo ndodh duke shpërndarë shpërblime ose ndëshkime. ‘Vlerat autoritare’ janë të pranuar gjërisht në shoqëri dhe konsiderohen të detyrueshme për masën’ (marrë nga Heywood, 2005, f. 7).

Ashtu siç shprehej Aristoteli tek ‘Politika’, njeriu mund të konsiderohet si një ‘kafshë politike’ çka do të thotë se ‘jeta e mirë’ është e mundur vetëm brenda komunitetit politik. Kjo i jep një përmasë etike politikës. Ky dimension etik ndan teoricienët e ndryshëm në lidhje me përmasat e shtetit dhe të shoqërisë civile. Ka këndvështrime të ndryshme në lidhje me atë çka konsiderohet sferë private, liri individuale, zgjedhje personale dhe atë çka rregullohet nga makineria qeverisëse. Politika shihet veçanërisht si mjete për të zgjidhur konfliktet me anë të

kompromisit, konsensusit, pajtimit dhe negociatave përkundrejt forcës apo dhunës së zhveshur. Këto këndvështrime kanë karakter pozitivist, larg zgjidhjeve utopike.

Në një kuptim më të përgjithshëm, politika lidhet me prodhimin, shpërndarjen dhe përdorimin e burimeve në shtrirjen e ekzistencës sociale. Nga një këndvështrim tjetër Makiavelist, në thelb politika mund të shihet si aftësia për të arritur qëllimet e dëshiruara me të gjitha mjetet e mundshme. Gjithsesi, ky përkufizim i humb trajtat dhe ndarjet midis personale dhe publike apo të veçantës dhe të përgjithshmes. Përkufizimi është i tillë që humb trajtat e nocionit në përgjithësim duke shërbyer si shënues bosh.

Marksistët e kanë përdorur termin ‘Politikë’ në dy kuptime. Nga njëra anë u referohen aparaturave të shtetit. Marksi i referohet pushtetit politik si ‘pushteti i organizuar i një klase për të shtypur një klasë tjetër’. Politika është pjesë e ‘Superstrukturës’ që dallon nga ‘Baza’ ekonomike që është themeli i vërtetë i jetës sociale. Sidoqoftë Baza Ekonomike dhe Superstruktura politike nuk janë totalisht të ndara sipas Marksit. Në një nivel më të thellë, pushteti politik është i rrënjosur në sistemin klasor dhe në një farë kuptimi ‘ajo që është ekonomike është politike’, pra politika është një formë e përqëndruar e ekonomisë. Kështu lufta e klasave është thelbi i politikës.

Studiuesit pluralistë argumentojnë se sidoqoftë nuk është e thënë se duhet të ketë një konsensus për vlerat në shoqëri. Me zgjerimin e shoqërive të ndryshme diferencimi bëhet më i dukshëm. Kjo qëndron në terma interesash shoqërore

specifikë për çdo grup, të cilat avancojnë në konkurim me njëri tjetrin. Ka shumë lloje diferencimesh/dallimesh grupore në një shoqëri. Të tilla janë mosha, gjinia, etnia, klasa, feja, etj dhe asnjëra nuk mund të dominojë e vetme jetën shoqërore. Kështu pluralistët nuk e pranojnë pikëpamjen marksiste se klasa është diferencimi dominant në shoqëri. Shoqëritë mobilizojnë resurse të ndryshme e të shumëfishta në mënyrë që të arrijnë qëllimet e tyre dhe fuqia nënkupton kapacitetin për mobilizimin e resurseve. Mobilizimi i këtyre resurseve çon në arritjen e qëllimeve të caktuara të cilat mund të sjellin zhvillim të shoqërisë. Gjithsesi, disa grupe mund të jenë më të fuqishme se disa grupe të tjera dhe kjo nuk është detyrimisht negative.

Sipas pikëpamjeve funksionaliste të Talcott Parsons: a. Realizimi i qëllimeve të përbashkëta krijon nevojën e bashkëpunimit b. Bashkëpunimi krijon nevojën e organizimit c. Organizimi krijon nevojën e komandimit apo udhëheqjes dhe d. Aftësia për të udhëhequr kërkon fuqi.

Në lidhje me udhëheqjen politike detyrimisht na duhet të konceptualizojmë njëkohësisht termin qeveri ashtu si dhe atë të qeverisjes. Në studimin e politikës duhet bërë dallimi mes dy kuptimeve të gjera të konceptit të qeverisjes. Kuptimi i parë i referohet qeverisjes si përshtatje e shtetit ndaj mjedisit të jashtëm sipas modelit të fundit shekullit XX. Nga kjo perspektivë, qeverisja mund të konsiderohet si një proces ku aktorët publikë dhe privatë angazhohen në rregullimin e qëllimshëm të marrëdhënieve dhe konflikteve shoqërore. ‘Kështu



qeverisja është e ndryshme nga qeveria, kjo e fundit duke theksuar strukturat hierarkike të vendim-marrjes dhe rëndësinë e aktorëve publik, ndërsa tjetra nënkupton pjesëmarrjen e aktorëve publikë dhe privatë ashtu si dhe format jo-hierarkike të vendim-marrjes. Kuptimi i dytë i referohet qeverisjes si ‘përfaqësim konceptual ose teorik i bashkërendimit të sistemeve sociale’ (Marks dhe Hooge, 2001).

### **2.2.2. Ideologjia: ‘Gjenealogjia e konceptit’, përkufizime të ndryshme dhe funksionet e saj**

Ky studim do t’i referohet momentit të ndarjes midis heshtjes mbi ideologjinë dhe momentit kur fillojnë artikulet mbi të. Pra, në një aspekt të përgjithshëm nuk do të përpiqem të nxerr në dritë rrënjët e ideologjisë, por në mënyrë instrumentale në funksion të këtij studimi do përpiqem të bëj një gjenealogji të konceptit.

Termi ideologji është krijuar nga mendimtari francez Claude Destutt De Tracy në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Sipas tij ideologjia ishte shkencë e ideve dhe e origjinës së tyre. De Tracy besonte se është e mundur të zbulohet objektivisht prejardhja e ideve dhe se kjo shkencë e ideve do të gëzonte të njëjtën saktësi dhe status si shkencat natyrore. Ideologjia sot nuk nënkupton shkencën e ideve por vetë idetë dhe për më tepër ide të një lloji të veçantë. Ideologjitë janë ide, qëllimi i të cilave nuk është epistemik por politik.

Më tej, ideologjia si term kyç politik rrjedh nga shkrimet e Karl Marksit. Përdorimi që i bëri Marksi termit ideologji, si dhe interesi i neomarksistëve dhe postmarksistëve mbi këtë përdorim në një farë mase shpjegon ‘famën’ që ideologjia gëzon në jetën politike dhe sociale në ditët e sotme. Koncepti i Marksit për ideologjinë ka një sërë karakteristikash. Së pari, ideologjia lidhet me zhgënjim dhe keqfunksionim duke trajtësuar një imazh të gabuar për botën. Këtë Engelsi e quajti më vonë ‘ndërgjegje të rreme’. Idetë e veta Marksi i konsideronte shkencore, sepse ishin projektuar për të zbuluar ligjet e historisë dhe ato të funksionimit të shoqërisë. Për Marksit dallimi midis ideologjisë dhe shkencës, midis të vërtetave dhe të pavërtetave është thelbësor. Së dyti, ideologjia lidhet me sistemin e klasave ku ideologjia shërben për legjitimimin e sundimit ndaj klasës së shtypur. Së treti, ideologjia është një manifestim fuqie. Ideologjia përbën idetë sunduese të epokës. Sipas Marksit, klasa e proletariatit, nuk ka nevojë për ideologjinë, sepse është klasë që nuk ka nevojë për iluzione.

Nëse duam të kuptojmë themelet sociale të mendimit, sipas Karl Mannheim-it, duhet të merremi me ideologjinë. Gjithsesi Mannheim e përdor konceptin ndryshe nga kuptimi që ky term merr pas Luftës së Dytë Botërore. Mannheim dallon dy lloje ideologjish: ‘Të veçanta’ dhe ‘Totale’ si dhe bën gjithashtu dallimin midis Ideologjisë dhe Utopisë.

Ideologjitë në kuptimin ‘Të veçanta’ përfaqësojnë mënyrën se si individët ‘ngjyrosin botën’ sipas pikëpamjeve dhe interesave të tyre. Në kuptimin ‘Totale’

idologjitë shihen si kategori mendimi që përfshijnë gjithçka ne shohim dhe interpretojmë. Pra, ideologjitë mund të konsiderohen si një palë syze që na transformojnë në mënyrë sistematike perceptimin për botën që na rrethon. Mannheim kritikon idenë e ideologjisë si ndërgjegje e rreme duke qenë se nuk duhet të ketë fokusim tek veçanësitë e ideologjisë klasore si version thjeshtëzues konceptimi, por fokusimi duhet të jetë tek aspekti i totalës. Mannheim ndryshon në disa pika nga Marksi. Kështu Mannheim u përpoq ta pastrojë ideologjinë nga konotacionet dhe ngarkesa negative. Sidoqoftë, ai pohon se sistemet idologjike, duke përfshirë këtu dhe utopitë janë të deformuara, duke qenë se përfaqësojnë pikëpamje të anshme të realiteteve sociale.

Sipas Mannheim një gjendje është utopike kur a.) është inkongruente me situatën imediate dhe b.) kur kalohet në veprim ka tendencën të shkatërrojë rregullin e gjërave (Mannheim, 1991, f. 341).

Përdorimi i konceptit *ideologji* u ndikua shumë nga periudha e dy luftërave botërore si dhe nga ngritja e tensioneve gjatë periudhës së luftës së ftohtë. Fashizmi, Nazizmi dhe Stalinizmi Rus shërbyen si sisteme shtypëse sundimi duke theksuar rolin e idologjive të sanksionuara në mënyrë zyrtare, në mënyrë që të promovohet bindja tek masat. Gjithsesi autorë të tillë si Karl Popper apo Hannah Arendt si dhe disa autorë të '*Fundologjisë*' e përdorën termin në mënyrë me të spastruar e të pangarkuar me etiketat e rënduara nga komunizmi dhe fashizmi. Sipas tyre, ideologjitë janë sisteme të mbyllura mendimi që zotërojnë monopolin e

të vërtetës dhe në një farë sensi mund të konsiderohen si fe shekulare me karakter totalizues. Duke qenë të tilla shërbejnë si mjet për kontrollin social. Gjithsesi sipas Poperit jo të gjitha ideologjitë kanë të njëjtën natyrë. Kështu liberalizmi ka themele që janë të bazuara tek toleranca dhe diversiteti gjë që e bën atë një sistem të hapur mendimi (Popper, 2002, f. 38).

Më tej, sipas Wright (Wright, 1999) ideologjia shihet së pari si mendim politik, së dyti ideologjia shihet si sistem besimi dhe norma, së treti ideologjia konceptohet si gjuhë, simbole dhe mite dhe së fundi ideologjia si fuqi e elitave.

Daniel Bell, sociologu amerikan autor i librit “Fundi i ideologjisë” e cilëson ideologjinë si një sistem besimesh të orientuar nga veprimet dhe fakti që ideologjia është e orientuar nga veprimet tregon që roli i saj nuk është ta bëjë realitetin transparent, por të motivojë njerëzit të bëjnë ose të mos bëjnë veprime të caktuara.

Një ideologji politike është një përmbledhje e organizuar e koherente idesh, principesh etike apo doktrinë e një lëvizjeje shoqërore, grupi të gjerë apo partie politike që shpjegon se si duhet të funksionojë shoqëria dhe ofron një projekt për një rregull të caktuar shoqëror.

Ideologjitë politike kanë dy dimensione, qëllimet që shprehin se si shoqëria duhet të funksionojë dhe metoda që shpreh mënyrat më të përshtatshme për të arritur idealet e përcaktuara për çështje të ndryshme të tilla si ekonomia, edukimi,

kujdesi shëndetësor, kodi i punës, sistemi i drejtësisë, siguria sociale, mirëqenia shoqërore, tregtia, emigrimi, ambjenti, feja etj.

Për të kuptuar rolin që ideologjitë luajnë në jetën politike ndihmon një qasje sipas funksioneve të tyre. Ideologjitë kanë kryesisht katër funksione. Funkzioni shpjegues i cili bën një analizë apo shpjegim të realitetit, funksioni vlerësues që shërben për të ofruar standarte për vlerësimin e shoqërisë, funksioni orientues që u jep mundësi njerëzve për të gjetur vendin e tyre në shoqëri dhe së fundi funksioni programatik duke qenë se japin një program për çfarë dhe si duhet të veprojnë.

Ndërsa sipas Michael Freedon (2003, f. 19), ‘një ideologji politike është një grup idesh, besimesh, opinionesh dhe vlerash që:

1. Shfaqin një model të përsëritur
2. Mbahen nga grupe të rëndësishme
3. Konkurojnë për të siguruar plane dhe kontrolluar politikat publike
4. E bëjnë këtë me qëllim për të justifikuar, kundërshtuar ose ndryshuar proceset dhe rregullimin social e politik të një komuniteti politik’.

Për ta qartësuar përkufizimin, kërkesa për shfaqjen e një modeli të përsëritur është mjaft e rëndësishme politikisht. Kjo tregon se bëhet fjalë për tradita të qëndrueshme dhe jo për skema idiosinkretike të momentit. Fakti që mbahen nga grupe të rëndësishme nuk do të thotë që duhet të lindësh aristokrat për t’u garantuar ideve një podium, por pohimi lidhet me grupet e intelektualëve si dhe

me grupet e reja që kanë hyrë në lojë të cilat janë në gjendje të influencojnë nëpërmjet medias apo të shërbejnë si *'spin doctors'* dhe të zotërojnë potencial për të prodhuar e modeluar ideologji. Kërkesa për të kontrolluar politikat publike lidhet drejtpërdrejt me faktin që kemi të bëjmë me ideologji politike. Ideologjitë janë në konkurim për konfigurimin e makroprogrameve si p.sh. të programeve të partive në lidhje me politikat sociale e ekonomike dhe për administrim efektiv. Jo çdo grup planesh është ideologji, por gjithsesi ato mund të interpretohen si një pjesë e një ideologjie. Së fundi qëllimi për të justifikuar, kundërshtuar apo ndryshuar proceset dhe rregullimin social-politik të një komuniteti politik lidhet me ofrimin e programeve dhe procedurave të cilat ndikojnë vendimmarrësit dhe aktorët politikë duke ndërtuar një botëkuptim me prirje homogjene, konstante dhe koherente.

Ideologjia është qendrore në fushën e politikës. Sipas Freedon, pozicioni qendror i saj është rrjedhojë e karakteristikave dhe funksioneve të saj. Ndër të tjera, ideologjitë janë *'forma tipike'* nëpërmjet së cilave shprehet mendimi politik. *'Tipi'* në këtë rast nuk mund të përfshijë gjithçka që ne kemi nevojë të dimë por ofron një bazë të domosdoshme për të matur *'pulsin politik'* të një shoqërie. Së dyti, ideologjitë janë mendim politik influences. Ato ofrojnë struktura vendimmarrëse, pa të cilën veprimi politik nuk mund të ndodhë. Ideologjitë janë instrumente pushteti për udhëheqësit, dhe instrumente që mundësojnë dhe fuqizojnë zgjedhjet nga pikëpamja e anëtarëve të një shoqërie të hapur e gjithëpërfshirëse. Së treti, ideologjitë janë shembuj të mendimit krijues

dhe sipas këtij roli nga to përftohen idetë prej të cilave konfigurohet mendimi politik. Ideologjitë kërkojnë koherencë dhe konsistencë dhe gëzojnë efektivitet më të madh nëse kanë dhe forcë morale. Ato janë shembuj të mendimit konstruktiv e vizionar të arritura nga gjykimi i intelektualëve të cilët ofrojnë opsione potenciale nga të cilat shoqëria mund të zgjedhë. Së katërti, ideologjitë duhet të jenë të komunikueshme. Duhet të jenë lehtësisht të përqafueshme nga publiku dhe duhet të kontribuojnë në debatin e qëllimeve politike.

### *Pragmatizmi dhe Utopia*

Sipas Kejnshit, njerëzit praktikë, të cilët e konsiderojnë veten pak të ndikueshëm nga influencat akademike e intelektuale bien pre e autoritetit arbitrar të udhëheqësve që pastrojnë frymën nga akademia e thartuar e disa viteve më parë (marrë nga Heywood, 2003, f. 3).

Gjithsesi, pragmatizmi si doktrinë filozofike asociohet/lidhet me William James, Richard Rorty dhe John Dewey. Pragmatizmi i referohet përgjithësisht një shqetësimi për rrethana specifike më tepër se sa besimeve teorike duke vënë përballë atë që mund të arrihet në terma realë konkretë përballë asaj që do të duhej të arrihej në një botë ideale. Sipas pragmatistëve vlera e ideve apo besimeve të ndryshme duhet të matet dhe gjykohet nga rezultatet konkrete praktike. Kështu një pragmatist nuk mund të jetë në të njëjtën kohë një ideolog apo një mbrojtës i ideologjisë. Stili i politikës pragmatike është jo-ideologjik dhe e thënë kjo në gjuhë ideologjike do të ishte stil pa principe. Sipas përkufizimit për

utopiken si 'një gjendje a.) inkongruente me situatën imediate dhe b.) kur kalohet në veprim ka tendencën të shkatërrojë rregullin e gjërave', pragmatikja dhe utopikja qëndrojnë në kampin e kundërt në raport me ideologjinë. Gjithsesi konceptimi për ideologjitë ka ndryshuar shumë me kalimin e viteve. Ideologjia shihet më tepër si një sistem mendimi i orientuar drejt veprimit dhe nuk është në vetvete as e mirë as e ligë, as e vërtetë as e rreme, e mbyllur apo e hapur sepse në fakt mund t'i ketë të gjitha së bashku.

### **2.2.3 Ndarja teorike: E majta dhe e djathta**

Për të klasifikuar ideologjitë politike e për rrjedhojë edhe politikat që prodhohen prej këtyre ideologjive ka disa mënyra. Pjesa më e madhe e analistëve i ndajnë politikat në të majta dhe të djathta. Ky klasifikim daton që nga koha e Revolucionit Francez, ku ato anëtarë të Asamblesë Kombëtare që ishin kundër monarkisë uleshin në të majtë, ndërsa ato që e mbështesnin uleshin në të djathtë. Kuptimi i të majtës dhe të djathtës ndryshon ndërmjet vendeve të ndryshme dhe kohëve të ndryshme por sipas një prirje të përgjithshme, mund të bëjmë një dallim themelor midis të majtës dhe të djathtës.

Përmbledhtazi disa pika që e ndajnë të majtën nga e djathta janë: Individidi, liria, barazia, progresi, shpenzimet publike apo roli i shtetit në këtë fushë, taksimi, korporatizmi, sigurimet shoqërore, mjedisi, të drejtat e grave si dhe prona.

Në lidhje me individin, e majta thekson vlerën e komunitetit dhe shoqërisë në tërësi ndërsa e djathta thekson vlerën atomiste të individit për shoqërinë. Në



raport me lirinë, për të majtën liria në raport me barazinë (egalitarizmin) qëndron në plan të dytë ndërsa për të djathtën liria në raport me barazinë (egalitarizmin) qëndron në plan të parë.

Në lidhje me barazinë, e majta përpiqet të çrrënjosë pabarazitë sociale ndërsa e djathta i sheh pabarazitë sociale si rezultat i pabarazive natyrore të paçrrënjoshme.

Progresi si një pikë tjetër e rëndësishme ndarjeje, e bën të majtën *Progressive* dhe *Lineare* që beson tek përmirësimi i shoqërisë stad pas stadi ndërsa të djathtën si shumëplanëshe dhe jolineare që beson në zgjedhjen e individit. Rritja e shpenzimeve publike në sferat sociale dhe rishpërndarja intensive e të ardhurave është karakteristike e të majtës ndërsa për të djathtën karakteristikë është shkurtimi i shpenzimeve publike dhe reduktimi i politikave sociale.

Në lidhje me taksimin, e majta favorizon taksimin progresiv ndërsa e djathta favorizon tarifën e sheshta. Korporatizmi është një çështje për të cilën e majta jep mbështetje për arsye të rolit të tyre që konsiderohet i spikatur kurse e djathta është e interesuar në mënyrë të kufizuar për korporatizmin. Për sigurimet sociale e majta mbështet sigurimet universale, me përfitime të lidhura me të ardhura të larta kurse e djathta mbron një shtrirje të kufizuar, me përfitime të ulëta. Mjedisi edhe pse është një çështje delikate për të gjithë, gjithsesi ndan të majtën dhe të djathtën. E majta është më e ndjeshme ndaj kërkesave të të gjelbërve dhe është për krijimin e koalicioneve me të gjelbërit ndërsa e djathta është më pak e interesuar dhe jo

krejtësisht pro kufizimeve ekologjike ndaj sipërmarrjes së lirë. Për të drejtat e grave e majta është më e ndjeshme ndaj kërkesave feministe kurse e djathta është më tepër kundër ndërhyrjes shtetërore në raport me këto çështje. Në lidhje me pronën si një element thelbësor i ekzistencës njerëzore e majta mbështet pronën shtetërore ndërsa e djathta favorizon pronësinë private.

Ndërsa sipas A.Lijphart linjat kryesore të dallimit midis të majtës dhe të djathtës janë: Së pari -Pronësia private përballë pronësisë shtetërore. Së dyti - Roli i madh i qeverive përballë rolit të vogël të tyre në planifikimin ekonomik. Së treti - Ndërmarrjet e rishpërndarjes së pasurisë përballë kundërshtimit të tyre. Së katërti -Zgjerimi përballë ngurimit në zbatimin e programeve qeveritare të mirëqënies sociale (marrë në Filo, 2004).

Duke krahasur platformat Liberale me ato Socialiste rezulton se Liberalët klasikë dhe Neoliberalët fokusohen në rolin qendror të lirisë dhe në kufizimin e qeverisë dhe të forcës shtrënguese të shtetit. Liria dhe drejtësia lidhen me mbrojtjen e tregut të lirë dhe pronës private. Liberalët dalin në mbrojtje të një qeverisjeje minimale dhe funksionimit të tregut të lirë.

Nga ana tjetër, Socializmi vendos si përparësi barazinë dhe lë në plan të dytë lirinë. Një nga pikat kryesore ku socializmi bie ndesh me liberalizmin është çështja e ndërhyrjes së shtetit në ekonomi dhe madhësia e qeverisjes. Përveç diskutimeve në rrafshin teorik, ekziston një ndryshim mes liberalizmit dhe socializmit edhe në rrafshin e politikbërjes. Ndërkohë që socialistët dalin në

mbrojtje të shtetit social dhe komponentëve të tij, liberalizmi është për një qeverisje sa më minimale. Liberalët mbështesin maksimalisht lirinë si në aspektin personal ashtu edhe në aspektin ekonomik. Bota që ata kërkojnë të ndërtojnë është një botë ku individët janë të lirë të ndjekin ëndrrat e tyre në mënyrën e tyre pa ndërhyrje nga qeveria apo ndonjë fuqi autoritare.

Sipas shumicës prej platformave liberale të marra në konsideratë, disa të drejta themelore të individit dhe pikëpamjet për to janë :

*Liria dhe përgjegjësia:* Liberalët mendojnë se qeveria i kundërvihet përgjegjësisë personale duke i mohuar individit mundësinë ta ushtrojë atë dhe në fakt mohimi i lirisë ushqen papërgjegjshmërinë. Politikat liberale promovojnë një shoqëri ku njerëzit janë të lirë të marrin vendimet e tyre dhe të mësojnë nga to.

*E drejta e pronësisë:* Sipas Liberalëve vetëm individët dhe entitetet private kanë të drejtën e plotë të kontrollojnë, të përdorin, të zotërojnë ose të gëzojnë pronën e tyre pa ndërhyrje për aq kohë e përderisa kjo nuk shkel të drejtën e vlefshme të të tjerëve.

*E drejta e privatësisë:* E drejta e individëve për privatësi, pronësi dhe e drejta për t'u shprehur ose jo nuk duhet të çenohet nga qeveria. Qeveria nuk duhet të përdorë mjete elektronike apo mjete të tjera për të mbikqyrur veprimet e individëve ose pronën private pa konsensusin e pronarit apo personit përkatës. Korrespondenca, transaksionet financiare e bankare, komunikimet personale nuk

duhet të jenë të hapura për qeverinë pa konsensusin e të gjitha palëve të përfshira në këto veprime.

*Seksualiteti dhe gjinia:* Njerëzit e rritur duhet të jenë të lirë të zgjedhin praktikat e tyre seksuale dhe marrëdhëniet e tyre ndërpersonale. Seksualiteti apo gjinia nuk duhet të kenë impakt në të drejtat e individit. Qeveria duhet të mohojë favorizimet apo diskriminimet mbi bazë të orientimit seksual apo identitetit gjinor.

Për këto arsye dhe më tutje argumentohet se veprimtaria e qeverisë duhet të jetë e kufizuar. Funkcionet e saj janë: (I) mbrojtja kombëtare, (II) ruajtja e rendit, (III) garantimi i rregullave të lojës, (IV) nxitja e tregut konkurrues dhe mbi të gjitha (V) mbrojtja e lirisë së individit.

Nga ana tjetër Socialistët e vënë theksin tek të drejtat sociale si të drejta themelore të njeriut. Ato janë për një shoqëri të drejtë dhe përfshirëse. Ndër principet kryesore të së majtës kryesisht të asaj Europiane janë :

*Të drejta dhe detyrime për të gjithë:* E majta nuk dëshiron ta lërë shoqërinë që të formësohet nga forca e tregut dhe në vënd të kësaj vihet në mbrojtje të të drejtave dhe detyrimeve për të ndërtuar bashkarisht një shoqëri moderne të mirëqënies. Qeveria ka detyrën t'u sigurojë qytetarëve akses në shërbimet publike dhe të mbrojë të drejtat e tyre. Në këmbim, qeveria ka pritshmëri nga qytetarët dhe aktorët e tjerë për kontribut për shoqërinë e mirëqënies. Është detyrë e biznesit që

të kontribuojë në financat publike, të ndihmojë punësimin e plotë dhe të ndihmojë shoqërinë nëpërmjet përgjegjësi sociale të ndërmarrjeve.

*Punësimi i plotë:* Realizimi i një punësimi të plotë në kontekstin e një shteti modern të mirëqënies. Tregjet e punës duhet të bëhen më dinamike nëpërmjet politikave përfshirëse të sigurisë dhe të mbështetjes.

*Investimi tek njerëzit:* E majta fokusohet në përmirësimin e aftësive të punëtorëve më pak të kualifikuar në vënd të përqendrimit vetëm tek oportunitetet për ato të kualifikuarit. Edukimi e trajnimi duhen përdorur jo vetëm për të rritur aftësitë e qytetarëve por për të luftuar përjashtimin social dhe për të arritur punësimin e plotë sepse ato që më shumë kanë nevojë për arsimim dhe edukim si të varfërit dhe të disavantazuarit janë ato që vazhdimisht përfitojnë më pak.

*Shoqëri gjithëpërfshirëse:* Politika shpesh e anashkalon përjashtimin e grupeve të tilla si: të moshuarit, pakicat etnike, apo ato nga komuniteti i të varfërve. Masa për kujdesin shëndetësor, shërbimet sociale dhe kujdesin e fëmijëve duhet të sigurohen me legjislacion duke analizuar rrjedhjet sociale në vënd të një analize nga pikëpamja e pastër ekonomike.

*Kujdes universal për fëmijët:* Për Socialistët janë të rëndësishme masat në cilësi të lartë për kujdesin ndaj fëmijëve për të patur një fillim të mirë edukimi, ndërkohë që prindërit janë të lirë për t'u punësuar.

*Të drejta të barabarta për burrat dhe gratë:* Për Socialistët duhet barazi më e madhe gjinore për të përmirësuar statusin e grave në shoqëri, vende pune dhe pagë e njësuar me ato të burrave. Ky nuk është vetëm një imperativ moral por një çështje kyçe për forcimin e demokracisë dhe për sigurimin e një mirëqënieje më të lartë për familjet.

*Dialogu social:* Në lidhje me këtë pikë, duhet inkurajuar dialogu midis punëdhënësve dhe punëmarrësve për të ndihmuar të drejtat, punësimin dhe rritjen ekonomike. Kjo shërben për të aftësuar një forcë punëtore më përfshirëse dhe dinamike.

Karakteristikë për të majtën është edhe koncepti i shtetit të mirëqenies (*welfare state*) dhe ai i shoqërisë së mirëqenies që përbëjnë atë që quhet *sistemi welfare*. Sipas konceptit të shtetit të mirëqenies sociale, shteti ka përgjegjësi parësore për mirëqenien e qytetarëve të vet sepse të gjitha aspektet e mirëqenies konsiderohen dhe aplikohen universalisht si të drejta. Tjetër karakteristikë e së majtës është ekonomia mikse e cila është një sistem ekonomik që inkorporon aspekte të më shumë se një sistemi ekonomik. Zakonisht nënkuptohet një ekonomi që përfshin si ndërmarrjet me pronësi private ashtu edhe ato me pronësi shtetërore, pra një kombinim i kapitalizmit me socializmin. Në kuptimin e ekonomisë mikse përfshihen aspekte si: një shkallë e lirisë së ekonomisë private e ndërthurur me një shkallë të caktuar të planifikimit ekonomik.

Socializmi ashtu si liberalizmi pranon sistemin industrial dhe ka si qëllim lirinë, arsyen, mobilitetin, standarte më të larta jetese për masën por socializmi përpiqet t'i arrijë këto qëllime me mjete si planifikimi dhe *komuniatarianizmi* që nuk përputhen me ato të liberalizmit.

E majta argumenton se njerëzit kanë nevoja sociale si strehimi e punësimi, të cilat shteti duhet t'i sigurojë ndërsa nga ana tjetër e djathta pretendon se ajo për çka kanë nevojë njerëzit janë oportunitetet, motivimi, njohuritë, mundësitë për tregun e lirë dhe qeveritë veçse mund t'i përkeqësojnë gjërat duke promovuar varësi e duke dekurajuar aktivitete të sipërmarrjes së lirë të njerëzve.

Gjithsesi, spektri linear 'majtas-djathtas' ka një sërë kufizimesh dhe inkonsistencash. Kështu për shembull, regjimet fashiste kanë aplikuar/zbatuar politika ekonomike dhe kontroll shtetëror në një masë mjaft të gjerë edhe pse qëndrojnë në kah të djathtë në këtë lloj klasifikimi linear. Nga ana tjetër një problem i këtij lloji haset edhe me anarkizmin i cili për nga dedikimi ndaj barazisë do mund të klasifikohet majtas por për nga refuzimi për çdo lloj menaxhimi dhe planifikimi shtetëror do të mund të qëndronte djathtas. Siç mund të kuptohet spektri linear i klasifikimit 'majtas-djathtas' ka një sërë dobësish që vijnë si rrjedhojë e një procesi mbithjeshtëzimi të ideologjive të cilat janë sisteme mendimi e besimi mjaft komplekse. Për këtë arsye janë bërë përpjekje për të zhvilluar sisteme më komplekse klasifikimi në mënyrë që të korrigjohen mangësitë e boshtit linear dhe kështu përfshijnë edhe dimensione të tjera.

Gjithsesi, rritja e fuqisë së lëvizjeve të reja ka vënë në vështrirësi çdo lloj klasifikimi. Të tilla lëvizje janë ambjentalizmi, feminizmi, lëvizjet për të drejtat e kafshëve, etj. Megjithë mangësitë e boshtit të klasifikimit ‘majtas-djathtas’ ky spektër është i rëndësishëm dhe i nevojshëm për të vlerësuar lidhjen e partive politike me rezultatet politike.

Studimi dhe klasifikimi është gjithashtu i nevojshëm për të studiuar strategjitë e krijimit të aleancave partiake si dhe variacionin e politikave publike në bazë të këtij elementi. Kështu, me anë të këtij klasifikimi zbulohen tendencat e blloqeve të ndryshme si dhe kufizimet e tyre. Megjithëse spektri ‘majtas-djathtas’ është mjaft i rëndësishëm ekziston edhe një kufizim tjetër. Ky kufizim konsiston në natyrën *ad hoc* të klasifikimit duke qenë se në terma empirikë lidhja e të majtës me të djathtën dhe e së djathtës me të djathtën në nivel ndërkombëtar midis shteteve të ndryshme rrallë ka kongruencë të plotë.

Ndryshimi gjeografik i konceptit të së majtës dhe së djathtës është një çështje e rëndësishme në diskutimin mbi ideologjitë. Në një farë kuptimi, thuhet që në Amerikë ‘gjithçka është liberale’. Në fakt duhet një përpjekje shtesë përtej këtij thjeshtëzimi në mënyrë që të kuptohet dallimi midis liberalizmit Amerikan dhe liberalizmit European, të majtës e të djathtës Amerikane dhe asaj Europiane. Ideologjitë politike në Amerikë janë variacione të liberalizmit klasik dhe për këtë arsye krijojnë ngjashmëri midis tyre. Kështu pothuajse të gjithë në Amerikë besojnë tek qeveria e kufizuar dhe e kontrolluar, tek tregu i lirë dhe tek individi.



Gjithsesi, Demokratët anojnë lehtë nga e majta dhe Republikanët lehtë nga e djathta. Këto diferenca lindin si rrjedhojë e dallimit të vizioneve për rrugën se si duhet të arrihen qëllimet pothuajse të ngjashme duke zbehur atë që konsiderohet trajtë monolite e ideologjive. Thyerja e trajtës monolite qëndron tek fakti që jo të gjithë Republikanët mendojnë njëloj dhe jo të gjithë Demokratët mendojnë njëloj. Sidoqoftë besimet kryesore të dy partive kryesore janë mjaft të ngjashme, ndryshe nga qëndrimet që mbajnë parti të ndryshme në vende të tjera.

Për të kuptuar ideologjitë politike në kontekstin Amerikan duhet bërë një dallim midis Liberalizmit dhe Konservatorizmit. Barazia e shanseve është një komponent kyç për Liberalizmin Amerikan. Ideja është se mirëqenia duhet të rrjedhë nga inteligjenca, përkushtimi, disiplina, puna e vazhdueshme e kështu me radhë. Stadi ku ndodhet individi nuk duhet të determinohet nga rrethanat që kanë shoqëruar lindjen e tij. Qeveria shihet si instrumenti që mund të sheshojë pabarazitë dhe padrejtësitë. Për këtë arsye liberalët favorizojnë politika publike të tilla që rishpërndajnë pasurinë nga më të pasurit tek më të varfrit duke vlerësuar mjetet me të cilat mund të arrihet barazia. Më tej liberalët mendojnë se sadoqë ekonomia e tregut ka një sërë vlerash për sigurimin e prosperitetit ajo është një bishë që ka nevojë për dorën e qëndrueshme të shtetit në mënyrë që ta zbusë atë. Një nga synimet kryesore është që të ndalohen monopolet të cilët dëmtojnë shoqërinë në tërësi. Duke artikuluar si të majtë, liberalët Amerikanë besojnë edhe tek fuqia e korporatizmit dhe interesat përkatëse në mënyrë që të shmangen rrjedhojat e padëshirueshme në aspektin social. Roli i qeverisë shihet tek rregullimi i

rrethanave ekonomike në mënyrë që të parandalohen abuzimet. Ndryshe nga Europeanët, Liberalët Amerikanë nuk kanë përqafuar ndonjëherë idenë e shtetëzimit të industrive private. Ajo që kanë argumentuar liberalët Amerikanë është se nuk duhen privatizuar sektorë të ndryshëm shtetërorë (Ellis dhe Stimson, 2012, f. 4). Për më tepër ky kamp është pro rregullimit –brenda limiteve të biznesit. Ekziston një frymë mosbesimi tek dora e fshehtë e tregut dhe ajo që besohet është se fuqia ekonomike private e lënë e pakontrolluar mund të shkaktojë dëme sociale. Në sferën sociale, Liberalët mbrojnë parimin e mosndërhyrjes në jetën private dhe vendimet private.

Nga ana tjetër Konservatorët besojnë së është individi, familja apo grupe të ndryshme të komunitetit që sjellin përparimin në një shoqëri. Konservatorët vënë në pikëpyetje si aftësinë si mundësinë e shtetit për t'u bërë ballë problemeve sociale dhe për të korrigjuar tregun. Në vend të kësaj, ata mendojnë se individët privatë, duke vepruar pa pengesën e agjensive qeveritare, janë më të motivuar dhe më të sukseshëm për të gjeneruar sukses. Konservatorët besojnë tek barazia e shanseve, por besojnë gjithashtu edhe se liria e tregut duhet shtrirë duke i dhënë secilit mundësinë të zgjedhë strategjinë ekonomike që mendon si më të përshtatshme, duke mënjanuar dorën e qeverisë që përpiket të rregullojë pabarazitë në të ardhura. Konservatorët janë kundër procesit të rishpërndarjes që u jep favore njerëzve që nuk i kanë merituar ato nëpërmjet punës së tyre. Sipas tyre, problemet e shtresës së disfavorizuar të një shoqërie mund të zgjidhen më mirë nëpërmjet organizatave bamirëse dhe nga ato me baza fetare.

Pjesa më e madhe e Konservatorëve gjithsesi njohin dhe vlerësojnë disa role të rëndësishme të shtetit. Të tilla janë ato të sigurimit të një ambjenti të sigurt, transaksione të pastra midis pjesëmarrësve në tregun ekonomik në mënyrë që të shtohet liria e tregut, etj. Sidoqoftë, konservatorët nuk heqin dorë nga besimi që kanë tek fuqia e tregut të lirë dhe e shohin atë si të vetmen rrugë për të arritur prosperitet. Çështja ndryshon në pjesën që lidhet me vlerat morale dhe kulturën. Këtu roli i shtetit për të promovuar rendin dhe sigurinë sociale shihet si më i nevojshëm.

#### **2.2.4 Metanarrativat totalizuese**

Në terma literale, metanarrativa nënkupton një ‘histori të madhe’ dhe përfaqëson shkurtimisht një histori apo një shpjegim të çdo gjëje që ndodh në një shoqëri. Funkcionalizmi, Marksizmi, Liberalizmi, Feminizmi etj, janë të gjithë shembuj të asaj çka postmodernët quajnë metanarrativa.

Postmodernët i kushtojnë vëmendje të veçantë konfuzionit konceptual që shpesh ka qenë burim vështirësish në studimin e politikës. Konfuzioni konceptual në shkencë sociale dhe sigurisht në shkencë politike sjell vështirësi si në analizën empirike ashtu edhe në atë normative. Postmodernët, të cilët kanë mbërritur tek ideologjia nëpërmjet fuqisë së diskursit janë pezull midis metodave interpretative dhe atyre normative. Kjo nënvizon diferencën midis të bërit teori dhe analizimit të teorisë. Në një farë kuptimi kjo do të thotë që ata të cilët analizojnë teoritë mbajnë kahun e ‘konceptualistëve’ dhe të morfologjistëve. (Freeden, 2006, f. 39 )

Pra, duke u nisur nga terma postmodernë, ideologjitë shihen si metanarrativa totalizuese. Postmodernizmi është një fenomen kulturor kompleks që mes të tjerash karakterizohet nga mosbesimi tek diskursi përgjithësues për shkak të problemit të së vërtetës universale. Thuhet që diskursi krijon regjimin e vet të së vërtetës dhe nuk mund të maten fenomene totalisht të ndryshme me anë të të njëjtit diskurs. Postmodernizmi është kritik ndaj konceptit të ideologjisë sepse nuk mund të gjykohet një diskurs nëpërmjet një diskursi tjetër. Megjithë kritikën e autorëve si Foucault, Baudrillard dhe Lyotard për ideologjinë, në fakt në vetë këtë subjekt ka kontradiksion. Kontradiksioni vjen si rrjedhojë e faktit se ndërkohë që dyshojnë tek vlefshmëria e diskurseve totalizuese dhe parashtrojnë kritikën për ideologjinë, krijojnë vetë një diskurs totalizues duke e rifutur konceptin nga ‘dera e pasme’ (Larrain, 1994, f. 289).

Duke analizuar ideologjitë si metanarrativa në një konceptim postmodern, Liberalizmi dhe Socializmi përbëjnë elemente kryesore të këtij diskursi. Liberalizmi si teori politike e ka përqëndrimin thelbësor tek liria individuale. Përkundrajt barazisë, përparësi i jepet lirisë dhe vlera e barazisë për liberalët kalon në plan të dytë. Nga fundi i shek. XIX liberalizmi u nda në dy rryma kryesore: a) liberalizmi klasik dhe b) liberalizmi revizionist apo modern.

Nga ana tjetër, edhe brenda socializmit që konsiderohet po aq metanarrativë sa liberalizmi, janë parë dy tendenca kryesore. Dallimi qëndron në qëllimet që ka secili kamp i mendimit socialist. Konkretisht, ka mospajtim midis qëllimeve që

kanë socialistët revizionistë dhe socialistët si social-demokratë. Parimisht, socializmi i jep mundësi shtetit të bëhet ai që vendos për individin dhe cakton se ç'është e mirë dhe e keqe për të, duke shafqur tipare të theksuara paternaliste. Shteti socialist me në bazë mirëqenien sociale nënkupton dy elementë kryesorë. Së pari, sipas socialistëve jeta e individit është e varur nga shteti dhe së dyti, sa më shumë rritet shkalla e ndërhyrjes politike dhe ekonomike e shtetit në shoqëri aq më tepër shoqëria priret drejt progresit.

Sipas Gaus (2000), disa nga përbërësit kryesorë të shtetit social janë:

- Kujdesi, mbrojtja dhe sigurimi social që u siguron përfitime materiale shtetasve në periudhat më kritike të jetës së tyre.
- Asistenca apo mbështetja sociale
- Detyrimi për sigurimin e mirëqënies dhe të prosperitetit në shoqëri.
- Rishpërndarja e të ardhurave në mënyrë progresive

Si rezultat i depresionit të madh ekonomik gjatë viteve 1920-1930, në nivel ndërkombëtar u krijua nevoja për parashtrimin e propozimeve gjerësisht pragmatike për të nxjerrë nga kriza sistemin kapitalist me baza liberale. Për këtë shërbeu si bazë teorike, puna e Kejnstit tek 'Një teori e përgjithshme e punësimit, Interesit dhe Parasë'. Si rrjedhojë e kushteve historike politike, ekonomike e sociale të kohës ekzistonte një konsensus si nga e majta dhe nga e djathta lidhur me implementimin e politikave kejnialiste. Tregu i lirë e konkures dhe ekonomia e sipërmarrjes private pranohej nga kejnianizmi, por ndryshe nga

teoritë liberale e neoliberales, ndërhyrja sistematike e qeverisë në ekonomi, planifikimi sistematik si dhe sigurimet shoqërore shiheshin si mjaft të rëndësishme. Kejnsianizmi u dha jetë ekonomive mikse, ku përveç sektorit privat, rol të rëndësishëm kishte edhe dora e shtetit. Kejnsianizmi përkon kryesisht me (Gaus, 2000):

- Forcimin e rolit rregullator dhe planifikues të shtetit.
- Zhvillimi i korporatizmit, pra bashkëpunimi mes qeverisë, kapitalit privat dhe punëtorëve në marrjen e vendimeve.
- Rritja e shpenzimeve publike .
- Shtimi i sasisë së parasë që qarkullon në ekonomi etj.

Më vonë, kriza ekonomike e viteve '70, e vuri në dyshim rolin pozitiv të politikave kejnsoniane. Përballë kësaj, u formulua një platformë neoliberales e cila ndjek linjën e mendimit të liberalëve klasik. Si teoricienë të këtij mendimi janë F. Hayek dhe M. Friedman, ndërsa si implementues të këtyre politikave janë M. Thatcher dhe R. Regan.

Neoliberalizmi bazohej në disa koncepte kyçe. Së pari, privatizimi i pasurisë shtetërore. Së dyti, është derregullimi i kontrollit mbi bizneset e mëdha duke e zhvendosur vëmendjen nga korporatizmi dhe ambjentalizmi dhe duke ia lënë tregut privat rregullimin e sektorëve të ndryshëm, si shëndetësia dhe edukimi. Një element tjetër i rëndësishëm i neoliberalizmit është heqja e barrierave për tregun ndërkombëtar gjë që nxiti globalizimin e udhëhequr nga korporatat e ndryshme

të kohës. E gjithë kjo vuri në konkurrencë qeveritë e ndryshme në rang ndërkombëtar për të përmbushur axhendën neolibérale në mënyrë që të sigurohej prosperitet nëpërmjet tërheqjes së investimeve.

Në mënyrë të përmbledhur, pikat kryesore të platformës neolibérale, ndryshe nga kejnsonianizmi, ishin (Gaus, 2000):

- ‘Prishja e sistemit të ekonomisë mikse dhe zëvendësimi i tij me sistemin e ekonomisë së tregut të lirë.
- Kufizimi i rolit të qeverisë, reduktimi i ndërhyrjes së qeverisë në jetën ekonomike dhe sociale, pra qeverisja minimale.
- Shmangia e korporatizmit nëpërmjet kufizimit të ndikimit të sindikatave punëtore në bërjen e politikave ekonomike.
- Zbatimi i politikave monetariste me theksin tek oferta në treg dhe ulja e taksave për bizneset e mëdha.
- Shkurtimi i shpenzimeve publike dhe reduktimi i politikave sociale.
- Zhvillimi i kulturës së tregut siaps së cilës individi është përgjegjës për veten dhe jo shteti për të’.

#### **2.2.5 Kritika ndaj të majtës dhe të djathtës**

Kriza e viteve 2007-2008 ishte në një farë mase ekonomike por pati si rrjedhoja politike ashtu edhe rrjedhoja sociale. Kriza u konsiderua si një ngjarje me rrënjë tek kolapsi i tregut dhe ideologjia që e shoqëron atë. Në atë periudhë u gjenerua

debati si dhe ideja se ashtu siç u erdhi fundi regjimeve komuniste në bllokun lindor, ashtu do shihej edhe shembja e regjimit të bazuar tek tregu dhe bota mund të lëvizë në një fazë tjetër transformimi po aq domethënës sa fundi i komunizmit. Që nga viti 1945 ka shumë diskutime dhe lëkundje për mënyrën se si duhet të shihet roli i shtetit. Vitet e para pas luftës e panë shtetin me mirëbesim dhe shpresë për tek arritja e një shoqërie të mirëqenies që ofron një siguri të lartë për individin. Kjo pikëpamje u thye më vonë gjatë viteve 1980 gjerësisht sepse shteti shfaqti inefiçensa në drejtimin e ekonomisë dhe krijoi pengesa në lirinë e individit duke u bërë barrë për nismën private. Ky perceptim ishte kryesisht i fortë në SHBA si dhe në Mbretërinë e Bashkuar. Strategjia e zgjidhjes u pa në tërheqjen e shtetit nga roli menaxhues dhe rregullues. Në mungesë të dorës së shtetit, i mbetej tregut të rregullonte situatën me anë të alokimit dhe rialokimit të resurseve.

Teoritë e Hayek dhe Friedman gjetën terren për t'u zbatuar. Sipas këtyre teorive, tregu sjell ekuilibër nëpërmjet vetërregullimit. Kjo u bë ideologjia sunduese madje, ashtu siç e quajnë disa si dogma e kohës. Tregu shihej optimal si nga pikëpamja normative ashtu dhe si një zgjidhje për zhvillimin e një shoqërie moderne. Kjo qasje e bazuar tek fuqia e tregut e ktheu politikën në mekanizëm menaxhimi, pra u krijua qasja e 'politikës si menaxhim' si një formë apo si një trajtë depolitizimi. Përveç këtij rezultati, një produkt tjetër shoqëruar i kësaj qasjeje ishte dhe niveli i lartë i diskursit populist. Ky diskurs populist ka shërbyer për të ushqyer të pakënaqurit e regjimit të tregut si dhe për të stimuluar mbështetjen për regjimin ekzistues. Të pakënaqurit e kohës mendonin se sfera



politike nuk i vë re problemet e tyre dhe as përpiqet t'i zgjidhë ato ndryshe nga parimet e qytetarisë në një demokraci të shëndoshë. Sidoqoftë, delegitimimi i shtetit si rrjedhojë e rënies së regjimeve komuniste u forcua edhe më tepër dhe dimensionin ideologjik i tregut u përforcua edhe më shumë në fund të viteve 1980. Pastaj, ngritja ekonomike e Kinës dhe Indisë e konkretizuan dhe më shumë forcën e tregut dhe ideologjinë që e shoqëron atë. Ky linearitet i fuqisë së tregut u lëkund gjatë vitit 2008 dhe shumë akademikë e panë këtë si fundin e një epoke të vjetër që duhet t'i lërë vendin një cikli të ri epokal. Problemi ende i pazgjidhur qëndron në faktin se duhet rimenduar rolin e secilit aktor, si ai i tregut ashtu dhe ai i shtetit. Problemi i përhershëm është se duhet gjetur një zgjidhje larg stancionit të shtetit dhe larg pabarazisë së gjeneruar nga tregu i lirë.

#### 2.2.6 **Politika, Radikalizmi, Demokracia dhe Ideologjia**

Ashtu siç shprehet Chantal Mouffe dhe autorë të tjerë të së njëjtës linjë “Politika mund të përkufizohet si tërësia e praktikave, diskurseve dhe institucioneve që kanë si synim të vendosin një rregull të caktuar dhe të organizojnë ekzistencën njerëzore” (Mouffe, 1999, f. 754); ndërsa *politikja* përkufizohet si “dimensioni i antagonizmit që është inherent në marrëdhëniet njerëzore, antagonizëm që mund të marrë forma të ndryshme dhe të shfaqet në lloje të ndryshme marrëshëniesh sociale” (Mouffe, 1999, f. 754). Nga ana tjetër, demokracia si metodë mund të jetë asociative, agregative, kapitaliste, komunitariane, konstitucionale, deliberative, elitiste, liberale, diskursive, minimaliste, përfaqësuese, parlamentare, globale, e gjelbër, feministe, presidenciale, populiste, sociale e madje edhe

radikale. Thuhet që ka më shumë demokraci në teori se sa në praktikë. Me zhvillimin, diferencimin dhe specifikimin e detyrave të shtetit si dhe me rritjen e masës heterogjene të *politisë*, format institucionale të demokracive janë tekno-burokratizuar edhe më shumë. Megjithatë ky tekno-burokratizim në administrim duket në një farë mase i paaftë për t'u dhënë zgjidhje problemeve të reja që shfaqen me kalimin e viteve. Demokracia nuk mund të identifikohet vetëm me metodat dhe procedurat siç janë zgjedhjet elektorale konkurruese. Në mënyrë që të përmbushet thelbi i demokracisë duhet rritja e rolit të mekanizmave përfshirës të qytetarëve, ndërtimi i dialogut politik dhe konsensusit mes palëve, projektimi i politikave publike të tilla që mund të sigurojnë një ekonomi dhe shoqëri të shëndoshë, etj. Gjithsesi, i gjithë ky mekanizëm duhet të funksionojë pa prishur autonominë e individit dhe pa u bërë tepër i kushtueshëm dhe më në fund ineffiçent. Përfitimet e pjesëmarrjes demokratike duhet t'i tejkalojnë kostot e angazhimit civik ashtu si benefitet e supozuara si përfitim prej shtetit nuk duhet t'i tejkalojnë kostot e efincës që pretendohet nga niveli i përgjegjshmërisë së sistemit e kështu me radhë.

Në aspekte të ndryshme, ka një lloj shumëkuptimësie të termit 'radikalizëm politik' përballë 'radikalizmit demokratik'. Nga njëra anë, çdo lloj demokracie duhet të shfaqë një lloj vendosmërie parimore dhe nga ana tjetër duhet ruajtur balanca midis parimeve të përqafulara dhe mjeteve apo mënyrave me anë të të cilave ndiqen parimet. Sidoqoftë, duhet bërë një dallim midis radikalizmit të mjeteve dhe radikalizmit parimor që përfshin vlerat morale, gjykimet normative

dhe orientimin politik në përgjithësi. Radikalizmi i mjeteve përfshin një mungesë të theksuar veprimesh të integruara me gjykime bazuar në principet morale, vlerore duke u lënë shteg aksioneve deri të dhunshme për arritjen e objektivave të caktuara. Megjithatë nuk përjashtohet fakti që në një masë të caktuar është edhe radikalizmi parimor një iniciues i radikalizmit të aksionit politik. Sipas *think tank*-eve të ndryshme që janë një zë i rëndësishëm në lidhje me çështjet e demokratizimit ashtu si Freedom House deklaron, rekordet e demokratizimit që nga fillimi i valës së tretë prej vitit 1974 të cilat më vonë u përshpejtuan me rënien e murit të Berlinit, janë impresionuese për amplitudat dhe ciklet politike. Gjithsesi ngjarje të mëvonshme si kriza të ndryshme të ngjashme me atë të vitit 2008 kanë ndikuar në një lloj recesioni demokratik dhe përkeqësimi në zhvillimet politike duke theksuar nevojën e ‘kurimit’ të demokracisë. Shumë autorë bashkëkohorë mendojnë se demokracia liberale e cila konsiston në orientimin drejt manipulimit të masës si dhe orientimin drejt tregut ndodhen në një lloj krize e cila mund të konsiderohet si krizë përfaqësimi. Ekziston një defiçit si mungesë e vullnetit pozitiv për ushtrimin e qytetarisë. Si rrjedhojë e kësaj krijohet dilema nëse njeriu duhet të jetë i lirë të ushtrojë politikën apo duhet të çlirohet nga politika. Kjo krijon shteg për atë që konsiderohet si depolitizim apo epoka e depolitizimit. I tillë është konsiderimi që shfaq Hanna Arendt kur pozicionohet midis kufirit të liberal demokracisë dhe pozitivizmit juridik (Duarte, 2007, f. 107). Kështu Arendt përdor termin ‘demokraci radikale për të shpjeguar dinamikën e demokracisë në ditët e sotme. Autorë të tjerë poststrukturalistë që argumentojnë rreth gjendjes së

demokracisë në ditët e sotme, diversitetit, qytetarisë dhe komunitet janë gjithashtu Chantal Mouffe, Habermas etj. Demokracia Radikale shpreh në një farë mase humbjen e besimit tek politika tradicionale e cila bazohet tek funksionimi i partive politike me anë të proceseve të agregimit e artikulimit të interesave. Kjo qasje sjell konceptime të reja për lirinë, diversitetin dhe përgjegjësinë civike. Debatet e parashtruara nga teoricienët e Demokracisë Radikale shtrojnë pyetjen nëse demokracia duhet të shihet thjesht si një formë e vendimmarrjes apo duhet të shihet si një instrument i fuqizimit popullor.

Nga ana tjetër, vihet në diskutim dilema nëse demokracia është një ideal abstrakt apo një çështje konkrete e realizueshme në parametra reale. Sfera publike merr një kuptim tjetër për teoricienët që hulumtojnë këtë qasje. Çështjet e lidhura me qytetarinë dhe komunitetin janë subjekte debati bashkëkohor si nga e majta ashtu edhe nga e djathta dhe secili kamp përpiqet t'i mobilizojë përreth kauzave përkatëse. Nga e majta, këto nocione janë qendrore sepse antagonizmat dhe diversiteti shihen si mjeti për thellimin e demokracisë dhe njëkohësisht si baza sociale për diferencimin ideologjik. Në konceptimet e demokracisë radikale, në një farë sensi pluralizmi radikalizohet në heterogjenitet absolut. Në këtë mënyrë çështja bëhet delikate kur prek kufirin e pluralizimit. Për këtë duhet ruajtur balanca që pluralizmi të mos rrezikojë kufijtë e formave demokratike të qeverisjes dhe procedurave që e shoqërojnë.

### 2.2.7 Teza mbi 'Fundin e Ideologjisë'

Shumë autorë kanë parashikuar ose përshkruar fundin e ideologjive. Termi 'Fundin e ideologjisë' mund të jetë hasur së pari në shkrimet e eseistit e romancierit francez Albert Kamy në kritikën e tij për socialistët francezë. Më vonë Seymour Martin Lipset argumentoi që problemet politike themelore të zhvillimit industrial nuk ngrenë më debate apo konflikte ideologjike, por një formulim më të mprehtë të këtij koncepti e ka dhënë Daniel Bell në Librin e tij 'Fundin e Ideologjisë'. Ideologjitë e vjetra të shekullit të nëntëmbëdhjetë janë sosur, të minuara nga tmerri i komunizmit sovjetik dhe suksesi i kapitalizmit liberal. Bell thotë që "pasionet e vjetra janë shuar" dhe radikalizmi i vjetër politikë ekonomik e ka humbur kuptimin e vet. Sipas tij situata duket e qartë; "Koha e ideologjive ka mbaruar" Në botën perëndimore midis intelektualëve ka konsensus të fortë mbi çështjet politike:

Pranimi i shtetit të mirëqenies sociale, pushtet i decentralizuar, një sistem i ekonomisë mikse dhe pluralizëm politik. Ideologjia është "intelektualisht e pajetë", politika ofron shumë pak ngacmim.

Francis Fukuyama riformuloi në mënyrë më të sofistikuar propozimin e fundit të ideologjisë. Në një artikull që i paraprin librit "The End of History and the Last Man", Fukuyama shprehet se "triumfi i Perëndimit dhe ideve perëndimore është i dukshëm në sosjen totale të alternativave të mundshme ndaj Liberalizmit

Perëndimor.” Në fakt, ky është dhe argumenti i Bell, fitorja e kapitalizmit dhe sosja e alternativave ideologjike.

Megjithatë, “Fundi i Ideologjisë” është një tezë shumë kontroversiale. Teza e Bell shprehet në nëntitullin e librit të tij “Sosja e ideve politike në vitet ‘50”. Argumenti i Bell-it është se ideologjitë e mëdha politike të shekullit XIX, liberalizmi dhe socializmi secilën prej të cilave ai e quan “një grup besimesh, të përziera me pasion dhe që synojnë të ndryshojnë mënyrën e jetesës” kanë humbur së fundi aftësinë e tyre për të mobilizuar njerëzit e shoqërive industriale të përparuara. Ai argumenton se kjo ka ndodhur për dy arsye. Së pari, sepse ideologjitë nuk kanë mundur dot të parandalojnë luftrat, depresionet ekonomike dhe shtypjen politike dhe së dyti, nga modifikimi i kapitalizmit që ka ardhur nga ndryshimet e sjella nga ajo që mund të përmblihet me termin shtet i mirëqenies.

Sipas deklaratave të Anthony Giddens gjatë vitit 1983, ekzistojnë katër pista apo teza kryesore pse duhet braktisur ideologjia. Së pari, koncepti i ideologjisë duhet të ndahet nga koncepti i shkencës. Së dyti, ideologjia është pa përmbajtje, pra boshe sepse ajo që i bën sistemet e besimit ideologjike është inkorporimi i tyre me sistemet e dominimit. Së treti, në mënyrë që të kuptojmë këtë inkorporim duhet të analizojmë mënyrën se si këto modele kuptimore inkorporohen me praktikën e përditshme, Së fundi, duhet të jemi kritikë ndaj ‘tezës së ideologjisë dominante’ të

përpunuar në versione të ndryshme nga autorë të ndryshëm si Parsons, Althusser dhe Habermas.

Argumentat për fundin e ideologjisë kanë ardhur në kohë të ndryshme nga anë të ndryshme, por veçanërisht nga teoria e konvergencës, homogjenizimit të shoqërive, ndryshimit të rendit botëror, postmodernizmi, globalizmi etj. Në rastin e Shqipërisë ajo që unë parashtroj si skicë për analizën e fenomenit të ‘deideologjizimit’ si alternativë ndaj fundit të ideologjisë lidhet me shqyrtimin e tetë faktorëve kryesorë të cilët janë:

- Dimensioni i partive politike
- Programet politike në lidhje me politikat publike/Dekomunistizimi
- Roli i elitave
- Ndikimi ndërkombëtar
- Dimensioni i shoqërisë civile
- Personalizimi i politikës
- Niveli i i diskursit politik
- Nivelet e populizmit

Gjithsesi, ashtu siç u përmend më lart, në mënyrë parimore përshtkrimi i ‘fundit të ideologjisë’ në nivel ndërkombëtar si rrjedhojë e konteksteve, zhvillimeve dhe historikut specifik, shihet në dimensione të ndryshme si tek teoritë e konvergencës, homogjenizimit të shoqërive, globalizmi si dhe veçanërisht tek postmodernizmi dhe dinamikat që e shoqërojnë në kontekste të ndryshme. Kjo

përballje midis aspektit teorik-parimor dhe faktorëve të analizës për rastin studimor që unë paraqes, është vendosur për të vënë në pah trajtat jo të rregullta - *ideografike* të rastit përballë ndonjë modeli teorik testues.

### ***Teoritë e konvergjencës***

Sipas teorive të konvergjencës, kemi konvergjencë ndërmjet rendit ekonomik e shoqëror kapitalist dhe atij socialist (Feraj, 2008).

- *Në vendet perëndimore*

-Konstatohet një zhvillim që shkon drejt një sistemi të përzier

-Angazhimi sociopolitik në rritje i shtetit, ‘shteti i mirëqënies’

-Rritja e instrumentave shtetërorë të drejtimit dhe planifikimit të ekonomisë

-Ndarja e menaxhimit dhe pronësisë në firmat e mëdha

-Teknokratizimi i proceseve të vendimmarrjes ekonomike dhe politike

- *Në vendet socialiste*

-Prirje decentralizuese

-Eksperimente të ekonomisë së tregut

-Pranimi i metodave moderne të planifikimit ekonomik

-Afrimi me modelin konsumator perëndimor

-Kalimi nga një rritje ekstensive në intensive të ekonomisë



Konvergjencia kuptohet si përshtatje e sistemeve ekonomike socialiste ndaj kritereve të efikasitetit të prodhimit që mund të plotësohet vetëm nëpërmjet një ekonomie tregu. Si socializmi ashtu edhe kapitalizmi po kryejnë praktika që i përafrojnë me njëra-tjetrën. Vetë proceset shoqërore i shtërngojnë të veprojnë ashtu. Kështu, megjithëse pjesë të programit të liberalizmit klasik janë adaptuar gjerësisht në vende të ndryshme ai nuk është përfaqësuar plotësisht askund. Nëse liberalizmi mund të jetë një sukses si ideologji politike, nëse i duhet të fitojë besnikëri të gjerë, i duhet të jetë më përfshirës. Në një farë kuptimi, për të mbijetuar liberalizmi duhet të mësojë nga socializmi.

Nga ana tjetër, socializmi nuk është një prerogative e socialistëve. Shtrirja e demokracisë përmban një mori aspiratash dhe politikash të socialistëve por gjithnjë mund të gjenden çështje të shumta të tilla të implementuara nga partitë josocialiste madje dhe nga e djathta. Është e vërtetë që socialistët kanë qenë të detyruar të përshtasin kërkesat e tyre dhe të bëjnë kompromise por e njëjta gjë ka ndodhur me liberalët. Konsistenca e ngurtë mund t'u lejojë disa partive të vogla të mbijetojnë por do të përbëntë shkatërrimin për partitë dhe lëvizjet me ambicje hegjemonike.

### ***Teoritë e homogjenizimit të shoqërive***

Sipas teorive të homogjenizimit të shtresave shoqërore kompleksiteti teknik dhe ekonomik në rritje, bëjnë të domosdoshme sjelljen pragmatike, zgjidhjet larg ideologjive dhe largimin nga utopitë shoqërore. Shoqëritë industriale perëndimore

janë zhvilluar në një shoqëri të niveluar shtresash të mesme me marrëdhënie relativisht të homogjenizuara ku ballafaqimet ideologjike e kanë humbur mjaft rëndësinë e tyre. Politikisht prirja shfaqet në përshtatjen e partive social-demokrate apo socialiste me konsensusin liberal kapitalist në demokracitë perëndimore dhe në braktisjen përfundimtare të trashëgimisë së vet marksiste-leniniste. Për më tepër vihet re nivelizim i shtresave shoqërore, dmth një afrim i shtresave sociale duke i bërë partitë të prirën drejt mesit për të fituar votat e shtresës së mesme.

### ***Globalizmi***

Sipas qasjes globaliste, fenomeni i globalizmit ka bërë që politika të funksionojë sipas logjikës së konsumit dhe prodhimit, pa lojalitet ndaj ndonjë ideologjie. Globalizimi, një term i aplikuar së pari në investime, prodhim dhe tregti, gradualisht përqafoi një gamë të gjerë fenomenesh e procesesh komplekse të cilat shpesh herë janë edhe kontradiktore. Globalizmi aktualisht përfshin pothuajse çdo aspekt të jetës, që nga 'fast food-i', muzika, moda e shumëçka tjetër. Çdo lloj informacioni përhapet shumë shpejt ndihmuar nga revolucioni në teknologji, veçanërisht nga përhapja e internetit dhe televizionit satelitor. Më tepër sesa një ideologji, termi 'globalizim' shënon një set procesesh e dukurish të përfshira nën një epitet të vetëm. Në një vështrim të përgjithshëm duket sikur 'rendi i ri botëror' është më pak politik sesa ekonomik sepse nga një pikpamje realiste, faktorët materialë ekonomikë kanë qenë gjithnjë të një rëndësie parësore krahasuar me

diplomacinë dhe ‘fuqinë e butë’ civilizuese në arenën ndërkombëtare. Gjithsesi, është fakt që globalizimi ka ndikuar jo vetëm në dimensionin ekonomik por edhe në fushën politike, kulturore e atë sociale. Globalizimi është triumfi i logjikës së tregut mbi qeverinë. Si mbështetësit ashtu edhe kundërshtuesit e globalizimit janë në një mendje në lidhje me faktin se forca drejtuese sot është ajo e tregut, i cili po ndryshon rolin e çdo qeverie. Për mbështetësit e globalizimit, rezistenca do të ishte e panatyrshme, jo racionale dhe madje e rrezikshme. Duhet theksuar që liberalizimi i suksesshëm i tregjeve varet jo vetëm nga roli i kufizuar i qeverisë i konceptuar sipas mënyrës neoliberale por njëkohësisht, në mënyrë të paevitueshme edhe nga ndërhyrja dhe roli i fuqisë së centralizuar shtetërore. Globalistët kanë pritshmëri të larta nga qeveritë në lidhje me implementimin e axhendës së tyre dhe kjo del jashtë logjikës së ofruar në mënyrë të njëanshme nga ndonjë ideologji.

### ***Postmodernizmi***

Autorët postmodernistë si Foucault, Jean-François Lyotard dhe Jean Baudrillard e kanë braktisur ideologjinë (Ellis dhe Fopp, 2000, f. 5). Foucault argumenton se koncepti ‘ideologji’ vështirësisht mund të përdoret për tri arsye. E para, duke qenë se ideologjitë qëndrojnë në kah të kundërt me të vërtetën, sepse ideologjia ka një konotacion që ka të bëjë me diçka false, apo shfaqet e lidhur pazgjydhshëmrisht me diçka që është e vërtetë. Gjithsesi në këtë pikë ky konceptim postmodern ka një problem, sepse ligjërimi nuk e ka aftësinë e të vërtetës apo të pavërtetës

megjithëse Foucault është i etur për të gjetur funksionin social të cilin e luan koncepti i të vërtetës në të tilla ligjërime. Foucault është i matur në lidhje me ideologjinë duke qenë se ajo nënkupton një lloj të vërtete.

Arsyeja e dytë prej të cilës ideologjia është ‘diçka e pafavorshme’ për Foucault është se duket se aludon për nocionin e subjektit si të konstruktuar në një vend dhe kohe të veçantë i cili nuk është një vëzhgues autonom ose i pavarur sepse nuk ka vend kulturalisht neutral nga ku të merret një pozicion i privilegjuar. Së treti, ideologjia mund të braktiset sepse ideologjia është rezultat i përcaktuesve materialë, ekonomikë. Këtu problemi është manifestimi i një lloj materializmi ekonomik të vrazhdë apo i një lloj determinizmi të cilin Foucault nuk e pranon.

Lyotard i asocion të gjitha ideologjitë me metanarrativa totalizuese. Shqetësimi i tij është natyra totalitare e metanarrativave. Baudrillard është i mendimit se ideologjia nuk është më e përshtatshme në kontekstin e “zhdukjes së subjektit, vdekjes së kuptimit, fragmentarizimit të sociale, fundit të së vërtetës”.

### **2.2.8 Teza mbi ‘Fundin e Historisë’**

Konceptimi i fundit të historisë nuk e ka origjinën tek Fukuyama megjithëse ky është një ndër konceptimet më të famshme të kësaj teze ndoshta për faktin se lidhet me diskutimin e çështjeve bashkëkohore. Propoganduesi kryesor i kësaj teze në fakt ka qenë Karl Marksi i cili besonte se drejtimi i zhvillimit historik prirej drejt arritjes së një utopie komuniste e cila do të zgjidhte kontradiktat

paraprirëse. Gjithsesi, koncepti i historisë si një proces dialektik me një fillim, mes dhe përfundim u huazua nga Marksi i cili e huazoi nga filozofia e Hegelit.

Sipas *Francis Fukuyama*, triumfi i Perëndimit, pra i ideve Perëndimore është i dukshëm së pari tek shtërimi i alternativave sitematike ndaj Liberalizmit Perëndimor. Në dekadat e kaluara prej nga periudha kur autori shkruan, ka patur ndryshime të pakundërshtueshme në klimën intelektuale të vendeve më të mëdha komuniste si dhe fillim të lëvizjeve reformatore gjithashtu.

Fukuyama pretendonte se ajo që mund të ishte duke ndodhur nuk ishte vetëm fundi i Luftës së Ftohtë apo kalimi nga një periudhë e caktuar në një periudhë historike post luftë por në një të tillë periudhe që është fundi i historisë. Kjo pikë sipas tij është pika përfundimtare e evoluimit ideologjik të njerëzimit dhe e universalizimit të Demokracisë Liberale Perëndimore si forma përfundimtare e qeverisjes njerëzore.

Duke e shtyrë argumentimin më tej, sipas kësaj teze pretendohet që nuk do të ketë më ngjarje që do të mbushin buletinet e politikës së jashtme dhe marrëdhënieve ndërkombëtare. Sipas kësaj teze të Fukuyama-s fundi i historisë mund të rezultojë si një periudhe e mërzitshme, sepse ‘vullneti për të rrezikuar jetën për qëllime abstrakte, përplasja ideologjike mbarëbotërore që u bënte thirrje elementeve të guximit, kurajës, imagjinatës dhe idealizmi do të zëvendësohen nga përlllogaritjet ekonomike, zgjidhja pafund e problemeve teknike, shqetësimet në lidhje me - çështjet mjedisore dhe kënaqja e kërkesave të sofistikuar të konsumatorëve’

(Fukuyama,1989, f. 16). Për më tepër teza e fundit të historisë sipas Fukuyama-s parashikonte se në epokën post historike nuk do të ketë as art e as filozofi por vetëm përkujdesje të vazhdueshme për muzeumet e historisë njerëzore.

### **2.2.9 Rruga e tretë dhe ajo ‘Përtej të majtës dhe të djathtës’**

Prej viteve '80 diskutimet për të ardhmen e social demokracisë kanë ngritur një mori debatesh dhe problemesh. Këto çështje janë thelbësore për të kuptuar qasjen e *Rrugës së Tretë* në zhvillimet politike. Anthony Giddens e ka parë *Rrugën e Tretë* si një përgjigje ndaj një sërë elementesh kyçe. Sipas Giddens këto elemente apo dilema lidhen me:

- Globalizimin – Çfarë është globalizimi dhe cilat janë implikimet e këtij procesi
- E majta dhe e Djathta – si duhet të përballemi me arsyetimin se këto kategori nuk kanë më kuptim.
- Individualizmin – në çfarë kuptimi shoqëritë moderne po bëhen më individualiste nëse kjo po ndodh vërtetë.
- Agjensitë Politike – A po rrëshket politika nga mekanizmat ortodoksë të demokracisë?
- Problemet Ekologjike – Si mund të integrohen në politikën Social Demokrate?

Një karakteristikë tjetër e vizionit të rrugës së tretë është fakti që përpiqet të lëvizë përtej konfliktit dhe njëkohësisht përpiqet të harmonizojë pikat që krijojnë kundërshti. Qeveritë e majta që janë në pushtet ditët e sotme kanë lëvizur nga doktrina tradicionale e së majtës duke pranuar që vlerat e majta duhet të ndiqen me mjete të tjera nga ato të mëparshmet.

Sipas Anthony Giddens në librin “Përtej të Majtës dhe të Djathtës” demokracia liberale dhe shteti ‘welfare’ nëse shihen në mënyrë të veçantë, të dyja legjitimojnë njëra-tjetrën, nëse shihen së bashku, fshijnë vijën e ndarjes midis të majtës dhe të djathtës duke riformësuar proceset politike në Perëndim.

Konceptimi i një politike përtej të majtës dhe të djathtës i komplikon më tej gjykimet në lidhje me politikën në përgjithësi dhe veçanërisht me ideologjinë. Ngjarjet e vitit 1989 në Bashkimin Sovjetik dhe në bllokun e Europës Lindore kanë ndryshuar konceptin e asaj që mund të konsiderohet radikale. Kështu vihet në dyshim vlefshmëria e socializmit, neoliberalizmit si dhe konservatorizmit në një botë që karakterizohet nga globalizmi dhe braktisja e traditës. Kjo tezë vë në pikëpyetje shtetin ‘welfare’. Pasi Giddens identifikon se çfarë përbën një pozicionim të majtë duke e karakterizuar të majtën me barazinë më tej ai identifikon se çfarë del jashtë të majtës dhe të djathtës. Socializmi shihet më tepër si një teori e menaxhimit ekonomik dhe kështu ndodh që një nga vijat kryesore ndarëse midis të majtës dhe të djathtës fshihet. Sipas tezës së “Përtej të Majtës dhe të Djathtës”, çështje të tilla si ato ekologjike, familja si dhe identiteti

personal-kulturor janë përtej të majtës dhe të djathës. Më tej Giddens parashtron konceptin e ‘qendrës radikale’ duke sugjeruar se social-demokracia duhet të jetë radikale dhe jo e moderuar. Një fakt tjetër në të njëjtën linjë argumentimi është se zgjidhjet radikale që kërkohen për zgjidhjen e problemeve të qeverisjes nuk kanë gjithnjë relevancë për boshtin e ndarjes midis të majtës dhe të djathtës.

Në tregun politik shqiptar, prej kohësh ka patur diskutime për sloganin e Partisë Socialiste ‘*përtej së majtës e së djathtës*’. Argumentohet se ky slogan i frymëzuar nga veprat e Anthony Giddens u përdor nga Kryetari i PS-së Edi Rama për të treguar reformimin e Partisë Socialiste dhe të majtës shqiptare në periudhën ‘post-Nano’. Megjithatë ka dakordësi se kur u propozua ky slogan, në fakt nuk u shoqërua mirëfilli nga ndonjë shpjegim i qartë se çfarë do të transformonte konkretisht kjo qasje në politikat e Partisë Socialiste. Sidoqoftë, në periudhën para zgjedhjeve parlamentare, pothuajse në çdo katër vjet në Shqipëri, ende ka debate rreth çështjes a duhet të ketë programi i ardhshëm qeverisës një bosht ideologjik të djathtë ose të majtë apo duhet të jetë ‘*përtej të majtës e të djathtës*’. Politologë të ndryshëm në vend argumentojnë se prirja që zakonisht mbizotëron është prirja për ruajtje të *status quo-së* që karakterizohet nga qëllime të realizueshme dhe të matshme me kriteret objektive të asaj që quhet ‘qeverisja e mirë’ e cila shtyhet dhe monitorohet nga instrumentat ndërkombëtarë. ‘Kjo i mban programet larg ndikimit ideologjik dhe është një presupozim i ndërtuar mbi idenë se në parim të gjithë votuesit duan të njëjtën gjë dhe se për ta arritur atë mjafton vullneti i mirë i njerëzve të caktuar’. Gjatë zgjedhjeve parlamentare të vitit 2009, megjithëse pa



ndryshime rrënjësore në orientimin programor të PD-së dhe PS-së, ishte PS-ja me në krye Edi Ramën që u shfaq si artikuluere e politikës *‘përtej të majtës e të djathtës’*. Kjo në fakt nuk rezultoi zhgënjyese për pritshmërinë e shumë qytetarëve të stërlodhur nga debatet e ashpra politike. Argumentohet se *‘artikulimi përtej të majtës e të djathtës, nuk ofroi ndonjë program të mirëkonfiguruar apo ide të reja, por më tepër ofroi njerëz të tjerë për të qeverisur’*. Gjithsesi nuk ishte kjo arsyeja kryesore për dështimin e PS-së në zgjedhje përballë gabimeve taktike në formimin e koalicioneve, kështuqë politika *‘përtej të majtës e të djathtës’* nuk njohu transformime programore dhe nuk e provoi dështimin apo suksesin në veprim.

#### **2.2.10 Kritika të ‘Fundologjisë’**

Sipas grupit të autorëve që kritikojnë tezën e *‘fundit të ideologjisë’*, së pari parashikuesit e këtij fenomeni janë gabuar në vetë konceptimin e ideologjisë dhe së dyti, janë gabuar në mbrojtjen empirike të tezës së tyre. Në përdorimin e zbehjes së ndasive të vjetra shoqërore si argument ka pavlefshmëri sepse sidoqoftë në çdo shoqëri janë ngritur ndasi të reja. Kjo ka krijuar dilemën nëse ideologjitë po shuhen apo në vend të kësaj thjesht po zhvendoset përmbajtja e konkurrencës mbi baza të tjera ideologjike. Lloje të reja çështjesh postmateriale po ripolarizonjë publikun në Perëndim, duke stimuluar konflikte të reja në lidhje me cilësinë e ambjentit, barazinë gjinore si dhe në lidhje me përzgjedhjen e stilit të

jetës, etj. As parashikimi i Daniel Bell (1960) për shekullarizimin masiv të shoqërisë nuk rezulton i vërtetë. Ky shekullarizim nënkuptonte pakësimin e përmbajtjes morale të debatit politik. Nga ana tjetër ideologjitë sipas Bell duhet të konkuronin me fenë për suport publik. Feja sot mbetet një element i rëndësishëm në shumë demokraci perëndimore megjithë modernizimin social.

Nga ana tjetër, nëse trajtojmë teoritë e konvergencës, ato bazohen në konceptime të ngushta të rrethanave e institucioneve sociale, ekonomike e politike. Fakti është se edhe nëse këto teori provojnë një lloj konvergjence, ky fenomen vetë nuk përbën ‘fundin e ideologjisë’ por një ideologji në vetvete dhe argumenti shtrihet edhe më gjerë. Ky lloj argumentimi mund të shtrihet edhe mbi tezën e ‘fundit të historisë’ ku dominante është demokracia liberale, mbi fenomenin e globalizimit, çështjet ekologjike e kështu me radhë. Në vend që të mbrojnë ‘fundin e ideologjisë’, elementë të tillë përbëjnë vetë ideologji. Tezat e ‘fundologjisë’ në vetvete parashikojnë minimizimin e moralit dhe idealeve politike në shoqërinë postindustriale, por kjo nuk rezulton e vërtetë. Sjellja politike, besimet dhe qëndrimet e individëve ende ushqehen dhe udhëhiqen nga moraliteti dhe idealet në çdo shoqëri. Në përmbyllje të kritikës së ‘fundologjisë’, tezat e fundit të ideologjisë përbëjnë vetë një ideologji dhe siç u theksua edhe më lart, si rrjedhojë e karakteristikave dhe funksioneve të saj ideologjia është qendrore në fushën e politikës.

### **3.Kapitulli III : Hyrje në Rastin Studimor**

#### **3.1. Sfondi Politik**

Perandoria Osmane la gjurmë të thella në ndërgjegjen e shqiptarëve duke qenë se kjo Perandori e sundoi Ballkanin për rreth 500 vjet. Në vitin 1912, Shqipëria fitoi pavarësinë nga Osmanët duke u bërë kështu shteti i fundit që shkëputej prej këtij regjimi. Në vijim, uniteti dhe pavarësia e shtetit Shqiptar u vu në pikëpyetje shumë herë. Gjatë viteve të para të Pavarësisë, territori i vendit u kërcënua nga ushtritë fqinje të Greqisë, Malit të Zi dhe Serbisë. Për Shqipërinë pati vite të gjata lufte, kaosi, pushtimesh, dhe rreziku për zhdukje nga harta e Ballkanit. Një nga hapat vendimtar për t'i dhënë fund këtij kaosi dhe rreziku, e ndërmori Kongresi i Lushnjës, me përfaqësues/delegatë, gjerësisht nga i gjithë vendi. Kështu, në Janar të vitit 1920 në qytetin e Lushnjës u tubua një Kongres që u quajt Kongresi i Lushnjës. Ky Kongres shërbeu si Parlamenti i parë shqiptar. Pjesëmarrësit hartuan një Kushtetutë që shpallte Shqipërinë Republikë. Qëllimi kryesor ishte studimi i situatës dhe rrethanave të brendshme e të jashtme të vendit dhe masat që duhet të merreshin për shpëtimin e Shqipërisë. Pas ceremonisë së hapjes, u bë ndarja e deputetëve nëpër grupe (komisione) të ndryshme, të cilët filluan nga puna menjëherë.

Në mbledhjen e dytë të Kongresit, e cila u mbajt me datën 28 janar, u zgjodh si Kryetar i Kongresit Aqif Pashë Elbasani. Mbledhja e tretë vendosi pas shumë diskutimesh që të bëheshin protestat më të ashpra kundër vendimit të Fuqive të

Aleatëve për zbatimin e Paktit të fshehtë të Londrës, i cili ishte mbajtur më 26 prill të vitit 1915-të. Ky pakt sanksiononte copëtimin e Shqipërisë. Pas këtij vendimi, mbledhja analizoi qëndrimin e qeverisë së Durrësit, si në situatën e brendshme, ashtu dhe në atë të jashtme. Nga kjo analizë doli si konkluzion se qeveria e Durrësit kishte dalë dhe kishte vepruar jashtë programit të dhënë prej Kongresit të Durrësit, që ishte mbajtur në 25 dhjetor të vitit 1918. Po ashtu, ajo qeveri kishte penguar mbledhjen e Senatit që ishte vendosur në Durrës dhe me administrimin e saj të keq, e kishte futur vendin në anarki dhe kishte çuar në krijimin e një situatë të acaruar politike. Nisur nga këto rrethana, qeveria e Durrësit ishte përpjekur me çdo kusht për ta penguar mbajtjen e Kongresit të Lushnjës.

Kongresi i Lushnjës vendosi unanimisht rrëzimin e qeverisë së Durrësit. Pas kësaj u zgjodh dhe përbërja e qeverisë së re, e dalë nga ky kongres. Qeveria kryesohej nga kryeministri Sulejman Delvina. Pas Delvinës, në përbërje të qeverisë u zgjodhën dhe Ahmet Zogu, Ministër i Brendshëm, Mehmet Konica, Ministër i Punëve të Jashtme, Hoxhë Kadria, Ministër i Drejtësisë, Ndoc Çoba, Ministër i Financave, Sotir Peci, Ministër i Arsimit, Ali Riza Kolonja, Ministër i Luftës, Eshref Frashëri, Drejtor i Përgjithshëm i Punëve Botërore dhe Idhomene Kosturi, Drejtor i Përgjithshëm i Postë-Telegrafave. Në mbledhjen e pestë që u mbajt më 31 janar, Kongresi zgjodhi antarët e Senatit dhe u vendos që delegatët të mos shpërndareshin derisa qeveria të merrte në dorë drejtimin e shtetit. Pas kësaj

mbledhjeje, me 31 janar të vitit 1920, Kongresi u dha fund punimeve duke caktuar Tiranën si kryeqytet të Shqipërisë.

Menjëherë pas përfundimit të Kongresit në Lushnjë, Ahmet Zogu që u zgjodh Ministër i Punëve të Brendshme, u dërgoi të gjitha prefekturave një qarkore me anë të së cilës i bënte të ditur popullit shqiptar arsyet për mbajtjen e Kongresit Kombëtar të Lushnjës dhe u shpjegonte atyre vendimet që mori për shpëtimin e Shqipërisë nga rreziqet që e kërcënonin.

Në Dhjetor të vitit 1920 Shqipëria u pranua në Lidhjen e Kombeve. Prej vitit 1920 deri në 1924 Shqipëria u shënua nga një eksperiencë e shkurtër në lidhje me regjimin demokratik në shtet. Gjatë një lëvizjeje të dhunshme për marrjen e pushtetit dhe konfliktit midis Ahmet Zogut si konservator dhe Fan Nolit si përfaqësues i një aleance reformiste, Ahmet Zogu mori pushtetin. Më vonë, në vitin 1928 Ahmet Zogu u shpall Mbret. Gjatë sundimit të Zogut, Italia ushtroi një fuqi domethënëse në aspektin ekonomik dhe në aspektin militar në Shqipëri. Gjatë vitit 1939 Italia e aneksoi shtetin Shqiptar. Më tej u hap shtegu për pushtimin Gjerman të vendit. Gjatë vitit 1940 u shfaqën tre grupe kryesore të rezistencës ndaj pushtimit. Njëri nga këto grupe ishte ai monarkist dhe kryesohej nga Abaz Kupi, grupi tjetër ishte grupi komunist me në krye Enver Hoxhën kurse grupi i tretë ishte grupi republikan i Ballit Kombëtar i organizuar nga Mid'hat Frashëri. Njësitë antiguerrilje gjermane, të shoqëruara nga milicia, u angazhuan në luftime të pandërprera kundër Ushtrisë Nacional-Çlirimtare gjatë sezonit të vjeshtës dhe

të dimrit 1943 përreth qyteteve të mëdha në qendër dhe në jug të vendit. Kjo vinte si pasojë e vështirësive të hasura nga ushtria gjermane për t'u përhapur në vend dhe për të siguruar rrugët e komunikimit me Greqinë e Veriut dhe nëpërmjet saj, me Maqedoninë dhe Serbinë. Më 24 maj 1944 Lëvizja Antifashiste Nacional-Çlirimtare *LANÇ* mendoi se kishte mundur të krijojë kushtet për të thirrur në Përmet Kongresin e Parë Antifashist, gjatë të cilit ai ndërroi edhe emrin në Fronti Antifashist Nacional – Çlirimtar (FANÇ). Në planin praktik, Kongresi i Përmetit përcaktonte linjat e politikës së ardhshme. Ai vendosi ngritjen e një Shqipërie demokratike dhe popullore, ndaloi kthimin e Mbretit Zog në vend, anulloi të gjitha marrëveshjet dhe traktatet të nënshkruara nga qeveritë e mëparshme dhe vendosi për vazhdimin e lufës së armatosur deri në çlirimin e plotë të vendit. Më 1944 Fronti Nacional Çlirimtar çliroi Shqipërinë nga pushtimi i huaj. Tërheqja e trupave ushtarake gjermane në fund të nëntorit të vitit 1944 nga Shqipëria dhe futja 'triumfuese' e qeverisë së vetëzgjedhur komuniste në fund të tetorit 1944 në qytetin e Beratit, në kryeqytetin e 'çliruar' nga partizanët (apo të boshatisur nga vetë gjermanët), shënon edhe kohën e marrjes zyrtare të pushtetit nga komunistët në Shqipëri. Enver Hoxha u bë Kryeministër i Shqipërisë. Asambleja Kushtetuese e vitit 1946 e zëvendësoi Monarkinë me Republikën Popullore të Shqipërisë. Partia Komuniste e ndryshoi emrin në Partia e Punës. Marrja e pushtetit nga Enver Hoxha shënoi një ngjarje thelbësore në historinë e Shqipërisë. Regjimi i tij e 'paralizoi' vendin gjatë disa dekadash.

Sipas Hoxhës ekzistonte një rrezik i vazhdueshëm pushtimi për Shqipërinë prandaj marrëdhëniet e tij me aleatët ishin mjaft të turbullta dhe kjo gjë ndikoi edhe politikën në vend. Ky frikësim dhe rrezik i vazhdueshëm e çoi Shqipërinë në një izolim pothuajse total. Pas përjashtimit të Jugosllavisë nga Kominform-i gjatë regjimit komunist në Shqipëri, marrëdhëniet me Jugosllavinë u përkeqësuan si rrjedhojë e mbështetjes së Shqipërisë ndaj kampit Rus. Aleanca e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik mbeti e fortë por deri kur Sovjetikët shfaqën shenja afrimi me Jugosllavët pasi vdiq Satalini në vitin 1953. Marrëdhëniet Shqipëri-Rusi u përkeqësuan në vitet 1960 dhe në vitin 1961 marrëdhëniet diplomatike u ndërpreu. Kështu u bë Kina ajo që ofroi suport politik, ekonomik e teknik duke e deklaruar Shqipërinë si shtet ‘klient’ në përplasjet me Bashkimin Sovjetik. Afrimi me Kinën zgjati deri në vitin 1971 kur Kina rihapi relatat me Amerikën. Pas vdekjes së *Mao Tse Tung* në vitin 1976 Shqipëria ndërpreu marrëdhëniet me Kinën duke u afruar me Jugosllavinë. Përgjatë viteve, lidhshipi politik ndryshoi shumë pak dhe një ndryshim që ai i zgjedhjes së Ramiz Alisë si President i Presidiumit Parlamentar më 1981 duke e bërë kryetar shteti. Më 1985, Enver Hoxha vdiq pasi kishte sunduar për rreth 40 vjet si udhëheqës i vendit. Kursi që i dha Alia drejtimit të vendit ishte përgjithësisht më pozitiv se sa ai i regjimit Hoxha. Kështu më 1985 u hap kufiri me Greqinë si rrjedhojë e nënshkrimit të disa marrëveshjeve bashkëpunimi ekonomik. Pavarësisht hapjes, gjendja ekonomike në Shqipëri u përkeqësua si dhe vëmendja e shqiptarëve po kthehej nga media e

huaj që pasqyronte ngjarjet revolucionare në Europën Lindore. Ky kontakt me botën e jashtme e vuri më në pah izolimin e gjatë dhe varfërinë e Shqipërisë.

Kështu u arrit që në Dhjetor 1989, studentët e Universitetit të Tiranës të protestonin ndaj kushteve të jetës në konvikte. Një muaj më vonë, ky veprim u pasua nga një demonstratë studentore në Shkodër gjatë të cilës popullata u përpoq të rrëzonte statujën e Stalinit. Në këtë mënyrë lindi një lëvizje opozitare e rezistente ndaj regjimit. Ramiz Alia bashkë me Komitetin Qëndror u përpoq të ulte pakënaqësitë duke ndërmarrë një program demokratizimi të kufizuar të institucioneve sociale dhe ekonomike. Sidoqoftë kufijtë mbaheshin të mbyllur dhe ushtrohej kontroll total mbi mediat. Ende besohej se Shqipëria do të ndiqte një itinerar specifik në lidhje me socializmin pavarësisht zhvillimeve në Europën Lindore. Gjatë sesioneve parlamentare të 7 dhe 8 Majit 1990, Kryeministri Adil Çarçani shpalli se do ndërmerreshin programe liberalizimi që përfshinin lirinë për të udhëtuar jashtë vendit si dhe reduktime të dënimeve të parashikuara nga kodi penal. Një tjetër synim i parashtruar ishte edhe ai i vendosjes së marrëdhënieve me Komunitetin Europian dhe pjesëmarrja në Konferencën për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë. Me 28 Qershor qindra shqiptarë u ngjitën në rrethimet e sigurisë së ambasadave të huaja në Tiranë duke pushtuar tokën e Ambasadave për ditë me rradhë.

Kjo ishte një shenjë proteste për pamundësinë për të udhëtuar jashtë Shqipërisë. Me 6 Korrik mijëra njerëz dolën në rrugët e Kryeqytetit duke protestuar për



reforma. Përgjatë viteve 1990 deri me 1991 qëllimet e Ramiz Alisë ishin të paqarta por ndryshimet që qe i detyruar t'i ndërmerre nuk bënë gjë tjetër veçse rritën pritshmëritë për reforma më thelbësore. Në Dhjetor 1990 pati sërish demonstrata studentore të cilat u kthyen në konfrontime me shtetin. Në këto kushte u formua Partia Demokratike. Persona të ndryshëm kundërshtarë të regjimit të vjetër, si Sali Berisha, Azem Hajdari, Arben Imami, Gramoz Pashko dhe Eduard Selami draftuan statutin e partisë Demokratike. Kështu nisi mobilizimi për suport. Me datë 19 Dhjetor Partia Demokratike mori statusin ligjor nga Ministria e Drejtësisë. Më 1 Janar 1991, Ramiz Alia deklaroi se zgjedhjet do mbaheshin me datë 10 Shkurt dhe do të ishin totalisht të lira. Për arsye se opozita nuk do të kishte kohën e duhur për t'u përgatitur, zgjedhjet u shtynë për në 31 Mars. Gjithsesi kjo ndodhi pas grevës së minatorëve që paraqitën kërkesën për shtyrjen e zgjedhjeve. Njoftimi për mbajtjen e zgjedhjeve gjallëroi atmosferën në lidhje me shoqërinë civile në Shqipëri. Gjatë Shkurtit 1991 më shumë se 60000 njerëz u mblodhën në sheshin Skënderbej për të rrëzuar statujën e Enver Hoxhës dhe për të djegur veprat e tij. Pak më vonë, Partia e Punës e ndryshoi emrin në Partia Socialiste.

Zgjedhjet e 31 marsit 1991 për herë të parë u zhvilluan me subjekte të tjera, veç PPSH-së. Këto zgjedhje ishin një zhgënjim për ata që menduan se demokracia do të vinte menjëherë në Shqipëri. Gjurmët e komunizmit ishin më të thella nga sa ishte menduar, veçanërisht në fshat. Fshati nuk votoi për alternativën demokratike

pavarësisht se u premtua që do t'i kthehej toka. Në atë kohë u pa që reagimi i diktaturës ishte akoma i fortë, si në rastin e dëshmorëve të Shkodrës.

Në zgjedhjet e mbajtura me 31 Mars dhe 8 Prill, Partia e Punës fitoi 170 nga 250 vende. Opozita e legalizuar rishtas fitoi 75 vende kurse 5 vendet e tjera i fitoi lëvizja Omonia. Drejtuesit e Partisë Demokratike mendonin se zgjedhjet ishin të padrejta dhe jo legjitime. Këto ankesa u bazuan në avantazhet infrastrukturore të Partisë së Punës si dhe në dizenjimin e zonave zgjedhore të cilat ishin disproporcionale. Kjo do t'i shtynte mbështetësit e PD-së drejt favorizimit të sistemit proporcional për zgjedhjet e tjera. Gjithsesi, vendi arriti në një gjendje paralize dhe qeveria dha dorëheqjen me 5 Qershor 1991. Kjo qeveri e dorëhequr u zëvendësua nga një qeveri e quajtur 'Qeveria e Stabilitetit Kombëtar' dhe dominohej sërish nga e majta. Përfaqësues kishte edhe nga Partia Agrare, ajo Republikane si dhe nga Social Demokratët. Ylli Bufi, një ekonomist (dhe ish anëtar i Partisë së Punës) u caktua si Kryeministër. Mes paqëndrueshmërisë dhe trazirave politike, do të duhej edhe një vit tjetër që të mbërrinte 22 Marsi i 1992-shit, që të shënohej transferimi i pushtetit dhe një largim përfundimtar nga diktatura. Me numërimin e votave në këto zgjedhje të bazuara në sistemin proporcional, Partia Demokratike kishte fituar 92 nga 140 mandate, Partia Socialiste fitoi 38 mandate kurse partitë e vogla fituan 10 mandate. Katër muaj më vonë u zhvilluan zgjedhjet për përfaqësuesit Lokal ku Partia Socialiste doli në avantazh me 18 bashki të fituara. Këto zgjedhje të cilat nuk e favorizuan PD-në

nuk i shërbyen shumë stabilitetit politik të vendit. Gjithsesi, në verën e vitit 1992, Shqipëria kishte ndërmarrë një rrugë të vështirë në tranzicionin demokratik.

### **3.2. Sfondi Juridik**

Forma e qeverisjes që shpreh parimet dhe mënyrën e organizimit të organeve të larta të shtetit është element shumë i rëndësishëm i formës së një shteti duke qenë se ka të bëjë me organizimin e organeve më të larta të pushtetit shtetëror. Ky pushtet kuptohet si i aftë të marrë vendime, të lëshojë urdhra, të sigurojë zbatimin e tyre edhe me përdorimin e shtërngimit fizik duke qenë se shteti cilësohet edhe si monopol i ushtrimit të dhunës së ligjshme në rast se kjo është e nevojshme. Pushteti shtetëror sipas formës së tij, në një kuptim më të ngushtë është kriter dallues i shteteve që kanë ndarje të pushtetit dhe atyre ku ekziston unitet pushteti. Një dallim i tillë rrjedh nga raporti midis organeve ligjvënëse, ekzekutive dhe organeve gjyqësore mbi bazë të të cilave dallohen tre pushtetet përkatëse. Në rast se pushteti legjislativ, pushteti ekzekutiv dhe ai gjyqësor janë të shkëputur nga njëri-tjetri dhe kanë sferat e tyre të veprimit e të kompetencës, atëherë shteti është i bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve. Ky parim është një nga shtyllat kryesore të organizimit të shteteve demokratike. Vendi që do të zënë organet në pushtetin legjislativ, ekzekutiv apo gjyqësor duke përcaktuar edhe natyrën e tyre në raport me këto pushtete është mjaft i rëndësishëm pasi përputhja e vendit që i jepet me natyrën e tij ndikon në funksionimin e aparatit shtetëror dhe në mbajtjen e balancës midis pushteteve.

Çdo shtet funksional, ashtu si dhe Republika e Shqipërisë ka patur dhe ka veprimtari ligjvënese. Organ ligjvënës në vendin tonë është Kuvendi si një organ përfaqësues nëpërmjet të cilit populli ushtron sovranitetin e tij të sanksionuar në Kushtetutë (neni 2/1). Kushtetuta e paraqet Kuvendin si shprehësin më autentik të sovranitetit të popullit dhe i jep atij pushtetin më të lartë në shtet duke vendosur Republikën Parlamentare. Qeverisja në mënyrë demokratike lidhet ngushtë jo vetëm me Parlamentin si organ përfaqësues por edhe me parlamentarizmin dhe me epërsinë ligjvënese të Parlamentit. Kjo është një çështje që ka lidhje edhe me parimin e pluralizmit ku pakicat parlamentare dhe opozita në tërësi është një organ i sovranitetit popullor po aq sa edhe qeveria (Anastasi, 2004, p. 129).

Iniciativa ligjvënese i dedikohet çdo deputeti e njëkohësisht Këshillit të Ministrave dhe 20 mijë zgjedhësve, pra në vendin tonë hasim iniciativë ligjvënese parlamentare, qeveritare dhe popullore. Iniciativa ligjvënese parlamentare ushtrohet nga çdo deputet çdonjëri prej të cilëve ka të drejtë t'i paraqesë një projektligj Kuvendit. Iniciativa ligjvënese e Qeverisë ushtrohet me miratim nga ana e Këshillit të Ministrave të një projektligji i cili i paraqitet Kuvendit. Kushtetuta e vitit 1998 i dha më tepër mundësi Qeverisë të ushtrojë iniciativën ligjvënese duke qenë se kjo tagër kushtetuese nuk i përket më Presidentit të Republikës. Procesi i hartimit të projektligjeve në Ekzekutiv në dallim nga ai në Kuvend është i mbyllur. Kjo është karakteristikë e organeve kolegjiale jo të zgjedhura (neni 9 i ligjit 8480). Kuvendi nuk ka një funksion të thjeshtë për nxjerrjen e ligjeve por gëzon edhe funksionin për të bashkëvepruar me Qeverinë

në zhvillimin e gjithë aktivitetit të drejtimit politik të vendit. Në formën Republikë Parlamentare të qeverisjes Parlamenti dhe Qeveria si organe të drejtimit politik nuk veprojnë të ndara nga njëra-tjetra por veprojnë me një koordinim të ngushtë ndërmjet tyre që në momentin kur Qeveria merr votëbesimin nga Parlamenti. Kuvendi është një organ i drejtimit politik sepse miraton programin e Qeverisë duke i dhënë asaj votëbesimin, nxjerr një seri aktesh të drejtimit politik, urdhëra të ditës, mocione (edhe mosbesimi) e rezoluta të cilat u takon organeve qendrore t'i zbatojnë. Nga Kushtetuta duket se Presidenti i Republikës dhe Gjykata Kushtetuese nuk janë organe të drejtimit politik. Institucionalisht megjithatë atyre u njihet një forcë politike e konsiderueshme.

Në Kushtetutë parashikohet si organ me rëndësi kushtetuese Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) si një organ i përhershëm kushtetues që përgatit, mbikqyr, drejton dhe verifikon të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me zgjedhjet e referendumet dhe shpall rezultatin e tyre. Kushtetuta është përkujdesur të sigurojë veprimtari të paanshme e të pavarur të KQZ-së duke përcaktuar statusin e anëtarëve të KQZ-së dhe mënyrën e zgjedhjes së tyre. Duke u nisur nga parimi i paanshmërisë, Kushtetuta nuk e ka përfshirë atë në asnjërin nga pushtetet duke i lënë kështu një rregullim të posaçëm kushtetues por kjo më vonë është rirregulluar me ligj.

Kushtetuta e miratuar në nëntor të vitit 1998 sanksionoi nenin 154 ku bëhej fjalë për përbërjen dhe mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve të Komisionit Qendror të

Zgjedhjeve (KQZ). Konkretisht: dy anëtarë zgjidheshin nga Kuvendi, dy nga Presidenti i Republikës dhe tre nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD). Përmbajtja e këtij neni u pasqyrua edhe në kodin zgjedhor që u miratua në vitin 2000. Në vitin 2002, opozita e atëhershme kundërshtoi procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të KQZ-së me pretendimin se kjo mënyrë zgjedhjeje ishte në favor të mazhorancës. Për kapërcimin e këtij ngërçi bllokues në nenin 22 të kodit zgjedhor të vitit 2003 u ndryshua procedura e zgjedhjes të anëtarëve të KQZ-së. Presidenti i Republikës dhe KLD-ja duhet të mbështeteshin dhe të kishin parasysh propozimet e partive politike përkatëse. Synimi i këtij ndryshimi ishte balancimi relativ politik i përbërjes së KQZ-së. Kjo procedurë, në fakt, ashtu siç theksohej edhe në raportet e OSBE/ODHIR, e kthente Presidentin dhe KLD-në në ‘vulosës’ të propozimeve partiake. Në dhjetor të vitit 2008 u miratua Kodi i ri Zgjedhor, dhe neni 154 u shfuqizua. Ndryshime në sajë të ndërmarrjes së reformës së kodit zgjedhor pati edhe gjatë vitit 2012 megjithëse këto ndryshime nuk mund të thuhet se ishin thelbësore në lidhje me kuadrin ligjor të zgjedhjeve. Me konsensusin e vitit 2012 u riformatua mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të KQZ-së dhe mandatet e tyre.

Pushteti ekzekutiv përbëhet nga organe qendrore ose vendore në krye të të cilëve qëndron Qeveria. Qeveria shqiptare përbëhet nga Kryeministri e Zv. Kryeministri të cilët e kryesojnë Qeverinë dhe nga Ministrat të cilët qëndrojnë në krye të ministrive përkatëse (organe kushtetuese). Qeveria, si organ kolegjial, përbëhet nga disa organe individuale. Sipas Kushtetutës në fuqi, Kryeministri shfaqet si

pika qendrore e ekzekutivit. Një vend të rëndësishëm në kuadrin e organeve ekzekutive zënë edhe zyrat e administrimit publik sipas sektorit në të cilin veprojnë.

Kryeministri dhe Ministrat janë organe me veshje ‘të dyfishtë’, atë burokratike duke qenë se janë organe të vendosura në mënyrë hierarkike në krye të Institucioneve përkatëse dhe me veshjen e ‘organeve të qeverisjes’ sepse në mënyrë kolegjiale veprojnë për drejtimin politik dhe administrativ të vendit. Këto funksione janë të ndërvarura ndërmjet tyre. Përveç funksioneve administrative dhe drejtimit politik organet ekzekutive mund të nxjerrin edhe akte normative që kanë përmbajtjen tipike të ligjit (por jo formën e tij) .

Aktet që nxjerr Këshilli i Ministrave, janë vendime dhe udhëzime të Qeverisë në cilësinë e Organit Kolegjial të cilat janë të vlefshme kur nënshkruhen nga Kryeministri. Në hartimin e akteve të saj, Qeveria i nënshtrohet ligjeve të miratuara nga Kuvendi dhe Kushtetutës; në rast të kundërt ato mund të lihen pa fuqi nëse deklarohen të paligjshme nga Gjykata.

Pushteti Gjyqësor është një nga pushtetet më të ndjeshëm në lidhjen e tij me qytetarët prandaj Kushtetuta përcakton disa nga parimet më të rëndësishme të pushtetit e të funksionimit gjyqësor. Si i tillë është parimi i pavarësisë së gjyqësorit. Çështjet e pavarësisë së Gjyqësorit dhe raportet e tij me pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv kanë qenë gjithmonë probleme të shtruara për zgjidhje në nivel kushtetues. Kushtetuta shqiptare ka afirmuar ekzistencën e shkallëve

kryesore të gjykimit: Gjykata e Lartë, Gjykatat e Apelit dhe Gjykatat e Shkallës së Parë. Shteti, ndërsa me anë të funksionit ligjvënës vendos normat që përbëjnë rendin e tij juridik, me anën e funksionit gjyqësor garanton mbikqyrjen dhe mbrojtjen e normave kryesore. Në dallim nga administrata publike, sistemi gjyqësor nuk organizohet në mënyrë hierarkike. Në bazë të Kushtetutës pavarësia e autoriteteve gjyqësore në raport me organet e tjera garantohej nga Presidenti i Republikës si organ ekuilibruar i asistuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe nga Kuvendi. Funksionet e pushtetit Ekzekutiv duken të kufizuara në fushën e administrimit gjyqësor. Ministrat të Drejtësisë i rezervohet që të përkujdeset vetëm për organizimin e funksionimit të shërbimeve që i përkasin drejtësisë. Përveç gjykatave, organe të drejtësisë janë edhe hetuesia e cila heton sipas një procedure të caktuar veprat penale para se t'i çohen për gjykim gjykatës dhe prokuroria e cila ka për detyrë të ushtrojë ndjekjen penale dhe të përfaqësojë akuzën në gjyq. Në një farë mënyre, organizimi i organeve të larta të shtetit dhe ndërthurja, lidhja dhe njëkohësisht veçanësimi i sferave të funksioneve e kompetencave në një shtet, krijon një pasqyrë të formës së qeverisjes ku shkalla e zhvillimit të elementeve të kontrollit e të balancimit është tregues i modernizimit të formës së qeverisjes.

Duke iu rikthyer çështjes së zgjedhjeve, duhet theksuar se sistemi zgjedhor i përcaktuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në vitin 1998 si dhe ndryshimet në Kushtetutë dhe në Kodin Zgjedhor në vitin 2008 e 2012 për sistemin e zgjedhjeve dhe formulën zgjedhore janë çështje mjaft të rëndësishme të



cilat kanë ndikuar zhvillimet politike në vend. Në vitin 1998 Kushtetuta përcaktoi një sistem zgjedhor të përzier, mazhoritar të korrigjuar. Me këtë sistem 100 deputetë zgjidheshin drejtpërdrejt në zonat njëemërore, ndërsa 40 deputetë zgjidhen nga listat shumëemërore. Formula zgjedhore e ndarjes së mandateve shtesë duhej të siguronte një ndarje të mandateve në proporcion me numrin e votave. Pas zgjedhjeve të vitit 2001 u vu re se sistemi zgjedhor dhe formula e ndarjes së mandateve të zgjedhjeve lejonin hapësira ligjore të cilat u shfrytëzuan nga parti politike për të deformuar rezultatin e zgjedhjeve dhe për të fituar ‘bonuse’ zgjedhore në sigurimin e një numri më të madh të mandateve në parlament në raport me numrin e votave të fituara në shkallë vendi. Në vitin 2001, Partia Socialiste me bllokimin e zgjedhjeve në raundin e parë në zonën zgjedhore 60, u krijoi mundësi aleatëve të saj si parti të vogla të marrin votat e nevojshme për të mbërritur pragun elektoral 2.5 për qind. Megjithë kundërshtimet e opozitës për shkelje të Kushtetutës dhe të ligjit zgjedhor në rastin e përsëritjes së zgjedhjeve në këtë zonë, Gjykata Kushtetuese duke interpretuar Kushtetutën vendosi të konsiderojë të ligjshme zgjedhjet e zonës së Dushkut dhe përcaktoi se kuptimi i kësaj dispozite lidhet me kryerjen e votimit në të gjithë vendin. Kushtetuta, në nenin 68 ka parashikuar se rregullat e zgjedhjeve për caktimin e kandidatëve për deputetë rregullohen nga Kodi Zgjedhor, i cili nuk mund të mos zbatohet. Zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2001 treguan se sistemi i zgjedhjeve dhe formula e zgjedhjeve lejonin modifikimin dhe deformimin e rezultatit të

zgjedhjeve nga partitë politike. Ishte e nevojshme të bëheshin modifikime në sistem dhe në formulën e zgjedhjeve.

Me ndryshimet e Kodit Zgjedhor në vitin 2003 u prekën kryesisht dy çështje: -U kalua në zgjedhje të përgjithshme me sistem mazhoritar me një raund dhe u shfuqizua dispozita e parashikuar nga neni 63 i Kodit Zgjedhor të vitit 2000, që parashikonte zgjedhje me dy raunde. Formula zgjedhore për ndarjen e mandateve shtesë u ndryshua, por përsëri mbeti e ndërlikuar dhe jo e qartë. Komisioni i Venecias në raportin paraprak të paraqitur në vitin 2004 sugjeroi hartimin e një formule të re për ndarjen e mandateve shtesë të Kuvendit, me synimin që formula e ndarjes së mandateve të zbatonte më me saktësi dhe me qartësi paragrafin e dytë të nenit 64 të Kushtetutës. “Eliminimin e raundit të dytë e sanksionoi një vendim i Gjykatës Kushtetuese, që interpretonte pikërisht nenin 64 të Kushtetutës, ku afirmohej se raundi i dytë kuptohej vetëm si një mundësi dhe jo një detyrim. Në këtë mënyrë u ruajt sistemi i përzier, me raportin numerik ekzistues midis deputetëve të zgjedhur në listat njëemërore dhe në ato shumëemërore por me një thjeshtëzim të dukshëm të procesit zgjedhor.

Zgjedhjet e vitit 2005 u bazuan në ndryshimet e bëra në sistemin zgjedhor. Zgjedhjet u zhvilluan me një raund por zgjedhësit kishin të drejtën e dy votave, njërën për zonën njëemrore dhe tjetrën për proporcionalin. Formula e zvogëlonte mjaft mundësinë e partive të mëdha për të fituar nga ndarja e mandateve shtesë dhe dy partitë e mëdha nuk pretenduan vota në proporcional duke orientuar

zgjedhësit që votat e tyre t'i hedhin për partitë e vogla aleate. Për këtë shkak në këto zgjedhje u realizua trafik votash në favor të partive të vogla aleate. Partitë e vogla siguruan më shumë mandate sepse ato përfituan vota nga aleatët e mëdhenj. Kjo u quajt formula e “Megadushkut”.

Në zgjedhjet e vitit 2005 Partia Demokratike dhe Partia Socialiste, nuk siguruan asnjë mandat nga ndarja e mandateve plotësuese. Partia Demokratike siguroi 56 mandate, 40 për qind të vendeve në Kuvend dhe Partia Socialiste 42 mandate, 30 për qind të vendeve në Kuvend dhe dyzet mandatet plotësuese u ndanë vetëm nga partitë e vogla. Në qoftë se në zgjedhjet e vitit 2001 dy partitë e mëdha siguruan numër vendesh në Kuvend të përafërt me numrin e votave të tyre të marra në shkallë vendi, në zgjedhjet e vitit 2005, këto dy parti në shkallë vendi morën përkatësisht, Partia Demokratike 7,6 për qind të votave dhe Partia Socialiste 8.89 për qind të votave. Trafikimi i votave të proporcionalit krijoi akses për trafik mandatesh. Partia fituese nuk përbënte shumicën parlamentare dhe u detyrua të krijojë aleanca paszgjedhore, që të sigurojë shumicën parlamentare për formimin e qeverisë.

Dy partitë e mëdha e toleruan formulën e “Megadushkut”, që të siguronin shumicën në Kuvendin e Shqipërisë. Në të vërtetë synimi i sistemit ishte të shfrytëzohen avantazhet e dy sistemeve: e votimit në zonën njëemërore dhe e votimit në proporcional që synonte të korrigjonte deformimin e natyrshëm të

zgjedhjeve në mazhoritar, por jo një korrigjim të plotë, vetëm një korrigjim të pjesshëm të rezultatit të siguruar në mazhoritar.

Zgjedhjet e vitit 2001 dhe të vitit 2005 provuan se, për të shmangur devijimet e ‘dushkut’ dhe ‘megadushkut’ ishte e nevojshme të ndryshonte sistemi zgjedhor në Shqipëri. Është ky shkaku që në vitin 2008 Kuvendi i Shqipërisë bëri ndryshime në Kushtetutë për sistemin e zgjedhjeve dhe formulën zgjedhore. U ndryshua neni 64 i Kushtetutës dhe sistemi zgjedhor i kombinuar u zëvendësua me një sistem proporcional të rajonizuar. Kjo do të thotë se nuk kemi të bëjmë me një sistem të pastër proporcional në të cilin Shqipëria do të ishte një zonë zgjedhore. Sistemi proporcional bazohet në ndarjen e vendit në zona shumëëmërore. Kushtetuta ka përcaktuar se zona shumëëmërore përputhet me ndarjen administrative të një prej niveleve të organizimit administrativo – territorial. Kodi Zgjedhor ka përcaktuar se “zona zgjedhore përputhet me territorin e qarkut. Duke vështruar sa përcaktohet në Kushtetutë për sistemin e zgjedhjeve, mund të nënvizohet se sistemi proporcional i zgjedhjeve synon që rezultati i zgjedhjeve për partitë politike apo subjektet zgjedhore të jetë në proporcion me numrin e përgjithshëm të votave të fituara në zgjedhje, në çdo zonë zgjedhore. Sistemi zgjedhor proporcional u lejon votuesve të drejtën e vetëm një vote për subjektin politik që ai preferon dhe nuk lejon akses për të trafikuar votën e zgjedhësit. Zgjedhësi ka vetëm një alternativë.

Kodi Zgjedhor i cili u miratua më 29 Dhjetor 2008 u kundërshtua nga partitë e vogla fillimisht për shkak të sistemit zgjedhor proporcional rajonal ndërsa më

vonë edhe për përbërjen e komisioneve zgjedhore. Pretendimet në këtë drejtim u shprehën sidomos nga Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) dhe Partia Demokristiane (PDK). Gjithsesi nuk u arrit të pengohej miratimi i Kodit të ri Zgjedhor. Sistemi i ri zgjedhor shmang dukurinë e “Dushkut” të vërtetuar në zgjedhjet e mëparshme që siç u theksua, lejonte transferimin e votës dhe deformimin e vullnetit të zgjedhësve. Gjithashtu për herë të parë parashikohej se të paktën 30% e listës shumëemërore të kandidatëve për deputet duhet t’i përkasin secilës gjini. Moszbatimi i këtij rregulli shoqërohet me sanksione. Megjithatë Kodi i ri Zgjedhor paraqiti disa mangësi si për shembull ajo e mospërfshirjes së një ri/rregullimi mbi referendumet. Gjithashtu, rekomandime të rëndësishme të OSBE-ODIHR mund të thuhet se nuk janë marrë plotësisht parasysh. Në vitin 2012 u bë një përpjekje tjetër për riformatimin e KQZ-së dhe pati disa ndryshime konsensuale. Një nga ndryshimet kryesore ishte edhe riformatimi i mënyrës së zgjedhjes së anëtarëve të KQZ-së si dhe mandatet e tyre. Tanimë duhet theksuar se sistemi ka pësuar një reformë rrënjësore duke iu nënshtruar Reformës Administrative-Territoriale por kjo është jashtë fokusit të këtij studimi me kufizimet e përcaktuara në shtrirjen e tij që prej fillimit.

### **3.3. Tranzicioni demokratik**

Fundi i viteve '80 dhe fillimi i viteve '90 të shek. XX, u shoqëruan me zhvillime të rëndësishme politike në Europën Lindore. Nga këto ngjarje nuk u përjashtua vendi ynë. Vitet që kaluan si vite tranzicioni karakterizohen nga zhvillime të

fuqishme politike, sociale e mbi të gjitha ekonomike. Në vendin tonë sistemi kaloi nga ai një partiak në atë demokratik pluralist. Ndodhi kalimi nga një ekonomi e centralizuar në themel të së cilës ishte filozofia e pronës së përbashkët në një ekonomi të decentralizuar me themel pronën private. Sipas Adrian Civicit (2012), dhjetë politikat dhe masat e para të fillimit të tranzicionit në Shqipëri ishin; së pari, aprovimi i “ligjit për tokën” më 19 korrik 1991, i cili parashikonte shkatërrimin e kooperativave bujqësore (që zinin mbi 75% të fondit të tokës së punueshme në shkallë vendi në vitin 1989) dhe shpërndarja falas e tokës për anëtarët e këtyre kooperativave në varësi të disponibilitetit të tokës dhe numrit të anëtarëve. Përfundimi i çdo mundësie që ish-pronarëve t’u kthehej fizikisht toka sipas pronave të para vitit 1944 dhe reformës agrare mbas Luftës së Dytë Botërore; përfundimi i të huajve nga mundësia e blerjes së tokës. Së dyti, krijimi i një agjencie kombëtare të privatizimeve, që duhet të administronte gjithë procesin e privatizimeve në sektorët e shërbimeve, tregtisë, industrisë etj. U parashikua që vetëm gjatë vitit 1992 të dilnin për privatizim mbi 25000 objekte të vogla e të mesme tregtare, artizanale etj. Faza e privatizimeve të mëdha duhej të fillonte mbas vitit 1992, mbasi të përfundonte dhe transformimi i ndërmarrjeve të mëdha shtetërore në shoqëri aksionere. Së treti, liberalizimi i çmimeve duhej të bëhej i plotë me përfundim të tre produkteve bazë, si buka, vaji ushqimor dhe sheqeri. Së katërti, futja e sistemit të konvertibilitetit të lirë të lekut dhe përcaktimi në treg i kursit të këmbimit të lekut me monedhat e tjera të huaja. Për blerjet dhe shitjet me monedhë të huaj, qeveria shqiptare vendosi ECU si monedhë njësi reference. Së

pesti, liberalizimi i tregtisë së jashtme me përjashtim të një liste të veçantë produktesh që kërkonin miratim të veçantë nga Ministria e Ekonomisë. U vendos dhe një tarifë unike doganore prej 10%. Së gjashti, në janar 1991, Shqipëria aderon në FMN dhe menjëherë përfiton një kredi *stand-by*, e cila i hapte rrugën dhe burimeve të tjera të financimit për ekonominë dhe zhvillimin. Së shtati, në prill 1991, Shqipëria bëhet anëtare e Bankës Botërore, e cila ofron menjëherë ekspertizë për sektorin bankar dhe atë agro-ushqimor. Së teti, më 9 tetor 1991, Shqipëria hyn në BERZH (Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim) duke lehtësuar së tepërmi financimet e huaja shumë të domosdoshme në këtë moment. Së dhjeti, Shqipëria vendos marrëdhënie diplomatike me të gjitha vendet e BE-së.

Gjatë këtyre viteve tranzicioni, shoqëria shqiptare është përballur me një sërë problemesh ku nga më të rëndësishmet mund të përmendim papunësinë masive, emigracionin, dukurinë e ekonomisë informale dhe tregun informal të punës, trafiqet e jashtëligjshme, destabilitin politik, varfërinë, mungesën e shërbimeve elementare të jetesës etj. Shqipëria tashmë është futur në dekadën e tretë të periudhës së tranzicionit nga ekonomia e centralizuar në ekonominë e tregut. Gjatë kësaj periudhe kanë ndodhur ndryshime të mëdha në shumë fusha. Në vitet e para të tranzicionit, Shqipëria pati arritje ku u përfshinë përpjekjet e mëdha për një stabilizim të gjithanshëm dhe zbatimin e reformave të gjera strukturore. Reformat ekonomike të kryera në këtë periudhë u mbështetën në një masë të konsiderueshme nga ndihma e huaj, e cila së bashku me hyrjet e mëdha të transfertave private nga jashtë, ndihmoi në stabilizimin e vendit. Me gjithë

përparimet e bëra, përpjekjet për të krijuar një shtet me kapacitetet e duhura të qeverisjes në mënyrë efektive u hasën shumë sfida. Falimentimi i firmave piramidale në fillim të vitit 1997 u shoqërua me një krizë të thellë qeveritare, e cila u pasua shumë shpejt nga trazira shoqërore që u manifestuan në forma të ndryshme dhe që kulmuan në shpërthime dhune dhe një rebelim të armatosur. Kjo krizë jo vetëm ndali procesin e tranzicionit demokratik dhe atë të mëkëmbjes ekonomike, por shkatërroi mjaft arritje të deriatëhershme.

Pavarësisht nga fakti që rritja ekonomike gjate viteve ka qenë e qëndrueshme, ajo nuk ka mundur të çojë ende në një përmirësim të ndjeshëm të jetës së shqiptarëve. Shqipëria vazhdon të jetë një nga vendet më të varfra të Europës, me pabarazi të theksuar në rritje të të ardhurave. Shqiptarët përgjithësisht janë të varfër, me të ardhura të kufizuara dhe kushte jetese të papërshtatshme. Varfëria është më e theksuar në zonat rurale, veçanërisht në zonat e thella të vendit. Përparimi i vendit vazhdon të jetë i varur në një masë të konsiderueshme nga shkalla e ndihmës dhe pranisë së organizmave të huaj.

Tranzicioni i Shqipërisë me synim demokracinë dhe ekonominë e tregut të lirë provoi të ishte më i vështirë nga sa u parashikua fillimisht nga shqiptarët. Në stadin aktual të zhvillimit të vendit, si rezultat i ndryshimeve të shpejta dhe të gjithanshme social-ekonomike dhe nën trysninë e dukurive të tilla që bashkëshoqërojnë tranzicionin si: papunësia, varfëria, flukset e larta të emigracionit, rritja e kriminalitetit dhe tronditja e vlerave tradicionale, është rritur



prekshmeria sociale për shtresa dhe grupe të ndryshme të popullsisë. Varfëria si dukuri shumëdimensionale qëndron në rrënjë të mjaft problemeve sociale të shfaqura në periudhën e tranzicionit.

Klima politike ka njohur si përmirësime në disa drejtime ashtu edhe luhatje më pak pozitive përgjatë viteve të fundit. Gjithsesi në përgjithësi, institucionet kushtetuese kanë bërë progres në përpjekje për të arritur funksionimin e tyre të plotë. Pas fenomeneve të tilla të vazhdueshme si mosnjohja e zgjedhjeve dhe bojkoti politik, Partia Socialiste (PS) e cila ishte në opozitë që prej vitit 2005, u rikthye në Kuvend duke rimarrë jetën parlamentare. Pas bojkotit që pasoi zgjedhjet e vitit 2009, ky rikthim ndodhi si rikthim i kushtëzuar me anë të premtimit për për ngritjen e një komisioni të posaçëm për reformën zgjedhore dhe të ndërtimit të një grupi pune për rishikimin e Rregullores së Kuvendit si dhe zgjedhjen e Avokatit të ri të Popullit. Aktualisht gjatë këtij mandati qeverisës për koalicionin e kryesuar nga Partia Demokratike (PD), klima politike qëndron peng e votimit me shumicë të cilësuar me tri të pestat. Konfliktet të herëpashershme politike çojnë në ngërçe institucionale e zbehje të reformave në një sërë sektorësh. Interesat partiake luajnë një rol pengues në arritjen e synimeve afatgjata që lidhen kryesisht me Integrimin European, megjithëse ky proces shërben si katalizator për zhvillimet politike në vend. Si një ngjarje politike e një rëndësie të veçantë, zgjedhja e Presidentit në vitin 2012 ishte një lëvizje politike e një profili të lartë në Shqipëri. Kjo zgjedhje ndodhi pas shumë raundesh votimi të planifikuara në Kuvend, gjatë muajve maj dhe qershor. Asnjë kandidat nuk mori shumicën e

kërkuar prej tri të pestash gjatë tre raundeve të para. Për më tepër, dy kandidatë nga Partia Demokratike (PD) – asnjëri prej të cilëve nuk ishte prezantuar zyrtarisht – i tërhoqën kandidaturat e tyre për katër raundet e para. Në fund, në raundin e katërt të votimit dhe me votat e koalicionit qeverisës u propozua dhe u zgjodh kandidati Bujar Nishani i Partisë Demokratike (PD), ish Ministër i Brendshëm i Republikës së Shqipërisë. Partia Socialiste (PS) mori pjesë në seancat plenare, por zgjodhi të mos merrte pjesë në asnjë prej proceseve të votimit, duke pretenduar se koalicioni qeverisës bëri përpjekje të pakta për të arritur një qasje vendimmarrëse gjithëpërfshirëse ndaj opozitës, në lidhje me gjetjen e një kandidati që do të konsiderohej konsensual.

Një tjetër ngjarje me rëndësi për klimën politike në vend vitet e fundit ka qenë zgjedhja në muajin dhjetor të vitit 2011 e Avokatit të ri të Popullit, pas një procesi të konsideruar transparent në Kuvendin e Shqipërisë. Kjo ngjarje pati ndikim pozitiv në zhvillimet politike. Avokati i Popullit është përpjekur të rrisë ndërgjegjësimin e publikut për çështjet e diskriminimit të grupeve të dobëta e të pafavorizuara në shoqëri. Gjithashtu, ai ka bërë komente mbi projektligje të ndryshme dhe ka dhënë rekomandime në lidhje me praktikën e gabuar administrative dhe keqtrajtimit në vendet e vuajtjes së dënimit. Gjithsesi ende duket se ka një mungesë vullneti nga autoritetet për të zbatuar si duhet rekomandimet e Avokatit të Popullit.

Në lidhje me reformën zgjedhore, hapi që tregoi vullnetin e partive politike për të kapërcyer ngërçin politik, u hodh me arritjen e një marrëveshjeje ndërpartiake në Kuvend, në muajin nëntor të vitit 2011. Është tepër e rëndësishme që Kodi Zgjedhor të zbatohet me përpikmëri të plotë në mënyrë që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) të mund të jetë efikas dhe i gatshëm për zgjedhjet vit pas viti (pavarësisht nevojave për përmirësim të vetë Kodit). Në mënyrë që një gjë e tillë të mund të arrihet me sukses është e nevojshme që të gjitha palët politike të shfaqin vullnetin e nevojshëm politik për zhvillimin e zgjedhjeve të lira e të ndershme sepse një rol kryesor u takon partive kryesore si dhe drejtuesve përkatës. Në lidhje me proceset legislative, nuk mund të mohohet se gjatë viteve ka një lloj përparimi në mekanizmat e konsultimit të përdorur nga autoritetet kombëtare gjë që vihet re tek mekanizmat e shoqërisë civile. Gjithsesi, megjithë përmirësimin e përfshirjes së shoqërisë civile nevojitet ende një qasje më e strukturuar për të krijuar një mjedis politik më gjithëpërfshirës.

Për sa u përket forcave politike në Shqipëri vetë eksponentët të këtyre partive shprehen se ato janë përgjithësisht të mbyllura, kanë mungesë të theksuar tolerance dhe më shumë sesa në interes të zhvillimit të vendit dhe shoqërisë veprojnë si grupe interesi. Konstatohet se kur ato vijnë në pushtet, administrata drejtohet nga militantët e partive dhe kjo është një çështje e cila në Shqipëri nuk ka bërë pothuajse fare progres gjatë gjithë këtyre viteve tranzicion. Po ashtu gjuha e politikanëve në mënyrën sesi i drejtohen njëri-tjetrit tenton të nxisë përçarje dhe dhunë. Në lidhje me spektrin politik, mund të argumentohet se sot e djathta dhe e

majta kanë nevojë për një reformim. Si e majta ashtu edhe e djathta shqiptare prej vitesh e kanë humbur identitetin politik. Nevoja për vota, për marrjen dhe zgjatjen sa më shumë të pushtetit, si dhe mungesa e një vizioni të qartë për të majtën dhe të djathtën tradicionale e problematikat që lidhen me to e kanë zhvendosur të 'djathtën' zyrtare majtas si dhe të 'majtën' zyrtare djathtas. Nga dhjetori 1990 e deri aktualisht, ka pasur shumë zhvillime brenda PD-së, të diktuara shpesh nga zhvillimet politike në vend, si p.sh. ngjarjet e 1997-ës. Sipas disa prej eksponentëve të Partisë Demokratike, krahasuar me atë që hasim në ditët e sotme, PD-ja e fillimeve të pluralizmit ishte më tepër një lloj utopie apo idealizmi politik, sesa një realitet politik. PD-ja që erdhi më pas ishte shndërrimi në realitet politik i kësaj utopie fillestare. E djathta nuk ka arritur të mbajë premtimet elektorale për kthimin e kompensimin e pronave. E njëjta gjë mund të thuhet për të përndjekurit. Në vitet '90 PD ishte partia më demokratike, me konkurrencë, mbështetje rinore dhe elitare, kurse sot nuk ka më votime të mirëfillta në parti, nuk ka konkurrencë. PD është shndërruar nga parti qytetare në parti rurale dhe ndodhet nën kritika të vazhdueshme ndërkombëtare për cilësinë e vendimmarrjes dhe qeverisjes. E majta gjithashtu është në kërkim të identitetit dhe ka probleme madhore për të zgjedhur programin dhe sjelljen e saj politike. Ajo enede vuan nga mitet e të kaluarës. E djathta ka fituar pushtet falë përçarjes së të majtës dhe aleancës me përfaqësues të së majtës, jo për shkak të votës popullore apo aftësisë së saj për të ofruar një model ndryshe qeverisjeje. Më 21 gusht të vitit 2009, KQZ shpalli rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve. PD arriti të sigurojë 68 vende në Kuvend. PS arriti të

fitojë 65 vende, Partia Republikane 1 vend, PDI 1 vend, PBDNJ 1 vend dhe LSI, 4 mandate. Koalicioni PD, LSI dhe PR me 74 mandate bënë të mundur krijimin e Qeverisë. PS vendosi të mos njohë rezultatin e zgjedhjeve duke i konsideruar si të manipuluar në disa drejtime.

Qeveria e vitit 2009 doli nga koalicioni PD-LSI dhe Ilir Meta, i cili është kryetari i LSI-së deklaroi se e pranonte ftesën për hir të stabilitetit të vendit. Nga zgjedhjet parlamentare të vitit 2009 në Shqipëri doli një mazhorancë miks të djathtësh dhe të majtësh. Ilir Meta deklaroi kalimin e tij djathtas, në përgjigje të ftesës së liderit të PD-së, Sali Berisha për të bërë të mundur formimin e koalicionit qeverisës. Berisha i kërkoi LSI-së dhe kryetarit të saj Meta të bashkëpunojë për të formuar mazhorancën parlamentare në kushtet kur ai nuk arrinte në 71 mandate për të formuar qeverinë e re. Meta iu përgjigj pozitivisht kësaj ftese ndaj PD dhe LSI bashkarisht bënë 74 deputetë apo mandate në Parlament. Ilir Meta u shpreh se ishte gati të shkonte djathtas për hir të stabilitetit të vendit. Ai deklaroi se pranonte ftesën e kryetarit të PD-së për një qeverisje më efikase. Sipas tij, ky ishte një vendim i vështirë por i nxitur nga vetë Edi Rama që braktisi LSI-në disa herë radhazi gjatë këtyre viteve të fundit. Më tej ai i është shfajësuar elektoratit të tij të majtë duke ngritur pyetjen se ‘cila do të ishte zgjidhja; bashkëpunimi me koalicionin fitues apo lënja e vendit në krizë?’. Sipas gjykimit të kryetarit të LSI-së, koalicioni me PS-në nuk mund të sillte asgjë përpos kaosit pasi nuk plotësoheshin mandatet për të formuar qeverinë. Mandatet e PS-së dhe LSI-së bashkë sipas Ilir Metës mund të ishin vetëm bllokuese për

zhvillimin e vendit. Berisha ftoi publikisht LSI-në të bëjë koalicion për të qeverisur vendin sepse sipas tij, kjo parti ka në qendër të programit të saj integrimin dhe punësimin si kryefjalë e reformave dhe përpjekjeve të saj. U deklarua se këto elemente përputhen më së miri me programin e PD-se megjithëse LSI është një parti e spektrit të majtë. Kështu u krijua një koalicion qeverisës me një spektër më të gjerë se më parë.

Në Shqipëri në fakt lidhja e politikës me ideologjinë nuk është e fortë dhe funksionet e ideologjisë nuk realizohen. Ky është një tregues se kompleksiteti politik i vendit përshkohet nga fenomeni i deideologjizimit si mungesë e pozicionimit të saktë ideologjik, inkoherenca dhe kontroversialiteti nga pikëpamja ideologjike. Konceptet e së majtës dhe të së djathtës në vendin tonë duhet të merren me rezervë duke qenë se kjo lloj ndarje ideologjike nuk respektohet aspak. Ajo forcë që përfaqëson të majtën nuk ngurron të kapërcejë djathtas e njëkohësisht forca që përfaqëson të djathtën shpesh vepron në mënyrë majtiste. Përveç këtyre kapërcimeve nga ana e partive është mjaft e dukshme edhe një qasje pragmatiste ndaj problemeve.

Analisti *Janusz Bugajski*, një njohës i mirë i politikës shqiptare vë në pah gjashtë çështje të cilat ai i quan çrregullime, që së bashku pengojnë zhvillimin politik, ekonomik dhe ndërkombëtar të Shqipërisë dhe që mund të precipitojnë në një spirale të një konflikti destabilizues. Duke trajtuar veç e veç secilën prej tyre, këto çështje lidhen kryesisht me bipolarizmin politik, konkurrencën e kufizuar

politike, klientelizmin politik, kulturën politike, faktorin e hakmarrjes politike si dhe konfliktet jo ideologjike.

*Bipolarizmi politik:* Sipas Bugajskit “Shqipëria ka zhvilluar një sistem të ndarë mes dy partive, pavarësisht përpjekjeve për rrugë të tretë. Kjo ka polarizuar jetën politike vendase dhe mënjanuar konkurrencën politike”. Në të vërtetë sot Shqipëria ndodhet me një sistem politik të imponuar nga të dy partitë kryesore, që nuk janë aspak të demokratizuara brenda tyre, që si të tilla rrotullohen rreth një lideri ‘të fortë’ jo demokrat dhe autoritar dhe klanit të ngushtë rreth tij, zbatues i verbër i urdhërave, apo siç thuhej dikur i direktivave (me fjalime e sms). Mos zbatimi i parimit “një anëtar një votë” brenda partisë (e shumta votohet për kandidatët e përzgjedhur nga liderët sipas shëmbëlltyrës së tyre), mos tolerimi me egërsi i “mendimit ndryshe”, d.m.th i “të tjerëve”, ka mënjanuar pjesëmarrjen në hartimin e politikave dhe vendimmarrje të anëtarëve të partisë e aq më tepër të popullsisë.

Ligji elektoral i vitit 1992-2001, proporcional i personalizuar, mundësonte dhe forca të tjera dhe vota vlente njëherazi për individin dhe partinë dhe kur kandidati nuk merrte shumicën kishte dy turne dhe atëherë hynin në lojë koalicionet. Me ndryshimet e vitit 2005 u krijua një Kod që mund të merrte dhe karakter mazhoritar, nëse transferimi i votave zbatohet vetëm nga njëri prej koalicioneve, por mbi të gjitha lejonte transferimin e votave, çka dhe ndodhi, duke tjetërsuar vlerat reale të partive të vogla pjesëmarrëse në koalicione. U krijua kështu

bipolarizmi, të cilin e përforcoi Kodi i vitit 2009 me ndihmën edhe të vjedhjes së votave të kundërshtarëve brenda secilit krah. Kështu nga ana e të dy partive të mëdha u shmang mundësia për krijimin e një force të tretë, por kemi vetëm satelitë, të cilëve u mblidhen votat në dobi të koalicionit në këmbim të ndonjë posti të rangut të dytë, dhe sot shumica e tyre nuk kanë as anëtarësi, as ideale e as programe, vetëm nostalgjikë, ndërsa votat ua jep partia e madhe.

Bipolarizmi, duke ia dhënë gjithë pushtetet fituesit, u realizua me ndryshimet e 21 Prillit 2008, nga dy liderë autoritarë, duke ua imponuar shqiptarëve. Ky bipolarizëm i imponuar e që nuk rrjedh nga tradita politike e vendit, që i dalë nga diktatura kërkonte pluralizëm real, siç ka treguar dhe në vende të tjera, krijon konflikte sociale e politike me pasoja për ekonominë dhe zhvillimin e vendit dhe në rastin tonë dhe për integrimin në botën perëndimore.

*Konkurencë e kufizuar politike:* Bugajski mendon se kanë qenë të vështira përpjekjet për të formuar parti të treta apo dhe fraksione. Edhe pse ka parti të tjera sipas tij dy kryesoret dominojnë parlamentin. Me vjedhjen e votave u shmang dhe Poli i Lirisë. Pra nuk kemi konkurrencë të kufizuar por shmangie të saj, rezultat i mentalitetit primitiv bardhë e zi, o me mua o kundër meje. Shtojmë këtu dhe kushtet tejet të vështira për pjesëmarrjen në zgjedhje të kandidatëve dhe partive të reja. Po ashtu koalicionet janë formuar përpara zgjedhjeve dhe vetë njëri prej tyre, ai me LSI-në pas zgjedhjeve iu bashkua Partisë Demokratike për të qenë në qeveri.



*Klientelizmi politik:* Një konstatim i drejtë është se klientelizmi politik është një nga mjetet me të cilën realizohet politika negative e përdorimit të shtetit për përfitime personale korruptive e të jashtëligjshme. Pra një mjet, krahas krahinorizmit dhe nepotizmit, që për mendjet e mbrapshta dhe primitive janë garanci besnikërie, e nevojshme kjo për punë jo të mira. Po kështu, është e vërtetë, që në këtë mënyrë mohohet konkurenca politike e bazuar në programe dhe meritë. Sepse kërkohet jo zotësi por bindje dhe zbatim pa mëdyshje e besnikëri të urdhërave, sidoqofshin ato. Sot shohim katapultime, shtim të vendeve të paguara mirë, shpenzime me pseudotendera e të tjera e të tjera. Pikërisht që të realizohen këto nuk zbatohen parimet demokratike të ndërtimit të partive, në vend të votës së lirë ka përzgjedhje nga lart, sipas kriterëve të mësipërme, në vend të debatit dhe propozimeve për diskutim ka imponim dhe përjashtime për ata që mendojnë ndryshe.

*Kultura politike:* Fjala është për kulturën politike demokratike që pranon votën e lirë dhe rezultatet e saj, që toleron dhe dëgjon opozitën duke realizuar me të reformat kryesore të ndërtimit të shtetit ligjor dhe të ekonomisë së tregut të lirë. Për ne këtu kjo është e qartë sepse është rrjedhojë e natyrshme e politikave për pushtet absolut dhe një mentalitet aspak demokratik për shekullin XXI. Dhe vetëkuptohet që kur e kërkon për qëllime jo të ligjshme, të gjithin për vete dhe për shumë kohë, do nxitësh konfliktin me palën tjetër. *Faktori i hakmarrjes politike:* Detyrohem të bëj vërejtjen se kontestimi i zgjedhjeve nuk mund të quhet princip kur ato janë jashtë çdo standardi e realizohen me dhunë e incidente, me

çrregullime të votuesve, të njehsimit të votave dhe të ruajtjes së tyre. Kontestimi është një mjet demokratik e ligjor. Ai merr forma të ashpra të protestave pas refuzimit të kërkesave për zbatim të kodit Zgjedhor e për mos ndryshim të rregullave pas procesit. Protestat për vjedhjen e demokracisë (votës së lirë) janë shumë më të ligjshme se protestat për gjëra sekondare që shohim përditë e kudo në Perëndimin demokratik. Protesta është një mjet i luftës demokratike.

*Konfliktet jo ideologjike:* Bugajski vëren se “mosmarrëveshjet themelore politike nuk rrjedhin nga ideologjitë dhe programe të ndryshme politike, por sepse ndajnë të njëjtat objektiva”, Sidomos me formimin e koalicionit qeverisës Berisha në 2005 (pas zgjedhjeve), ku u bashkuan parti deri më parë pjesë e qeverive Nano, u bë e qartë se tani e tutje doktrina e vetme është pushteti. Me ndonjë përjashtim të rrallë u paraqitën programe të plota e të hollësishme qeverisëse nga partitë, krahas premtimeve për një Shqipëri fushë me lule dhe e bukura e dheut apo politika të reja. Teza si ajo “përtej së djathtës dhe të majtës” tregojnë se populizmi anarkist për marrjen e pushtetit është doktrina udhëheqëse. Polarizimi dhe mungesa e ideologjive dhe programeve ka sjellë votën për inat të kundërshtarit. Përkishtë synimi i pushtetit si qëllim në vetvete është shkaku i konfliktit të tejskajshëm politik në Shqipëri. Ndërsa dezinteresimi programor për zgjidhjen e problemeve dhe nevojave aktuale të shoqërisë e tregon qartë këtë. Po kështu, populizmi shprehet në premtime të pafundme, kundërprodhuese dhe të një të ardhmeje të largët por jo të momentit.

Në përpjekje për të analizuar gjendjen e politikës në vend si dhe lidhjen e saj me ideologjinë, në këtë punim doktore analizohen tetë faktorë/indikatore kryesorë të cilët do të trajtohen në kapitullin në vijim.

#### **4. Kapitulli IV: Brenda rrethit vicioz të politikës: Faktorët e lidhur me ‘deideologjizimin’**

##### **4.1. Dimensioni i Partive Politike**

Partitë moderne si organizata me strukturë përgjithësisht të qëndrueshme u shfaqën në shek. XVII dhe XIX, periudhë kjo e cila u ndikua nga shembulli i jetës politike në Angli, ku në shek. XVIII, si parti relativisht të qëndrueshme, u formuan *Tories dhe Whigs*, të cilat u pozicionuan në çështje të caktuara politike dhe u angazhuan në drejtimin e shtetit në një sistem dypartiak. Më tej, grupe partiake me strukturë më të përgjithshme lindën në luftërat amerikane të pavarësisë dhe në Revolucionin Francez.

Qëllimi i një partie apo i një grupi partish me elemente organizative e programore të përafërta është fitimi apo ruajtja e shumicës në parlament dhe fitimi në këtë mënyrë i ndikimit dominues në politikë. Kundërshtarët e saj apo të tyre janë partitë opozitare të mundura në zgjedhjet pas fushatës zgjedhore. Loja reciproke dhe konkurimi i partive bashkëkohore është një nga kushtet themelore të jetës moderne kushtetuese, sidomos të sistemit parlamentar. Aty ku një parti e vetme

tenton të përfaqësojë vullnetin e popullit apo e konsideron veten elitë, shfaqet sistemi njëpartiak që mund të marrë trajtat e diktaturës.

Në një demokraci të shëndoshë, raporti mes zgjedhësve në tërësi dhe të zgjedhurve në veçanti nuk duhet kuptuar si proces në të cilin qytetarët japin votën, ndërsa pjesën tjetër e kryejnë përfaqësuesit e zgjedhur prej tyre në mënyrë të pavarur. Politika në demokracitë perëndimore thekson se një karakterizim i tillë nuk i përshtatet aspak rolit të votuesve. Ndikimi i përbashkët politik i individëve shtrihet më gjerë nëse merren parasysh mundësitë e tyre të ndikimit në parti dhe shoqata, në nisma qytetare dhe lëvizje sociale. Këto grupime në mënyrë të drejtpërdrejtë apo përmes ndikimit të opinionit publik, përpiqen të ndikojnë në kuptueshmërinë, bindjet dhe interesat e ndryshme në formimin e vullnetit politik duke u paraqitur qeverive kërkesat dhe shqetësimet nga kënde të ndryshme.

Partitë bashkojnë, zgjedhin dhe shprehin interesat e orientimeve të ndryshme në shoqëri. Të gjitha pikëpamjet nuk mund të përfaqësohen në mënyrë të pafiltruar. Për të parandaluar tensionimin e konflikteve, partitë duhet të përpiqen të krijojnë një barazpeshë mes grupeve të ndryshme të shoqërisë.

‘Produkti’ i një partie është programi i saj politik, të cilin ajo ua ofron votuesve dhe kjo u lejon atyre që të bëjnë zgjedhje. Programet partiake të partive kryejnë kryesisht dy funksione kryesore. Nga njëra anë, ato duhet të artikulojnë interesat e qytetarëve, ndërsa nga ana tjetër është detyrë e programeve partiake ndikimi i formimit të vullnetit politik tek qytetarët -partitë si ‘formuese’ të vullnetit të

popullit. Formini i vullnetit politik zhvillohet kryesisht nëpërmjet partive. Ato marrin vendimet më të rëndësishme politike dhe bëjnë të mundur orientimin politik të qytetarëve.

Partitë dallohen nga organizatat dhe institucionet e tjera në një pikë të rëndësishme. Ato synojnë ndikim të drejtpërdrejtë në vendimet e sistemit politik në kuadrin e parlamentit dhe të organeve të tjera shtetërore. Gjithsesi edhe organizatat e tjera, sidomos organizatat e shoqërisë civile, përpiqen të marrin pjesë në procesin e vendim-marrjes. Megjithatë, aktiviteti i tyre nuk legjitimohet përmes votës së qytetarëve.

Tipologjia e partive bazohet dhe përcaktohet nga kritere të ndryshme si ato të organizimit, të qëllimeve politike, strukturës së anëtarëve dhe kritere të funksionit politik. Në aspektin tipologjik për partitë e fokusuara tek interesat dhe programet është i rëndësishëm përcaktimi i qëllimeve politike, ndërsa për partitë popullore dhe ato të klasave ajo që theksohet dhe ka më tepër rëndësi është struktura e anëtarëve. Në të vërtetë, në sistemet demokratike gjenden forma të përziera të partive. Në fillim të ekzistencës së tyre, partitë kishin shumë pak anëtarë. Qytetarë të ndryshëm mblidheshin dhe ushtronin punën e tyre vullnetarisht. Sot, ndryshe nga ajo që hasej kohë më parë, flitet për partitë e votuesve. Kjo do të thotë se numri i votuesve është shumë më i madh se sa numri i anëtarëve të një partie. Lidhja me partinë shpesh është jo e fortë.

Partitë dallojnë edhe sipas qëllimeve politiko-shoqërore. Kështu partitë nacionaliste, duke i refuzuar rregullat e përgjithshme demokratike predikojnë mendim nationalist, shpesh të përzier me ideologji populiste dhe me pikëpamje raciste. Partitë konservatore paraqiten skeptike ndaj risive dhe ndryshimeve, mirëpo edhe theksojnë se parimet tradicionale nuk mund të ruhen gjatë pa reforma të zgjeruara. Partitë liberale theksojnë të drejtat e lirisë së individit dhe theksojnë gjithashtu edhe pathyeshmërinë e shtetit juridik. Partitë socialdemokratike synojnë arritjen e rendit politik të bazuar mbi drejtësi sociale dhe barazi të gjerë sociale të njerëzve dhe angazhohen në rend të parë për të dobëtit në aspektin ekonomik. Partitë komuniste pretendojnë arritjen e rolit udhëheqës si pararojë e progresit shoqëror dhe propagandojnë diktaturën e proletariatit. Partitë popullore përpiqen t'i përfshijnë interesat dhe nevojat e të gjitha grupeve të popullsisë. Këto parti nuk largohen nga shtresat specifike të popullsisë por integrojnë sa më shumë qytetarë. Përgjithësisht, fakt është që pikëpamjet botëkuptuese nuk luajnë rol të rëndësishëm në programet e partive popullore. Nga ana tjetër ka parti të tilla që mund të konsiderohen si parti të interesave të cilat ndihen të obliguara ndaj interesave të grupeve të veçanta (psh. sociale, fetare, rajonale) dhe nuk synojnë arritjen e votave nga të gjitha grupet e popullsisë. Këto parti theksojnë në mënyrë të veçantë *programatiken* tek organika partiake.

Një dallim midis partive qëndron edhe tek funksioni në sistemin politik. Partitë qeveritare janë treguar të suksesshme në zgjedhje dhe përbëjnë qeverinë deri në zgjedhjet e ardhshme. Mund të ketë disa parti qeveritare, të cilat, së bashku, si

koalicion, përbëjnë qeverinë. Nga ana tjetër, partitë opozitare kanë humbur në zgjedhje dhe përbëjnë opozitën në parlament. Është e zakonshme që mund të ketë disa parti opozitare, qëllimi i të cilave është fitimi i zgjedhjeve të ardhshme përmes parqitjes së alternativave. Pikërisht ky konkurim i vazhdueshëm shërben si garanci për sigurimin e një sistemi demokratik mirëfunksionues.

Për më tepër, demokracia përparon efektivisht po qe se ajo ka një organ legjislativ të gjallë, energjik, me peshë dhe të ligjshëm që është në varësi të drejtpërdrejtë nga funksionimi i partive politike. Organi legjislativ është një komponent i domosdoshëm për qeverisjen demokratike në shoqëritë komplekse të botës bashkëkohore. Këto organe përfaqësojnë lidhje të përhershme midis popullatës dhe qeverisë sigurisht me anë të ndërmjetësimit partiak. Demokracia në kuptimin e vetëqeverisjes së një populli dhe ushtrimit të sovranitetit në mënyrë jo të drejtpërdrejtë mundësohet nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur. Kështu përfaqësuesit e popullit, të cilëve u është deleguar pushteti i përcaktimit të politikës së shtetit duhet të jenë llogaridhënës për veprimet e tyre. Organi legjislativ i cili përfaqëson popullin dhe shërben si mëkëmbës i tij përbën thelbin e demokracisë.

Çdo shtet ka veprimtari legjislativ dhe nëpërmjet normave të përgjithshme rregullon marrëdhëniet ndërmjet shtetasve, midis tyre dhe organeve shtetërore dhe ndërmjet vetë organeve shtetërore. Në kuptimin e thjeshtë, organi legjislativ si organ i shprehjes dhe përfaqësues i vullnetit të popullit, bën ligje por gjithsesi

gama e veprimtarive dhe e përgjegjësive është e një sferë më të gjerë duke patur parasysh edhe shumëllojshmërinë e organeve legjislative që ekzistojnë në vende të ndryshme të botës. Me gjithë diversitetin, ka disa karakteristika e funksione bazë që janë të përbashkëta për të gjitha organet legjislative në vendet demokratike. Karakteristika e parë e një organi legjislativ është lidhja e tij e brendshme me qytetarët e një kombi apo shteti, nëpërmjet përfaqësimit. Një tjetër karakteristikë e shumicës së organeve legjislative është roli i dyfishtë që kanë ligjvënësit. Nga njëra anë organi legjislativ bën ligje që kanë të bëjnë me kombin në tërësi dhe që presupozohen të jenë në favor të së mirës së përgjithshme dhe nga ana tjetër secili nga anëtarët ka për detyrë të përfaqësojë interesa elektorale të veçanta. Ekziston edhe një tension midis roleve të të mirëbesuarit dhe të deleguarit, role me të cilat vishet përfaqësuesi në të gjitha organet legjislative. Çdo vend e çdo organ legjislativ duhet të zgjidhë se si t'i kanalizojë këto tensione.

Organet legjislative e fitojnë ligjshmërinë e tyre duke përfaqësuar vullnetin e popullit ndaj tipar karakteristik është fakti se vota e secilit anëtar, pavarësisht nga përgjegjësitë e veçanta peshon në mënyrë të barabartë duke qenë se ky organ vepron sipas sistemit të vendimmarrjes kolektive.

Detyra e mirëfilltë e një asambleje përfaqësuese është të vëzhgojë e të kontrollojë qeverinë, t'i bëjë të njohura veprimet/aktet e saj, gjithashtu ka për detyrë të jetë edhe komitet ankesash e opinionesh për kombin. Përveç cilësisë së tyre si



ligjvënës zyrtarë kryejnë edhe një rol edukativ të veçantë duke përdorur resurset e aftësitë e ekspertëve nëpërmjet paraqitjes së opsioneve të qarta.

Një ndër funksionet më të mëdha të organit legjislativ në demokraci është që t'i sigurojë përfaqësim opozitës së ligjshme. Gjetja e një ekuilibri midis një roli të përshtatshëm për pakicën dhe të drejtës së ligjshme të shumicës për të vepruar është qëllim i rëndësishëm i një organi legjislativ demokratik. Organi legjislativ në demokraci duhet të jetë një organizëm i hapur i procesit politik duke qenë se roli i tij është t'i përfaqësojë të gjitha forcat e shoqërisë. Një nga rrugët për të gjetur ekuilibër midis grupeve të ndryshme të shoqërisë të cilët kanë zërat e tyre të ligjshëm, është 'dydhomësia'. Shumica e vendeve demokratike kanë dy dhoma në organin e tyre legjislativ ku në njërin përfaqësimi është i bazuar në madhësinë e popullsisë dhe tjetra bazuar në kritere të tjera specifike. Shpesh organi legjislativ është forumi më i mirë duke qenë gjithashtu edhe një forum i ligjshëm për debatimin mbi pikëpamjet e ndryshme duke qenë se çdo shoqëri ka qëndrime të ndryshme për shumë çështje si drejtimet politike, çështjet e tematikës kombëtare, etj. Sigurimi i mundësive për debate të vërteta përbën një funksion të rëndësishëm të organit legjislativ. Në regjimet demokratike të hapura organet legjislative marrin larmi formash. Një aspekt ku organet legjislative mund të shfaqin ndryshime nga njëri-tjetri është në lidhjen me sistemin politik tërësor, pjesë e të cilit janë. Kështu një organ legjislativ mund të jetë pjesë e një sistemi parlamentar ose pjesë e një sistemi presidencial. Në një sistem parlamentar pushteti ekzekutiv dhe udhëheqësit e organeve administrative zgjidhen dhe janë llogaridhënës ndaj

maxhorancës së parlamentit. Në sistemin presidencial pushteti ekzekutiv është krejtësisht i ndarë nga trupi legjislativ. Organi legjislativ qoftë në një sistem parlamentar apo presidencial duhet të veprojë si kundërpeshë e pushtetit ekzekutiv. Asnjë institucion i qeverisjes nuk mund të ketë zotësinë e të vepruarit pa përgjegjshmëri, pa ekzistencën e një organizmi tjetër përmes të cilit ai bëhet llogaridhënës ndaj publikut. Detyrë e rëndësishme por edhe delikate e organit legjislativ është të ofrojë një përfaqësim të balancuar. I takon organit legjislativ të balancojë nevojën për përfaqësim me nevojën për qeverisje, pra zotësia për të vepruar duhet të jetë në balancë me nevojën për t'i dëgjuar të gjithë zërat në mënyrë që të sigurohet ekuilibrim palësh.

Duke qenë se organet legjislative janë një hallkë vendimtare në lidhjen midis popullatës dhe qeverisë, qytetarët mund të shprehin vullnetin e tyre dhe mund të ndikojnë në rezultatet e procesit legjislativ në sajë të zgjedhjeve, peticioneve, lobeve dhe pjesëmarrjes si në partitë politike ashtu edhe në grupet e interesave. Siç u vu në dukje edhe më lart, organe të ndryshme legjislative, tipare të caktuara i zotërojnë në shkallë të ndryshme megjithatë studiues që merren me legjislacionin kanë vënë re se kohët e fundit, në organe të ndryshme legjislative në botë ekziston një prirje e dukshme konvergimi. Pavarësisht ndryshimeve lidhur me rrjedhën historike, organi legjislativ, i cili përfaqëson popullin nëpërmjet rolit të tij shumëdimensional, përbën palcën e traditës demokratike duke i dhënë qeverisjes ligjshmërinë e duhur. Duke njohur rolin vendimtar të organit legjislativ në një sistem demokratik për rrjedhojë duhet njohur si po aq vendimtar edhe roli i

partive politike si hallka që siguron ndërlidhjen e vullnetit popullor me organet e institucionalizuara të vendimmarrjes në një shtet. Kjo ndodh nëpërmjet një procesi përfaqësimi tek i cili arrihet nëpërmjet një procesi të sofistikuar angazhimi, antarësimi, përzgjedhjeje dhe aktivizmi. Gjithsesi, në ditët e sotme ekzistojnë shumë pika të dobëta dhe kritika në lidhje me organizimin e proceseve të agregimit dhe artikullimit të partive politike. Kjo lidhet me një rritje të mosinteresimit të qytetarëve për politikën dhe partitë në mënyrë specifike si dhe me dinamika të zbehura të angazhimit të brezave të rinj.

Gjithsesi, nuk do të ishte e drejtë të supozohej se partitë demokratike nuk i marrin si shtytje për reforma organizative kritikën në rritje dhe mosinteresimin e madh të qytetarëve ndaj partive, të cilat shprehen veç të tjerash në rënien e numrit të anëtarëve të qëndrueshëm dhe të anëtarëve në përgjithësi, si dhe në rezonancën e zvogëluar dukshëm të të rinjve. Pika diskutimi intensiv janë masat reformuese si: miratimi i përcaktimeve për kufizimin e kohëzgjatjes së mandatit dhe për pengimin e akumulimit të mandateve të përfaqësimit; zgjerimi i mundësive të ndikimit të simpatizantëve të partisë pa anëtarësi formale; përfshirja intensive e femrave dhe e të rinjve në kongreset dhe organet partiake, etj. Shtresa e hollë e qytetarëve politikisht aktivë nuk rritet shumë lehtë. Numri i tyre mund të rritet nëse partitë do të ofronin mundësi më atraktive bashkëveprimi, nëse do t'i hapnin më shumë dyert e organizatave të tyre për anëtarët.

Motivet e votimit kanë ndryshuar me kalimin e kohës. Ato ndikohen gjithnjë e më pak nga normat e trashëguara botëkuptimore dhe fetare apo nga prejardhja sociale dhe gjithnjë e më tepër nga aftësia dhe kompetenca e partive për zgjidhjen e problemeve në fushat prioritare të politikës dhe nga kompetenca e drejtuesve të tyre. Partitë popullore ndodhen ndërkohë në një situatë gjithnjë e më të ndërlikuar. Ato duhet t'i lidhin shumicat e reja me votuesit e tyre tradicionalë, nëse dëshirojnë të mbijetojnë si parti të mëdha.

Mendohet se aktualisht kompleksiteti i çështjeve sociale dhe ekonomike kërkojnë përgjigje të shpejta dhe më teknike dhe kjo vë në pikëpyetje nevojën që të sigurohet përfshirja e anëtarëve të partisë në vendime të ndryshme politike. Partitë politike janë duke kërkuar mënyra të reja për t'u ballafaquar me një mjedis që kërkon përgjigje të shpejta dhe veprim të menjëhershëm ndërsa kërkohet që të mbahen të forta dhe të jenë përfshirëse edhe proceset e brendshme në një parti. Partitë politike në përgjithësi janë zhvendosur drejt modelit të zhvillimit të politikave me përpjekje për sa më shumë pjesëmarrje. Modelet pjesëmarrëse janë ato në të cilat një popullsi e gjerë e përbërë nga zyrtarë të partisë, anëtarë, mbështetës dhe grupe të ndryshme, ndikojnë vazhdimisht në politikat e propozuara dhe të mbështetura nga një parti e veçantë. Çështjet e përfshira lidhen me një gamë të gjerë subjektësh nisur nga buxheti dhe zhvillimi ekonomik, arsimi dhe kujdesi shëndetësor, infrastruktura, përkujdesja ndaj fëmijëve zhvillimi i sektorit privat dhe programet e punës deri te vlerat e parimet kryesore dhe besimet e partisë përkatëse.

Lëvizja drejt zhvillimit për pjesëmarrje të gjerë dhe konsultative në disa raste është nismë e krerëve të partisë. Kjo është një përpjekje për t'i mbajtur anëtarët e partisë më të angazhuar si dhe është një përpjekje për të artikuluar politika më domethënëse për votuesit. Gjithsesi ka raste të tjera më të rralla kur lëvizja drejt zhvillimit pjesëmarrës vjen nga anëtarësia me një interes të veçantë në politikë duke kërkuar që partitë politike të bëhen më të hapura dhe përfshirëse në zhvillimin e politikave të tyre. Partitë politike adoptojnë modele përfshirëse për një sërë arsyesh të ndryshme. Disa parti theksojnë vlerat apo bazën ideologjike për përfshirjen e anëtarëve dhe qytetarëve në politikëbërje. Disa parti të tjera janë më praktike, duke theksuar faktin se konsultimi krijon mundësinë për artikulimin e politikave më të forta, dhe më domethënëse.

Duke qenë se pjesëmarrja në votime dhe anëtarësimi në parti është në rënie të vazhdueshme në pothuajse gjithë Europën, partitë politike tanimë kanë zhvilluar tendencën për të përdorur proceset e konsultimit të gjerë për agregimin dhe artikulimin e politikave si dhe tendencën e gjithëpërfshirjes përkundrejt votuesit.

Gjithsesi, gjithëpërfshirja mund të krijojë vështirësi për një parti në lidhje me ndërtimin e profilit të saj megjithëse ka si synim të rrisë mbështetjen. Përfshirja e sa më shumë individëve në agregimin dhe artikulimin e politikave mund të ndihmojë që përpjekjet e fushatave të fillojnë herët, dhe i shtojnë partitë të organizojnë marketing për axhendën e saj legislative jashtë periudhave zyrtare të fushatave. Zhvillimi gjithëpërfshirës i partive e bën më të lehtë për të promovuar

dhe zbatuar politikat, gjithsesi ka vështirësi që t'u japë përgjigje pyetjeve: “Çfarë duhet bërë për të mbajtur anëtarët tradicionalë të partisë të përfshirë dhe të angazhuar?” dhe “Si mund të tërheqim anëtarë të rinj pa lënë mënjanë kauzat tradicionale?” Politika që krijon një parti duke përdorur proceset gjithëpërfshirëse ka më shumë gjasa të jetë e bazuar në realitetin dhe përvojat e fragmentarizuara të votuesve nga shumë anë të ndryshme, dhe për këtë arsye mund të ketë një shkallë më të lartë të fluiditetit parimor dhe përafrim drejt mesit duke lënë mënjanë dinamikat e polarizuara.

Zhvillimi i politikave gjithëpërfshirëse ofron një spektër të gjerë përfitimesh për partitë politike, por kjo nuk do të thotë se kjo është e lehtë dhe pa komplikime. Zhvillimi gjithëpërfshirës mund të jetë një proces kompleks në çfarëdo rrethane. Proceset gjithëpërfshirëse në zhvillimin e politikave marrin shumë kohë, e cila duhet planifikuar me kujdes. Disa çështje politike zhvillohen aq shpejt sa që nuk lejojnë të ndodhë një proces konsultimi. Në kontekstin e gjithëpërfshirjes duhet mbajtur parasysh se përveç se politikëbërja duhet të jetë pjesëmarrëse, konsultative ajo mund të kthehet në proces luftarak pasi palët e ndryshme brenda partisë garojnë për dominim rreth politikave përfundimtare. Ky është një tension i cili duhet të menaxhohet. Rezultati i proceseve gjithëpërfshirëse ndonjëherë mund të jetë i paqartë, kur palët nuk kanë pikëpamje të fortë për një politikë; pikëpamje gjerësisht të ndryshme, apo informaciona/informata të pamjaftueshme.

Nga ana tjetër, për të sqaruar deri në një farë mase nivelet e mobilizimit popullor apo apatisë në zgjedhje vit pas viti, Ivan Krastev (2014) thekson se ‘kur demokracia është gjuha politike që flitet anembanë globit, shumë njerëz dyshojnë për aftësitë e regjimeve të tyre demokratike për t’i shërbyer synimit kolektiv’. Krastev beson se ‘është shkëputur lidhja midis lirisë personale të individit dhe pushtetit kolektiv të votuesve. Një herë e një kohë individi e dinte se kish nevojë për të tjerët, që të mbronin të drejtat e veta personale, prandaj anëtarësohej në parti... Tani individi ose i merr liritë e veta për të mirëqena, ose beson se ai mund t’i mbrojë ato vetë, ose duke klikuar me miun e kompjuterit, ose duke e hedhur qeverinë në gjyq’ (f. 18).

Si zgjidhje për rastin specifik të Shqipërisë, duhet theksuar se aktualisht është koha për përcaktimin ideologjik të partive dhe kjo është një sipërmarrje mjaft e vështirë. Shumica dërmuese e liderëve partiakë në Shqipëri, e kanë prejardhjen ideologjike nga e majta dhe një pjesë krejt e vogël nga e djathta. Kjo dinamikë ka ndikuar në pozicionimet politike të periudhës së tranzicionit demokratik si dhe në cilësinë e demokracisë së arritur gjatë këtyre viteve.

Përveç artikulimeve për përkatësi të majtë apo të djathtë të partive politike në vend, një nga çështjet e debatuar nga partitë politike kohët e fundit ka qenë ajo e nacionalizmit, si një çështje që ka përfshirë publikun masivisht. Në lidhje me këtë çështje, e djathta shqiptare edhe pretendon ta përfshijë nacionalizmin shqiptar (në mënyrë të moderuar) por argumentohet se kjo është e vështirë sepse nacionalizmi

shqiptar përgjithësisht i takon lëvizjes së rezistencës kundër pushtimeve, madje edhe në retrospektivë kundër pushtimit ultra të djathtë, fashist, italian e gjerman. E djathta shqiptare, në krye të herës, ka pësuar një ‘komprometim’ për sa i përket bashkëpunimit me fashizmin, ashtu sikurse edhe e majta shqiptare, e cila në esencë ishte nacionaliste/‘përparimtare’, u bë objekt i koniukturave politike që e rreshtuan në ‘bllokun majtist’ që ka ndikuar në viktimizimin e çështjes shqiptare në favor të forcave të tjera hegjemoniste në Ballkan.

Organizimi partiak socialist, -më vonë komunist, në Shqipëri ka një histori më ‘frytdhënëse/efiçente’ sesa organizimi i së djathtës. E djathta shqiptare asnjëherë e konsoliduar në mënyrë të mirëfilltë, gjatë kohës së komunizmit ishte e paorganizuar. Po ashtu, edhe pse pluralizmi politik në Shqipëri daton qysh në vitet 20 të shekullit të kaluar, ai asnjëherë nuk ishte pluralizëm i mirëfilltë demokratik edhe për faktin se mendësia politike ishte mendësi ‘njëdimensionale’ qoftë ajo e majtë apo e djathtë.

Gjithsesi duke u kthyer në ditët e sotme, një çështje kyçe e trajtuar nga politologë të ndryshëm në vend, është fakti që partitë politike konkurojnë për ‘të njëjtin elektorat me të njëjtat mjete’. Në këtë mënyre kemi një transformim gjithëpërfshirës të partive politike në vend. Së pari, Hasimja (2005) thekson se ka një ndryshim organizativ duke i shndërruar partitë politike në parti elitiste pra duke u dhënë më shumë pushtet elitave. Së dyti, është ndryshimi programatik ku si rrjedhojë, dallimet ideologjike janë minimizuar. Prioriteti kryesor i partive



gjithëpërfshirëse është bërë maksimizimi i votave dhe përfitimi i tyre nga të gjitha drejtimet. Një parti që rend thjesht pas numrit të votave është një parti e ndryshme nga ajo që rend pas politikave.

Kështu, partitë e mëdha që kanë ndikimin kryesor në arenën politike në Shqipëri nuk funksionojnë në të vertetë sipas ideologjive përkatëse që do të duhej t'i motivonin veprimet e tyre. Nga ana tjetër qasja gjithëpërfshirëse është kundër çdo lloj ngurtësie ideologjike dhe mbron një shumësi ideologjish dhe pikëpamjesh brenda të njëjtës parti. Në fakt partitë gjithëpërfshirëse adaptojnë çdo lloj politike që u duhet për të fituar, pa ndonjë besnikëri ideologjike.

Kjo lloj qasje, është krejt ndryshe nga ajo e partive politike që promovojnë/mbështesin ideologji specifike. Mbrojtësit e partive gjithëpërfshirëse mendojnë se njerëzit me një gamë të gjërë pikëpamjesh mund të bashkohen në një parti të vetme për të optimizuar çështjet kryesore për të cilat bien dakort, edhe pse ato nuk bien dakort në çështje të tjera. Kështu partitë mund të tërheqin një bazë të gjerë mbështetësish në zgjedhje. Edhe pse partitë më të mëdha politike mund të shfaqin një përafrim ideologjik, në fakt praktikisht ndjekin një përafrim gjithëpërfshirës. Ideja është se partitë që janë të udhëhequra vetëm nga një ideologji, zakonisht nuk performojnë mirë në zgjedhje dhe mbeten parti të vogla.

Në lidhje me transformimin gjithëpërfshirës të partive në Shqipëri kanë ndodhur disa ndryshime. Së pari është ndryshimi i organizimit si rrjedhojë e të cilit partitë janë bërë me elitiste pra duke i dhënë një pushtet më të madh elitave të

shkëputura. Së dyti ndryshimi është ideologjik dhe si rrjedhojë e këtij ndryshimi diferencat ideologjike midis partive janë bërë shumë më të vogla.

Për partitë gjithëpërfshirëse prioriteti kryesor është maksimalizimi i votave ndaj ato kërkojnë vota nga të gjitha anët. Kështu karakteristika të këtyre partive janë:

- Ulje drastike e ngarkesës ideologjike në favor të taktikave afatshkurtra në përpjekje për të tërhequr grupet e reja,
- Forcim i konsiderueshëm i grupit drejtues dhe i liderave
- Ulja e rolit që një anëtar partie luan
- Një theksim më i vogël i grupeve apo klasave kryesore që do të duhej të përfaqësonin partitë përkatëse
- Rritja e aftësisë për të rekrutuar votues nga popullata në përgjithësi

Partitë gjithëpërfshirëse karakterizohen nga një interes në çështje që nuk hasin pothuajse fare kundërshti tek komuniteti dhe tërheqin një maksimum votuesish. Një parti gjithëpërfshirëse mund të shfaqet vetëm si rrjedhojë e deideologjizimit. Pra, dinamika e partive e lidhur me përpjekjen e tyre për gjithëpërfshirje ka patur ndikim të drejtëpërdrejtë në prodhimin e politikave të deideologjizuara duke qenë ky një rezultat apo një rrjedhojë e natyrshme e kësaj dinamike të partive kryesore.

Mbivendosja e pozicioneve të partive politike jep një numër pasojash të rëndësishme politike. Për shembull, sipas analizës së Downs (1957), është e kuptueshme që mbivendosja të sjellë keqkuptim për partitë në lidhje me pozicionet e tyre, sepse ambiguiteti rrit numrin e votuesve që një parti mund të

tërheqë. Megjithatë, kjo paqartësi politike mund ta bëjë të vështirë për qytetarët që të marrin vendime ‘të informuara’. Në këtë mënyë, votuesit drejtohen në zgjedhjen e kandidatëve të tyre për arsye të ndryshme nga ato të pozicionimit për çështje specifike. Në këtë drejtim, sjellja racionale për një parti arrihet shpesh në kosto të racionalitetit të votuesve (fq. 135). Për më tepër, në sajë të mbivendosjes partizane shkaktuar nga mungesa e diferencimit apo pozicionimi i paqartë i politikave të partive, partitë politike konsiderohen nga publiku si më pak përgjegjëse për politikën e tyre. Më tej, fakti që votuesit mesatarë e humbasin interesin e tyre në politikën partiake nuk mund të jetë i papërfillshëm, kjo sepse pozicionet e palëve bëhen më të padallueshme kur ideologjitë e partive janë konvergjente.

Politika po shndërrohet në një zanat të ‘zakonshëm’ dhe ekzistojnë elemente të ndërlikura që e zbulojnë këtë të dukuri. Së pari, në disa kontekste, politika po bëhet më pragmatike e gjithnjë e më tepër gjenden argumente si dëshmi. Kështu, politika po kthehet gjithnjë e më shumë në një garë në mes ekipeve rivale të menaxhimit që ofrojnë pothuajse të njëjtin produkt dhe duke përdorur qasje të ngjashme të menaxhimit. Megjithëse ka qasje që janë në favor të një centralizimi relativ me bazë idetë e ndryshme diferencuese, si dhe qasje për vendosjen e qëllimeve nga ana e shtabeve dhe kampeve të ndryshme, gjithsesi, nuk sugjerohet ndryshimi e riorientimi i asaj që partitë bëjnë. Rezultati është rritja e pragmatizmit dhe një politikë që është më pak ideologjike. Në këtë pikë, politika është më pak ‘dogmatike’, nga të gjitha anët e hapur për idetë të çfarëdoshme me çfarëdo

origine dhe me rol minimal të ideve dhe filozofive për politikën e ndjekura nga palët partiake. Thuhet gjerësisht që ‘-ajo çfarë funksionon, është ajo që ka rëndësi’.

Së treti, ka një marrëveshje në rritje në lidhje me atë që është e rëndësishme. Në këto terma, ekziston një konsensus në axhendën politike, dallimet e mëdha në vizionet për shoqërinë kanë kaluar dhe shumë nga zgjedhjet e mëdha janë bërë.

Në kohën kur në politikën shqiptare flitej për politikën përtej të majtës dhe të djathtës, po të analizohet diskursi politik i kryetarit të Partisë Socialiste të Shqipërisë Edi Rama kuptohet nga deklaratat e tij se për interesat e vendit dhe për interesat e njerëzve mund të shkohet përtej kufijve të partive, nuk diskutohet më për të lëvizur majtas apo djathtas, por bëhet fjalë për t’u ngjitur në një dimension tjetër as majtas as djathtas, në mënyrë që të ofrohen zgjidhje për popullatën në tërësi. Në këtë kontekst gjatë kësaj periudhe shtrohej nevoja për një politikë të re dhe kjo politikë e re duhej të niste nga qytetarët dhe duhej të ishte në kundërshti me stereotipet e këtyre viteve. Sipas këtyre pikëpamjeve Partia Socialiste i nënshtrohej një procesi transformimi rrënjësor të brendshëm dhe njëkohësisht politika shqiptare ndodhej në procesin e një transformimi rrënjësor.

Konkretisht në mënyrë eksplicite, sipas deklaratave të vitit 2008 të Kryetarit të Partisë Socialiste Edi Rama, thuhet se “kur flitet për interesat e vendit, për interesat e njerëzve shkohet përtej kufijve të partive, nuk bëhet fjalë për të shkuar majtas apo djathtas, por bëhet fjalë për t’u ngjitur më lart, apo ta lësh vendin dhe njerëzit

të zhyten më poshtë. Në këtë kontekst, ne kemi nevojë për një politikë të re dhe kjo politikë e re duhet të nisë nga qytetarët dhe duhet të jetë në kundërshti me stereotipet e këtyre 17 viteve, në kundërshtim me politikën si aritmetikë, apo në kundërshtim me interesat e një grushti njerëzish të ndarë nga qytetarët e vendit. Partia Socialiste është në procesin e një transformimi rrënjësor të brendshëm dhe njëkohësisht në procesin e një transformimi rrënjësor të vetë politikës shqiptare. Në këtë sens doja t'i linim pas stereotipet që e shikojnë bashkimin apo ndarjen si llogari mes disa grupesh, që janë grupe të vetëquajtura parti, apo që mbrojnë interesa krejt personale dhe t'i japim jetë një bashkimi me qytetarët, përtej kufijve të partive dhe mbi të cilat duhet t'u japim mundësi qytetarëve ta përdorin PSSH si instrument për të ndryshuar shoqërinë, vendin dhe jetën. Në këtë sens, nuk ka një të majtë të ndarë, por ka një fuqi të madhe dhe një vullnet të madh për ndryshim nga ana e PSSH në funksion të një procesi të ri politik në Shqipëri dhe nga ana tjetër llogaritë e vjetra, stereotipet e vjetra, skemat e vjetra dhe që bazohen vetëm te një aritmetikë dhe te logjika e pazarit paraprak, që për mua nuk na duhet dhe që për shqiptarët është e pavlefshme në këtë stad të vendit dhe botës, ku Shqipëria duhet të marrë në duar fatin e saj përmes një politike të re, ku ne duhet të kuptojmë se nuk janë zgjedhje mes PD dhe PSSH, të majtës e të djathtës, por mes të tashmes dhe të shkuarës".

#### **4.2 Programet politike në lidhje me politikat publike -*Dekomunistizimi***

Me rënien e shtetit socialist, shumë do të besonin se një erë e re e lirisë do të kishte ardhur automatikisht. Në fakt ekziston një tundim për të identifikuar lirinë me tregun e lirë dhe ndërmarrjet apo sipërmarrjet private; -‘Lëreni tregun të bëjë magjinë e tij dhe të gjitha problemet do të zgjidhen’. Në thelb, liberalët së bashku me konservatorët, duke vlerësuar rindërtimin post-komunist, kanë qenë të prirur për të theksuar rëndësinë e reformave të tregut të lirë dhe në një farë mënyre kanë lëvizur në drejtim të zbehjes së rëndësisë së lirive e të drejtave me baza sociale dhe kulturore. Ata duket se janë prirur drejt besimit se me një bazë të tregut të lirë, të gjitha vështirësitë politike, sociale dhe kulturore zgjidhen lehtësisht. Nga mbitheksimi i tregut vetërregullues, në një farë mase neglizhohen kërkesa të tilla si ajo për një rend të fortë rregullator ligjor e politik, parti politike të shëndosha e aktive dhe një mirë-funksionim i sistemit arsimor si themel për përmirësimin e vetë sistemit politik. Në fakt, liria e tregut në vendet postkomuniste nuk mund t’i adresojë vetë, drejtpërdrejt problemet politike e madje edhe marrëdhëniet me fusha të tjera politikisht të rëndësishme janë mjaft të paqarta.

Proceset politike në Shqipëri janë të lidhura me atë që quhet proces ‘ri-rregullimi’ gjatë transformimit postkomunist. Përpjekja për të lëvizur drejt atij që quhet ‘de-rregullim’ nën tregun e lirë, në rastin e Shqipërisë do të thotë ri-rregullim thelbësor dhe imponim i rregullave për çështje të ndryshme të pacekura më parë. Si rrjedhojë e kësaj dinamike, rrjedh që partitë në të majtë nuk mund të premtojnë nivele të

larta mbrojtjeje sociale dhe partitë në të djathtë nuk mund të premtjnë derregullim të lartë.

E majta shqiptare është transformuar pothuajse rrënjësisht duke kaluar nga komunizmi drejt një socializmi apo një social demokracie të reformuar dhe më tej ka artikulluar në gjuhën e një rrugë të tretë për ta braktisur më tej këtë ligjërim. Ky transformim ka qenë një proces dekomunistizimi i së majtës në Shqipëri dhe vetë dekomunistizimi është i lidhur me procesin e deideologjizimit. Megjithatë ky deideologjizim si rrjedhojë e dekomunistizimit ka prekur edhe të djathtën kryesisht gjatë mandatit të parë të qeverisjes së saj sepse politika e atyre viteve më tepër sesa mirëfilli programore në përputhje me parimet e djathta ishte një kundërvënie me të gjitha mënyrat ndaj komunizmit dhe çdo gjëje që identifikohet me të.

Shqipëria ka ndryshuar shumë vitet e tranzicionit, por e shkuara e saj gjithsesi nuk mund të fshihet. Për vite me radhë i tërë vendi ka qenë i indoktrinuar nga ideologjia Marksiste Leniniste dhe ka qënë e dominuar nga një parti e vetme pa asnjë alternativë.

Në fakt Marksizmi në Shqipëri shihet si i lidhur ngushtë me Leninizmin. Kontributi i Leninit qendron në prezantimin e partisë pararojë apo revolucionare. Në këtë mënyrë diktatura e proletariatit u kthye në diktaturë të Partisë Komuniste të quajtur Partia e Punës së Shqipërisë që veprroi si forca udhëheqëse në shtetin një partiak.

Si sistem teorik Marksizmi ka qënë në kah të kundërt me liberalizmin dhe komunizmi si forca armike e kapitalizmit.

Elementët e Marksizmit që shërbejnë si bazë e komunizmit janë:

*Materializmi historik:* Filozofia e Marksit bazohej në konceptimin materialist të historisë. Sistemi ekonomik kushtëzon superstrukturën ideologjike e politike duke sugjeruar se zhvillimet shoqërore e historike mund të shpjegohen duke u nisur nga faktorët ekonomikë dhe klasorë.

*Lufta e klasave:* Kontradikta bazë në kapitalizëm është ekzistenca e pronës private që çon në krijimin e borgjezisë së pasur dhe klasës punëtore që nuk ka asgjë dhe është e detyruar të shesë krahun e punës. Në sajë të pasurisë materiale, borgjezia është e aftë të mbajë pushtet politik duke u bërë klasa drejtuese.

*Revolucioni i proletariatit:* Marksii besonte se kapitalizmi ishte i dënuar dhe se fundin e tij do ta sillte proletariati.

*Revolucioni social:* Një ndryshim cilësor në strukturën e shoqërisë, një ndryshim në mënyrën e prodhimit dhe të sistemit të pronësisë.

*Komunizmi:* Marksii parashikonte se revolucioni i proletariatit do të çonte në një periudhë tranzitore ‘socialiste’ ku diktatura e proletariatit do të ruante sistemin nga rreziku i ndonje kundër-revolucioni që do të tentonte të risillte borgjezinë në pushtet. Me zbehjen e antagonizmit klasor dhe me vendosjen e komunizmit do të stabilizohej një shoqëri komuniste pa klasa ku prona do të ishte e të gjithëve.



Diktatura e proletariatit është një term që shënon fazën e kalimit nga kolapsi i kapitalizmit tek vendosja e komunizmit të plotë, i karakterizuar nga ngritja e një shteti të proletariatit.

Sidoqoftë komunizmi i shekullit XX ndryshonte në mënyrë domethënëse nga idetë dhe pritshmëritë e Marksit dhe Engelsit. Së pari, liderët komunistë u jepnin rëndësi të madhe çështjeve të tilla si drejtimi, organizimi politik dhe manaxhimi ekonomik më tepër se sa Marks i bënte dhe së dyti, regjimet komuniste u formësuan edhe mbi bazën e rrethanave kontekstuale. Regjimi komunist u bë sundimi i elitës komuniste dhe i liderëve komunistë nëpërmjet partisë shtet. Ideologjia marksiste-leniniste u shndërrua në një kod ideologjik të detyrueshëm. Besnikëria ndaj 'kudit ideologjik' u shpall si qëllimi më i lartë kombëtar shoqëruar me sloganin : "Edhe bar do të hamë dhe parimet nuk i shkelim". Ndërkohë që në Kushtetutën e Shqipërisë të vitit 1976 "marksizëm-leninizmi", që identifikohet me "mësimet e shokut Enver", u sanksionua me ligj kushtetues si ideologji e vetme dhe sunduese. Në nenin 3, të Kushtetutës, shkruhej: "Në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë ideologjia sunduese është marksizëm-leninizmi".

Gjithsesi, si rrjedhojë e shumë faktorëve edhe në Shqipëri në fillim të viteve '90 komunizmit i erdhi fundi dhe po ashtu edhe partisë simbol të këtij regjimi. Në situatat që u krijuan pas përmbysjes së regjimit komunist, përtëritja e Partisë së Punës jo vetëm në aspektin ideologjik por edhe në atë organizativ, shtrohej si një

çështje urgjente dhe e domosdoshme. Në kushtet e reja PPSH ose duhej të shpërndahej, të shuhej apo të tërhiqej nga jeta politike, ose të ndryshonte cilësisht në përmbajtjen e vet. Pra çështja e reformimit apo riformimit nuk ishte një kërkesë subjektive e disa liderëve që dëshironin t'i zgjasnin jetën PPSH. Ripërcaktimi i idealit, i një strategjie e taktike të re që t'u përgjigjeshin situatave të krijuara përbënte një kërkesë objektive për alternativën e majtë. Tentativat për të filluar ndryshimin e Partisë së Punës ishin tepër kaotike. Sipas Servet Pëllumbit (2008), në rrethet e saj intelektuale diskutoheshin kryesisht tre opsione:

- Shpëtimi Partisë së Punës dhe adaptimi i saj në kushtet e reja;
- Fillimi i transformimit të saj duke filluar nga ndryshimi i emrit, dhe;
- Shpërbërja e Partisë së Punës e rikrijimi i shpejtë i një partie të re të majtë.

Më 12 qershor 1991, pas shumë zigzakesh fitoi opsioni i transformimit të saj. Kështu Partia e Punës u transformua në Partinë Socialiste të Shqipërisë. Sigurisht që ky nuk qe një ndryshim vetëm i emrit por në fakt kishte të bënte me një riformësim thelbësor të alternativës së majtë. Një shkoputje nga e kaluara do të thoshte një shkoputje edhe nga ideologjia që kishte mbizotëruar "Partinë nënë". Kështu e majta ishte në kërkim të një identiteti të ri. Gjithë vitet e tranzicionit kanë qenë një përpjekje për transformim duke u distancuar nga pjesa negative e të kaluarës së saj. Nga ana tjetër edhe koalicioni i partive të djathta, që erdhi në pushtet në mars të vitit 1992, edhe pse mori përsipër barrën e rëndë të realizimit të reformave standarde të ekonomisë së tregut dhe të demokracisë pluraliste, nuk

tregonte interes bazik për filozofinë politike të liberalizmit, që si rregull përbën ideologjinë e të djathtëve. Gjithë angazhimi i tyre "ideologjik" përqendrohej në luftën kundër opozitës së majtë, kryesisht kundër PS-së, të cilën e trajtonin si parti që vazhdon të 'ngulë këmbë' te ideologjia e vjetër dhe që sipas tyre ishte partia e mëparshme komuniste, por me emër tjetër.

Megjithëse procesi i dekomunistizimit ka ndikuar tek të gjitha forcat politike në Shqipëri, ky proces dhe fenomenet që e shoqërojnë janë të lidhura më tepër me kampin e majtë. Një nga fenomenet më të rëndësishëm që bashkëshoqëron apo vjen si rrjedhojë e dekomunistizimit është deideologjizimi. Kjo sepse ideologjia marksiste leniniste dhe të gjithë simbolikat e lidhura me të duheshin çrënjësuar një herë e përgjithmonë. Megjithëse Partia Socialiste ka qenë në opozitë nga viti 1992 deri në vitin 1997 kjo periudhë i ka shërbyer për t'u ripozicionuar dhe, pas marrjes së pushtetit, ajo teorikisht ka vazhduar të mbetet në spektrin e majtë, në fakt të një të majte krejt ndryshe nga ajo e së kaluarës. Përveç transformimit të brendshëm, këtë ridimensionim është përpjekur ta krijojë edhe duke iu referuar shtresave të ndryshme shoqërore nga ato të cilave u referohej me parë. Politika e PS-së ka evoluar shpejt dhe nuk ka qenë konstante gjatë periudhës së tranzicionit. Socialistët janë shfaqur si të majtë gjatë periudhës në opozitë por janë shndërruar në pragmatikë gjatë periudhës në pushtet. Veprimi i PS-së është më tepër pragmatik sesa i lidhur me ndonjë ideologji.

Në kuadër të transformimit nga e majta e përfaqësuar nga PPSH deri tek socializmi modern e ndoshta tek një rrugë e tretë apo tek ajo përtej të majtës dhe të djathtës politika e majtë ka njohur një proces deideologjizimi.

Kështu kryetari aktual i Partisë Socialiste është kritikuar për qëndrimin e tij mbi identitetin e kësaj partie. Deklarata e Ramës, ‘përtej së majtës dhe së djathtës’ nuk është pritur mirë nga shumë aktorë të politikës por as nga Servet Pëllumbi, një prej themeluesve të PS-së, i cili përmes një deklaratë të tillë ka parë një devijim të PS-së si parti e majtë drejt qendrës. “PS-ja është parti e majtë dhe s’mund të synojë të ndërrojë pozicion”, - është shprehur Servet Pëllumbi, në shkëmbim replikash me kreun e PS-së përgjatë mbledhjes së Asamblesë Kombëtare të PS-së gjatë vitit 2008. Kryetari i PS-së është përpjekur që të argumentojë një deklaratë të tillë që në fakt më shumë se e tillë, u bë një qëndrim i PS-së. “Tendenca e sotme e së majtës dhe e së djathtës është larg asaj tradicionales”, - është shprehur kryetari i PS-së. Në fakt, kjo është kritika e parë që ish-themeluesi e ish-drejtuari i PS-së, Pëllumbi ka adresuar te Rama. Pëllumbi shprehet se PS-ja e drejtuar prej Ramës po shkonte në rrugën e duhur, reformimi i nisur prej tij, ishte i duhuri, por nga këndvështrimi i një politikani të vjetër, për herë të parë po shihet një devijim i faktit që ajo mbetet mbi të gjitha një parti e majtë. Prej disa vitesh me ardhjen e Ramës në krye të PS-së është folur për një politike të re të kësaj partie. Në kuptimin e togfjalëshit “politika e re” u përfshinë edhe deklarata të tilla si: “Unë nuk jam politikan, por qytetar, apo edhe për një politikë të re përtej së majtës dhe të djathtës”.

Pra, në këtë kuadër, mund të shihet një evolucion nga e majta komuniste tek një e majtë e rrugës së tretë si proces dekomunistizimi ku spikat deideologjizimi dhe gjithashtu një sërë sjelljesh politike të periudhës së hershme të qeverisjes nga partia demokratike mund të interpretohen nga pikëpamja e procesit të dekomunistizimit të bashkëshoqëruar me deideologjizim.

Çdo forcë politike që vjen në pushtet ka një program qeverisës që përbën ofertën e saj politike dhe ndër të tjera është edhe një hartë konceptuale që pasqyron vlerat dhe pikëpamjet që forca politike përfaqëson. Programi i qeverisë pasqyron filozofinë me të cilën do të qeveriset gjatë viteve të mandatit. Forca të ndryshme politike kanë konceptime të ndryshme të problemeve dhe njëkohësisht ofrojnë edhe zgjidhje të ndryshme të tyre. Ky është një nga dimensionet kryesore ku ideologjia do të duhej t'u jepte identitetin forcave politike.

Në teori e majta dhe e djathta kanë konceptime të ndryshme në radhë të parë për problemet e rrjedhimisht edhe për zgjidhjet që propozojnë me anë të programit qeverisës. Praktikisht në Shqipëri nuk ndodh kështu. Ofertat politike të së majtës dhe të së djathtës ndryshojnë pak ose aspak, po ashtu edhe konceptimi i problemeve. Kjo pasqyron një gjendje deideologjizimi. Në vijim do të pasqyrohet konkretisht se si ndarja ideologjike mes të majtës dhe të djathtës është krejt e paqartë e madje e padukshme. Në këtë mënyrë po të analizosh programet e qeverisë socialiste dhe asaj demokratike pa lexuar në fillim se kujt i përkasin, të bësh dallimin e tyre nga pikëpamja ideologjike është pothuajse e pamundur.

Socialistët nuk ngurojnë të mendojnë djathtas ndërkohë që edhe demokratët nuk ngurojnë të mendojnë majtas. Në programet e qeverive socialiste dhe demokrate spikat një inkoherencë e theksuar ideologjike nga çështja në çështje dhe gjithashtu vihet re një dominim i mendimit pragmatist e tejte teknik në çështjet themelore. Kështu në sajë të inkoherencës, nëse fillimisht tek programi i demokratëve kemi një qëndrim djathtist në vazhdim të të njëjtit program gjejmë një ligjërim dhe një ofertë krejt të majtë. Nga ana tjetër programi i socialistëve luhetet midis ligjërimin majtist që gjithsesi nuk është shumë i theksuar, ligjërimin pragmatik dhe për më tepër edhe atij djathtist. Kjo është një situatë e deideologjizimit të plotë e cila do të konkretizohet në vazhdim nga analiza në pikpamje ideologjike të programit politik të qeverisë socialiste të shapllur në vitin 2002 dhe programit të qeverisë demokratike të vitit 2005 të marra në konsideratë si dy programe në pikun e tranzicionit demokratik.

Kështu në programin politik të socialistëve të kryesuar nga Fatos Nano, në vitin 2002 thuhet:

*“Programi i qeverisë trajton me përparësi çështjet emergjente dhe më të rëndësishme për qytetarët dhe për vendin, në çdo fushë, por në radhë të parë: Garantimin dhe forcimin e rendit publik, luftën kundër krimin të organizuar e trafikëve të paligjshme dhe korrupsionit, me objektivin e qartë të arritjes së sukseseve të dukshme për çrrënjëzimin e këtyre plagëve nga realiteti shqiptar. Tejkalinin tashmë të nisur të krizës energjitike, rritjen e furnizimit të familjeve*

*dhe bizneseve me energji, dhe kalimin në procesin normal të zhvillimeve të balancuara dhe afatgjata në këtë sektor. Përgatitjen serioze për nisjen e negociatave për marreveshjen e stabilizimit asociimit dhe vazhdimin e suksesshëm të tyre.*

*Programi orientohet drejt vazhimit dhe thellimit të reformave institucionale dhe ligjore për ta bërë qeverisjen më demokratike, më transparente, më të decentralizuar e më pranë qytetarit, më pak të korruptuar dhe njëkohësisht më efektive dhe më efçente.*

*Ai është një program që harmonizohet me objektivin tonë afatgjatë të zhvillimit modern dhe të integritetit europian dhe euro-atlantik e në këtë kuadër edhe me angazhimet tona në nismat rajonale dhe në Paktin e Stabilitetit.”*

E më tej:

*“Qeveria do të vazhdojë përpjekjet e saj në drejtim të forcimit të rendit publik dhe të luftës kundër krimit të organizuar e trafikëve ilegale. Masat prioritare në këtë fushë janë: forcimi institucional dhe i kapaciteteve të organeve të rendit publik; forcimi i bashkërendimit dhe bashkëveprimit me institucionet ndërkombëtare të luftës kundër krimit të organizuar dhe trafikëve; harmonizimi i masave goditëse me ato parandaluese. Qeveria do të thellojë luftën kundër korrupsionit, duke e konsideruar atë si një nga dukuritë më negative dhe me kosto të lartë publike që shoqërojnë tranzicionin, mbështetur në Planin e Masave të Luftës Kundër*

*Korrupsionit dhe në një angazhim të përditshëm kundra tij duke bashkëpunuar me të gjitha institucionet e specializuara të shtetit. Drejtimet kryesore të luftës kundër korrupsionit përfshijnë: rritjen e transparencës; forcimin e përgjegjshmërisë ligjore dhe publike; adoptimin e masave parandaluese dhe dekurajuese për korrupsion; forcimin e zërit dhe pjesëmarrjes së publikut, grupeve të interesit, komunitetit të biznesit, komuniteteve vendore. Reforma e gjyqësorit, që përbën një nga drejtimet më të rëndësishme të reformave institucionale, synon të bëjë të mundur që ligji të zbatohet me drejtesi dhe i barabartë për të gjithë.”*

Në programin e demokratëve të vitit 2005 thuhet:

*“Qeveria angazhohet drejt përkushtimit dhe përgjegjshmërisë së lartë në ushtrimin e pushtetit, çmontimit të sistemit të korrupsionit dhe monopoleve, luftës kundër fenomenit të korrupsionit, krimit të organizuar dhe trafiqeve kriminale.*

*Forcimi e garantimi i rendit e sigurisë publike, individuale e komunitare do të përbëjë angazhimin parësor të maxhorancës së re e qeverisë së saj. Motoja e Qeverisë është: "Tolerancë zero ndaj krimit".*

*Synimet themelore të reformave të qeverisjes për katër vitet e ardhshme janë:*

*-zhvillimi e konsolidimi i shtetit demokratik në themel të të cilit qëndrojnë liritë dhe të drejtat themelore të individit;*

*- rikthimi i forcës së shtetit ligjor ku ligjet zbatohen plotësisht dhe në mënyrë të barabartë për të gjithë, çmontimi i sistemit të korrupsionit;*



*- zhvillimi i shpejtë, i balancuar e i qëndrueshëm ekonomik e njerëzor;*

*- integrimi i Shqipërisë në BE dhe NATO.*

*Progresi i njëkohshëm në të katër objektivat madhore do të shënojë mbylljen e tranzicionit, shërimin e problemeve të mëdha të nënzhvillimit veçanërisht ato të varfërisë, të shëndetit publik, të arsimit dhe të aksesit në shërbimet bazë publike, degradimit të mjedisit dhe kalimin e vendit në fazën e një ecjeje të shpejtë drejt integritit europian dhe euroatlantik.”*

Këto elementë tregojnë se të dy programet përshkohen nga e njëjta mënyrë konceptimi dhe nga të njëjtat prioritete. Dallimi është minimal, roli i ideologjisë po ashtu. Për më tepër në paraqitjen para parlamentit të programit të vitit 2002 Kryeministri i atëhershëm është shprehur:

*“Bashkëpunimi me opozitën konsiderohet i hapur për çdo çështje të rëndësishme me interes të përbashkët, por në veçanti në lidhje me procesin e integritit europian të vendit, të luftës kundër krimit, trafikëve të paligjshme, korrupsionit dhe ndëshkimit ligjor të tyre, si çështje që kanë të njëjtën ndjeshmëri për të gjithë ne, pavarësisht pozicioneve tona politike”*

Ky është në fakt një konfirmim eksplicit i deideologjizimit dhe mungesës së dallimeve programore. Më tej në lidhje me zhvillimin e infrastrukturës në programin e vitit 2002 thuhet:

*“Zhvillimi i infrastrukturës dhe përmirësimi i shërbimeve jetësore që lidhen me të, duke konsideruar efektet e drejtpërdrejta dhe të shumëfishuara të saj në zhvillimin ekonomik dhe social konsiderohen nga Qeveria si fushë prioritare e programit të saj.”*

Në atë të vitit 2005:

*“Në projektin e ndryshimit të mazhorancës së re dhe qeverisë së saj, zhvillimi i një infrastrukture moderne që e integron vendin me rajonin dhe me Europën konsiderohen si kusht bazë për sigurimin e rritjes së synuar ekonomike dhe për zhvillimin në tërësi të vendit. Qeveria do të forcojë kapacitetet projektuese dhe zbatuese të projekteve infrastrukturore, do të rrisë ndjeshëm alokimin e shpenzimeve publike në këtë fushë.”*

*Nga ana e së majtës vihet re një shmangie e konsiderueshme drejt së djathtës në zgjidhjen e çështjeve të shumta të tilla si energjia elektrike, uji i pishëm, telekomunikacioni e burimet minerare.*

Energjia elektrike

*“Gjatë gjithë viteve të tranzicionit, krahas problemeve të tjera, shqiptarët janë përballur edhe me mungesën e energjisë, mungesë e cila aktualisht ka marrë trajtat e një krize, kapërcimi i së cilës kërkon angazhim serioz. Pikërisht për këtë arsye, sektori i energjisë do të jetë një nga prioritetet më madhore të Qeverisë. Bazuar në rezultatet e dukshme të kohëve të fundit në drejtim të rritjes së shkallës*

*së furnizimit, rritjes së arkëtimeve, nisjen e disa programe investuese dhe rehabilituese me një mbështetje të gjerë të partnerëve ndërkombëtarë dhe hapat e parë të hedhura në reformën e çmimit të energjisë elektrike”*

#### Uji i pishëm

*“Qeveria është e ndërgjegjshme për problemet ende mjaft të mprehta me të cilat përballlet popullsia në sektorin e furnizimit me ujë dhe evadimit të ujërave të zeza. Qeveria e shikon kapërcimin e kësaj situate si një element thelbësor të punës gjatë mandatit të saj nëpërmjet përdorimit të formave alternative të menaxhimit nëpërmjet shtrirjes të konçesionit, kontratave të menaxhimit dhe deri tek privatizimi.”*

#### Telekomunikacioni

*“Ndër masat që do të ndërmerren nga Qeveria për arritjen e këtyre objektivave mund të përmenden: (I) privatizimi i kompanisë Albtelekom; (II) krijimi i kushteve për thellimin e konkurrencës në telefoninë celulare; (III) forcimi i institucioneve rregullatore.”*

#### Burimet minerare

*“Në lidhje me burimet minerare do të shtrihen më tej format e ndryshme të konçesionit.”*

Kurse nga ana e demokratëve hasen shmangie të theksuara drejt së majtës kryesisht në konceptimin e dimensionit social të shtetit. Kështu në program thuhet:

*“Maxhoranca e re konsideron se natyra sociale e shtetit është jo vetëm një detyrim, por edhe një qasje efikase në shërbim të zhvillimit ekonomik e social të vendit. Një trajtim i tillë kërkon që politikat sociale të shndërrojnë thelbësisht natyrën e tyre nga pasive në politika aktive dhe njëkohësisht të jenë një investim për rritjen dhe fuqizimin e kapitalit social.”*

Më tej:

*“Rritja e pageve dhe pensioneve do të jetë një prioritet i politikave buxhetore të mazhorancës së re dhe qeverisë së saj. Pensionet do të dyfishohen brenda periudhës 4 vjeçare ndërsa do të vazhdojë ngushtimi i diferencës së pensioneve të qytetit me ato të fshatit. Në këtë mënyrë pensionet do të tejkalojnë ndjeshëm minimumin jetik, nivel në të cilin ato mbeten në vitet e qeverisjes socialiste.”*

*“Pagat në administratën publike do të rriten, me përparësi pagat e ulta, duke synuar që në fund të periudhës 4-vjeçare raporti mes pagës më të lartë dhe më të ulët në administratën publike të jetë 1 me 5. Në këtë sektor do të ngushtohen edhe diferencat e theksuara dhe çbalancimet e krijuara mes degëve të ndryshme duke i dhënë përparësi rritjes së pagave në sektorët e shërbimit të drejtpërdrejtë të*

*qytetarëve e vaçanërisht në arsim, shëndetësi, rend publik. Rritje të ndjeshme periodike do të ketë edhe për pagën minimale në sektorin privat.”*

Në mënyrë krejt majtiste dhe madje të një të majte disi utopike në program gjejmë shprehje të tilla si:

*“Politikat dhe instrumentat sociale do të reformohen në mënyrë të tillë që çdo i varfër të ndihmohet të dalë nga varfëria”.*

Apo:

*“Asnjë fëmijë nuk do të braktiset, çdo fëmijë do të ketë kujdesin që meriton.”*

Në lidhje me barazinë gjinore që në fakt është një çështje që është me ndjeshmëri të lartë për të majtën ndërmerren zotime të tilla si:

*“Politikat gjinore të qeverisë do të synojnë një akses më të lartë të gruas në tregun e punës, në shanset për karrierë zyrtare, politike, biznesi. Me përparësi politikat nxitëse e promovuese të barazisë gjinore do të përqëndrohen në zonat rurale e të prapambetura të vendit”.*

Kështu në bazë të një analize të thjeshtë të pozicionimit ideologjik të demokratëve dhe socialistëve në lidhje me ofertën e tyre për të qeverisur, vihen re njëherazi; konceptime dhe zgjidhje të pastra teknike e pragmatike ku linjat e ndarjes mes të majtës dhe të djathtës nuk janë të dukshme; kontroversialitet ideologjik ku e majta mendon e vepron djathtas ndërsa e djathta, majtas; dhe gjithashtu një

konvergencë ideologjike e cila në fakt nuk zhvillohet në trajtën e ndonjë konsensusi mes palëve. Megjithëse këtu u paraqitën vetëm disa shembuj ilustrues, duket qartë *'tipi'* i ofertave politike në një situatë *deideologjizimi*.

### **4.3 Roli i elitave**

Shumëllojshmëria e mënyrave të organizimit të jetës shoqërore e politike në çdo shoqëri paraqet nevojën apo edhe domosdoshmërinë për të kuptuar se kush vendos, vullneti i kujt zbatohet realisht, kush qeveris, kush administron. Zakonisht vëmendja drejtohet tek elitat që mund të shihen si një pjesë numerikisht e vogël e popullsisë e përbërë nga ndividë që rrjedhin nga një ose disa shtresa shoqërore të aftë që të ushtrojnë ndikim më shumë se proporcional në raport me numrin e atyre që e përbëjnë. Ekzistenca e elitave në çdo shoqëri është empirikisht e konstatueshme dhe (pse jo, edhe) e dëshirueshme për vetë faktin se mendohet se përbëhet nga elementët më të vlefshëm të shoqërisë. Një dallim mjaft i rëndësishëm që duhet mbajtur parasysh është ai midis elitave dhe asaj çka përkufizohet si klasë, dy realitete krejt të ndryshme, megjithëse jo rrallë, ato gjejnë shprehje tek njëra-tjetra. Sundimi i elitës nuk është sundimi i klasës. Duhet theksuar se pavarësisht se çfarë ngjyrimesh mund të marrë në kontekst të gjithëpërfshirjes e deliberimit demokratik, ka gjithnjë një elitë që udhëheq si një pakicë përkundrejt masës. Kështu, duke u rikthyer tek çështja se kush vendos dhe vullneti i kujt zbatohet, sot, pothuajse në mënyrë të natyrshme mendojmë për sistemin demokratik. Sipas qasjeve elitiste, demokracia e cila është mjet i masave

për shprehjen e vullnetit të tyre, në fakt është e mundur vetëm në një kuptim të kufizuar duke qenë e lidhur ngushtë me përfaqësimin dhe organizimin e partive. Demkracia është e lidhur domosdoshmërisht me partitë e mirëorganizuara dhe procedurat e rregullta të votimit çka në vetvete sjell përparimin e burokracisë dhe zhvillimin e makinave partiake. Këto makina partiake ‘kërcënojnë’ autonominë e parlamenteve apo *kongreseve* si organet ku diskutohen dhe hartohen politika. Sa më tepër zgjerohet partia si një organizatë aq më tepër burokratizohet dhe për më tepër, vetë partia drejtohet nga zyrtarë të cilët monopolizojnë pushtetin duke qenë në krye e në drejtim të partisë. Për më tej, partia që ka shumicën mund të diktojë vendimet që konsideron si më oportune. Shkalla e demokracisë së arritur realisht është shumë e ulët. Kështu demokracia paraqitet si metodë për realizimin e qeverisjes nga elitat më tepër se sa mjet i sigurimit të pushtetit të masave duke siguruar zëvendësimin e një politikani apo partie politike me një tjetër dhe në një farë mënyre e humb kuptimin si sundim i popullit. Duhet mbajtur parasysh si një e dhënë me mjaft rëndësi edhe fakti që politikisht aktive është një pjesë e shoqërisë dhe jo të tërë qytetarët. Ajo që do të përbënte ‘sundim politik’ arrihet të shmanget në një farë mënyre nëpërmjet konkurrencës për vota dhe ky është dimensionin ku shihet ndikimi i qytetarëve, si një indikator për sjelljen e politikanëve. Elita është ajo që merr vendimet sipas axhendave zyrtare dhe jozyrare si në politikën e jashtme ashtu edhe në atë të brendshme. Sipas Schumpeter demokracia rezulton si sundimi i politikanit si një ‘tregtar votash’ dhe jo sundim i popullit. Pra rezulton se është maja e piramidës ajo që zakonisht i

merr vendimet ose ka influencën më të madhe në marrjen e tyre. Mënyra më tipike e shprehjes së vullnetit të masave është ajo e demokracisë së drejtpërdrejtë nëpërmjet referendumeve. Sidoqoftë edhe në këtë rast, kur votohet për të vendosur për një ose disa çështje, është një elitë ajo që servit alternativat dhe arrin edhe ta manipulojë masën në mënyra të ndryshme, si p.sh. në sajë të informacionit që i servit apo mënyrës se si parashtrohen situatat.

Numri më i madh i vendimeve në lidhje me çështje të ndryshme si politike, ekonomike, të sigurimit e më gjerë merren me dyer të mbyllura nga politikanë, burokratë apo teknikën. Qytetarët në mënyrë të vazhdueshme po tëhuajësohen nga politika, siç mund të shihet nëpërmjet niveleve të ulëta të pjesëmarrjes në zgjedhjet elektorale. Fati i tyre nuk mbetet të kontrollohet nga elitat. Inkopetencës së masës i shtohet dhe apatia apo disinteresi. E gjithë kjo mund të shihet si rrjedhojë e marrjes së vendimeve në nivelet e larta. Njerëzit e humbin interesin në shkallën që ato humbin aftësinë për të kontrolluar situatën apo për të vepruar për arritjen e rezultateve të dëshiruara. Apatia e gjerë mund të konsiderohet deri në një farë mase edhe si 'e natyreshme', si rrjedhojë e shqetësimit të njerëzve për shumë çështje të tjera të përditshme jashtë sferës së zhvillimeve politike. Paradoksisht edhe sikur të ndodhemi përballë një aktivizmi të gjerë qytetar ku shumë grupime apo individë i depozitojnë sistemit qeverisës kërkesat e tyre, kjo do ta bllokonte sistemin dhe sërisht do ishin elitat (qeverisëse) ato që vendosin drejtimin e veprimit për ta zhbllokuar atë. Në kushtet e problematikave komplekse që paraqet sistemi i demokracisë në kohët e sotme, masa është



konsumatore më tepër se sa krijuese e politikave, ku çështjet më të rëndësishme mbeten jashtë kontrollit të qytetarëve. Roli i tyre kufizohet tek zgjedhja e përfaqësuesve dhe udhëheqësve dhe komunikimi e depërtimi i dëshirave popullore në marrjen e vendimeve politike është i mundur deri në një farë niveli. Realiteti është se shoqëria moderne në mënyre të pashmangshme ndahet në një pakicë qeverisëse dhe në një shumicë të qeverisur, ashtu si pashmangshmërisht gjithnjë krijohet ndarja elitë-masë. Elitat vendosin axhendat politike ndërkohë që aksioni i popullit është shpesh simbolik. Ajo që kuptohet si demokraci s'është veçse 'mjete për të ndërruar elitat në pushtet'.

Në kuadër të marrëdhënies së dy-anëshme qeveri/të qeverisur - elitë/masë, pyetja se cila është madhësia e duhur e një qeverie nuk është një pyetje e thjeshtë. Ajo varet në një masë të madhe nga pritshmëritë e qytetarëve për të mirat publike dhe mbrojtjen e shtetit nga vështirësitë ekonomike. Në Shqipëri, grupet e pafavorizuara dhe në risk të shoqërisë dhe shtresat e varfëra përfaqësojnë dy kategori të ndërthurura të cilat ushqejnë/përforcojnë njëra-tjetrën. Varfëria ekonomike reflektohet në problemet sociale me të cilat ballafaqohen sot të moshuarit e vetmuar, pensionistët, fëmijët e rrugës, të rinjtë e papunë (dhe me sjellje kriminale), viktimat e dhunës, gratë kryefamiljare, fëmijët/të miturit e përfshirë në forma të ndryshme të punës, etj. Varfëria duket se gjithashtu ka një dimension rajonal dhe gjeografik në vend. Duke përdorur një spektër të gjerë përkufizimesh, fshati në përgjithësi dhe zonat malore në veçanti janë të varfëra. Kjo influencon programet dhe politikat për uljen e varfërisë në këto zona.

Sipas statistikave dhe anketimeve të ndryshme të Bankës Botërore në vite, 10 % e familjeve në qytet në Shqipëri, shpenzojnë rreth katër herë më shumë sesa 90 % e familjeve të tjera, duke krijuar kështu një 'shtresë të pasur' shqiptare. Nga ana tjetër gjysma e shpenzimeve të familjeve shqiptare shkon ende për ushqime, ndërkohë që arsimimi dhe shpenzimet shëndetësore janë në fund të listës së shpenzimeve (Banka Botërore, 2006). Gjithsesi niveli i jetesës në Shqipëri, mbetet i pakrahasueshëm jo vetëm me Europën perëndimore, por edhe disa vende ish-komuniste të Europës qendrore. Vrojtimit e realizuara nxjerrin në pah polarizimin e fortë midis shtresave të ndryshme sociale.

Kjo gjendje ekonomike e sociale në vend është terreni që shërben si *input* për ndërmarrjen e politikave të ndryshme nga ana e qeverive. Kështu, ndikimi i rrethanave ekonomike e sociale ka qenë mjaft i fortë në mënyrën e qeverisjes së të dyja kampeve politike kryesore në vendin tonë. Gjendja e vështirë ekonomike dhe pozita të vështira sociale në Shqipëri kanë qenë faktor me ndikim të drejtpërdrejtë në deideologjizimin e politikave të qeverisjes.

Sipas politologut Hasimja (2005), 'diçka shumë akute dhe problematike për demokracinë si dhe për një sistem të shëndoshë politik në vend është shkëputja e elitave nga elektorati. Kjo shprehet me një seri faktorësh të tillë si nivele të larta abstenimi, elektorati gri dhe radikalizimi i komunikimit politik midis forcave politike, etj'. Elitat, pushteti, demokracia dhe partitë politike janë elementë të ndërlikur dhe dinamika e tyre në fakt pasqyron jetën politike të një vendi.

Në kontekstin shqiptar, qytetarët e thjeshtë në parim, janë më pak kompetentë e më pak të përditësuar se politikë-bërësit ekspertë që vendosin për çështjet politike. Kështu, procesi politik më tepër se sa të formësohet nga preferencat e elektoratit, drejtohet nga aspiratat, qëllimet dhe ambicjet e politikanëve në vend. Në këtë mënyrë procesi politik në Shqipëri funksionon më tepër nga lart-poshtë se sa nga poshtë-lart. Në një farë mënyre fati i shumicës është në dorën e një pakice që përbën elitën pavarësisht se si përkufizohet ajo. Elitat politike janë ato që qeverisin një komb dhe është mjaft e rëndësishme të kuptohet se në çfarë procesesh kalojnë elitat dhe se si qarkullojnë apo alternohen ato duke qenë se mëtimi i pushtetit është karakteristikë e çdo elite politike.

Marrëdhënia e elitave me masën apo me elektoratin është mjaft e rëndësishme për procesin politik. Në një kohë kur rolin kryesor në politikë e luajnë elitat dhe ndikimi i masës është i kufizuar, për të kuptuar proceset politike dhe rrjedhimisht edhe procesin e deideologjizimit, duhen analizuar veprimet politike të elitës. Pra deideologjizimi mund të shihet edhe si një rezultat i lojës së komplikuar politike të elitës që ka si qëllim fitimin dhe ruajtjen e pushtetit për një kohë sa më të gjatë. Thelbi është se për marrjen dhe ruajtjen e pushtetit elitat nuk i kanë kushtuar ndonjë vëmendje ideologjisë dhe shpesh, përkundrazi, kanë dalë edhe në kah të kundërt të spektrit ideologjik ku do të duhej të ishin të pozicionuar. Kështu në këtë kuadër mund të analizohen një sërë veprimesh të rëndësishme të politikanëve shqiptarë dhe mund të kuptohen derivatet e procesit politik të menaxhuar nga elitat.

Një nga fenomenet e shpeshta të politikës gjatë qeverisjes së kampit të majtë ka qenë ndryshimi i shpeshtë i Kryeministrave dhe i Ministrave në kabinetin qeveritar si rrjedhojë e konfliktit të brendshëm pa ndonjë përmbajtje ideologjike (Fuga, 2003). Për vetëm rreth 8 vjet qeverisje të së majtës ka patur rreth 8 herë ndryshime në përbërjen e qeverisë apo të ndërrimit të Kryeministrit:

Qeveria e kryesuar nga Fatos Nano 25 korrik '97 – 23 prill 1998

Kjo qeveri vjen pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 29 qershorit '97. Forcat e majta vijnë në pushtet.

Ndryshime në qeverinë Nano, 24 prill 1998 – 28 shtator 1998;

Muaji prill 1998 përkon me krizën e qeverisë Nano, e cila risjell riformulimin e kabinetit të tij. Shumë propozime të tij për ministra të rinj në kabinet, rrëzoheshin nga Kuvendi.

Qeveria e kryesuar nga Pandeli Majko, 2 tetor 1998 – 25 tetor 1999;

Si pasojë e konflikteve të ashpërsuara brenda PS-së, por dhe si pasojë e gjendjes së krijuar pas vrasjes së deputetit Azem Hajdari, trysnia mbi qeverinë Nano u rrit, duke e detyruar atë të jepte dorëheqjen. PS-ja caktoi Pandeli Majkon si kryeministër.

Qeveria e kryesuar nga Ilir Meta, 28 nëntor 1999 – 6 shtator 2001;

Majko jep dorëheqjen si Kryeministër, si pasojë e humbjes së tij në zgjedhjet në Kongresin e PS-së për kryetar partie.

Mandati i ri qeveritar i Ilir Metës, 6 shtator 2001 – 29 janar 2002;

Kjo qeveri erdhi pas zgjedhjeve parlamentare të 24 qershorit 2001 dhe fitores së rishit të së majtës.

Qeveria e kryesuar nga z. Pandeli Majko, 22 shkurt 2002 – 25 korrik 2002;

Konfliktet brenda vetë partisë në pushtet, shtoheshin çdo ditë. Pandeli Majko vjen në krye të qeverisë, si rrjedhojë e marrëveshjes së përkohshme brenda palëve në PS, konkretisht pas konflikteve të acaruarra Nano-Meta

Qeveria e kryesuar nga Fatos Nano, 29 korrik 2002- 29 dhjetor 2003;

Nano vjen sërisht në krye të qeverisë, bazuar edhe në hapësirën e lejuar nga statusi i PS-së, sipas të cilit kryetari i partisë duhet të jetë edhe kryeministër. Kështu, qeverisja e shkurtër e Majkos merr fund në 25 korrik. Meta në këtë qeveri mban postin e zëvendëskryeministrit. Në dukje konflikti i brendshëm në PS, shfaqet sikur u zgjidh.

Dhjetor 2003 – 1 shtator 2005;

Nano riformulon qeverinë, ku Ilir Meta mbetet jashtë kabinetit. Konflikti Nano-Meta çoi në largimin përfundimtar të këtij të fundit nga PS dhe krijimin e një partie të re të spektrit të majtë. Kabineti i ri i kryesuar nga Nano vazhdon punën

deri në zhvillimin e zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare në 3 korrik 2005, ku pas 8 viteve në pushtet të majtët kalojnë në opozitë. Në zgjedhjet e vitit 2009 PD-ja si parti e djathtë krijoi koalicion qeverisës me LSI si parti e majtë.

Të gjitha këto ndryshime të vazhdueshme janë rrjedhojë e konflikteve të brendshme partiake të cilat janë pa përmbajtje ideologjike. Ndryshimet paraqiten si një përpjekje për të ruajtur pushtetin, për të qeverisur e në të njëjtën kohë krijojnë përshtypjen e një lufte të fortë për pushtet brenda partisë, si një element që motivon elitat duke zbehur rëndësinë e programeve apo parimeve ideologjike. Ndërkohë kjo logjikë funksionon edhe në kampin e djathtë, ku si përpjekje për marrjen e pushtetit bëhen manovra politikisht të çuditshme dhe parimisht të papranueshme. Kështu koalicioni i ‘djathtë’ që fitoi zgjedhjet në vitin 2005 i përbërë nga PD, PR, PDR, PBDNJ, PAA dhe PDK në fakt nuk është mirëfilli i djathtë. Kjo sepse në këtë koalicion përfshihet partia Agrare Ambientaliste që ka një orientim të majtë dhe që më parë ishte pjesë e koalicionit të majtë. Edhe gjatë fushatës elektorale për zgjedhjet parlamentare të vitit 2005 përkrahja e kësaj partie ishte për të majtën, por menjëherë pas humbjes në zgjedhje të këtij koalicioni me ftesë të së djathtës, PAA kaloi në koalicionin që më parë e shihte si kundërshtar. Kështu Kryetari i Partisë Agrare Ambientaliste gjatë qeverisjes së të majtës ka qenë Ministër Bujqësie dhe me fitoren e të djathtës ai sërish është pjesë përbërëse e qeverisë si Ministër i Mjedisit. Kjo i dha emrin fenomenit të Xhuvelizmit politik që më vonë u bë edhe më flagrant kur në zgjedhjet e vitit 2009 PD si parti e djathtë krijoi koalicion me LSI si parti e majtë. Kjo dëshmon

se është pikërisht pushteti ai që vlerësohet më tepër se parimet që do të duhej të udhëhiqnin politikën. Kjo është një flakje tej në mënyrë demonstrative e ideologjisë dhe e rolit që ajo do të duhej të luante. Nga zgjedhjet parlamentare të vitit 2009 në Shqipëri doli një mazhorancë miks të djathtësh dhe të majtësh. Ilir Meta deklaroi kalimin e tij djathtas, në përgjigje të ftesës së liderit të PD-së, Sali Berisha për të bërë të mundur formimin e koalicionit qeverisës. Berisha i kërkoi LSI-së dhe kryetarit të saj Meta të bashkëpunojë për të formuar mazhorancën parlamentare në kushtet kur ai nuk arrinte në 71 mandate për të formuar qeverinë e re. Meta iu përgjigj pozitivisht kësaj ftese ndaj PD dhe LSI bashkarisht bënë 74 deputetë apo mandate në Parlament. Ilir Meta u shpreh se ishte gati të shkonte djathtas për hir të stabilitetit të vendit. Ai deklaroi se pranonte ftesën e kryetarit të PD-së për një qeverisje më efektive. Sipas tij, ky ishte një vendim i vështirë por i nxitur nga vetë Edi Rama që braktisi LSI-në disa herë radhazi gjatë këtyre viteve të fundit. Sipas gjyqimit të kryetarit të LSI-së, koalicioni me PS-në nuk mund të sillte asgjë përpos kaosit pasi nuk plotësoheshin mandatet për të formuar qeverinë. Mandatet e PS-së dhe LSI-së bashkë sipas Ilir Metës mund të ishin vetëm bllokuese për zhvillimin e vendit. Berisha ftoi publikisht LSI-në të bëjë koalicion për të qeverisur vendin sepse sipas tij, kjo parti ka në qendër të programit të saj integrimin dhe punësimin si kryefjalë e reformave dhe përpjekjeve të saj. U deklarua se këto elemente përputhen më së miri me programin e PD-se megjithëse LSI është një parti e spektrit të majtë. Kështu u krijua një koalicion qeverisës me një spektër më të gjerë se më parë. E njëjta gjë ka ndodhur edhe me PBDNJ e cila

gjatë periudhës 1997-2005 ishte në aleancë qeverisëse me socialistët dhe për një periudhë të gjatë ka drejtuar Ministrinë e Shëndetësisë dhe atë të Drejtësisë. Në vitin 2005 kjo parti kaloi me demokratët dhe drejtoi Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale. Kështu, dy nga gjashtë partitë e koalicionit 2005-2009 kanë patur mospërputhshmëri ideologjike me të djathtën dhe veprimi i tyre politik nuk është aspak i motivuar nga parimet ideologjike që në teori do të duhej t'i udhëhiqnin. Kjo sigurisht përkthehet edhe në politikat konkrete që ndërmerren në kuadër të qeverisjes së koalicionit. Një faktor tjetër i rëndësishëm që ka ndikuar në deideologjizim është tërheqja e specialistëve, ekspertëve dhe teknikienëve nga fusha të ndryshme e praktikuar që herët nga forcat politike në pushtet duke krijuar 'kabinete ekspertësh' apo 'qeveri specialistësh' dhe duke i dhënë politikës ngjyrimet e një politike "teknicienësh". Kjo është një prirje për t'i depolitizuar ekipet politike dhe ato qeveritare dhe sigurisht që ka patur ndikim të konsiderueshëm në qëndrimet gjithnjë e më pak ideologjike të partive.

Në Shqipëri gjatë viteve të tranzicionit elitat politike gjithnjë kanë qenë më tepër të shqetësuara për pushtetin dhe përfitimet e lidhura me të sesa për artikullimin e programeve apo platformave ideore të pozicionuara në mënyrë korrekte. Pra lufta për pushtet ka sjellë humbjen e rolit të ideologjisë në veprimin politik. E majta është shndërruar në 'të majtë kaviar' dhe e djathta është bërë më e përlulur.

Kastriot Islami (2009) argumenton se termi e 'majta kaviar' është përdorur për herë të parë në Francë, për të cilësuar ato personalitete apo lider që hiqen si të



majtë, por për shkak të pasurisë së tyre janë shumë larg njerëzve të thjeshtë dhe mjediseve popullore. Shpesh për ta thuhet se ‘ata kanë zemrën majtas por portofolin djathtas’. Ky është një term i futur në vitet ’80, për të përshkruar të gjithë ata personazhe që hiqeshin si të majtë duke dhënë këshilla se çfarë duhet bërë dhe nuk bënin asgjë nga ato që thoshin, sepse asgjë e përbashkët nuk i lidhte me votuesit apo shtresat e varfra apo të mesme që votojnë për të majtën. Laurent Joffrin në librin e tij ‘Historia e të Majtës Kaviar’ thotë se e majta kaviar, duke u bërë më shumë kaviar se e majtë, është bërë e paaftë të ulë papunësinë, të luftojë varfërinë dhe përjashtimin social, të sigurojë barazinë e shanseve, etj, sepse ajo ka harruar popullin, votuesit e saj. Në vende të ndryshme, për këtë lloj të majte përdoren terma të ndryshëm. Në Australi përdoret termi “socialist i Chardonese”, në Irlandë “socialist i salmonit të tymosur”, në Angli “socialist i Shampanjës” etj. “Kjo është një nga arsyet themelore që e majta thuhet se është në krizë identiteti, ku elita nuk është përfaqësuese kur është në opozitë dhe nga ana tjetër kur është në pushtet nuk mbron interesat e shtresave kryesore që e votojnë, por ushqehet nga ‘shtresat e kaviarit’ dhe nxjerr ligje në favor të tyre.

Në të njëjtën kohë, nuk mungon edhe djathtas një terminologji pezhorative. Kryesisht nga e djathta, shumë personalitete e lider tentojnë në mënyrë populiste të bëhen tërheqës për shtresat e varfra ose të ulta të popullsisë, apo për ato votues që është vështirë të gjenden zgjidhje të problemeve sociale. Termi i gjetur në Francë është ai i të ‘djathtës kasule’ (kasule është një gjellë me fasule dhe salçiçe që përdoret shumë si ushqim për të varfrit)”.

Në kushtet e një boshllëku ideologjik në ligjërimin politik, çështjet konkrete dhe praktike të shtruara për zgjidhje janë adresuar nga vendimet politike të detyrueshme për të gjithë shoqërinë të cilat janë shpeshherë në kundërshti me njëra-tjetrën, në masën dhe në mënyrën që elita politike e ka konsideruar si më të përshtatshme për të realizuar interesat e veta të ngushta të lidhura me pushtetin. Mungesa e kompromisit në politikën shqiptare nuk mund të shihet si pasojë e divergjencës parimore por vjen si rrjedhojë e mungesës së vullnetit politik për të hequr dorë nga interesat specifike larg nga interesat partiake për hir të interesit të përgjithshëm.

Kështu, në përpjekje për të vijëzuar/modeluar e organizuar praktikat kaotike në vend, një përjasje do ishte politika e asaj që mund të konsiderohet si ‘rruga e tretë’ që konsiston në forma jo ideologjike të administrimit të çështjeve publike. Kjo do të thotë gjetje e zgjidhjeve tërësisht rrethanore, konkrete dhe jodoktrinare për problemet shqiptare. Ndryshe nga filozofitë politike, kjo praktikë shkon në kundërshti me metodën ‘aksiomatike’ të mendimit dhe të veprimit politik. Mendimi ‘aksiomatik’ i bazuar në doktrinë e sheh zbatimin konkret të parimeve teorike si absolutisht të vlefshëm për të gjitha shoqëritë. Në lidhje me politikën e përtej të majtës dhe të djathtës, zgjidhjet janë të vlefshme nëse induktohen dhe nxirren nga rrethana të veçanta e konkrete, duke u paraqitur në këtë mënyrë, rrethanore dhe relative. Rrjedhimisht, një politikë e tillë është cilësuar si një praktikë në kërkim të vazhdueshëm të ‘doktrinës’ dhe lind në kushtet e humbjes së besimit tek parimet e përgjithshme.

#### 4.4 Ndikimi ndërkombëtar

Integrimi European është një nga çështjet që qëndron në majë të piramidës e prej vitesh përbën prioritet për politikën shqiptare. Në mes studiuesish të ndryshëm në vend, ka konsensus se ekziston një problem për faktin që integrimi në Shqipëri ngre më shumë çështje teknike dhe administrative sesa çështje politike parimore, në sensin që nuk përbën bazën e ndonjë debati apo deliberimi ndërmjet anëve të ndryshme. Integrimi ngre më shumë çështje menaxheriale. Kjo e bën ideologjinë të parëndësishme dhe zbeh diferencat në platformat e partive politike duke i shtyrë në një pragmatizëm të sforcuar.

Zhvillimi i Bashkimit European është përshkruar gjerësisht në bazë të një numri të dallueshëm fazash apo periudhash të procesit të integrimit dhe në raport me këtë zhvillim kanë lindur disa teori që përpiqen t'u japin shpjegim këtyre fazave duke filluar me funksionalizmin që në vitet 1950. Në këtë fazë besohej se Integrimi European do të avanconte më së miri duke u fokusuar në sektorë të veçantë ekonomikë të cilët mund të manaxhoheshin më efçence dhe në mënyrë teknokrate nga institucione sopranacionale, larg nga turbullirat politike. Duke ndjekur lëvizjen nga Komuniteti i Qymyrit dhe i Çelikut si sektor i veçantë tek Komuniteti Ekonomik, vonë, gjatë 1950-ës, lindën teoritë neofunksionaliste si një mënyrë alternative për të shpjeguar zhvillimin e procesit të integrimit (përfaqësuesi kryesor i kësaj qasje është Haas).

Kështu funksionalizmi nisët nga premisa sipas të cilave “duke promovuar bashkëpunimin funksional ndërmjet shteteve mund të jetë e mundur që të frenohet zgjidhja e problemeve të ndryshme në mënyrë agresive. Logjika pas kësaj qasjeje është se lufta mund të parandalohet jo negativisht –duke i mbajtur shtetet të veçuara –por pozitivisht, duke i angazhuar ato në veprimtari bashkëpunuese, duke vendosur njësi funksionale bashkëpunimi.

Neofunksionalistët kanë një pikë të përbashkët nisjeje me funksionalistët në lidhje me qëndrimin ndaj ndjekjes së qëllimeve të përbashkëta, të cilat sjellin benefite për të gjitha palët dhe rrisin prosperitetin ekonomik. Neofunksionalistët e shohin integrimin si një proces të bazuar tek forma “*spill-over*”. Kjo do të thotë që, nëse ekziston bashkëpunim në një sektor, kjo detyrimisht do të sjellë bashkëpunim edhe në sektorë të tjerë duke përfshirë gjithnjë e më shumë fusha të ndryshme dhe duke ulur fuqinë e qeverive kombëtare, duke sjellë një fuqizim të “qendrës” në aftësinë për të përballuar çështje politike delikate.

Qasja neofunksionaliste u sfidua nga ajo që quhet faza “Ndërqeveritare” (Intergovernmentaliste) e Komunitetit gjatë 1970-ës kur institucionet politike sopranacionale të Komunitetit u dukën se humbën iniciativën dhe influencën dhe interesat e shteteve anëtare dominuan procesin. Neofunksionalizmi u sfidua nga neorealistët dhe neoracionalët e më tej dhe nga *liberal intergovernmentalism*. Kjo qasje paraqiti shtetet më tepër se sa institucionet sopranacionale si aktorët kyçë në

procesin e integritit. Shtetet përpiqen të ndjekin preferencat e tyre të veçanta dhe të mbrojnë sferën e tyre të pushtetit.

Vonë, gjatë 1980-ës dikotomia *sopranacionalizëm-intergovernmetalizëm* që përbën debatin kryesor midis dy kaheve të teorive të integritit të neofunksionalizmit dhe neorealizmit është vënë në pikëpyetje nga literatura, e cila e sheh Bashkimin Europian si një sistem me shumë nivele qeverisjeje (*multi-level governance*). Gjithsesi debatet për shpjegimin e integritit ende vazhdojnë të evoluojnë duke u dhënë jetë përplasjeve të reja si për shembull debatit mbi racionalizmin që e sheh vendimmarrjen si të udhëhequr nga ndjekja e interesave materiale nga aktorët strategjikë v.s qasjet konstruktiviste, të cilat e vendosin theksin tek influenca e normave, ideve dhe parimeve në procesin e integritit.

Integrimi i Shqipërisë në strukturat europiane dhe euro-atlantike është prioritet kryesor i veprimit politik në Shqipëri dhe çka është më e rëndësishme, prioritet i çdo qeverie shqiptare, vit pas viti. Integrimi shihet si e vetmja rrugë për Shqipërinë ndërkohë që zhvillimi shihet si i lidhur me integrimin dhe anasjelltas. Në fakt procesi i integritit është një proces më tepër administrativ e teknik sesa politik. Kjo e bën të parëndësishme ideologjinë dhe i shuan dallimet programore midis partive duke i nxitur drejt një pragmatizmi të domosdoshëm mbi bazë të të cilit partitë garojnë në lidhje me kohëzgjatjen dhe ritmin e teknikaliteteve të procesit të integritit.

Aktualisht vendi ndodhet në proces delikat si kandidat potencial për integrim dhe ka përpara një set standardesh që duhet të plotësojë. Këto standarde janë uniforme për të gjitha vendet sepse esenca e BE-së është një grup i njëjtë standardesh i detyrueshëm në lidhje me pothuajse të gjitha politikat publike për të gjitha shtetet anëtare. Kjo do të thotë që çdo vend duhet t'i arrijë ato standarde dhe mund të thotë që e zbatoi marrëveshjen vetëm kur standardet të jenë vendosur.

Pra, për t'u anëtarësuar në BE nuk mjafton vetëm dëshira e vendeve aspirante, sepse BE-ja ka përcaktuar një listë të gjatë me kërkesa. BE nuk është një formacion politik, ku vendimet se cili vend lejohet të anëtarësohet dhe cili jo merren me arbitraritet politik, por përkundrazi, është një subjekt që vendos kushte të qarta. Vendet që duan të antarësohen në BE duhet të kalojnë nga një stad i procesit në tjetrin, por vetëm nëse të gjitha kushtet e secilit stad paraprak janë plotësuar. Në këtë mënyrë aspirata për anëtarësim shërben si stimul për reformat që duhen kryer.

Procesi i Stabilizim Asocimit është një platformë e gjerë marrëdhëniesh që konsiston në një sërë instrumentesh me karakter të ndryshëm si politik, institucional, ligjor, ekonomik, tregtar, financiar, burimesh njerëzore, social, etj. Ai përbën platformën themelore të marrëdhënieve mes BE-së dhe Shqipërisë. Shqipëria është e detyruar të plotësojë kriteret e vendosura nga Këshilli European i Kopenhagenit në qershor të vitit 1993. Këto kritere janë të karakterit politik dhe ekonomik. Ato kërkojnë nga njëra anë që shteti kandidat për integrim të garantojë

demokracinë, shtetin e së drejtës, respektimin e të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve dhe, nga ana tjetër, të vendosë një ekonomi tregu që mund t'i bëjë ballë presionit të konkurrencës së tregut të përbashkët European. Së fundi, shteti kandidat duhet të jetë i aftë t'i përgjigjet detyrimeve që rrjedhin nga “*acquis communautaire*”-legjislacioni i Bashkimit European.

Në Qershor 2006, Shqipëria nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit (MSA) me BE-në duke aspiruar anëtarësimin e saj të plotë në Bashkimin European. Nënshkrimi i MSA-së, përveç vlerës politike, është një platformë e pastër reformash drejt arritjes së standarteve të BE-së në çdo aspekt të jetës politike, ekonomike dhe sociale. Qëllimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit është vendosja e stabilitetit politik dhe ekonomik të shtetit kandidat. Pikërisht për këtë arsye kjo marrëveshje përmban detyrime asimetrike në favor të Bashkimit European. Shqipëria duhet të arrijë rezultate të larta në shumë drejtime, kryesisht në harmonizimin e legjislacionit të brendshëm me standardet e BE-së duke adaptuar tërësisht 80 000 faqet e *acquis communautaire*. Kështu çështjet kryesore në politikën Shqiptare ato që burojnë prej Procesit dhe Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit. Këto çështje janë tejet teknike e standarde dhe lidhen kryesisht me:

- Mëtimin për bashkëpunim politik konstruktiv mes qeverisë dhe opozitës në lidhje me reformat
- Arritja e rezultateve më të mira dhe konkrete në lidhje me luftën kundër krimit të organizuar

- Luftimi i korrupsionit
- Krijimi i pavarësisë dhe e transparencës për sistemin e drejtësisë
- Stabilitet i institucioneve garantuese të demokracisë, sundimi i ligjit, respektimi i të drejtave të njeriut duke përfshirë të drejtat e minoriteteve
- Një ekonomi tregu funksionale e aftë për konkurrencë me komunitetin dhe kapacitet për të përballuar obligimet e anëtarësimit duke përfshirë mbështetje për objektivat politike, ekonomike dhe monetare
- Krijimi i kushteve për integrimin me përshtatjen e strukturave administrative dhe institucionale duke garantuar implementimin efektiv të *acquis communautaire*
- Ndjekja e një politike të jashtme të njëjtë me atë të Bashkimit Europian etj.

Ndërkohë, deri në vitin 2013, qeveria shqiptare ka qenë angazhuar të ndërmarrë hapa konkretë nëpërmjet Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) për periudhën 2007-2013, e cila ka përcaktuar qëllimet afatmesme e afatgjata të Qeverisë shqiptare dhe strategjitë sektoriale. Kryeministri i kohës, Sali Berisha, e ka konsideruar Strategjinë si dokumentin themelor të zhvillimit dhe realizimit të projekteve të mëdha të vendit, integrimin në Bashkimin Europian dhe në NATO. “Strategjia synon përshtatjen e ‘*acquis communautaire*’, të domosdoshme që Shqipëria dhe shqiptarët të integrohen në BE, të standardeve europiane të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit në përputhje me normat,



parimet dhe kriteret e përcaktuara nga BE-ja,” shprehej Kryeministri Berisha në vitin 2008 (Këshilli i Ministrave, 2008).

SKZHI ka shërbyer si dokumenti themelor për projektin e konsolidimit në Shqipëri të standardeve të Bashkimit European, që në thelbin e tyre kanë funksionimin e shtetit ligjor. SKZHI gjithashtu ka krijuar kushtet për përshtatje me kërkesat dhe prioritetet e partneritetit european dhe Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit. Kjo Strategji ka shërbyer si dokument bazë për të gjitha ligjet, vendimet dhe reformat që do të ndërmerren. Pra, duke qenë një strategji e përcaktuar për një afat kohor 6 vjeçar është e qartë se del jashtë shtrirjes kohore të një mandati të vetëm qeverisës dhe vetë hapat që duhet të ndërmerren janë të orientuara e të mirëpërcaktuara nga strukturat përkatëse të BE-së pavarësisht se cila forcë politike është apo do të jetë në pushtet. Është më se e qartë se janë programet e forcave të ndryshme politike ato që përshtaten me prioritetet e parapërcaktuara dhe jo përcaktimi i prioritetëve në bazë të programeve. Në këtë mënyrë nuk ka aspak vend të flitet për ndonjë ideologji dhe ndonjë rol të saj. Duket sikur BE më tepër ka imponuar kushte mbi Shqipërinë, sesa është angazhuar në dialog me të, por zyrtarët Europeanë shprehen se ky është një mit sepse procesi në tërësinë e tij nuk është i detyrueshëm. Askush nuk e detyron Shqipërinë të shkojë drejt Bashkimit European apo të kërkojë një marrëveshje Stabilizim-Asocimi. Natyrisht mirëpritet orientimi euro-atlantik i Shqipërisë, dhe aspiratat e saj për integrimin si në NATO që tashmë është plotësuar, ashtu dhe në Bashkimin European që aspirohet me ngulm. Kjo është pikëpamja pothuajse unanime e gjithë shqiptarëve

dhe se nuk ka ndonjë grupim opinionesh që mbështet një tjetër drejtim alternativ. BE i ka kufizuar shumë alternativat mbi atë çka shteti mund të bëjë dhe rrugët për arritjen e rezultateve. Modeli i shtetit i cili i ka bazat te *acquis communautaire* është ai i një shteti burokratik normash dhe standardesh që rregullojnë tregun dhe jo vetëm tregun ekonomik por edhe atë politik. Duke qenë se ekziston një konsensus paraprak pro reformës, partitë rivalizojnë në lidhje me faktin se cili është manaxheri më i mirë e më efikas dhe jo mbi përmbajtjen e politikave publike. Komisionerët dhe shtetet e BE-së janë të mendimit se ajo që ato eksportojnë nuk është një ‘model shteti’ por janë thjesht praktikat më të mira teknike të cilat në fakt mbulojnë tërë fushat e politikave publike. Pra forcat politike në Shqipëri e kanë të parapërcaktuar rrugën të cilën do të ndjekin dhe nuk mbetet gjë tjetër veçse të konkurojnë mbi baza të aftësisë menaxheriale dhe jo të ndonjë vizioni ideologjik.

Nga ana tjetër, përveç ndikimit që ka procesi i integritimit në Bashkimin Europian, proceset e globalizimit kanë gjithashtu një ndikim të rëndësishëm në lidhjen e politikës shqiptare me ideologjinë. Globalizimi, një term i aplikuar së pari në investime, prodhim dhe tregti, gradualisht përqafoi një gamë të gjerë fenomenesh e procesesh komplekse të cilat shpesh herë janë edhe kontradiktore. Globalizmi aktualisht përfshin pothuajse çdo aspekt të jetës, që nga ‘*fast food*-i’, muzika, moda e shumëçka tjetër. Çdo lloj informacioni përhapet shumë shpejt ndihmuar nga revolucioni në teknologji, veçanërisht nga përhapja e internetit dhe televizionit satelitor. Më tepër sesa një ideologji termi ‘globalizim’ shënon një set

procesesh e dukurish të përfshira nën një epitot të vetëm. Në një vështrim të përgjithshëm duket sikur 'rendi i ri botëror' është më pak politik sesa ekonomik sepse nga një pikpamje realiste, faktorët materialë ekonomikë kanë qenë gjithnjë të një rëndësie parësore krahasuar me diplomacinë dhe fuqinë e 'butë' civilizuese në arenën ndërkombëtare. Gjithsesi, është fakt se globalizimi ka ndikuar jo vetëm në dimensionin ekonomik por edhe në fushën politike, kulturore e atë sociale. Globalizimi është deri në një farë mase triumfi i logjikës së tregut mbi qeverinë/qeverisjen. Si mbështetësit ashtu edhe kundërshtuesit e globalizimit janë në një mendje në lidhje me faktin se forca drejtuese sot është ajo e tregut i cili po ndryshon rolin e çdo qeverie. Për mbështetësit e Globalizimit, rezistenca do të ishte e panatyrshme, jo ekonomikisht e politikisht racionale dhe shpesh e rrezikshme. Liberalizimi i suksesshëm i tregjeve varet jo vetëm nga roli i kufizuar i qeverisë, i konceptuar sipas mënyrës neoliberales por njëkohësisht, në mënyrë të paevitueshme edhe nga ndërhyrja dhe roli i fuqisë së centralizuar shtetërore. Globalistët kanë pritshmëri të larta nga qeveritë në lidhje me implementimin e axhendës së tyre. Ka autorë që argumentojnë se globalizimi po i jep fund epokës së shtetit-komb për shkak të intensifikimit të tregut global. Shqipëria më tepër po i pëson fenomenet e globalizimit, me të mirat dhe të këqijat e veta, pa qenë e vetëdijshme për këto. Globalizimi në aspektin ekonomik konsiderohet se është rezultat i revolucioneve të fundit në teknologji, në informacion, tregti, investime të jashtme dhe biznes ndërkombëtar si dhe i demokratizimit të këtyre, veçanërisht pas shembjes së murit të Berlinit. Aktorët kryesorë të këtij revolucioni janë të

shumtë: kompani, investitorë, banka, dhe industri private, kryesisht perëndimore, por jo vetëm; janë edhe shtetet me politikat e tyre ekonomike, ndër të cilët pa dyshim promotorët janë shtetet perëndimore me në krye SHBA-të si dhe organizmat ndërkombëtare ndër të cilët më së pari mund të përmenden FMN, Banka Botërore dhe OTB-i.

Nga njëra anë qëndrojnë shqetësimet e ngushta proteksioniste për mirëqenien e qytetarëve të një vendi të veçantë dhe nga ana tjetër qëndrojnë shqetësimet për ndërtimin e një rendi ndërkombëtar të paanshëm të bazuar në solidaritetin global. Për shumë arsye, përgjithësisht globalizimi shihet si fenomen pozitiv. Disa karakteristika të Globalizimit janë:

- Globalizimi mëton liberalizimin dhe integrimin e tregjeve në rang global
- Globalizimi është i pashmangshëm dhe i pakthyeshëm
- Askush nuk është përgjegjës për globalizimin në sensin që globalizimi nuk reflekton axhendën e veçantë të ndonjë klase të caktuar apo të ndonjë grupi dhe është larg interesave partizane
- Globalizimi është i dobishëm për të gjithë si ato që kanë vizion liberalizmin ashtu edhe ato që kanë një vizion socialist
- Globalizimi ndihmon përhapjen e demokracisë nëpër botë.

Ndërsa disa rrjedhoja të globalizimit janë :

- Rritje e ndërvarësisë në rang botëror

- Kontroll i reduktuar i komb shteteve në çështjet makroekonomike në mënyrë të veçantë në lidhje me çështjet e politikave buxhetore dhe monetare.
- Zhvendosja e industrive prodhuese nga vendndodhjet e tyre të vjetra drejt vendeve kryesisht me të dhëna më të favorshme.
- Industrializim i shpejtë
- Përhapje e shpejtë e teknologjisë së re në investime në vende të ndryshme

Ndërkohë që njohim përparësitë dhe të mirat e globalizimit, ne duhet të merremi dhe me humbjet që rrjedhin prej tij. Globalizimi i rrit të ardhurat por edhe pabarazitë sociale brenda vendeve. Në disa fusha, globalizimi lë disa vende e sigurisht dhe disa grupe shoqërore prapa. Prandaj ne si shoqëri jemi dëshmitarë të protestave kundër globalizimit si në botën e zhvilluar dhe në atë në zhvillim.

Për fenomenin e Globalizimit nuk mund të përcaktohet data e nisjes së tij, sepse autorë të ndryshëm e trajtojnë në mënyra të ndryshme, madje ka autorë që e trajtojnë si një fenomen të vjetër sa bota, për debatin rreth tij mund të thuhet se ai ka hyrë pas rënies së murit të Berlinit, dmth pas shembjes së sistemit bipolar të ndeshjes së dy sistemeve ideologjike dhe zhvillimeve që e pasuan atë në vitet '90, duke bërë që kjo epokë të quhet nga shumë autorë 'epoka e globalizimit'. Sipas Fatos Lubonjës (2011), si çdo zhvillim tjetër i mendimit botëror edhe debati i lidhur me globalizimin do të hynte me vonesë në një vend si Shqipëria që i ka ende të mangëta si zhvillimet bashkëkohore edhe instrumentet kulturore për të

ndjekur me një hap ecjen e mendimit botëror. Një arsye tjetër është se, si tradicionalisht, edhe në këtë rast, elitat kulturore politike u impenjuan në orientimin e shoqërisë shqiptare drejt imitimit të modeleve dhe teorive që vijnë nga bota më e përparuar, pa mundur të zhvillonin sensin kritik ndaj tyre. Pra Shqipëria, pas rënies së komunizmit, më shumë se çdo vend tjetër kërkoi të realizojë modelet e propozuara nga Perëndimi, ndërkohë që debati mbi globalizimin ka të bëjë pikërisht me shqetësimet në rritje lidhur me këto modele, dhe përgjithësisht ndaj politikave perëndimore, e veçanërisht amerikane, në këtë proces.

Lubonja argumenton se ka edhe një arsye tjetër të rëndësishme që ndikon debatin shqiptar mbi globalizimin. Përgjithësisht debatin lidhur me globalizimin ose më saktë kontestimin e globalizimit e ka nxitur në Evropë e majta (ka edhe një të djathtë ekstreme që e konteston). Kjo, pasi e majta e ka parë globalizimin kryesisht si triumf të neoliberalizmit amerikan dhe jo rrallë e ka trajtuar edhe si formë neokolonializmi ekonomik dhe kulturor. Ndërkaq, klasa politike kulturore shqiptare ka qenë refraktare ndaj ideve të së majtës evropiane, sa për shkak të përqaqimit pa frymë kritike të modeleve liberale aq edhe për shkak të qëndrimit larg ideve të së majtës evropiane. Ky qëndrim, që mund të quhet edhe vetizolim, ka ndodhur pjesërisht për shkak se e kaluara ende e freskët komuniste e vendit i ka bërë njerëzit të jenë refraktarë ndaj ideve të së majtës në përgjithësi, dhe pjesërisht për shkak të një ndjenje faji të mjaft individëve që e përbëjnë këtë klasë për shkak të së kaluarës së tyre komuniste.

Në një farë mënyre, qeverisja globale është bërë e ndjeshme në gjithë botën. Rekomandimet që rrjedhin nga Konferencat Globale të Kombeve të Bashkuara të mbajtura gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, arritën kulmin e tyre në Samitin e Zhvillimit të Mijëvjeçarit, në shtator të vitit 2000 ku 147 kryetarë Shtetesh dhe Qeverish dhe 191 kombe miratuan Deklaratën e Mijëvjeçarit, duke u angazhuar për arritjen e një sërë objektivash deri në vitin 2015. Ato përbëjnë një bazë të fuqishme të të gjitha përpjekjeve për zhvillim.

Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit që rezultuan nga ky organizëm përcaktojnë fushat kryesore ku duhet të fokusohen përpjekjet e qeverive si dhe paraqesin synime numerike dhe indikatorë sasiorë nëpërmjet të cilëve do të vlerësohet progresi i arritur. Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZhM) pasqyrojnë të drejta që i gëzon çdo qytetar i Shqipërisë dhe i mbarë botës; të drejtën për arsimim, kujdes shëndetësor, për strehim dhe siguri.

Ne korrik 2003, Parlamenti i Shqipërisë miratoi një rezolutë mbi OZhM, e cila përforcon detyrimin e Qeverisë së Shqipërisë për të raportuar rregullisht mbi progresin e arritur me OZhM-të. Të gjitha partitë politike janë të përgjegjshme për ndjekjen e OZhM-ve. Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZhM) janë një platformë që ka si qëllim zhdukjen e varfërisë dhe përjashtimin social dhe Deklarata e Mijëvjeçarit nënshkruar nga kryetarët e shteteve përfaqëson një program botëror për uljen e varfërisë në vitet në vazhdim. Tetë objektivat e saj,

krijojnë një kompleks angazhimesh kombëtare duke përcaktuar prioritetet e zhvillimit të vendit (UNDP).

1. Zhdukja e varfërisë ekstreme dhe urisë
2. Arritja e një arsimimi cilësor
3. Nxitja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i rolit të gruas
4. Zvogëlimi i vdekshmërisë foshnjore
5. Përmirësimi i shëndetit të nënës
6. Të luftohet HIV/SIDA, malaria dhe sëmundjet e tjera
7. Sigurimi i mjedisit të qëndrueshëm
8. Përmirësimi i qeverisjes

Në këtë mënyrë, si Partia Socialiste ashtu edhe Partia Demokratike, në disa aspekte, kanë një rrugëtim të shënuar nga OZhM.

Nga ana tjetër Fondi Monetar Ndërkombëtar si një institucion qendror në arenën ndërkombëtare kryen tre lloje funksionesh: funksioni i parë është mbikqyrës, pra monitoron zhvillimet ekonomike e financiare, funksioni i dytë është huadhënia për vendet në vështirësi për mbështetjen e politikave dhe uljen e varfërisë dhe, së treti, FMN-ja u siguron shteteve asistencë teknike në fushat e veta të ekspertizës. Njëkohësisht edhe Banka Botërore është e përfshirë direkt në çështjet e qeverisjes me anë të projekteve të ndryshme të saj.

Misioni i vlerësimit të sektorit financiar të Bankës Botërore dhe Departamentit të Kërkimeve të Fondit Monetar Ndërkombëtar takohen me zyrtarët më të lartë të



financave dhe ekonomisë shqiptare dhe vëzhgojnë respektimin e standardeve ndërkombëtare të kësaj fushe. Autoritetet shqiptare janë angazhuar për bashkëpunim të ngushtë për të rritur rezultatet e sistemit financiar dhe ekonomik krahas respektimit të standardeve ndërkombëtare. Është shfaqur si praktikë e zakonshme që projekt-buxheti të përgatitet në javët e fundit të çdo viti, duke i lënë debatet e specialistëve për këtë ligj gjithnjë të vakëta dhe me gjithë kritikën e shumta që bëhen, nuk ndodh që të reflektohen gjerësisht mbi projekt-buxhet. Zyrtarët i reduktojnë/zhvendosin kritikën vetëm pas shprehjeve se materialet janë të konsultuara me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore. Kështu duke ndjekur udhëzimet e FMN-së dhe Bankës Botërore dhe duke qenë nën varësinë e tyre nga pikëpamja ekonomike, pavarësisht se cila forcë politike ka qenë në pushtet, secilës i është dashur të ndjekë udhëzimet dhe rekomandimet e ndërkombëtarëve duke krijuar luhatje ideologjike herë në një drejtim e herë në një tjetër dhe ku herë të majtës i është dashur të lëvizë djathtas dhe herë të djathtës majtas. Si fakte që mbështesin luhatjen dhe mungesën e pozicionimit korrekt të forcave politike nga pikëpamja ideologjike mund të marrim procesin e privatizimeve. Pothuajse të gjitha ndërmarrjet e vogla e të mesme janë privatizuar gjatë qeverisjes socialiste. Njëkohësisht, ka patur edhe privatizime të ndërmarrjeve të mëdha në sektorë strategjikë si telekomunikacion, miniera etj. Janë privatizuar kështu minierat e kromit e të bakrit dhe pjesërisht edhe sektorë të naftës. Gjithashtu është privatizuar banka më e madhe në Shqipëri, “Banka e Kursimeve” dhe Shoqëria e Sigurimeve INSIG. Privatizimi i Bankës së

Kursimeve përbën një ndër projektet më të mëdha të privatizimeve në historinë shqiptare dhe është kryer gjatë kohës kur qeveriste Partia Socialiste. Ndërkohe me miratimin në Kuvend të ligjit për privatizimin e INSIG-ut, qeveria shqiptare plotësoi një nga kushtet e vendosura nga Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar për arritjen e një marrëveshjeje midis tyre. Privatizimi i INSIG-ut, ishte kusht i vendosur nga insitucionet ndërkombëtare për arritjen e një marrëveshjeje trevjeçare me qeverinë shqiptare në një vlerë prej 120 milionë dollarë.

Nga ana tjetër shpesh institucionet ndërkombëtare e shtyjnë të djathtën të ndërmarrë politika që në thelb janë majtiste. Ndërkaq efektet e revolucionit globalist janë komplekse dhe të mbarsura me mjaft kontradikta. Kur flitet për efektet pozitive, edhe një autor si Stiglitz, mjaft kritik ndaj globalizimit, arrin të vërë në dukje disa aspekte pozitive të globalizimit. Sipas tij zhvillimi i tregtisë ndërkombëtare e ka ndihmuar zhvillimin ekonomik të mjaft vendeve, pasi eksportet e një vendi nxisin rritjen e tij ekonomike. Rritja e udhëhequr nga eksporti ka qenë qendra e politikës industriale që pasuroi një pjesë të madhe të Azisë dhe u solli miliona njerëzve, atje kushte më të mira. Për shkak të globalizimit, shumë njerëz në botë jetojnë më gjatë dhe standardi i tyre i jetesës është më i mirë. Edhe ndihma e jashtme është një aspekt tjetër i botës së globalizuar. Me gjithë problemet e veta, edhe ajo ka sjellë përfitime për miliona njerëz kudo në botë. Nuk mund të mohohet fakti se një vend si Shqipëria ka parë efektet pozitive të këtyre aspekteve, veçanërisht përse i përket ndihmës së jashtme

dhe mund të thuhet se shqiptarët e izoluar po ndjehen gjithnjë e më shumë pjesë e botës. Por, ndërkaq, debati mbi zhvillimet në vendet e Lindjes pas rënies së komunizmit nën efektin e globalizimit është i mbushur me kontradikta të cilat edhe eksperiencia shqiptare i përforcon më tej. Një nga pikat e nxehta të këtij debati që ka filluar të bëhet gjithnjë e më aktual në vendet e tjera të Lindjes, është ai se Perëndimi nuk është treguar luajal në ofrimin e modeleve të zhvillimit ekonomik për këto vende. Vetë Perëndimi nuk ka ndjekur të njëjtat politika ekonomike pas Luftës së Dytë si ato që u rekomandoi vendeve të Lindjes pas rënies së komunizmit. Sipas Stiglitz shumica e vendeve më të industrializuara, përfshirë Shtetet e Bashkuara dhe Japoninë, e ndërtuan ekonominë e tyre duke mbrojtur me zgjuarsi dhe në mënyrë të përzgjedhur disa prej industrive të tyre, deri sa këto u bënë të forta për të konkuruar me kompanitë e huaja. Po ashtu, në kuadrin e kësaj kritike, përmendet fakti se vendet perëndimore i detyruan vendet e varfra të heqin barrierat tregtare, duke parandaluar eksportet e prodhimeve bujqësore nga vendet e varfra, duke i lënë pa të ardhura nga eksporti, për të cilat kanë aq shumë nevojë, ndërkohë që të vetat i mbajtën.

Në këtë kontekst Shqipëria si një vend që doli me një ekonomi të asfiksuar tërësisht nga 50 vjet izolim teknologjik e profesional nuk mund të konkuronte në tregun e lirë. Fatos Lubonja argumenton se e vetmja mënyrë konkurimi u bë nëpërmjet emigracionit, shitjes së krahut të punës si dhe zhvillimit të trafiqeve të paligjshme të qënieve njerëzore dhe të drogës. Për shumë njerëz kjo ekonomi solli varfërim dhe krijoi kaos social dhe politik. Bujqësia shqiptare u asfiksua

krejtësisht, ndërkohë që shqiptarët u kthyen në argatë të keqpaguar, madje në të zezë, të fermerëve grekë. Më tej Lubonja argumenton se futja e ekonomisë në rrugët informale krijoi një kriminalitet të mprehtë që njohu edhe momente tragjike si ato të vitit 1997 kur u shembën piramidat financiare, - jo vetëm, por mund të thuhet se globalizim, nga pikëpamja ekonomike, për Shqipërinë do të thotë mbi të gjitha futje e vendit në rrjetin e krimit të organizuar. Pasojat e një ekonomie të tillë janë të paparashikueshme. Roli i shtetit në zhvillimet ekonomike është një problem tjetër që ngre debati mbi globalizimin. Veçanërisht pas prestigjit që fitoi liberalizmi në vitet '80 e më vonë, edhe më, në vitet '90, me shembjen e komunizmit, teoria politiko - ekonomike më e përhapur deri vonë theksonte se shteti duhet të ketë sa më pak rol në ekonominë dhe shoqërinë njerëzore, pasi ai priret të shtypë liritë, dhe si rezultat, të pengojë mirëqenien njerëzore. E dalë nga eksperiencia e shtetit totalitar, klasa e re politike shqiptare e përqafoi pa rezerva këtë model për shtetin dhe me ndihmën e drejtpërdrejtë të institucioneve perëndimore, filloi një proces tkurrjeje të rolit të shtetit që në shumë aspekte ishte proces i domosdoshëm. Në këtë proces, përveç vështirësive, përsa i përket konkurrueshmërisë së ekonomisë shqiptare në tregun e lirë, që çuan në emigrimin masiv dhe ekonominë e trafiqeve, duhet të kemi parasysh edhe një tipar tjetër të zhvillimeve politike dhe ekonomisë shqiptare: brenda pak vitesh Shqipëria kaloi nga kolektivizimi i shfrenuar në një ekonomi të privatizimit të egër, ku sfera e qarkullimit monetar mbizotëronte mbi ekonominë reale, ku pasuritë e mëdha krijoreshin e shembeshin nëpërmjet lojës financiare, korrupsionit politik e

paligjshmërisë. Lubonja vijon të argumentojë se ligjet e kësaj ekonomie bënë që në Shqipëri të mund të pasuroheshin lehtë kryesisht dy kategori: ata që merreshin me punët e paligjshme dhe politikanët, të cilët mund t'ua lehtësonin apo t'ua pengonin atyre këto punë. Kjo rrethanë, e kombinuar me mungesën e traditës demokratike, bëri që natyra e shtetit që u ndërtua, të ishte ajo e një shteti mafioz. Paradoksalisht, pra, modeli i një shteti liberal, që duhej të garantonte më shumë liri, dalëngadalë e çoi vendin në modelin e një shteti të ngjashëm me diktaturat amerikano-latine ku një pakicë gjithnjë e më e pasuruar kërkon të ruajë, me mjete që bëhen gjithnjë e më autoritare, privilegjet që ka fituar.

Sipas Gidens, shumë fenomene të globalizimit të sotëm si p.sh aktet terroriste të 11 shtatorit dhe luftrat e reja të SHBA-ve janë një aspekt i kësaj dinamike, ashtu sikurse janë edhe kërcënimet që i vijnë botës nga pikëpamja ekologjike e në përgjithësi nga komercializmi i shfrenuar. Sipas Gidens, ndonëse ideali Iluminist nuk është treguar i sukseshëm kjo nuk do të thotë se duhet të heqim dorë nga synimi për të vënë më tepër rregull, kontroll dhe drejtim njerëzor të ndërgjegjshëm mbi botën.

Në këtë kontekst Stiglits e krahason atë që po ndodh me globalizimin në nivel botëror me fenomenet e liberalizimit dhe nacionalizimit të vendeve evropiane në shekullin e XIX. Por, sipas tij, në këtë rast nuk kemi një qeveri botërore, e cila jep llogari para popullit të çdo vendi dhe mbikqyr procesin e globalizimit ashtu siç udhëhoqën qeveritë kombëtare procesin e nacionalizimit, por një sistem që mund

të quhet qeverisje globale pa qeveri globale, në të cilën disa institucione Banka Botërore, FMN-ja, OBT-ja dhe disa aktorë të tjerë mbizotërojnë skenën, por në të cilën shumë prej atyre që preken prej vendimeve që marrin këta aktorë janë lënë gati pa zë. Kuptohet se sa e rëndësishme është, pra, të kesh një zë për të përfaqësuar vendin tënd në këto procese. Shqipëria në këtë aspekt është shembulli më i mirëfilltë i pazëshmërisë.

#### **4.5 Dimensioni i shoqërisë civile**

Shoqëria civile funksionon në arenën e veprimit kolektiv duke u organizuar përreth interesave, qëllimeve dhe vlerave të përbashkëta. Në teori, format e organizuara të shoqërisë civile janë të dallueshme nga shteti, familja, tregu, kurse në praktikë kufijtë midis shtetit dhe shoqërisë civile janë komplekse, të mjegullta dhe të negociueshme. Shoqëritë civile shpesh përbëhen nga organizata të tilla si organizata bamirësie të institucionalizuara, organizata jo-qeveritare me funksione të ndryshme, grupe të komuniteteve të ndryshme, organizata të grave me fokus të drejtat dhe promovimin e tyre, organizata fetare, shoqata profesionale, sindikatat, lëvizje shoqërore dhe bashkime jo politike si dhe grupe të mbrojtjes apo të përkrahjes sociale. Sipas shumë autorëve, debati publik duke përdorur dialektikën është i domosdoshëm për të siguruar ‘qytetarinë’ apo civilizimin në qytet dhe ‘jetën e mirë’ të njerëzve të tij. Aristoteli mendonte se ‘polis’ (qyteti) është një organizim shoqëror që u jep mundësi qytetarëve të tij të ndajnë së bashku detyrat e drejta e të moralshme ndërmjet të qeverisurit dhe qeverisjes. Kurse Hegel e

ndryshoi kuptimin e shoqërisë civile duke i dhënë një kuptim modern liberal të saj si një formë e shoqërisë së tregut e cila u bën oponentë institucioneve të shtetit kombëtar/modern në kapitalizëm; pikërisht sepse kjo shoqëri civile u shërben të drejtave të individit dhe pronës private. Marksi pohonte se shoqëria civile përbën bazën ku ndërthuren forcat prodhuese dhe lidhjet sociale, ndërsa shoqëria politike është superstruktura. Gramshi ishte oponent ndaj këtij konceptimi të Marksit duke thënë se shoqëria civile është brenda superstrukturës politike. Sot ky term përdoret shpesh nga kritikët dhe aktivistët për t'ju referuar burimeve të kufizuara të sferës së jetës sociale e cila ka nevojë të mbrohet kundër pushtetit të përqëndruar në majë.

Sipas Young (2000), në parim grupet dhe lëvizjet shoqërore, duke u mobilizuar përreth diferencimeve të ndryshme si raca, gjinia, feja, kombësia, etj, bashkë me atë që mund të quhet 'klasë' (term mjaft i kontestuar ky) e komplikojnë gjetjen e një të mire të përbashkët. Përfshirja eksplicite e grupeve shoqërore në procese demokratike deliberimi e vendimmarrjeje, e rrit probabilitetin e përmirësimit të parametrave të demokracisë. Grupet, identitetet e tyre dhe interesat përkatëse nuk formojnë bazën për pozicionime ideologjike, ato janë thjesht konsumatore të politikës. Synimi i politikës për të ndikuar grupet shoqërore është aq i fortë sa e arrin këtë edhe në mungesë përputhshmërie me parimet ideologjike apo koherencën e ndonjë doktrinë që duhet të udhëheqë forcat politike. Diferencat sociale në Shqipëri nuk përdoren në mënyrën e duhur, dmth si resurse politike.

Fakti që ideologjia bazohet te identiteti i grupimeve të caktuara shoqërore dhe mbartet prej tyre është mjaft domethënës, por në Shqipëri ka një kontroversialitet apo mospërputhje midis grupeve që zakonisht në parim do të duhej të ishin mbështetëse të së majtës në krahasim me ato që do të duhej të mbështesnin të djathtën. Kështu Partia Socialiste në shumicën e zgjedhjeve të mbajtura është mbështetur kryesisht nga elektorati i zonës jugore të Shqipërisë me mirëqenie relativisht të lartë në raport me mbështetësit e Partisë Demokratike që janë kryesisht elektorat i zonave veriore e të varfra të vendit. Në fakt në teori do të duhej të ishte e anasjellta. Kështu PS ka një sfumim të identitetit të saj të majtë dhe e njëjta gjë ka ndodhur me identitetin e djathtë të Partisë Demokratike. Për të kuptuar këtë fenomen duhen marrë parasysh një sërë faktorësh të tillë si dinamika e grupeve të ndryshme shoqërore në Shqipëri, migracioni dhe emigracioni dhe dinamika e shoqërisë civile si paaftësi e grupeve të interesit apo komponentëve të tjerë për të ndikuar drejtpërdrejt politikat publike, ndikim ky që do të duhej të kishte buruar nga identiteti i tyre dhe nga artikulimi i interesave në bazë të këtyre identiteteve. Pra një sërë faktorësh socialë kanë ndikuar në deideologjizimin e politikave në vendin tonë.

Në periudhën paskomuniste janë krijuar grupe të ndryshme shoqërore duke dalë kështu nga masa homogjene dhe pa formë e shoqërisë, karakteristikë e periudhës së kaluar komuniste. Kështu ky riformësim ka ndodhur si rrjedhojë e disa proceseve të ndryshme. Ndër këto procese mund të përmendim lëvizjen e popullsisë nga zonat rurale drejt atyre urbane, pasurimin e ndryshëm të disa



shtresave shoqërore etj. Pra kemi daljen në pah e diferencim më të theksuar midis grupeve. Gjithsesi shumica e grupeve shoqërore janë të pastabilizuara dhe jo shumë të qëndrueshme duke qenë të hapura ndaj lëvizshmërisë. Anëtarët e këtyre grupeve mund të lëvizin lehtë drejt grupeve të tjera shoqërore duke mospatur një identitet të qëndrueshëm. Studimi i sjelljes së këtyre grupeve është mjaft i rëndësishëm për të kuptuar sjelljen votuese të tyre që është mjaft fluide në përgjithësi sepse është pikërisht kjo sjellje fluide që ndikon edhe fluiditetin e parimeve të partive kryesore. Pra për të kuptuar fenomenet politike duhen kuptuar edhe dinamika apo proceset e grupeve shoqërore në Shqipëri të cilët nuk kanë kufij të përcaktuar qartë.

Procese me rëndësi e me shumë ndikim të shoqërisë shqipëtare janë lëvizja e popullsisë nga zonat rurale drejt atyre urbane dhe njëkohësisht edhe emigrimi jashtë Shqipërisë. Këto fenomene kanë një ndikim të shumëfishtë si në aspektin social ekonomik ashtu edhe në atë politik. Kështu lëvizja e popullsisë nga zonat rurale drejt atyre urbane ka ndikuar në ridimensionimin e marrëdhënieve shoqërore duke na dhënë pamje kaotike. Shoqëria shqiptare është në kërkim të asaj çka në gjuhën ‘Durkheimiane’ do të përkufizohet si solidaritet organik. Si rrjedhojë e migrimit të brendshëm është bërë një shkëputje e një pjese të madhe të popullsisë nga mënyra e mëparshme e jetesës dhe këto grupe nuk arrijnë t’i japin vetes një identitet të qartë në “botën e re” ku po jetojnë. Kështu ato janë të pa fokusuar duke e patur të vështirë të integrohen. Megjithatë pjesa më e madhe e popullsisë në Shqipëri jeton në zonat rurale. Ndërkohë një pjesë shumë e vogël e

atyre që banojnë në zonat rurale janë fermerë të lidhur me mënyrën tradicionale të jetës dhe prodhimit në fshat. Shumica jetojnë me të ardhurat që vijnë nga të afërmit e tyre në emigracion jashtë Shqipërisë. Kështu, megjithëse ende pjesa më e madhe e popullsisë jeton në fshat, organizimi i tyre në bazë të interesave të mirëpërcaktuara e të dallueshme nuk është i dukshëm sepse në fakt në Shqipëri zhvillimi bujqësor nuk është në nivelet e duhura, gjendje e cila po të ishte ndryshe do të krijonte mundësinë për një solidaritetet përmes identitetit të lidhur me këtë funksion në shoqëri. Në rang kombëtar nuk kemi ndonjë komunitet fermerësh të aftë të artikulojë në mënyrë koherente interesat e vetë komunitetit dhe të shërbejë si grup interesi për ndikimin e politikës në përgjithësi apo politikave të veçanta në interesin e tyre. Nga ana tjetër gjendja e atyre që migrojnë nga zonat rurale në ato urbane është më e disintegruar nga pikëpamja e agregimit në bazë të interesave të përbashkëta. Organizimi i tyre shoqëror është në një profil mjaft të ulët.

Një rol të rëndësishëm në formësimin e politikave të ndryshme dhe në ruajtjen e një koherence ideologjike do të luante një shoqëri civile e mirëorganizuar dhe vepruese. Shoqëria civile i referohet shumës totale të atyre organizatave dhe rrjeteve të cilat gjenden jashtë aparatit ligjor të shtetit. Ajo përfshin gjithë gamën e organizatave që janë quajtur tradicionalisht “grupe interesash” dhe jo vetëm OJQ-të, por edhe bashkimet profesionale, shoqatat profesionale, dhomat e tregtisë, fesë, grupet studentore, shoqëritë kulturore, klubet sportive dhe grupe joformale komuniteti.

Shumë grupe të shoqërisë civile janë të dhëna pas kauzës së tyre të veçantë dhe nuk janë të interesuar në balancimin e aspiratave të tyre brenda të mirës më të gjerë publike por do të ishte e udhës që forcat politike që alternohen në qeverisje t'i përfaqësonin këto alternativa në përputhje me programet përkatëse të cilat në fakt duhet të hartohen nën ndikimin e këtyre kërkesave.

Është diskutuar shumë mbi ndikimin e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në cilësinë e qeverisjes. Kështu De Toqueville e lidh forcën e demokracisë në SHBA me përhapjen dhe fuqinë e 'tipeve të ndryshme shoqatash qytetare'.

Në lidhje me marrëdhënien midis pjesëmarrjes civile dhe qeverisjes, në ato komunitete civile që dallohen për pjesëmarrje aktive në çështjet publike, qytetarët presin nga qeveria e tyre që të ndjekë standarte të larta. Zbatimi i parimeve bazë të demokracisë do të kërkonte një debat të fortë të politikës publike, gatishmëri ndaj kërkesave të qytetarëve, dhe pranimit të inputeve të shoqërisë civile. Në vend të kësaj, shteti ka nguruar ta përfshijë shoqërinë civile si një partner. Herë pas here shoqëria civile është parë si rival, si në kuptimin e pushtetit dhe influencës, ashtu edhe në atë të ndihmës së jashtme të marrë nga kanalet që tradicionalisht kanë qenë fushë ekskluzive e qeverisë. Kështu duke mos pranuar shoqërinë civile, kanë dështuar në zbatimin e mekanizmave që do të institucionalizojnë llogaridhënie, dhe krijojnë besimin e publikut dhe besnikëri ndaj grupeve të ndryshme. Megjithatë roli i shoqërisë civile në zhvillimin ekonomik e social të Shqipërisë ka shënuar rritje, por ende ka shumë pengesa për një pjesëmarrje të

plotë të saj në zhvillimin e vendit. Shumë institucione qeveritare kanë mangësi kapacitetesh për zbatimin e ligjeve që kanë të bëjnë me shoqërinë civile. Zbatimi i kuadrit ligjor që lë për të dëshiruar dhe vështirësitë në procedurat e regjistrimit dhe liçensimit cilësohen si dy nga pengesat kryesore të angazhimit të shoqërisë civile në ecurinë ekonomike e sociale. Në këtë përfundim ka arritur Banka Botërore, përmes raportit të publikuar prej saj, “Mjedisi ligjor dhe rregullator për shoqërinë civile dhe angazhimin qytetar në Shqipëri”. Duke u nisur që nga zbatimi i ligjeve, regjistrimi e liçensimi, gjetja e burimeve financiare, shprehja e lirë e mendimit e deri në negociim ka ende shumë punë për të bërë.

Faktorët që ndikojnë në përcaktimin e angazhimit qytetar janë kryesisht: Faktorët politikë dhe qeverisës; Kuadri ligjor dhe rregullator; Karakteristikat social-kulturore dhe; Faktorët ekonomikë. Të gjitha këto ndikojnë në: lirinë e asociimit, mobilizimin e burimeve, lirinë e shprehjes, funksionimin e medias, aksesin në informacion dhe ekzistencën e mundësive dhe rregullave të angazhimit për negociim me shtetin. Dy faktorët e parë kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë me ndikim mjaft të fortë duke i përcaktuar edhe ritmet e angazhimit qytetar dhe duke e bërë këtë angazhim të varur nga politika.

Një gjendje e tillë dhe faktorë të tillë si mungesa e shtresave dhe grupimeve shoqërore me identitet të qartë, mosorganizimi dhe mosartikulimi i grupeve të interesit dhe roli i ngushtë i OJF-ve në formësimin e politikave apo programeve ka sjellë deideologjizim. Kjo sepse nuk janë grupet, identitetet dhe apo interesat e

tyre që janë bazë për pozicionimin parimor të politikës por janë thjesht ‘konsumatore’ të politikës. Në fakt, prirja e politikës për t’i ndikuar ajo më tepër grupet dhe forcat e caktuara sociale nga lart-poshtë, është e fortë në një masë të tillë sa që e bën këtë edhe në mosprurje me parimet apo ndonjë koherencë ideologjike që duhet të udheheqë forcën politike.

Nga ana tjetër, në përgjithësi, grupe të biznesit në Shqipëri janë mbështetëse të së majtës pra pjesa e pasur kryesisht biznesmenë, pronarë të rinj dhe zyrtarë të pasuruar përmes pushtetit janë pjesë e grupimeve të majta. Grupe të varfra të përbërë nga të papunët, ish të përndjekurit politikë etj, identifikohen me të djathtën. Në zgjedhjet vendore të vitit 2000 Partia Socialiste kandidoi një numër të madh biznesmenësh për pushtetin vendor, një traditë kjo e së djathtës, ndërkohë që Partia Demokratike iu përgjigj me kandidatë të marrë rishtas nga shoqëria civile, një traditë kjo e së majtës. Gjithashtu në zgjedhje u vunë re prirje të PD-së për të bashkëpunuar me kandidatët dhe partitë e minoritetit, tipar i së majtës dhe prirja e PS-së për të zhvilluar një fushatë nacionaliste në zonat e minoritetit, tipar ky i së djathtës (Krasniqi, 2006). Ky është një relacion i dyfishtë i paqartësisë së artikulimit të grupeve në bazë të identiteteve dhe krizës së identitetit ideologjik të forcave politike.

Drejtuues të Fondacionit “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë-Soros” në takime të organizuara bashkarisht nga prezenca e OSBE dhe Delegacioni i Komisionit European në Shqipëri në Tiranë gjatë vitit 2010 por gjithashtu sipas raporteve të

GTZ dhe sipas studimeve te UNDP mbi Shoqërinë Civile dhe Zhvillimin kanë theksuar disa karakteristika të veçanta në mjedisin e shoqërisë civile në Shqipëri.

Sipas këtyre raporteve që përbëjnë një zë të rëndësishëm analitik, karakteristikë për Shqipërinë është numri i jashtëzakonshëm dhe impresionues i OJF-ve të regjistruara por gjithsesi kjo nuk tregon gjendjen e vërtetë të shoqërisë civile. Shumica e këtyre organizatave funksionojnë si ‘të fjetura’ sepse janë formale ose nuk kanë kontakte apo lidhje me njerëzit dhe shpesh iu mungon aktivizmi *grass root*. Pjesëmarrja masive në shoqata është shumë e ulët. Shkalla e aktivitetit dhe antarësisë në organizatat e shoqërisë civile është minimale dhe kjo pa dyshim kontribuon në imazhin e një “shoqërie civile” të dobët. Struktura e shoqërisë civile është e pabalancuar – ekzistojnë sektorë të ndryshëm që janë të izoluar dhe nuk bashkëpunojnë në përpjekje të koordinuara për çështje me interes të përbashkët. Ka një pabarazi rajonale, që lidhet kryesisht me OJF-të dhe institutet/think tanket që gjenden kryesisht në kryeqytet dhe mungojnë plotësisht në rrethe të tjera të vendit. Promovimi i rrjeteve kombëtare dhe ndërkombëtare ndërmjet OJF-ve është gjithashtu shumë i rëndësishëm. Një faktor tjetër është dhe fakti që organizatat e shoqërisë civile përballen dhe me një sfidë tjetër si “lodhja me elitat” (*elite fatigue*). Në një farë mënyre, në këtë pjesë shoqëria civile pasqyron më së miri politikën në vend. Lidershipi i OJF-ve kryesore nuk ka ndryshuar shumë në këto vitet e fundit. Për sa kohë që lidershipi nuk ndryshon, idetë dhe objektivat nuk kanë gjasë të ndryshojnë. Në mungesë të rotacionit të elitave, OJF-të humbin kredibilitetin. Pa dyshim, aty ku ka pak ndryshim dhe

përfshirje minimale, nuk ka vend për rritjen dhe zhvillimin e lidërshipt të ri. Pa një bazë zgjedhjeje, drejtuesit aktualë nuk mund të zëvendësohen nga sfidantë të aftë dhe të artikuluar. Si rrjedhim, jo pak organizata kanë hasur e hasin probleme kur përpjekjet për advokim të drejtuesve të tyre asociojnë (herë më të drejtë e herë jo) imazhin publik të organizatës me një nga partitë politike. Kuadri institucional për një shoqëri civile të pavarur ka nevojë për përmirësime, duke filluar nga ligji për të drejtën e informimit, sistemimi dhe rregullimi përfundimtar i trajtimit fiskal të OJF-ve dhe unifikimit të të gjithë amendimeve që kanë të bëjnë me këto organizata në një ligj unik. Sfidë përbën edhe rregullimi dhe përmirësimi në ligj i një sërë problematikash të tjera që lidhen me shoqërinë civile si: ligji i sponsorizimeve, kuadri ligjor për nxitjen e filantropisë, rregullimi i punës vullnetare.

Shoqëria civile në Shqipëri vazhdon të jetë e dobët, e paorganizuar dhe pa një strategji të veten. Si një element thelbësor për një demokraci të konsoliduar dhe funksionale, dobësia e saj paraqet edhe një pjesë të problematikës së tranzicionit. Një shoqëri civile e organizuar dhe e shëndetshme duhet të shtrihet e të jetë funksionale në të gjitha aspektet e jetës sociale dhe politike: Ekonomi, politikë, arsim, fe, art dhe mjedis. Të gjithë këto sektorë përfshihen në axhendën e OJQ-ve specifike e jetëshkurtra që pak a shumë, përmbledhin gjithë konceptimin për shoqërinë civile në Shqipëri. Shoqëria civile në Shqipëri karakterizohet nga shumë probleme të jashtme e të brendshme. Pjesëmarrja publike është e ulët. Angazhimi civil, vullnetarizmi dhe anëtarësia sociale, njësoj si edhe angazhimi në

komunitet, janë të ulët. Besimi publik në organizatat civile është gjithashtu i ulët ndërkohë që apatia dhe indiferenca e qytetarëve për të marrë pjesë në aksione civile është shumë e lartë. Ata janë skeptikë për lëvizjet shoqërore dhe i perceptojnë ato si të korruptuara, klienteliste dhe të fokusuara vetëm në përfitimin personal. Përveç kësaj, OJQ-ve u mungojnë vlerat demokratike. Ato perceptohen shpesh si “one man show” (shfaqje me një person) për shkak të shfaqjeve publike të të njëjtit kryetar. Organizatat civile janë krejtësisht të varura nga donatorët dhe nuk kanë platforma të qarta e afatgjata. Ato nuk arrijnë të adresojnë shqetësimet urgjente të komuniteteve në nevojë e grupeve të interesit, dhe u japin prioritet çështjeve që përfshihen në axhendat e donatorëve. Duke pasur si objektiv primar mbijetesën financiare, ato shpesh janë të njëanshme politikisht. Përveç kësaj, sektori civil ka vuajtur gjithashtu një eksod në rritje të anëtarësisë organizative drejt posteve politike. Sipas ekspertëve të ndryshëm, elementët që ndikojnë negativisht zhvillimin e shoqërisë civile janë: 1) Indiferenca qytetare për vullnetarizëm; 2) Niveli ulët i angazhimit civil; 3) Kapitali i dobët social dhe mungesa e besimit social e ndërpersonal; 4) Mungesa e transparencës nga OJQ-të; 5) Varësia e tyre nga donatorët; 6) Njëanshmëria e tyre politike. Ndërkohë që tre elementët e fundit janë aktualë dhe të njohur për publikun shqiptar, tre elementet e parë duhen konsideruar si mbetje nga regjimi i kaluar komunist. Puna vullnetare dhe e papaguar shihet si një mbetje e periudhës komuniste. Si pasojë, angazhimi civil në çështje që shkojnë në të mirë të të gjithë komunitetit, konsiderohet humbje kohe.



Sidoqoftë, hapa përmirësues duhen ndërmarrë si nga sektori civil ashtu edhe nga shteti. Kuadri ligjor fiskal dhe financiar duhet të përmirësohen dhe të përfshijnë politika të cilat garantojnë fonde për OJQ-të dhe gjithashtu tërheqin sektorin privat në aktivitete filantropike. OJQ-të nga ana tjetër duhet të zhvillojnë struktura të brendshme demokratike për të tërhequr anëtarë të rinj dhe aktiviteti i tyre duhet të shtrihet gjerësisht jashtë kufijve të kryeqytetit.

Pra faktorë të tillë si mungesa e shtresave dhe grupimeve shoqërore me identitet të qartë, mosorganizimi dhe mosartikulimi i grupeve të interesit dhe roli i kufizuar i OJF-ve në formësimin e politikave apo programeve ka sjellë *de-ideologjizim*. Kjo sepse nuk janë grupet, identitetet apo interesat e tyre që janë bazë për pozicionimin parimor të politikës por janë më tepër ‘konsumatorë’ të politikës. Prirja e politikës për t’i ndikuar grupet dhe forcat e caktuara sociale nga lart-poshtë është mjaft e fortë.

#### **4.6 Personalizimi i politikës**

Në Shqipëri gjatë gjithë periudhës së tranzicionit dukuria e personalizimit të politikës është shfaqur në mënyrë mjaft të theksuar. Politika mbizotërohet nga debatet dhe akuzat reciproke mbi baza personale, më tepër se sa të jetë një përballje alternativash të mirëpërcaktuara e koherente për qeverisjen nga secili krah. Sigurisht që kjo dinamikë ka zbehur rolin e ideologjisë sepse në fakt ka zbehur vetë rolin e funksionin e programeve politike të cilat teorikisht frymëzohen nga ideologjitë përkatëse. Studiues të ndryshëm në vend mendojnë se

‘si rrjedhojë e personalizimit të politikës funksioni i liderëve është tejet i zgjeruar dhe roli i tyre në zgjedhje është shpesh vendimtar. Elektorati shndërrohet apo reduktohet në një ‘audiencë’ ndërkohë që politika “depolitizohet” duke u kthyer në një ‘luftë’ midis aktorëve në rrafsh individuale. Humbja në zgjedhje është një ‘tragjedi’ personale ndërkohë që fitorja është një triumf që u jep mundësinë liderëve të legjitimojnë veprimet politike që shpesh janë edhe inkohente’.

Procesi i personalizimit mund të identifikohet në nivele të ndryshme:

### ***Niveli institucional***

Personalizimi në nivel institucional gjen zbatim në mënyra të ndryshme në regjimet parlamentare krahasuar me ato presidenciale. Kjo vjen si rrjedhojë e kompetencave të ndryshme që ka lideri në rolin e një presidenti në republikën presidenciale dhe rolin që ka kryeministri në republikën parlamentare. Gjithsesi, në të dyja rastet lideri ka një rol mjaft të madh në mënyrën se si i jep formë qeverisjes së tij. Në lidhje me personalizimin e politikës në nivel institucional, krijimi i kultit të individit është shprehje e zgjerimit të funksioneve që i dedikohen në mënyrë zyrtare funksionarit. Kështu kulti i Berishës dhe “Berishizmi” i dedikohet pikërisht rolit që ky lider ka luajtur për një periudhë të gjatë në Shqipëri, si në postin presidencial, ashtu edhe në atë kryeministral. Gjatë periudhës që Berisha ishte president i vendit, roli i tij politik e institucional ishte mjaft i fortë duke krijuar ngjyresa të një regjimi gjysëm presidencial dhe faktikisht në rolin e kryeministrit Berisha i ka dhënë tipare të forta ekzekutivit gjë

që e rrit rolin e tij personal nëpërmjet rrugëve institucionale. Ai e ka lëvizur sistemin parlamentar drejt “presidencializimit” në kohën kur ishte president dhe e ka lëvizur atë drejt ”*kryeministrializimit*” gjatë periudhës që ka shërbyer si kryeministër. Në një farë mënyre nuk është Berisha që ka marrë formën e institucionit, por në fakt është ai vetë që i ka dhënë formë institucionit. Ngjashmërisht ka vepruar edhe Fatos Nano i cili jo rrallë ka imponuar figurën e tij ndaj institucioneve politike.

### ***Niveli i komunikimit politik***

Procesi i komunikimit politik ka qenë mjaft intensiv dhe shpesh veprimtaritë politike të paraqitura gjerësisht nga media janë etiketuar si ‘*telenovela*’ ku spikasin akuzat dhe thashethemet politike. Mbulimi i madh nga mediat e kthen imazhin e politikanëve në nivelet e superstarëve të lajmeve ku gjithnjë duhet atakuar kundërshtari. Kështu në mungesë të një oferte përmbajtësore dhe si rrjedhojë e pamundësisë për t’i paraqitur kundërshtarit politik një alternativë konkrete, nuk bëhet gjë tjetër veçse përdoren argumenta apo akuza *ad hominem*. Të përdorësh argumenta *ad hominem* është të kritikosh apo të sulmosh personalisht propozuesin e një argumenti në përpjekje për të diskredituar vetë argumentin. Këto argumenta nuk janë të vlefshme nga pikëpamja e logjikës formale, por gjithsesi kanë një ndikim mjaft të madh në mënyrën se si masa i percepton ngjarjet apo aktorët politikë. Me këtë lloj logjike ‘tjetri’ nuk është thjesht një kundërshtar politik por ai armiqëzohet duke vënë në dyshim

integritetin e tij dhe jo atë të alternativës që ai përfaqëson. Në këtë mënyrë Berisha e etiketonte në mënyrë të vazhdueshme Fatos Nanon si ‘padrino të krimit’, ndërkohë që edhe Nano nuk mbetej pas në të njëjtën logjikë duke u servirur shqiptarëve Berishën si një të keqe të madhe. Vazhdimisht shqiptarët janë gjendur nën ndikimin e antiberishizmit të Nanos apo antinanoizmit të Berishës madje edhe fushata elektorale për zgjedhjet parlamentare të vitit 2005 është konceptuar mbi këto baza. Kështu Partia Demokratike në spotet e saj elektorale u shtronte pyetjen shqiptarëve: “*A doni një kryeministër apo një krimministër?*” Një sulm i tillë ishte personalisht për Fatos Nanon. Ndërkohë nga Partia Socialiste, e keqja që u kishte ndodhur shqiptarëve në vitin 1997 personifikohej me Sali Berishën dhe si lëndë e parë përdorej anti-Berishizmi. Gjithsesi personalizimi i politikës nuk ndodh vetëm me liderët kryesorë por është një fenomen që përfshin të gjithë aktorët politikë. Politika e personalizuar në nivelin e komunikimit politik është një vorbull ku të gjithë akuzojnë të gjithë me argumenta *ad hominem*.

### ***Niveli i partive politike***

Vetë organizimi partiak i ka dhënë një rol mjaft të madh liderëve. Kështu të dyja partitë e mëdha kanë “prodhuar” liderë karizmatikë e mjaft të pushtetshëm. Partitë në Shqipëri siç është theksuar edhe më parë kanë tendenca gjithnjë e më tepër gjithëpërfshirëse. Kjo lloj tendence përveç efekteve që ka në lidhje me elektoratin dhe drejtpërdrejtë me zbehjen e rolit të ideologjisë si rrjedhojë e synimit për tërheqjen e sa më tepër votuesve, ka gjithashtu një efekt të konsiderueshëm në

çështjet e performancës dhe lidershit. Liderët gëzojnë një status të paprecedentë brenda organizatës dhe i japin jetë asaj që mund të quhet ‘*lider demokraci*’. Pra, partitë politike janë krejtësisht me qendërim tek lideri fakt ky që ushqen personalizimin e politikës. Në një farë mënyre ky është një “reaksion zinxhir” që ka si produkt përfundimtar deideologjizimin.

Si rrjedhojë e personalizimit të politikës në nivele të ndryshme kemi shmangien apo rrëshqitjen e interesit dhe vëmendjes nga programet politike dhe nga ideologjia duke u përqendruar tek individit si subjekt politik, jeta e tij private dhe elementë që në fakt nuk janë parësore për politikën. Kjo është një patologji e politikës që në fakt do të mund të evitohet nëse politikanët do të përqendroheshin tek programet përkatëse me bazë ideologjike.

Në dekadat e fundit ëshë vërejtur një ndryshim në rëndësinë e përfaqësimit nga partitë politike tek aktorët individualë politikë. Prirja drejt 'personalizimit të politikës' është identifikuar në një numër dimensionesh. Së pari, media gjithnjë e më shumë po përqendrohet tek liderët në kurriz të partive politike, së dyti, njerëzit votojnë gjithnjë e më shumë në bazë të cilësive të kandidatëve, kualifikimeve dhe sjelljes së tyre; dhe së treti, reformat institucionale kanë tendencën që ta bëjnë konkurrencën zgjedhore më të qendëruar tek liderët.

### ***Media dhe politika***

Raporti mes medias dhe politikës është një nga çështjet më të diskutuara nga publiku shqiptar pas viteve '90. Qytetarët në demokraci kanë nevojë për

informacione të përshtatshme, që të mund të marrin vendime me karakter politik, e më gjerë. Teknologjia e informacionit ka bërë të mundur që kur bëhet fjalë për vendimmarrje dhe për gjykime të sofistikuara individët më tepër të bazohen në informacione mediatike. Media audiovizuale, shtypi dhe rrjetet sociale kanë mundësuar lindjen e tipeve të rinj të sistemeve politike të bazuara në pjesëmarrjen e zgjeruar popullore. Tranzicioni nuk ishte i butë, por ata që i kuptuan shenjat që herët, përfituan nga një epërsi relative si pasojë e fillësës së komunikimit të hershëm. Ekspertë të komunikimit në vend argumentojnë se në mediat e dikurshme të ‘spektrit të ngushtë të frekuencave’, ku koha dhe hapësira ishin të kufizuara, medias i duhej të përzgjidhte lajme që ia vlenin të raportoheshin. *Mass media* mund të raportonte pak lajme të mëdha, në të cilat ishin në qendër pak protagonistë të mëdhenj. Në lajmet rreth politikës, protagonistët e mëdhenj ishin partitë politike. Sot kjo dinamikë paraqitet krejtësisht ndryshe. *Mass media* është përqendruar tek liderët e mëdhenj të cilët konturojnë rreth vetes aktivitetin politik. Në fakt mediat janë faktorë vendimtarë me një rol të fuqishëm. Madje, ato konsiderohen edhe si pushtet i katërt në aparatën shtetëror. Mediat orientojnë, si nga lart në drejtimin politik, ashtu si dhe nga poshtë në drejtimin e opinionit publik. Politika ditore ndërthuret me informatat e fabrikuara nga mediat dhe të njëjtat informata i përhap/amplifikon në opinionin publik si vendime të miratuara nga politika. Ekspertët e komunikimit argumentojnë se mediat mund të jenë njëkohësisht ‘kërcënuese’ dhe hulumtuese të axhendave politike. Nëse politikanët kanë marrë ndonjë vendim të rëndësishëm apo jo, kjo është për opinionin krejt pa

fokus derisa nuk emetohet dhe nuk bëhet çështje e njohur nëpërmjet mediave. Një vendim i tillë, sado i rëndësishëm që të jetë, mbetet praktikisht i pajetë nëse mediat nuk ia japin atij mundësinë të bëhet ‘i dukshëm’ për opinionin e gjerë. Marrëdhëniet e medias me politikën janë shumë komplekse, janë të mbushura me histori të ndërlikuara, me ngjarje e situata që konfliktohen me njëra-tjetrën. Klasa politike gjithsesi e njëh forcën ndikuese/mobilizuese të medias. Sidoqoftë marrëdhënia komplikohet më tepër kur merren parasysh lidhjet e politikanëve me punonjësit mediatikë, ushtrimi i presionit mbi mediat, presionet ekonomike, përgatitja paraprakisht e kuadrove/shablloneve të caktuara, donacionet me qëllime për blerjen e frymës kritike, etj. Indikator i rëndësishëm e mjaft i diskutuar është tipologjia e pronarëve të gazetave e të televizioneve në Shqipëri. Ka mjaft diskutime se kush janë në të vërtetë këta pronarë, si e kanë akumuluar kapitalin e tyre, çfarë lidhjesh kanë me politikanë e me njerëz me pushtet, çfarë interesash mbrojnë me mediat që zotërojnë, e në këtë kuptim është shumë e vështirë të flitet për *mass-media* të lirë në Shqipëri. Në Shqipëri, ka pronarë të fuqishëm mediash të cilët janë të lirë për të përkrahur ata që i favorizojnë qëllimet e tyre, e të lirë për të parë interesat që u sugjerojnë aleanca më të fuqishme. Në fakt, një media e tillë nuk mund të ketë në fokus shqetësimet konkrete të vendit por përkundrazi, ka në fokus lojërat/manovrat politike, ambiciet e ndryshme, anëtarësimet e lëvizjet partiake, takimet e politikanëve në kontekste të ndryshme, etj. Pranohet gjerësisht si fakt që shumë pronarë mediash i kanë konceptuar dhe vazhdojnë t’i menaxhojnë agjencitë e tyre të ‘fjalës së lirë’ si ndërmarrje familjare me gjithë

primitivitetin që i karakterizon struktura të tilla. Këto media nuk mund të shkojnë më larg se vizioni e interesi privat i pronarëve të tyre. Këtu e ka zanafillën problematika e një pjese të mirë të *medias* shqiptare, që reflektohet edhe në nivelin e performancës përkatëse.

Marrëdhënia midis medias dhe politikës në periudhën e tranzicionit post-komunist ka qenë shumë komplekse dhe është karakterizuar nga shumë kundërshti. Politika ka pasur ndikim të konsiderueshëm mbi zhvillimin e medias. Shtypi i ditëve të sotme është më shumë një zgjatim i politikës, se sa përfaqësues i opinionit publik dhe interesave të tij. Një pjesë e mirë e medias vazhdon të kontrollohet nga grupe të fuqishme politike. Në njëfarë kuptimi, ato lloje komentesh që lidhen me mungesën e pavarësisë së shtypit janë komente me vend. Zhvendosja nga ‘modeli i medias sovjetike/lindore’ të ndikuar nga partia shtet dhe makineria e propagandës shtetërore duket se ka rezultuar më i vështirë se sa mund të mendohej. Metodrat e trashëguara nga koha e komunizmit tregojnë që politikanët dhe partitë politike përpiqen vazhdimisht të ndikojnë e të kontrollojnë median, sepse qëndron e fortë bindja se kushdo që kontrollon informacionin ka edhe pushtetin në një vend. Politikanët, të cilët e kanë qëllim qëndror mbajtjen e pushtetit, e konsiderojnë median jo si instrument madhor me funksion publik, por si instrument kryesor për politikën e orientuar prej tyre/drejt tyre. Ky vizion për median është ‘një-dimensional’, i politizuar dhe i tej-thjeshtëzuar; ai beson në rolin misionar të gazetarëve në funksion të politikës dhe në shtypin e politizuar. Problemet themelore me të cilat përballet media, pa dyshim janë politizimi dhe



klientelizmi. Duke ndjekur dialektikën e marrëdhënies midis medias dhe politikës, mund të vërehet se politika ka ndikuar dhe i ka dhënë formë medias më shumë se sa media ka ndikuar dhe i ka dhënë formë politikës. Problemi në fakt qëndron tek perceptimi i politikës, e cila shihet më shumë si konflikt se sa si mundësi për dialog.

Remzi Lani (2011) thekson se ‘format më të zakonshme të klientelizmit politik gjenden tek transmetuesit publikë, të cilët në Shqipëri, IRJ të Maqedonisë, Kosovë dhe Malin e Zi vazhdojnë të jenë nën kontrollin e qeverive qendrore, të cilat i përdorin e keqpërdorin ato gjatë dhe përtej fushatave politike. Megjithëse do ishte e pamundur të krahasoheshin transmetuesit e sotëm publikë me bastionet e propagandës së periudhës së autoritarizmit të ri, prapëseprapë, në shumicën e rasteve, kanalet televizive të ashtuquajtura publike mbeten televizione të tapetit të kuq: pra, janë të mbushura me protokoll dhe informacion të qeverisë. Këto kanale publike më shumë i ngjajnë një Ministrie Propagande se sa medias normale.’ Kështu, politika në Ballkan është shndërruar në tele-politikë. Në përgjithësi, debati politik dhe publik është zhvendosur nga sheshet e tubimeve në ekranet e debateve televizive. Ndërkohë që dikur politika zhvillohej në rrugë, tani ka kaluar në debatet e studiove televizive. Megjithatë, duket se medias i është dashur të paguajë një çmim për këtë ndryshim. Për ta përshkruar këtë situatë, analisti shqiptar Fatos Lubonja përdor termin “regjim mediatik”. Sipas Lubonjës, “ndërsa në regjimet e ashtuquajtura policore apo ushtarake, përdoren policia, ushtria, apo shërbimet sekrete që regjimi të qëndrojë në pushtet, në rastin tonë përdoret

media.” Ndoshta termi më i saktë për t’u përdorur në këtë rast është media-kracia. Megjithëse në teori, çështjet që kanë të bëjnë me median paraqiten si çështje të demokracisë, në realitet, ato shndërrohen në çështje pushteti.

Sipas Belina Budinit (2011), mjedisi mediatik shqiptar ka njohur së fundi një zhvillim të ri, shfaqjen e politikanit-media. Budini e sheh këtë zhvillim si të lidhur me emrin e Edi Ramës, ‘që ka mishëruar në Shqipëri edhe prototipin invers, atë të politikanit produkt të mediave, i cili nuk doli në politikë nga mjedisi partiak, por nga “oxhaku” i mediave’. Në këtë konceptim, Rama është i pari politikan-media i këtij formati në qarkullim në Shqipëri dhe nuk ka se si të mos dallohet për atë që po bën aktualisht me lidhjen e medias me politikën. Rama është bërë politikani i parë shqiptar që e integron median “Twitter” e “Facebook” për mesazhet e tij në faqet pritëse në internet. Budini thekson se Rama është ‘një politikan-media i mirëfilltë, që rifreskon rregullisht informacionet që nxjerr, që publikon vijimisht pjesë ekskluzive nga libri i tij ende pa dalë në treg, që u përgjigjet herë pas here qytetarëve që i shkruajnë, që replikon aty për aty me cicërima në “Twitter” Berishën e shumicën, etj. Gjithsesi riformatimi mediatik nuk i takon vetëm Ramës. Edhe pse disi më me vonese, riformatimi i takon gjithashtu edhe Berishës duke i dhuruar shkëlqimin prej ylli mediatik në hapësirën publike. Megjithë vlerën e shtuar në procesin e komunikimit, mund të argumentohet gjithashtu se format e reja të komunikimit janë një ushtrim personalizimi i skajshëm, që përbën një sfidë të hapur ndaj partisë politike si forum dhe kolektivitet. Është tamam në stilin e yjeve të Hollivudit dhe nuk është çudi që edhe politikanët botërorë që e

përdorin më me ngulm kanë statusin e yjeve kombëtarë, por në këtë rast yje në politikë. Personalizimi i leadershipit mbi partitë në fakt, sjell dinamikën sipas së cilës njerëzit poshtë strukturave partiake të mos konceptojnë programet dhe partitë por vetëm liderët politikë siç ndodh me Sali Berishën dhe Edi Ramën. Kjo sjell devjacion të madh gjatë fushatave dhe perceptimit negativ të politikës në një sens të përgjithshëm. Gjatë fushatës nuk shqyrtohen programet apo ekipi në tërësi por ka përqendrim të vështrimit vetëm te lideri kryesor.

### ***Personalizimi bazuar në cilësitë e kandidatëve, kualifikimi dhe sjellja e tyre***

Çdo institucion përfaqëson një strukturë të ngritur për një qëllim specifik dhe në kuptimin e një shoqërie institucionale, si institucione duhet të pranojmë tërësinë e normave dhe rregullave ku bazohet organizimi dhe funksionimi i një shteti. Përkufizimi na lejon të kuptojmë se në ç'marrëdhënie është individi, me institucionin ku ai shërben. Në Shqipëri raportet e individit dhe subjektiviteti i tij me institucionet dhe detyrimet ligjore kanë krijuar një shoqëri që vijon të mbetet peng i institucioneve të personalizuara dhe të keqpërdorura nga autoritarizmi subjektiv individual. Në këto kushte, njeriu i zakonshëm dhe masa jo fort e specializuar kthehet tek instiktet e lidhura me gjykimet kategorike e dialektike. Kjo shfaqet përmes lavdërimit masiv dhe kultit të shpëtimtarit të 'Mesisë Politik' dhe 'krijimin e lidhjeve e marrëdhënieve klienteliste për qëllime të fitimit e të abuzimeve-favorizuese, drejtpërsëdrejti nën ndikimin e individit në krye të institucionit shtetëror.

Shoqëria shqiptare si një shoqëri në tranzicion është e ngarkuar me politikanë si individë megalomanë, populistë, dhe që përshkohen nga sensi i hakmarrjes politike. Karizma e shumë prej tyre, përdoret për të forcuar kultin e individit dhe është një shprehje e një populizmi tejet të theksuar, mbushur me përçmim ndaj shtresave që ende ruajnë si kult ndershmërinë e individit. Qëndrime të vazhdueshme tejet subjektive janë shfaqje flagrante të përdorimit të institucioneve, jashtë politikave dhe interesave publike gjithëpërfshirëse. Institucionet në Shqipëri, në këtë periudhë të tranzicionit, vuajnë nga shumë mangësi. Duhet të vihet në dukje qartazi fakti se raportet e ndryshme të materializuara midis komponentëve; rregull, ligj, ndërgjegjje institucionale, autoritet dhe traditë institucionale, shpesh janë në kaos. Individët që vihen në krye të institucioneve ose në përbërje të ekipeve të tyre, zgjidhen, por jo gjithnjë përzgjidhen në bazë konkurseshe e procesesh seleksionimi, emërohen por nuk konkurojnë ose e bëjnë këtë formalisht, caktohen nga eprorët por nuk maten nga atributet e përgjithshme intelektuale shkencore, qytetare, akademike apo më gjerë.

Individë të ndryshëm e njësojnë veten me vetë institucionet, jo në sensin e përkushtimit profesional, por në atë të zotërimit gati pronësor të tyre. Ka raste kur bëhen marrëveshje të ndryshme edhe në dimensione të tjera si për shembull marrëveshje me sferën e biznesit privat dhe në këtë mënyrë, krijohen grupime që sfidojnë institucionet shtetërore duke formësuar mundësi për t'i përdorur ato në favor të interesave specifike private. Ky proces i 'zotërimit' të institucioneve ruhet dhe mbrohet me propagandë nga kritikët, sulmet apo insinuatat duke

pretenduar se shkëmbehet sulmi ndaj individit që rezulton abuzues, me sulmin kundër strukturës së institucionit.

Një tjetër çështje e rëndësishme në atmosferën e përgjithshme të institucionalizmit dhe rolit të individit shqiptar, është autoritarizmi personal. Ai shfaqet në formën e injorimit hapur të attributeve ligjore të jetës dhe rregullave institucionale, në imponimin me autoritetin individual, në depersonalizimin e bashkëpunëtorëve dhe nënshtrimin e tyre. Mungesa e përgjegjësisë që kryesisht rrjedh prej mungesës së frikës nga ndëshkimi juridik për shkak të abuzimit me postin apo institucionin është një dukuri e cila haset gjerësisht përgjatë tranzicionit shqiptar. Autoritarizmi i theksuar individual lind gjithashtu në kushtet e mungesës së kompetenave profesionale, kur nuk pranohen sfidat e zhvillimit dhe në kushtet e një etjeje të lartë për karrierë dhe pushtet të pajustificuar.

### ***Personalizimi i bazuar tek reformat institucionale***

Përgjatë këtyre viteve demokraci në Shqipëri, vërehet që nga të gjitha anët është krijuar një lidhje e pazgjidhshme midis ‘fatit’ të liderit dhe ‘fatit’ të partisë. Në të njëjtën kohë është krijuar përshtypja se me humbjen e liderit që drejton partinë, do të thërrmohet edhe organizimi i partisë. Së pari kjo vjen si rrjedhojë e karizmës shumë të madhe që ka karakterizuar të liderët kryesorë të partisë Socialiste dhe asaj Demokratike. Megjithëse ka dallime midis liderit aktual të PS-së dhe ish liderit të PD-së edhe pse të dy kryetarët e partive të mëdha, përafrohen në aftësinë për të elektrizuar/mobilizuar masat dhe për t’i ‘manipuluar’ ato sipas

vullnetit të tyre. Përveç të tjerash, kjo vjen si rrjedhojë e fushatave marketuese shumë të forta, duke i dhënë politikës një pamje spektakli televiziv shumëdimensional. Elementi tjetër që rrit akoma më shumë varësinë e partisë nga lideri është vendosja e sistemit zgjedhor në fuqi. Me sistemin aktual, nuk ka më ballafaqime njerëzish në bazë të sistemit mazhoritar dhe mungon diskutimi i afërt midis kandidatëve dhe zonës prej së cilës ato zgjidhen. I gjithë ky dialog kanalizohet nga rrugët që të çojnë domosdoshmërisht te kryetari i partisë. Tani lideri pothuajse 'imponon' një listë që u serviret zgjedhësve dhe votimi i partisë në mënyrë të pazgjidhshme lidhet me vullnetin e liderit të saj. Megjithatë, mund të presupozojmë dhe është e dëshirueshme që -nga çasti që parlamentarët do të hyjnë në parlament do të fitojnë pavarësi ndaj liderit ose kryetarit të qeverisë. Përndryshe do të krijohet një tkurrje e veprimtarisë parlamentare të deputetëve që në këtë rast do të kthehen në zbatues të politikave të liderit/Kryeministrit. Kështu, bazuar në këtë sistem, përtej personalizimit të fushatave mund të shfaqen mundësi reale personalizimi të pushtetit në tërësi.

Reformat institucionale që kanë ndodhur në vend e kryesisht reformat zgjedhore kanë tendencën që ta bëjnë konkurrencën zgjedhore më të qendëruar tek liderët. Fushatat janë të dominuara nga figurat e dy liderëve kryesorë dhe pak u lihet vend kryetarëve të partive lokale. Procesi është i personalizuar dhe është mbështjellë rreth dy liderëve të partive kryesore politike. Për këtë arsye edhe tonet në distancë ndaj këtyre dy liderëve janë tejet të ashpërsuara. Fushatat drejtohen shpesh në sulme personale dhe jo në atë se çfarë kanë ndërmend të bëjnë për qytetarin.

Sistemi zgjedhor i përcaktuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në vitin 1998 si dhe ndryshimet në Kushtetutë dhe në Kodin Zgjedhor në vitin 2008 e 2012 për sistemin e zgjedhjeve dhe formulën zgjedhore janë çështje mjaft të rëndësishme që i kanë dhënë trajtë sistemit politik në vend. Në vitin 1998, Kushtetuta përcaktoi një sistem zgjedhor të përzier, mazhoritar të korigjuar. Me këtë sistem 100 deputetë zgjidheshin drejtpërdrejt në zonat njëemërore, ndërsa 40 deputetë zgjidheshin nga listat shumëemërore. Formula zgjedhore e ndarjes së mandateve shtesë duhet të siguronte një ndarje të mandateve në proporcion me numrin e votave. Megjithë procesin intensiv të komunikimit midis kandidatëve dhe elektoratit që mund të konsiderohet si një aspekt pozitiv i sistemit, ajo që ishte tejte e dëmshme, ishte fakti se pas zgjedhjeve të vitit 2001, sistemi zgjedhor dhe formula e ndarjes së mandateve të zgjedhjeve lejonin hapësira ligjore të cilat u shfrytëzuan nga parti politike për të deformuar rezultatin e zgjedhjeve dhe për të fituar *bonuse* zgjedhore në sigurimin e një numri më të madh të mandateve në parlament në raport me numrin e votave të fituara në shkallë vendi. Për të korigjuar fenomenin e ‘Megadushkut’, në vitin 2008 Kuvendi i Shqipërisë bëri ndryshime në Kushtetutë për sistemin e zgjedhjeve dhe formulën zgjedhore. U ndryshua neni 64 i Kushtetutës dhe sistemi zgjedhor i kombinuar u zëvendësua me një sistem proporcional të rajonizuar. Sistemi aktual proporcional bazohet në ndarjen e vendit në zona shumëemërore. Kushtetuta ka përcaktuar se zona shumëemërore përputhet me ndarjen administrative të një prej niveleve të organizimit administrativo–territorial. Kodi Zgjedhor përcakton se “zona

zgjedhore përputhet me territorin e qarkut. Duke vështruar sa përcaktohet në Kushtetutë për sistemin e zgjedhjeve, mund të nënvizohet se sistemi proporcional i zgjedhjeve synon që rezultati i zgjedhjeve për partitë politike apo subjektet zgjedhore të jetë në proporcion me numrin e përgjithshëm të votave të fituara në zgjedhje, në çdo zonë zgjedhore. Sistemi zgjedhor proporcional i lejon votuesit të drejtën e vetëm një vote, për subjektin politik që ai preferon dhe nuk lejon akses për të ‘trafikuar/shtrembëruar’ votën e zgjedhësit. Siç u theksua më parë, me këtë sistem nuk ka më ballafaqime njerëzish në bazë të sistemit mazhoritar dhe mungon diskutimi i afërt midis kandidatëve dhe zonës prej së cilës ato zgjidhen. Duke qenë se lista e kandidatëve është e lidhur me kryetarin e partisë, i gjithë ky dialog kanalizohet nga rrugët që të çojnë domosdoshmërisht te varësia nga kryetari. Aktualisht lideri pothuajse ‘imponon’ një listë që u ‘serviret’ zgjedhësve dhe votimi i partisë në mënyrë të pazgjydhshme lidhet me vullnetin e liderit të saj. Kështu, bazuar në këtë sistem, përtej personalizimit të fushatave mund të shfaqen mundësi reale personalizimi sistemik të pushtetit në tërësi.

Përzgjedhja e hapur dhe e drejtë e kandidatëve është mjaft e rëndësishme për një sistem demokratik të konsoliduar. Në mënyrë që të arrihet marrja e pushtetit, një nga synimet kryesore të partive politike është zgjedhja e kandidatëve me potencial dhe suportimi ndaj tyre në mënyrë që të fitojnë zgjedhjet. Me qëllim që të ruhet integriteti zgjedhor, kandidati i përzgjedhur duhet të jetë kandidati me cilësi e mbështetje të gjerë popullore. Në disa sisteme si në sistemin aktual shqiptar, udhëheqësit e partive politike në mënyrë të veçantë ose mbështetur në një grup të



kufizuar brenda partisë bëjnë përzgjedhjen dhe emërimin e kandidatëve. Në këtë lloj sistemi nxitet klientelizmi dhe i përzgjedhuri si kandidat që përfshihet në listën e partisë, është në një farë mënyre në 'borxh' ndaj liderit, i cili më pas mund të presë favore dhe trajtime të tjera preferenciale nga ana e kandidatëve. Mbledhja e partisë është një mekanizëm për të diskutuar kandidatët dhe për të bërë përzgjedhjen e tyre por ajo mund të bëhet vetëm me praninë e udhëheqësve të strukturave partiake duke mos përfshirë anëtarët e thjeshtë të partisë. Të tilla mbledhje/organizime kanë natyrë të parashikueshme, kanë mungesën e një ndarjeje/balancim të pushtetit brenda partisë, përdorimin e marrëveshjeve informale ose shkëmbimin e favoreve për të manipuluar situatën. Në të njëjtën kohë, ndodh që mund të kontrollohet procesi i kandidimit duke mos përfshirë të gjithë pjesëmarrësit që kualifikohen për mbledhje. Kjo dinamikë mund të sjellë kompromise midis faktorëve/aktorëve në krye të partisë, të cilët janë të përqëndruar tek lideri dhe favorizues të pushtetit të tij.

Kështu, shihet shkurtimisht që prirja drejt 'personalizimit të politikës' është identifikuar në një numër dimensionesh. Në radhë të parë, media gjithnjë e më shumë e përqëndruar tek liderët në kurriz të partive politike, së dyti, njerëzit votojnë gjithnjë e më shumë në bazë të cilësive të kandidatëve, kualifikimeve dhe sjelljes së tyre; dhe së treti, reformat institucionale kanë tendencën që ta bëjnë konkurrencën zgjedhore më të qendëruar tek liderët. Gjithashtu, procesi i personalizimit të politikës mund të identifikohet në nivele të ndryshme si në atë institucional, niveli i komunikimit politik dhe tek niveli i partive politike.

#### 4.7 Niveli i diskursit politik

Pak fusha studimi janë aq afërsisht të lidhura sa politika, ideologjia dhe diskursi. Politika është një nga sferat -praktikat e së cilës janë thellësisht diskursive. Konjicioni politik bazohet tek ideologjia dhe ideologjitë politike riprodhohen nga diskursi. Në këtë seksion këto lloj marrëdhëniesh shqyrtohen më në hollësi. Vlen të ritheksohet se koncepti 'ideologji' është përdorur shpesh në shkencat sociale, por ky koncept është tejet i paqartë. Përdorimi i tij në gjuhën e përditshme është kryesisht negativ, dhe zakonisht u referohet ideve të ngurta, të devijuara apo partizane. Fillimisht, *ideologjitë* nuk e kanë patur këtë kuptim negativ. Më shumë se dyqind vjet më parë, filozofi francez Destutt de Tracy e prezantoi termin në mënyrë që të tregojë një disiplinë të re që do të studionte 'idetë': *idéologie*. Gjithashtu në shkencat politike bashkëkohore, nocioni përdoret në një kuptim më neutral e deskriptiv, p.sh., për t'iu referuar sistemeve të besimit politik (Freedon, 1996). Një nga shumë dimensionet e theksuara në qasjet klasike mbi ideologjitë është natyra e tyre 'dominuese', në kuptimin që ideologjitë luajnë një rol në legjitimimin e abuzimit të pushtetit nga ana e grupeve dominante. Një nga format më efektive të mbizotërimit ideologjik është kur grupet e dominuara pranojnë ideologjitë dominuese si 'natyrale' apo 'të arsyeshme'. Gramsci i quan forma të tilla dominimi ideologjik si 'hegjemoni' (Gramsci, 1971). Bourdieu nuk përdor shumë nocionin e ideologjisë kryesisht për shkak se ai mendon se është shumë i paqartë dhe shpesh ka qenë keqpërdorur për të diskredituar të tjerët (Bourdieu dhe Eagleton, 1994). Bourdieu flet për *pushtet simbolik* apo *dhunë simbolike*. Duhet

theksuar se interesi i tij kryesor qëndron në kushtet sociale të pushtetit diskursiv dhe simbolik, si autoriteti dhe legjitimiteti i atyre që prodhojnë diskurs.

Në të vërtetë, ideologjitë politike jo vetëm që janë të përfshira në prodhimin ose të kuptuarit e diskurseve politike dhe praktikave të tjera politike, por janë edhe të (ri)prodhuara prej tyre. Në një farë mënyre, diskurset i bëjnë ideologjitë të 'vrojtueshme' në kuptimin që vetëm nëpërmjet ligjëritimit ato mund të shprehen dhe formulohen. Kështu, është kryesisht përmes diskursit që ideologjitë politike përftohen, shprehen, mësohen dhe kontestohen.

Marrëdhëniet midis diskursit dhe ideologjive politike janë studiuar zakonisht në terma të strukturave të diskursit politik, të tilla si përdorimi i termave 'të anshme' leksikor, struktura sintaksore aktive dhe pasive, përemra të tillë si *ne* dhe *ata*, metafora, argumente, implikime dhe shumë të dhëna të tjera të diskursit. Duhet theksuar se diskursi duhet të konceptohet edhe në aspektin e strukturave të konteksteve përkatëse (Duranti dhe Goodwin, 1992). Për shembull, nuk është e mjaftueshme të vëzhgohet se diskursi politik shpesh merr tiparet e njohura 'politike' me anë të përemrit *ne*. Është shumë e rëndësishme që të bëhet një përdorim i tillë i kategorive që përcaktojnë kush është duke folur, kur, ku dhe me/për cilin, si dhe për cilat aspekte të veçanta të situatës politike. Modele të caktuara mendore përcaktojnë se si pjesëmarrësit në një situatë përjetojnë, interpretojnë dhe përfaqësojnë aspektet e situatës politike. Këto modele të veçanta mendore quhen kontekste. Me fjalë të tjera, kontekstet janë përkufizimet

subjektive të pjesëmarrësve në lidhje me situatat komunikative. Kontekstet kontrollojnë të gjitha aspektet e prodhimit dhe të kuptuarit e diskursit. Kështu, diskursi politik nuk përkufizohet vetëm në terma të strukturave të diskursit, por edhe në aspektin e konteksteve politike.

Kontekstet politike mund të përcaktohen nga mjedise të veçanta, duke marrë parasysh vende të tilla si ndërtesa parlamentare apo zyrat e qeverisë ose ngjarje të tilla si debate apo takime në situatën e një bisede televizive me kohë të përcaktuar, etj. Aktorët politikë natyrisht që nuk marrin pjesë në mënyrë të pavetëdijshme në situata politike të caktuara por në fakt ato ndajnë njohuritë politike dhe vlerat kulturore, si dhe ideologjitë politike përkatëse. Në të vërtetë, është nëpërmjet kësaj forme të kontekstualizimit që ne jemi në gjendje të lidhim ideologjitë e pjesëmarrësve me diskursin e tyre (Gumperz, 1982). Qëndror për diskutimin në këtë rast është edhe fakti se është veçanërisht ideologjia politike e pjesëmarrësve në diskutim, e cila jo vetëm kontrollon shumë prej asaj çka thonë diskutantët, por gjithashtu ndikon edhe në mënyrën se si ata kuptojnë folësit e tjerë.

Një pyetje parësore që duhet të merret në konsideratë është nëse të gjitha parametrat e diskursit politik janë të ndikuara nga ideologjitë apo jo. Përgjigja për këtë pyetje është: natyrisht jo. Kështu, zgjedhja e përemrave më shumë ose më pak të sjellshëm është e ndryshueshme në bazë konteksti, kurse sa i përket strukturës sintaksore ajo është më pak e ndryshueshme. Njerëzit që u referohen

apo u përkasin ideologjive të ndryshme nuk kanë gramatika të ndryshme, edhe pse ata përdorin një lloj gjuhe nganjëherë më ndryshe. Njohuritë social-kulturore, duke përfshirë edhe gjuhën, përkufizojnë komunitetet dhe grupet ideologjike. Në këtë drejtim, të majtë apo të djathtë, socialistë apo neoliberalë, racistë apo antiracistë, nuk mund të flasin ose të shkruajnë shumë ndryshe nga njëri-tjetri. Kjo tregon se dallimet ideologjike duhet të kërkohen më tepër në atë që njerëzit thonë, në vend që të kërkohen në mënyrën se si ata e thonë atë. Idetë politike mund të mbrohen bindshëm nga ana e djathtë ose e majtë, kështu që ideologjikisht dallimet zor se përkufizohen vetëm në aspektin e retorikës.

Kështu, ideologjitë shpesh kanë një strukturë të polarizuar, duke reflektuar anëtarësinë konkurruese ose konfliktuale dhe kategorizimin brenda grupit dhe jashtë grupit. Këto modele mendore kontrollojnë 'përmbajtjen' e diskursit, dhe nëse anëtarët e grupit janë të polarizuar, ekziston mundësia që diskursi të tregojë edhe lloje të ndryshme të polarizimit. Kështu, hulumtimet e ndryshme kanë treguar se diskursi ideologjik shpesh ndjek strategjitë e theksimit të gjërave tona të mira dhe zhvlerësimit të gjërave të këqija duke theksuar edhe të këqijat e grupit tjetër në atë që mund të quhet 'arena ideologjike'.

Duhet theksuar se ka mjete sistematike për të shqyrtuar ligjërimin në nivele të ndryshme, kur shqyrtohen mënyrat për shprehjen e ideologjive apo nxjerrjen e tyre në pah nëpërmjet diskursit. Kurdo që një kuptim i caktuar është i lidhur me ngjarje pozitive, prirja do jetë që të krijohen lidhje me grupin e liderit, dhe të

gjitha parametrat strukturorë të diskursit mund të sjellin e të theksojnë kuptime të tilla. E kundërta qëndron në rastin për të tjerët, kundërshtarët apo armiqtë. Kjo është një strategji e përgjithshme e prodhimit të diskursit ideologjik nëpërmjet vetë-prezantimit pozitiv dhe prezantimit negativ për të tjerët. Një analizë e hollësishme e strukturave të diskursit jo/ideologjik që janë përdorur në këtë analizë janë shqyrtuar nëpërmjet kategorive konkrete që ritheksohen si vijon;

*Përshkrimi i Aktorëve.* Mënyra se si aktorët përshkruhen në ligjërime të ndryshme varet edhe nga ideologjitë. Zakonisht ne priremi që të përshkruajmë anëtarë të grupit tonë në një mënyrë neutrale ose pozitive, dhe anëtarët e grupeve të tjera në një mënyrë negative.

*Autoriteti.* Shumë folës në diskutime të ndryshme, si p.sh në parlament, përdorin thirrjen ndaj autoriteteve për të mbështetur rastin e tyre, autoritete këto të cilat zakonisht janë organizata apo njerëz që qëndrojnë më lart politikës partiake, apo të cilët janë të njohur përgjithësisht si ekspertë ose liderë moralë. Organizatat ndërkombëtare të tilla si Kombet e Bashkuara, Nato, apo kryesisht Bashkimi European etj, shërbejnë si pika reference të cilave u bëhet rekurs. Njerëzit me ideologji të ndryshme zakonisht përmendin autoritete të ndryshme.

*Kategorizimi.* Siç dihet nga psikologjia sociale, njerëzit kanë tendencë për të kategorizuar njerëzit, dhe kështu bëjnë folësit në parlament, ministrat, kryeministrat, etj. Kjo ndodh sidomos kur bëhet fjalë për kundërshtarët politikë.

*Mbështetja në evidenca.* Pretendimet apo qëndrimet e shprehura me anë të argumentit janë më të besueshme kur folësit paraqesin disa prova ose dëshmi për njohuritë ose opinionet e tyre. Kjo mund të ndodhë nga përdorimi i referencave dhe shifrave të autoriteteve apo institucioneve, ose nga forma të ndryshme të qartësimit si dhe ku merret informacioni.

*Shembull/Ilustrim.* Një veprim që fuqizon argumentimin është dhënia e shembujve konkretë, shpesh në formën e një historie të shkurtër. Ilustrimet e bëjnë më të mundur krijimin e pikave të përgjithshme me të cilat mbrohen folësit. Tregimet konkrete zakonisht memorizohen më mirë se sa argumentet abstrakte dhe kanë më shumë ndikim emocional, kështu që ata që argumentojnë me anë të shembujve dhe ilustrimeve krijojnë atmosfere më bindëse.

*Përgjithësim.* Në vend që të tregohen histori konkrete, folësit mund të bëjnë përgjithësime. Në mënyrë të ngjashme, në lidhje me strategjitë populiste, folësit mund ta përdorin shpesh këtë teknikë.

*Hiperbola.* Hiperbolat janë mjete semantike retorike për rritjen e kuptimit. Ndonjëherë forma të hiperbolës janë të shoqëruara nga përdorimi i metaforave të veçanta.

*Implikimi.* Për shumë arsye pragmatike e kontekstuale, folësit nuk duhet të thonë gjithçka që ata dinë apo besojnë. Në të vërtetë, një pjesë e madhe e diskursit mbetet i nënkuptuar, dhe informacione të tilla të nënkuptuara mund të nxirren nga

dëgjuesit nëpërmjet njohurive që ndahen me grupin apo qëndrimeve të përbashkëta duke qenë kështu pjesë e modeleve të tyre mendore në lidhje me ngjarjet ose veprimet të përfaqësuara në diskurs.

*Metafora.* Metaforat janë abstrakte, komplekse, të panjohura, të reja apo emocionale dhe shërbejnë për të sjellë informacion, i cili më pas mund të bëhet më i njohur dhe më konkret.

*Paqartësia.* Praktikisht në të gjitha kontekstet folësit mund të përdorin shprehje të mjegullta të cilat tregojnë se ata nuk kanë referenca të mirë-përcaktuara. Përcaktime të paqarta si 'pak', 'shumë' dhe mbiemra si 'i ulët', 'i lartë', mund të jenë shprehje tipike në diskursin me tipare të papërcaktuara.

Kategoritë dhe shembujt e treguar më lart nuk janë shtruese por shërbejnë si shembull për përkufizimin e veçorive të diskursit. Duhet theksuar se retorika 'boshe' dhe diskursi 'formal' i përdorur nga politikanët shqiptarë për qëllime të shmangjes së thelbit të problemeve përbën një nga karakteristikat e ligjëritimit politik në vend. Për shembull, seancat parlamentare nuk vijëzohen nga komunikimi me etikë e politika parimore por ndodh shpesh të jenë tragjike e pse jo edhe komike, aspak me parime (kod) etike. Pothuajse është bërë zakon që të gjitha seancat e Kuvendit dhe debatet e ndryshme politike të jenë në krye të lajmeve dhe kryeartikujve të të gjitha mediave të shkruara dhe atyre elektronike. Jo sepse aty zhvillohet ndonjë debat në frymën e konstruktivitetit politik, etik e civil, por pse në të gjitha seancat e tilla, politikanët e zhvendosin temën dhe



qëllimin e seancës nga diskursi parimor (politik) në atë personal. Kështu, megjithëse rëndësinë e takimeve apo mbledhjeve për trajtimin e çështjeve e objektivave me rëndësi kombëtare, ndodh që politikanët në mungesë të përgatitjes, aftësive teknike e përgjegjshmërisë politike, paraqitjes së fakteve/problematikave reale dhe analizës së tyre, e zhvendosin vëmendjen në debat personal. Në vend që të merren me problemet, sfidat dhe rrugëzgjdhjet, ata merren me njëri-tjetrin, në një kohë kur dominojnë akuzat e kundër akuzat, fyerjet e shantazhet *ad hominem*. Pra, diskursi rrëshqet në një komunikim të rëndomtë, pa etikë. Debatet politike janë pa vizion, pa rregulla komunikimi dhe pa ndonjë plan, si dhe me shumë dobësi si nga forma dhe përmbajtja. Politika vuan nga mungesa e misionit dhe vizionit, gjuha dhe komunikimi në nivele të papërshtatshme, mungesa e transparencës dhe llogaridhënies para qytetarëve, etj. Gjuha politike është larg parametrave etike, kjo për shkak të mungesës së vizioneve të qarta politike.

Fondacioni “*Shoqëria e Hapur për Shqipërinë*”, gjatë vitit 2012, ka publikuar një Raport mbi Ligjërimin Politik në Shqipëri, në të cilin për herë të parë pretendohet se jepet një pasqyrë e përafërt, e bazuar në metoda shkencore, për mënyrën sesi liderët kryesorë të politikës si dhe gazetatat me lexueshmërinë më të lartë në vend formulojnë diskursin e tyre në raport me disa çështje të rëndësishme, për të cilat prej shumë kohësh zhvillohet një debat i ashpër në vend. Raporti analizon ligjërimin e dy figurave kryesore politike, Kryeministrit Sali Berisha dhe Kryetarit të Partisë Socialiste Edi Rama, si edhe 5 nga gazetatat kryesore

(Panorama, Shekulli, Shqip, Mapo dhe Gazeta Shqiptare) në vend gjatë dy periudhave - 3 muaj përpara dhe 3 muaj pas zgjedhjeve të 2009-ës, dhe atyre të 2011-ës. Studimi është kryer nëpërmjet programeve kompjuterike bashkëkohore për analizën e përmbajtjes, për t'u dhënë përgjigje këtyre pyetjeve:

- Si e përshkruajnë Sali Berisha dhe Edi Rama njëri-tjetrin? Mbi ç'baza bëhen këto përshkrime (karakter personal, arritje, ideologji)? Sa të ngjashme janë këto përshkrime?

- Sa përputhet ligjërimi i aktorëve në secilin krah politik me ideologjitë përkatëse politike (e majta dhe e djathta)?

- Si trajtohen gratë, feja dhe minoritetet në ligjërimin e pushtetit, opozitës dhe shtypit të shkruar?

- Si trajtohet integrimi në BE në ligjërimin e pushtetit, opozitës dhe shtypit të përditshëm?

- Si trajtohen institucionet në ligjërimin e pushtetit, opozitës dhe shtypit të shkruar?

Për pyetjen e parë -si e përshkruajnë Sali Berisha dhe Edi Rama njëri-tjetrin? Mbi çfarë baza bëhen këto përshkrime (karakter personal, arritje, ideologji)? Sa të ngjashme janë këto përshkrime? -studimi del në këto përfundime kryesore:

1) Të dyja figurat kryesore politike në Shqipëri e përshkruajnë njëri-tjetrin me një gjuhë plotësisht negative;

2) Ligjërimi negativ i Edi Ramës ka ardhur në rritje nga viti 2009 në vitin 2011;

3) Kritikat mbi performancën përbëjnë vetëm rreth 50% të kritikave ndaj kundërshtarit, ndërsa pjesa tjetër janë kritika personale të karakterit, apo krahasime të përgjithshme me rezonanca negative;

4) Ligjërimi negativ ka ardhur në rritje në periudhën menjëherë para dhe pas zgjedhjeve.

Për pyetjen e dytë -sa përputhet ligjërimi i aktorëve në secilin krah politik me ideologjitë përkatëse politike (e majta dhe e djathta)?- studimi del në këto përfundime kryesore:

1) Me përjashtim të çështjes së Mjedisit dhe deri diku asaj të Institucioneve, ligjërimi i djathtë është më i pranishëm se ai i majtë. Kjo nuk çon automatikisht në përfundimin se një dokument është i djathtë: mund të themi vetëm se ky dokument përmban një pjesë të madhe të ligjërimit të djathtë që mund të jetë për dy arsye të mundshme:

a. ose ky dokument është vërtet i djathtë, ose

b. ky dokument përmban kritika ndaj ligjërimit të djathtë.

2) Sidoqoftë, ligjërimi i majtë është mjaft i pakët edhe në liderin e majtë edhe nëpër gazeta. Në rastin e Ramës, në bazë të numrit relativisht të vogël të ligjërimit të majtë në krahasim me atë të djathtë, tregon një ligjërimit që anon më tepër në kritika se sa në ofrimin e një alternative të majtë të matshme krahasimisht në ligjërimit.

Për pyetjen e tretë, -si trajtohen gratë, feja dhe minoritetet në ligjërimin e pushtetit, opozitës dhe shtypit të shkruar? -studimi del në këto përfundime kryesore:

- 1) Ligjërimi për dhunën ndaj grave ka ardhur në rritje;
- 2) Nuk ka ligjërim fyes ndaj minoriteteve etnike;
- 3) Ligjërimi për fenë ka ardhur në rënie në gjithë gazetatat përveç Gazetës Shqiptare.
- 4) Në ligjërimet e Ramës dhe të Berishës:
  - a. Çështjet e grave përmenden me më shumë shpeshtësi nga Rama sesa nga Berisha. Shumica e tyre është në lidhje me mbështetjen dhe përfaqësimin politik dhe raportimin e dhunës ndaj grave.
  - b. Rama flet më pak se Berisha mbi fenë dhe minoritetet.
- 5) Ligjërimet e Gazetave:
  - a. Ndryshe nga figurat politike kryesore, pothuajse asnjë nga gazetatat nuk e diskuton temën e mbështetjes së përfaqësimit politik të grave me të njëjtën shpeshtësi sa barazinë.
  - b. Ndërkohë, Gazeta Shqip diskuton më shpesh çështjet e etnisë dhe feve të ndryshme në krahasim me gazetatat e tjera

Për pyetjen e katërt, -si trajtohet integrimi në BE në ligjërimin e pushtetit, opozitës dhe shtypit të përditshëm?- studimi del në këto përfundime kryesore:

- 1) Ligjërimi për BE-në në përgjithësi është i shpeshtë tek të dy figurat kryesore si dhe tek të gjitha gazetatat;

2) Por, ndërkohë që ligjërimi për BE-në në terma të përgjithshëm është i lartë, ligjërimi për prioritetet të caktuara në qendër të integritetit është i ulët;

3) Përjashtim përbëjnë Prioritetet 4 dhe 5, si dhe 3 dhe 7. Kjo do të thotë se temat më me interes në vend janë ato të zhvillimit të zgjedhjeve dhe reformat në drejtësi.

Për pyetjen e pestë, -si trajtohen institucionet në ligjërimin e pushtetit, opozitës dhe shtypit të shkruar?- studimi del në këto përfundime kryesore:

1) Konstatohet se në pothuajse të gjitha dokumentet e studiuara, kritikata ndaj integritetit të institucioneve dhe sfidimi i tyre zënë vendin më të rëndësishëm në ligjërim dhe të dy këto aspekte kanë ardhur në rritje nga viti 2009 në vitin 2011;

2) Me përjashtim të ligjërimin të Berishës, i cili i ka ulur kritikata ndaj integritetit të institucioneve edhe pse ka rritur ligjërimin për sfidimin e tyre;

3) Dy kategoritë ‘pozitive’ të ndërtuara në lidhje me ligjërimin ndaj institucioneve – pikërisht besimi tek Funkcionaliteti i tyre dhe Pohimi apo Kërkesa për Integritet të tyre – kanë ardhur po ashtu në rritje në grafikët e mëposhtëm;

4) Megjithatë, duke marrë parasysh se fjalët brenda këtyre kategorive ndonëse janë pozitive në vetvete – si për shembull ‘administratë korrekte’ dhe ‘klimë besimi’ – fare mirë mund të kenë një fjalë mohuese përpara tyre dhe të shprehin një kritikë ndaj institucioneve.

Në lidhje me idologjitë, nga rezultatet e këtij studimi, ajo që bie menjëherë në sy është se dallimi midis Berishës dhe Ramës në ligjërimin e djathtë në shumicën e kategorive është shumë i vogël. Për sa u përket Institucioneve, ligjërimi i Berishës dhe i Ramës është thelbësisht i qendrës. Për çështjet social-ekonomike dallimet ideologjike mes Berishës dhe Ramës janë shumë të vogla. Për Ligjin e Rendin, Mjedisin dhe Vlerat, ligjërimi i Berishës është tipikisht i djathtë. Ndërkohë që edhe Rama demonstroi një ligjërim tipik të djathtë për çështjet e Rendit dhe Ligjit, si dhe atë të Vlerave. Duhet nënvizuar mungesa e ligjërimin të majtë në shumicën e kategorive. Në ligjërimin e katër gazetave kryesore, trajtimi i institucioneve, zë një volum shumë më të rëndësishëm në shtyp sesa temat e tjera, sidomos tema e mjedisit e cila, zë një volum të papërfillshëm. Gjithashtu, bie në sy fakti se trajtimi i majtë i ligjit dhe rendit është shumë i pakët dhe se shumica e ligjërimin mbi këtë temë është tipik i djathtë. Për sa u përket raporteve të përgjithshme vihen re: a) një ligjërim që priret drejt qendrës dhe disi nga e majta në trajtimin e institucioneve; b) një ligjërim predominues i djathtë në trajtimin e çështjeve të ligjit dhe rendit; c) një ligjërim lehtësisht më i majtë se i djathtë në trajtimin e çështjeve të mjedisit; d) një ligjërim thelbësisht më i djathtë dhe neutral në trajtimin e çështjeve sociale dhe ekonomike; dhe e) një ligjërim thelbësisht i djathtë në trajtimin e çështjes së vlerave.

Politika është një 'luftë' e vazhdueshme për pushtet në mënyrë që të vihen në jetë ide të caktuara politike, ekonomike dhe sociale. Në këtë proces, gjuha luan një rol vendimtar dhe çdo veprim politik është i përgatitur, i shoqëruar dhe i ndikuar nga

gjuha. Në këto kushte, duhet theksuar se retorika ‘boshe’ dhe diskursi që mund të quhet *steril*, i përdorur nga politikanët shqiptarë për qëllime të shmangjes së thelbit të problemeve përbën një nga karakteristikat e ligjërimit politik në vend. Konkretisht, për sa u përket ideologjive, ajo që vihet re është se diferenca në lidhje me pikat tradicionale të ndarjes majtas-djathtas midis liderëve kryesorë në vend, është shumë e paqartë dhe konfuze.

Sipas një studimi nga Blendi Kajsio (2005), ‘terminologjia, kategoritë gjuhësore dhe konceptet që përdoren në debatin apo diskutimin politik në Shqipëri, jo vetëm që nuk krijojnë hapësirë për ndryshimet dhe diferencat, por në të kundërt i eliminojnë ato. Ky ligjërim bazohet kryesisht mbi kategori përgjithësuese që presupozojnë uniformitet dhe jo variacion, ngjashmëri dhe jo ndryshim prandaj ky ligjërim quhet steril. Ai nuk prodhon, por neutralizon. Në vend të reagimit qytetar, ai prodhon apati politike’. Kajsio më tej argumenton se, ‘një ligjërim i tillë ka një sërë pasojash shqetësuese. Së pari, ai domosdoshmërisht çon drejt një modeli të një demokracie jo liberale që në vetvete ka tendenca totalitare. Një demokraci pa liberalizmin përfundon shumë lehtë në tiraninë e shumicës. Ky model nuk bazohet tek institucionalizimi dhe pranimi i dallimeve, por tek arritja e konsensusit midis aktorëve të ndryshëm. Në fakt, ky model kërkon sheshimin e diferencave në mënyrë që të arrihet sa më shpejt konsensusi, gjë që shpesh çon në abuzimin e të drejtave të pakicave, qofshin ato politike apo shoqërore. Së dyti, një ligjërim i tillë eliminon përgjegjshmërinë, pasi, duke i fajësuar të gjithë, ai nuk fajëson asnjë. Në këtë mënyrë, përgjegjësia individuale, apo institucionale humbet bëhet pjesë e një

kategorie më të gjerë, e cila fajësohet në tërësinë e saj. Rrjedhimisht, ky ligjërim prodhon *status quo*-në, pasi çdo dështim i forcës politike në pushtet kthehet në dështim të klasës politike apo të politikës në përgjithësi. Kështu përgjegjësia institucionale apo individuale neutralizohet. Pikërisht për arsyet e mësipërme, një ligjërim i tillë krijon shumë zhurmë, por realisht nuk thotë asgjë. Fajëson të gjithë, por nuk e kërkon përgjegjësinë askund. Me pak fjalë, ai është një ligjërim që ndonëse thekson nevojën për ndryshim, ruan *status quo*-në, pra është shterpë, ose ndryshe *steril*.

#### **4.8 Nivelet e populizmit**

Një faktor që ndikon në zbehjen e rolit të ideologjisë në Shqipëri është edhe populizmi. Populizmi nuk është një ideologji, duke qenë se nuk është ndonjë çelës që ndihmon në interpretimin e botës dhe as nuk mund të përkthehet në programe, norma dhe institucione. Për më tepër, çdokush që etiketohet si populist nuk e mbron kurrë këtë përkatësi, ndryshe nga çfarë ndodh me çdo ideologji tjetër. Populizmi është një lloj strategjie apo retorike politike me konture jo të mirëpërcaktuara, por nuk mund të konsiderohet si ideologji. Sipas Terry Eagleton (1991) në vazhden e këtij konceptimi duhet sqaruar se, “nëse nuk ka vlera dhe besime jo të lidhur me pushtetin, atëherë termi ideologji kërcënon të zgjerohet deri në zhdukje. Çdo fjalë e cila mbulon çdo gjë humbet përcaktimin e saj dhe shndërrohet në një tingull të zbrazët. Në mënyrë që fjala të ketë kuptim, ajo duhet të specifikojë se *çfarë*, në rrethana të veçanta, do të llogaritet si *–tjetra ndaj saj*, - e cila nuk do të thotë domosdoshmërisht që specifikon diçka që do të jetë



gjithmonë dhe kudo, -tjetër nga ajo. Nëse ‘pushteti’, si vetë ‘i Gjithëfuqishmi’ është i gjithëpranishëm, atëherë fjala ‘ideologji’ pushon së vëni në pah ndonjë gjë në veçanti dhe bëhet tërësisht joinformuese - ashtu sikurse çfarëdo pjesë e sjelljes njerëzore.

Besnik ndaj kësaj logjike, Foucault dhe pasuesit e tij, braktisin konceptin e ideologjisë duke e zëvendësuar atë me ‘diskursin’ si me më shumë kapacitete. Radikalët që mendojnë se ‘çdo gjë është ideologjike’ ose ‘gjithçka është politike’, duket se nuk e kuptojnë se rrezikojnë t’u shembet toka nën këmbët e tyre. Slogane të tilla, vlefshmërisht mund të sfidojë përkufizime tepër të ngushta të politikës dhe të ideologjisë, të përshtatshme për qëllimin e pushtetit qeverisës të depolitizuar, bashkë me shumë sektorë të jetës sociale; por po të zgjaten këto terma deri në pikën ku ata bashkështrihen me çdo gjë tjetër, është thjesht t’i zbrazësh ato prej forcës” (fq.7).

Në këtë linjë mendimi, populizmi nuk mund të mbivendoset me ideologjinë por në fakt mund shihet si një korruptim ideologjik i demokracisë. Populizmi është një retorikë politike që i thjeshtëzon problemet në maksimum dhe ofron zgjidhje të lehta për problemet. Politikani populist e prezanton veten si një njeri të zakonshëm që i kupton njerëzit ndryshe nga elitat e korruptuara të paafta për të qeverisur. Ai deklaron se përfaqëson të gjithë të paprivilegjuarit të nënvlerësuarit apo të papërfaqësuarit. Megjithëse populizmi është mjaft ambig dhe i vështirë për t’u përkufizuar ai në fakt në dukje prodhon zgjidhje të thjeshta për problemet,

edhe për ato më komplekset. Populistët në përgjithësi, imagjinojnë një botë të thjeshtë, në të cilën konceptet e ndërlikuara të ekonomisë së tregut dhe shtetit ligjor shpesh përbëjnë një pengesë për plotësimin e nevojave urgjente të popullit. Idetë e tyre janë zakonisht të thjeshta. Në qoftë se e keqja janë disa zyrtarë të lartë të korruptuar, qeveria duhet t'i zëvendësojë ata me të tjerë. Në qoftë se çmimet e energjisë janë të larta, shteti duhet t'i 'ngrijë' ato. Në qoftë se ka inflacion, shteti duhet të ndërhyjë për rritjen e rrogave dhe pensioneve. Në qoftë se ka papunësi, shteti duhet t'i punësojë të papunët. Në qoftë se kreditë janë me interesa të larta, shteti duhet të vendosë një tavan për to. Në qoftë se importet rrezikojnë prodhimin vendas, shteti duhet të vendosë barriera ndaj tyre. E kështu me radhë. Ndryshe nga të gjitha ideologjitë e njohura, populizmi i konsideron parimet apo idetë e përgjithëshme si të pamjaftueshme për zgjidhjen e problemeve dhe përpiqet të gjejë *'rrugën e vet të re'* në secilin rast. Megjithatë edhe një populist ka planin e tij, një plan ky i bazuar në utilitarizëm, oportunizëm e pragmatizëm. Ai ka mjaft ndikim kur përdoret kundër diçkaje apo kundër dikujt konkretisht. Gjithsesi populizmi nuk është aspak një set/seri idesh koherente dhe konsistente ashtu si ideologjitë e njohura. Në përgjithësi ato që përdorin retorikën apo strategjitë populiste në veprimtarinë politike janë në fakt duke i përdorur si 'veshje' ndaj orientimit të tyre parësor dhe populizmi është një pjesë e retorikës së tyre dhe jo elementi thelbësor. Populizmi është instrument i progresistëve, reaksionarëve, demokratëve, autokratëve, të së majtës dhe të djathtës. Arsyeja për përshtatshmërinë e tij aq të lartë qëndron në faktin se është 'pa shpirt' duke qenë

se atij i mungon lidhja me vlerat themelore. Disa, populizmin e konsiderojnë si formë të demokracisë moderne, në të cilin ekziston një raport i çuditshëm mes demagogjisë dhe masës: demagogu dëshiron t'i joshë masat dhe fillon të flasë atë që dëshiron të dëgjojë masa. Një tipar i populizmit është vendosja e një lidhjeje emotive mes udhëheqësit karizmatik dhe popullit. Duke shprehur mosbesim tek institucionet, populistët artikulojnë se institucionet e kanë tradhëtuar popullatën. Institucionet që nuk përfaqësojnë asgjë dhe udhëheqësi është ai që do t'i përfaqësojë interesat e popullatës. -Në demokracinë përfaqësuese institucionet shihen si pengesë dhe ofertat bëhen jashtë institucioneve. Karakteristikat e populistit është se ai luan me karta morale dhe bazohet në idenë se mungon drejtësia, thjeshtëzon çështjet në maksimum si dhe etiketon elitat si të korruptuara. Populizmi ndërmer kryqëzata kundër korrupsionit edhe pse ai e prodhon më shumë atë. Populizmi përpiqet të përfshijë në valën e tij sa më shumë njerëz që s'kanë ndjeshmëri politike.

Elemente të populizmit në Shqipëri gjejmë në të dyja kampet politike. Herë më të theksuara e herë më pak, prirjet populiste kanë luajtur një rol të konsiderueshem në komplikimin e panoramës ideologjike në vend. Pra populizmi i përdorur jo rrallë paraqitet si një faktor me mjaft ndikim në deideologjizim. Për të ndërtuar një koncept koherent të populizmit duhet që dimensionet e ndryshme që hyjnë në përpunimin e konceptit të mos jenë vetëm tipare diskrete të bashkuara nëpërmjet enumeracionit të thjeshtë, por pjesë e një tërësie teorikisht të artikuluar. Si fillim, kemi të bëjmë me populizëm në qoftë se kemi një seri praktikash politiko-

diskursive që ndërtojnë një subjekt popullor. Kështu, edhe nëse në zgjedhjet parlamentare të vitit 2005, nga shumëkush pritej që nga ‘e djathta’ të paraqitej një ofertë politike e djathtë shumë politika nuk kanë rezultuar të tilla që në konceptimin e tyre. Konkretisht, lufta antikorrupsion është përdorur në formën e një retorike populiste dhe në fakt kjo ka qenë karta politike e Kryetarit të Partisë Demokratike të kohës, Sali Berisha, për fitoren e zgjedhjeve parlamentare të vitit 2005. I tillë ka qenë edhe slogani elektorale ‘*Me duar të pastra*’. Më tepër se sa një slogan kjo u kthye në filozofinë e së djathtës, e cila premonte të zhdukte korrupsionin dhe t’u rikthente qytetarëve një qeverisje të ndershme të munguar gjatë periudhës së mëparshme. Lufta antikorrupsion në fakt nuk është as e majtë as e djathtë pra është thjesht një teknikalitet i cili përqafohet nga e djathta për të rritur ndjeshmërinë dhe përgjigjshmërinë e masës të cilës Berisha i drejtohet. Populizmi e shtyu Berishën në funksionin e Kryeministrit të vendit deri aty sa të bënte publik numrin personal të telefonit celular në mënyrë që çdokush të kishte mundësi t’i drejtohej Kryeministrit dhe të mundësohej një përgjigje drejtpërdrejt prej tij, në mënyrë që të luftohej korrupsioni. Në mënyrë të vazhdueshme ish Kryeministri Berisha u përpoq t’i tregojë popullit se qeverisja e tij ishte e ndershme dhe krejt ndryshe nga ajo e mëparshme. Kjo, nëpërmjet retorikës së tij e cila jo rrallë herë ka qenë ‘boshe’ dhe i është kthyer edhe kundër. Kështu në një takim me donatorët në janar të vitit 2006, Kryeministri Berisha ka mbajtur një fjalim në lidhje me programin e qeverisë për zgjidhjen e çështjes së energjisë. Fjalimi rezultoi të ishte i njëjtë fjalë për fjalë me një tjetër fjalim që ka mbajtur

ish-kryeministri Fatos Nano kur ka folur për çështjen e energjisë gjatë prezantimit të strategjisë kombëtare në Mars 2003. Ky është një shembull i ‘demagogjisë’ dhe retorikës boshe. Thelbi është se më tepër bëhen përpjekje për marketing populist sesa për veprim të fokusuar. Nëpërmjet këtij marketingu populist kërkohet të bindet masa se në fakt problemet e tyre po zgjidhen më me efikasitet.

Një tjetër politikë që ka rezultuar më tepër si populiste sesa si një plan apo projekt konkret i qeverisë ka qenë nisma ‘*Shqipëria një Euro*’, që Berisha e ka lançuar me shumë entuziazëm. Kjo nismë u është drejtuar të gjithë investitorëve të huaj që të investojnë në Shqipëri me kosto një euro. Pavarësisht se duken qartë ngjyrimet populiste të kësaj politike trajtën e saj e bën të komplikuar vetë Kryeministri me shprehjet e tij të tilla si:

“-Shqipëria një Euro është njëkohësisht një iniciativë antikorruptive. Reformat kanë shndërruar Shqipërinë në vendin me barrën fiskale më të ulët në Europë dhe në njërin nga 3-4 vendet me lirinë fiskale më të madhe në botë. Dua të them me bindjen më të thellë se ky nivel i lirisë fiskale është totalisht i papranueshëm me një nivel të lartë të korrupsionit, se gjenti toksik më i egër për lirinë është korrupsioni” (Këshilli i Ministrave, 2008), Duhet theksuar se fati i kësaj politike mbetet në varësi të ligjëritimit të ideuesit sepse edhe ana e saj përmbajtësore është gjithashtu kundërthënëse.

Megjithatë populizmi nuk ka munguar as gjatë qeverisjes së kampit të majtë duke krijuar të njëjtin efekt politik nga pikëpamja ideologjike. Pra populizmi si një

taktikë vështirësisht e klasifikueshme është një faktor me mjaft peshë që ka ndikuar në deideologjizimin në Shqipëri. Zhgënjimi i qytetarëve për masat në rritje të korrupsionit, mungesa e shtetit ligjor, përhapja e varfërisë, paqëndrueshmëria e administratës publike janë në nivele shqetësuese dhe tentojnë të jenë rrënjët e populizmit. Një dorë e fortë udhëheqësish abuzues në krijim e pushtetit personal të pakufizuar, kanë ndikuar në perceptimin dhe ndërtimin e një sistemi që funksionon mbi parimin e një shteti të fortë. Prof. Rexhep Qosja është i mendimit se pikërisht për faj të politikës, në Shqipëri është krijuar gjatë këtyre viteve, jo më një shoqëri pluraliste, d.m.th. demokratike, siç pritej dhe urohej nga të gjithë, por një shoqëri e përçarë. Forcat politike dhe sjelljet e tyre nuk përcaktohen asfare nga e mira e përgjithshme, shoqërore dhe kombëtare, siç është e udhës të ndodhë në një shoqëri demokratike; në të kundërtën, sjelljet e tyre përcaktohen nga interesat vetjake, lidhjet nepotike dhe përkatësitë partiake, fetare dhe krahinore. Sjellja me shtetin si me një gjë private, pushtimi, apo siç parapëlqen të thotë Prof. Qosja, ‘topallizimi i institucioneve’, instalimi i kulturës së përjashtimit, persekutimit e deri eliminimit të kundërshtarit politik, e ka egërsuar, e ka shpërfytyruar shoqërinë shqiptare, ka sjellë shkretimin shpirtëror, zvetënimin moral të saj, dëshpërimin masiv, që manifestohet çdo ditë në arrogancën e pakontrolluar të krimit, në ushtrimin e pandëshkuar të dhunës, në rrugë e në familje, në braktisjen e pandalshme të vendit nga rinia shqiptare, në tkurrjen e shoqërisë brenda qerthullit përherë e më të ngushtë të indiferencës dhe të një individualizmi të egër.

Problemet që kanë përfshirë demokracinë shqiptare, argumentohet se i kanë rrënjët sa tek kultura e shmangies dhe mosnjohjes së institucioneve nga vetë politikanët aq edhe tek reagimi popullor ndaj këtij fenomeni. Mungesa e ideologjive të qarta, konvergjenca e programeve të partive të mëdha, gjykimi se forcat e mëdha ekonomike duke përfshirë edhe botën e krimit e të informalitetit, kanë një ndikim të fortë në aktet vendimmarrëse të politikës, i kanë bërë qytetarët e thjeshtë që të shikojnë me mosbesim politikën dhe institucionet në vend. Në një demokraci të brishtë, sfida ndaj institucioneve përbën një rrezik shumëplanësh. Populizmi e lufton politikën dhe e kthen atë në politikë të personalizuar. Në një kohë kur ‘politika’, duke ndjekur interesa ngushtësisht personale, afatshkurtra, apo të lidhura me mekanizmat partiake në kërkim të fitimit e ruajtjes së pushtetit, nuk u përgjigjet më nevojave të qytetarëve dhe nuk arrin të mbajë lidhjet e duhura të sistemit *input-feedback* në raport me jetën demokratike të vendit. Janë pikërisht këto dimesione të lidhura me forcat politike kryesore shqiptare, të cilat me populizmin e tyre demagogjik e kanë bërë popullin që të mos ketë mosbesim tek politika dhe t’i largohet asaj gjithnjë e më tepër.

Në Shqipëri, më tej argumentohet se ‘shkëputja dhe distanca e politikës dhe institucioneve ndaj njerëzve, nuk ka ardhur për shkak të sjelljes së qytetarëve apo problemeve të demokracisë përfaqësuese, siç përpiqen të argumentojnë elitat. Në fakt demokracia ‘popullore’ është zëvendësuar me ‘demokracinë e partive’ e më tej me ‘demokracinë e liderëve’, të cilët, me anë të listave të tyre, janë në gjendje

ta shndërrojnë klasën politike të përzgjedhur nga qytetarët në një klasë politike që është në funksion të interesave të tjera që nuk kanë të bëjnë me to’.

Nga ana tjetër, mediat, gazetat, televizionet, interneti, në nivele të ndryshme japin përshtypjen se gjithçka mund të vendoset në *hapësirën virtuale*, zhvendosur nga ‘*agora tradizionale*’. Janë miliona ata që hyjnë në internet, që kanë një llogari në *facebook*, apo që mbajnë një *blog* dhe duket se në këtë mënyrë prodhohet opinion duke përdorur mjetet e reja të komunikimit/informimit. Llojet e rrjeteve sociale dhe përdoruesit e tyre nxisin gjithashtu populizmin. Megjithatë, jo rastësisht udhëheqësit populistë shfaqen me mitingje të tejmbushur dhe luajnë rolin e ‘*Mesisë*’ që manipulon turmat e të zhgënjyerëve. Pra, kemi përballë dy lloje tendencash ku -nga njëra anë qëndron sfera tradicionale e kontaktit të drejtpërdrejtë të liderit me masën dhe -nga ana tjetër kemi hapësirën kibernetike si hapësirë moderne. Të dyja këto metoda komunikimi janë të lidhura me një populizëm të theksuar.

Sheshi, si një hapësirë komunikimi filloi të merrte rëndësi bashkë me formimin e konceptit qytet/polis. Këto hapësira publike që materializojnë e konkretizojnë forma të ndryshme jete dhe të kaluarat historike të qyteteve janë një nga komponentet kryesor në modelimin e identitetit të hapësirës urbane. Të karakterizuara si hapësira të hapura urbane, sheshet kanë shërbyer si skena në të cilat zhvillohen aktivitetet ditore të qytetarëve. Në Epokën Antike dhe në Mesjetë, sheshet përfaqësonin thjesht hapësira ku ndizej debati publik, që përfshinte në fakt



vetëm pjesën e lirë të popullsisë. Ndërsa nga Rilindja e më tej sheshet përfaqësonin autoritetin dhe fuqinë e udhëheqësit, sepse arritja e autonomisë politike të qyteteve ishte shkak i shtrirjes së organizimeve të reja shoqërore. Kryesisht liderët shtypës kanë treguar në mënyrë të veçantë fuqinë e tyre në zhvillimin arkitektonik të qyteteve dhe kryesisht në hapësirat e lira publike. Tanimë sheshet nuk shihen më si hapësira të thjeshta publike por si vende ku liderët politik japin urdhra nga lartësitë e godinës që dominon sheshin dhe ku individët të bashkuar në një turmë dëgjojnë dhe ndjekin udhëzimet e tij. Ende edhe sot, ideja e shesheve për grumbullimin e masave vazhdon të jetë një ide joshëse për liderët e sistemeve të ndryshme politike. Liderët vazhdojnë të bëhen subjekte të këtij lloj populizmi dhe për të mbrojtur masa të ndryshme me ndjeshmëri të lartë, u drejtohen popullit duke përdorur hapësirat ku shpesh gjenerohet fryma e manipulimit të masave. Për më tepër në Shqipëri, sheshet sidomos ato në kryeqytet janë sinonim i hapësirave të aktiviteteve politike, të tubimeve dhe mbledhjeve me simbole partiake. Udhëheqësit me megalomaninë e tyre, sheshet i kanë përdorur si mjete për të udhëzuar, detyruar dhe për të dominuar masën. Duhet theksuar se zanafilla e garës elektorale në Shqipëri nisi nga sheshi. Në vitet e pluralizmit, fushatat elektorale kanë prodhuar një sërë fenomenesh komplekse, por sheshi qëndruar gjithnjë si matës i entuziazmit të masës apo ndryshe, si tregues i frymës/pasionit politik të masës. Fushatat elektorale dhe aktivitete të tjera politike që marrin jetë në shesh janë tepër populiste, bazuar tek historia dhe ‘histeria’ e rrugës, sharja dhe armiqësimi deri fatal i kundërshtarit.

Politikanët e kanë kuptuar prej kohësh se për të fituar zgjedhjet, ata duhet të promovojnë veten, idealet dhe vizionin e tyre për publikun. Sigurisht që ata duhet të angazhohen në diskutime me zgjedhësit në mënyrë që të mësojnë se çfarë është e rëndësishme për ta. Shumë politikanë kanë sofistikuar aftësitë e tyre me kalimin e kohës dhe janë bërë ekspertë në artin e vetë-promovimit. Ata kanë mësuar se si të përdorin në mënyrë efektive mjetet në dispozicion në mënyrë që të arrijnë publikun dhe janë vazhdimisht në kërkim për mënyra të reja për të kryer këtë mision. Për shumë vite, aktivitetet politike janë bërë ballë për ballë. Politikanët takojnë direkt publikun në mënyrë që të lidhen e të komunikojnë me ta. Huazuar nga një term klasik grek, koncepti i ‘*agoras*’ nuk ishte thjesht emri për një hapësirë të caktuar në qytet, por më thelbësisht ishte një hapësirë publike ku asambleja, Kuvendi popullor i qytetarëve të Athinës mund të mblidhej, të shkëmbehej informacioni, të angazhoheshin me njëri-tjetrin në debat për çështjet e rëndësishme që ndikojnë jetën në *Polis*. Politikanët e sotëm kanë gjetur një *agora* të re në hapësirën kibernetike. Hapësira kibernetike është një term që është përdorur për të përshkruar botën virtuale të kompjuterave. Pra, lind pyetja pse politikanët janë duke përdorur gjithnjë e më shumë faqet e rrjeteve sociale? Këto faqe të rrjeteve sociale janë përshtatur në mënyrë specifike ndaj një demografie që ka qenë e pakapshme nga shumë politikanë dhe ata janë të gjithë në kërkim të tregut të votuesve të mundshëm. Nëse përdoret siç duhet, politikanët mund të përdorin një faqe në *Facebook* për të paraqitur platformat e tyre, të ngarkojnë videot e fushatës, të japin përditësimet e ngjarjeve, të bëjnë thirrje për vullnetarë

dhe fonde. Për më tepër, politikanët mund të përdorin faqet e rrjeteve sociale për të udhëzuar ndjekësit e tyre që mund t'i sjellin ndihmesë fushatës me informacion të detajuar dhe mundësi vullnetarizmi. Ura e rrjeteve sociale ka bërë që ndarja e madhe mes politikanëve dhe publikut të tyre të sheshohet deri në një farë mase. Megjithëse një ndërverprim ballë-për-ballë mund të jetë më i fuqishëm, është tepër kohë-konsumues. Lidhja përmes një *web faqe* si *Facebook* ofron një mënyrë të lirë e të shpejtë për të arritur masat. Një rrjet si *Facebook* lejon përdoruesit që të kërkojnë politikanët me interes për ta, bëhen miq ose tifozë dhe të ndjehen sikur ata kanë një marrëdhënie personale me ta. Duke u nisur nga të tilla predispozita, roli i hapësirës kibernetike dhe format specifike të komunikimit që ofron ajo si p.sh. rrjetet sociale, po bëhen gjithnjë e më aktive në politikën shqiptare. Kjo ka rritur dozat e populizmit si në trajtën e komunikimit, ashtu edhe në anën përmbajtësore të politikës.

Duhet theksuar sërish se populizmi është një faktor me peshë që ndikon në zbehjen e rolit të ideologjisë në Shqipëri. Populizmi nuk është një ideologji, duke qenë se nuk është ndonjë çelës që ndihmon në interpretimin e botës dhe as nuk mund të përkthehet në programe, norma dhe institucione. Populizmi është një lloj strategjie apo retorike politike me konture të dyshimta. Në fakt ai duhet kuptuar si një korruptim ideologjik që dëmton jetën politike të bazuar në parime e vlera të cilat marrin jetë nëpërmjet funksioneve të ideologjisë.

## 5. Kapitulli V. Vërejtje dhe përfundime

Koncepti 'ideologji' është përdorur shpesh në shkencat sociale por ky koncept është ende tejet i paqartë. Përdorimi i tij në gjuhën e përditshme është kryesisht negativ, dhe zakonisht i referohet ideve të ngurta, të devijuara apo partizane duke krijuar një dikotomi sipas së cilës: ne kemi të vërtetën dhe ata kanë ideologjitë. Ky kuptim negativ na kthen prapa tek Marx-i dhe Engels-i, për të cilët ideologjitë ishin një formë e 'ndërgjegjes së rreme', pra, klasa punëtore mund të kishte ide të gabuara në lidhje me kushtet e ekzistencës së saj si pasojë e indoktrinimit nga ata të cilët kontrollonin mjetet e prodhimit. Gjatë gjithë pjesës më të madhe të shekullit të 20-të, në politikë dhe në shkencat shoqërore më gjerësisht, nocioni i ideologjisë vazhdoi të kishte konotacion negativ dhe është përdorur shpesh në kundërshtim me njohuritë 'objektive'. Fillimisht, 'ideologjitë' nuk e kanë patur këtë kuptim negativ. Më shumë se dyqind vjet më parë, filozofi francez Destutt de Tracy e prezantoi termin në mënyrë që të emërtojë një disiplinë të re që do të studionte 'idetë': *idéologie*. Gjithashtu në shkencat politike bashkëkohore, nocioni përdoret në një kuptim më neutral e deskriptiv, p.sh., për t'iu referuar sistemeve të besimit politik. Për të shkurtuar një studim të gjatë historik, duhet theksuar se një ideologji është një sistem mendimi i orientuar drejt veprimit dhe ideologjia nuk është në vetvete as e mirë as e ligë, as e vërtetë as e rreme, e mbyllur apo e hapur sepse në fakt mund t'i ketë të gjitha së bashku. Ideologjia është qendrore në fushën e politikës. Pozicioni qendror i saj është rrjedhojë e karakteristikave dhe funksioneve të saj. Sipas Freedën, ndër të tjera, ekziston një konsensus sipas të

cilit ideologjitë janë ‘forma tipike’ nëpërmjet së cilave shprehet mendimi politik. ‘*Tipi*’ në këtë kontekst nuk mund të përfshijë gjithçka që ne kemi nevojë të dimë por ofron një bazë të domosdoshme për të matur parametrat politikë të një shoqërie. Së dyti, ideologjitë janë mendim politik influences dhe ofrojnë struktura vendimmarrëse, pa të cilën veprimi politik nuk mund të ndodhë. Ideologjitë janë instrumenta pushteti për udhëheqësit, dhe nga ana tjetër janë instrumenta që mundësojnë dhe fuqizojnë zgjedhjet nga pikëpamja e anëtarëve të një shoqërie të hapur e gjithëpërfshirëse. Së treti, ideologjitë janë shembuj të mendimit krijues dhe sipas këtij roli nga to përftohen idetë prej të cilave konfigurohet mendimi politik. Ideologjitë kërkojnë koherencë dhe konsistencë dhe gëzojnë efektivitet më të madh kur kanë dhe forcën morale. Ato janë shembuj të mendimit konstruktiv e vizionar të arritura nga gjykimi i intelektualëve të cilat ofrojnë opsione potenciale nga të cilat shoqëria mund të zgjedhë. Së katërti, ideologjitë duhet të jenë të komunikueshme në mënyrë që të jenë lehtësisht të përqaftueshme nga publiku dhe të kontribuojnë në debatin e qëllimeve politike.

Ideologjia është një element bazë për politikën sepse është pikërisht në sajë të funksioneve të saj që alternativat dhe ofertat politike marrin kuptim. Në Shqipëri, në fakt lidhja e politikës me ideologjinë nuk është e fortë dhe funksionet e saj nuk realizohen. Kompleksiteti politik i vendit përshkohet nga fenomeni i *deideologjizimit* si mungesë e pozicionimit të saktë ideologjik, inkoherenca dhe kontroversialiteti nga pikëpamja ideologjike. Konceptet e së majtës dhe të së djathtës në vendin tonë duhet të merren me rezervë duke qenë se kjo lloj ndarjeje

ideologjike nuk respektohet. Ajo forcë që përfaqëson të majtën nuk nguron të kapërcejë djathtas e njëkohesisht forca që përfaqëson të djathtën shpesh vepron në mënyrë majtiste. Përveç këtyre kapërcimeve nga ana e partive është mjaft e dukshme edhe një qasje pragmatiste ndaj problemeve.

Ideologjia është së pari një sistem besimi që nuk mund të jetë privat ose personal, por 'ndahet' në mënyrë sociale midis anëtarëve të një shoqërie. Ideologjitë nuk janë detyrimisht negative, ndërgjegje të rreme dhe nuk janë detyrimisht dominante e nuk janë e njëjta gjë me praktika të tjera si *diskursi* që i riprodhon dhe i shfaq ato. Ideologjitë janë sisteme besimi të cialt kanë funksione specifike për shoqërinë. Rasti i Shqipërisë i cili është rasti studimor për punimin e doktoraturës është një shembull i keqfunksionimit të sistemit nga pikëpamja e filozofisë politike apo mendimit politik të lidhur me ideologjinë, duke qenë se forcat politike të majta në vendin tonë nuk ndjekin politika të majta dhe forcat politike të djathta nuk ndjekin politika të djathta apo nuk artikulohen si të tilla. Të dyja kampet janë të shtyra drejt një pragmatizmi të sforcuar dhe janë vazhdimisht inkoherentë. Kjo nuk është rrjedhojë e ndonjë konvergjence si fenomen kompleks i kohëve të fundit, por në fakt është një anomali e politikës. Mungesa e koherencës ideologjike dhe disfunksioni ideologjik sjellin deideologjizim dhe kjo sjell më pas një sërë pasojash si inkoherencë politikash, qeveri të paqëndrueshme e të thyeshme, luftë politike intensive, koalicione jo të natyrshme nga pikëpamja e koherencës ideologjike si dhe bashkëpunim në nivele të ulëta ndërmjet elitave politike, etj. Pra, në vend të idesë së ndonjë konvergjence të natyrshme midis të

majtës e të djathtës apo edhe ideve të ‘fundit të ideologjisë’ dhe ‘fundit të historisë’ kemi një rast keqfunksionimi të sistemit politik nga pikëpamja e parimeve, gjë që sjell një politikë kaotike e të pafrytshme në vend.

Koncepti dhe funksionet e ideologjisë janë koncepte qendrore për politikën dhe në të njëjtën kohë kanë një histori komplekse që ende vërtitet midis konotacioneve pozitive e negative. Në fakt, të studiuarit e ideologjisë është edhe studim i mendimit politik. Për çdokënd të interesuar për studimin e politikës, një studim i këtij lloji nuk do të ishte opsional. Duke u fokusuar tek idetë me anë të të cilave aktorët politikë drejtohen në rrugën e tyre si dhe në të njëjtën kohë arrijnë të kuptojnë rrethin social, një përpjekje e tillë është përpjekje thelbësore.

Diskutimet rreth ideologjisë janë veçanërisht komplekse sepse kanë të bëjnë me - çështje që lidhen me filozofinë dhe epistemologjinë. Nga ana tjetër, në përdorimin e përditshëm ekziston tendenca për ta parë ideologjinë si një element negativ apo të veshur me një konotacion pezhorativ që u atribuon ideve vlere ekstreme. Shpesh, ideologjia kontrastohet me pragmatizmin dhe të vërtetën. Në fakt, në Shqipëri më tepër se një debat akademik lidhur me çështjen e braktisjes së ideologjisë ka patur në të vërtetë artikulime nga *real politika*, artikulime që kanë shpallur se ideologjia është e pavlerë dhe e panevojshme. Nga ana tjetër, në mënyrë të përgjithshme, argumentat për ‘fundin e ideologjisë’ kanë ardhur në kohë nga kontekste të ndryshme por kryesisht nga teoritë e konvergencës, homogjenizimi i shoqërive, ndryshimi i rendit botëror, postmodernizmi,

globalizmi, etj. Në këtë kuadër punimi im synon të sqarojë nëse po levizim drejt një periudhe pragmatizmi në terma të zhvillimit politik dhe shoqëror apo kjo është një përshtypje e rreme, sepse në fakt politika është e lidhur në mënyre organike me ideologjinë (në një konceptim neutral të ideologjisë) dhe është e pamundur të mendosh përtej disa vlerave të klasifikueshme nga pikëpamja ideologjike. Për më tepër, në rastin studimor -Shqipëri, pavarësisht deklaratave të forta që vijnë nga sfera dhe aktorët e *real politikës* në lidhje me ‘fundin e ideologjisë’, ajo që synoj të sqaroj është se aktualisht nuk kemi të bëjmë me ‘fund të ideologjisë’, sepse debatet mbi lirinë, barazinë, obligimet politike, drejtësinë dhe moralitetin politik nuk mund të shuhen por janë dhe do të jenë gjithnjë të pranishme (të pashterueshme). Fenomeni i *‘deideologjizimit’* si alternativë ndaj ‘fundit të ideologjisë’ mund të shihet përveç të tjerash edhe në kontekstin e manovrave elektorale të cilat rrisin përfitimet politike afatshkurtra të aktorëve të ndryshëm, por jo *outputin* e një sistemi politik nga i cili duhet të përfitojë elektorati, i cili bëhet pjesë dytësore e këtij rrjeti kompleks manovrash politike. Gjithsesi, thelbi i diskutimit është se, në qoftë se nuk shihen qartësiht orientimet ideologjike atëhere kjo nuk do të thotë që kemi të bëjmë me ‘fundin e ideologjisë’. Në fakt ‘fundi i ideologjisë’ do të ishte fundi i vizioneve për qeverisjen. Sidoqoftë Shqipëria është një rast mjaft kompleks. Në Shqipëri, funksionet e ideologjisë në lidhje me politikën të tilla si ofrimi i ‘destinacioneve’ qëllimeve apo objektivave të mirëpërcaktuara nuk performohen si duhet. Idetë politike bazike nuk luajnë rolin



që do të duhet të luanin. Kjo është një situatë e dëmshme sepse aktiviteti politik është në varësi të arbitraritetit të aktorëve të ndrsyshëm, përfshirë partitë politike.

### *Hipoteza Kryesore*

Qëllimi i këtij studimi është të argumentojë se pavarësisht procesit të *deideologjizimit* që ka ndodhur në vend, *politika* është e lidhur ‘*organikisht*’ apo pashmangshmërisht me *ideologjinë*, në një konceptim neutral të ideologjisë në rrethanat e zhveshjes së konceptit nga konotacionet pezhorative. Kështu, për aq kohë sa ajo që konsiderohet si politike do të lidhet me mosmarrëveshjet dhe konsensusin mbi vlerat e ndryshme, do të duhet t’i bëjë referencë ideologjive në mënyrë që të përballlet me çfarë është e mirë apo e keqe, e dëshirueshme apo më pak e dëshirueshme, produktive apo më pak produktive e kështu me radhë. Edhe nëse gjendet marrëveshje për të njëjtën përmbajtje/natyre të politikave apo te politikës, debatet në lidhje me ‘*hierarkinë*’ e vlerave do të jenë gjithnjë të pranishme (në kuptimin e mos shterimit të tyre). Për më tepër, në Shqipëri pavarësisht trajtave të ndryshme të deklaratave për fundin e ideologjisë kryesisht me prejardhje nga sfera e *real politikës*, ajo që synoj të sqaroj është se nuk kemi të bëjmë me ‘fund të ideologjisë’ sepse debatet mbi lirinë, barazinë, detyrimet politike, drejtësinë dhe moralitetin politik janë dhe do të jenë gjithnjë të pranishme (të pashterueshme). Në qoftë se nuk shihen qartësisht orientimet ideologjike atëherë kjo nuk do të thotë që kemi të bëjmë me ‘fundin e ideologjisë’. Në fakt, ndryshe nga sa ka ndodhur dhe gjendja që është analizuar në

kuadër të kësaj teze, përmbushja e funksioneve të ideologjive do të shërbente si rregullues i parametrave politkë në vend. Fenomeni që analizohet në rastin studimor është fenomeni i *De-ideologjizimit* sipas të cilit e majta nuk ndjek politika të majta dhe e djathta nuk ndjek politika të djathta, duke i dhënë sistemit një natyrë inkoherente e inkonsistente.

### *Supozime për funksionet e ideologjisë*

Shkrimet mbi shterrimin e ideve politike dhe ‘fundin e ideologjisë’ të cilat e shohin ideologjinë në përgjithësi si një forcë të fikur, pa kapacitet për të përmbushur funksione të mëdha kanë disa mangësi. Ndër funksionet e ideologjisë, vendimtare për argumentet e shkrimtarëve të *fundologjisë* paraqiten; orientimi drejt veprimit, mobilizimi dhe funksioni ndarës i ideologjive. Në fakt, për tejkalimin e këtyre konceptimeve në vend të orientimit nominal për përkufizimin e ideologjisë, sugjeroj/mbështes një procedurë alternative, e cila fokusohet në formulimin e një përkufizimi minimal të ideologjisë me anë të një procesi që konverton funksionet, karakteristikat e të cilave janë konceptuar shpesh si elemente *apriori* të ideologjisë, në një mori të gjerë të variablave hipotetike të testueshëm brenda kornizave analitike specifike. Një hap fillestar në formulimin e një përkufizimi minimal të ideologjisë është të marrim në konsideratë elemente që shihen si njësi përcaktuese, të cilat duhet të shihen si variabla hipotetike. Në rastin e gjithëpërfshirjes hipotetike, një mënyrë për shqyrtimin e anëve negative si edhe të konotacione të panevojshme përkufizuese është që këto cilësi të konsiderohen

si variabla hipotetike të testueshme dhe që të përshkruhen si attribute të përgjithshme për të paraqitur aspekte të cilësive të ndryshueshme. Më saktësisht, natyra totalistike, ngurtësia dhe dogmatizmi mund të konceptohen si ekstremet e variablave të përgjithshme hipotetike. Në këtë mënyrë ideologjitë mund të shfaqin shkallë të ndryshme të ngurtësisë apo fleksibilitet.

### *Kritika të 'Fundologjisë'*

Sipas grupit të autorëve që kritikojnë tezën e fundit të ideologjisë, së pari parashikuesit e këtij fenomeni janë gabuar në vetë konceptimin e ideologjisë dhe së dyti janë gabuar në mbrojtjen empirike të tezës së tyre. Në përdorimin e zbehjes së ndasive të vjetra shoqërore si argument, ka pavlefshmëri sepse sidoqoftë në çdo shoqëri janë ngritur ndasi të reja. Kjo ka krijuar dilemën nëse ideologjiitë po shuhet apo në vend të kësaj thjesht po zhvendoset përmbajtja e konkurrencës mbi baza të tjera ideologjike. Lloje të reja çështjesh postmateriale po ripolarizojnë publikun në perëndim, duke stimuluar konflikte të reja në lidhje me cilësinë e ambientit, barazinë gjinore si dhe në lidhje me përzgjedhjen e stilit të jetës, etj. As parashikimi i Daniel Bell (1960) për shekullarizimin masiv të shoqërisë nuk rezolton i vërtetë. Ky shekullarizim nënkuptonte pakësimin e përmbajtjes morale të debatit politik. Nga ana tjetër ideologjitë sipas Bell duhet të konkuronin me fenë për suport publik. Feja sot mbetet një element i rëndësishëm në shumë demokraci perëndimore megjithë modernizimin social.

Nga ana tjetër nëse trajtojmë teoritë e konvergencës, ato bazohen në konceptime të ngushta të rrethanave e institucioneve sociale, ekonomike e politike. Fakti është se edhe nëse këto teori provojnë një lloj konvergjence, ky fenomen vetë, nuk përbën fundin e ideologjisë por një ideologji në vetvete dhe argumenti shtrihet edhe më gjerë. Ky lloj argumentimi mund të shtrihet edhe mbi tezën e ‘fundit të historisë’ ku dominante është demokracia liberale, mbi fenomenin e globalizimit, çështjet ekologjike e kështu me radhë. Në vend që të mbrojnë fundin e ideologjisë elemente të tilla përbëjnë vetë ideologji. Tezat e ‘*fundologjisë*’ në vetvete parashikojnë minimizimin e moralit dhe idealeve politike në shoqërinë postindustriale, por kjo nuk rezulton e vërtetë. Sjellja politike, besimet dhe qëndrimet e individeve ende ushqehen dhe udhëhiqen nga moraliteti dhe idealet në çdo shoqëri. Në përmbyllje të kritikës së ‘*fundologjisë*’ tezat e fundit të ideologjisë përbëjnë vetë një ideologji dhe siç u theksua dhe më lart, si rrjedhojë e karakteristikave dhe funksioneve të saj, ideologjia është qendrore në fushën e politikës.

Argumentat për fundin e ideologjisë kanë ardhur në kohë të ndryshme nga anë të ndryshme, por veçanërisht nga teoria e konvergencës, homogjenizimit të shoqërive, ndryshimit të rendit botëror, postmodernizmi, globalizmi etj. Në rastin e Shqipërisë, ajo që unë parashtroj si skicë për analizën e fenomenit të ‘*deideologjizimit*’ si alternativë ndaj fundit të ideologjisë, lidhet me shqyrtimin e tetë faktorëve kryesorë të cilët janë:

- Dimensioni i partive politike
- Programet politike në lidhje me politikat publike -*Dekomunistizimi*
- Roli i elitave
- Ndikimi ndërkombëtar
- Dimensioni i shoqërisë civile
- Personalizimi i politikës
- Niveli i i diskursit politik
- Nivelet e populizmit

Kjo përballje midis aspektit *teorik-parimor* dhe faktorëve të analizës të rastit studimor që unë paraqes është vendosur për të vënë në pah trajtat ideografike të vetë rastit.

- Dimensioni i partive politike

Ka konsensus mes studiuesish të ndryshëm në vend se një çështje kyçe është fakti që partitë politike konkurojnë ‘për të njëjtin elektorat me të njëjtat mjete’. Në këtë mënyrë argumentohet se kemi një transformim gjithëpërfshirës të partive politike në Shqipëri. Së pari, ‘ka një ndryshim organizativ duke i shndërruar partitë politike në parti elitiste, pra duke u dhënë më shumë pushtet elitave. Së dyti, është ndryshimi programatik që si rrjedhojë e të cilit, diferencat ideologjike janë minimizuar’. Prioriteti kryesor i partive gjithëpërfshirëse është bërë maksimizimi i votave dhe përfitimi i tyre nga të gjitha drejtimit. Një parti që thjesht rend pas numrit të votave është një parti e ndryshme nga ajo që rend pas politikave. Kështu partitë e mëdha që kanë ndikimin kryesor në arenën politike në Shqipëri nuk funksionojnë në të vertetë sipas ideologjive përkatëse që do të duhej t’i motivonin

veprimet e tyre. Nga ana tjetër, qasja gjithëpërfshirëse është kundër çdo lloj 'ngurtësie' ideologjike dhe mbron një shumësi pozicionimesh ideologjike e pikëpamjesh brenda të njëjtës parti. Në fakt, partitë gjithëpërfshirëse adaptojnë çdo lloj politike që u duhet për të fituar, pa ndonjë besnikëri ideologjike.

Kjo lloj qasjeje është krejt ndryshe nga qasja e partive politike që promovojnë/mbështesin një ideologji specifike. Mbrojtësit e partive gjithëpërfshirëse mendojnë se njerëzit me një gamë të gjerë pikëpamjesh mund të bashkohen në një parti të vetme për të optimizuar çështjet kryesore për të cilat bien dakord -edhe pse ato nuk bien dakord në çështje të tjera. Kështu partitë mund të tërheqin një bazë të gjerë mbështetësish në zgjedhje. Ideja është se partitë që janë të udhëhequra vetëm nga një ideologji, zakonisht nuk performojnë mirë në zgjedhje dhe mbeten parti të vogla.

Në lidhje me transformimin gjithëpërfshirës të partive në Shqipëri argumentohet se kanë ndodhur disa ndryshime. Së pari, është 'ndryshimi i organizimit si rrjedhojë e të cilit partitë janë bërë më elitiste pra, duke u dhënë një pushtet më të madh elitave të shkëputura. Së dyti, ndryshimi është ideologjik dhe si rrjedhojë e këtij ndryshimi dallimet ideologjike midis partive janë bërë shumë më të vogla'.

- Programet politike në lidhje me politikat publike -*Dekomunistizimi*

Proceset politike në Shqipëri janë të lidhura me atë që quhet proces 'ri-rregullimi' gjatë transformimit postkomunist. Përpyekja për të lëvizur drejt atij që quhet 'de-

rregullim' nën tregun e lirë, në rastin e Shqipërisë do të thotë ri-rregullim thelbësor dhe imponim i rregullave për çështje të ndryshme të paceskura më parë. Si rrjedhojë e kësaj dinamike, partitë në të majtë nuk kanë mundur të premtojnë nivele të larta mbrojtjeje sociale dhe partitë në të djathtë shpesh nuk kanë mundur të premtojnë/zbatojnë de-rregullim të lartë.

E majta shqiptare është transformuar pothuajse rrënjësisht duke kaluar nga komunizmi drejt një socializmi apo një social demokracie të reformuar dhe më tej ka artikuluar në gjuhën e një rrugë të tretë për ta braktisur më tej këtë ligjërim. Ky transformim ka qenë një proces dekomunistizimi i së majtës në Shqipëri dhe vetë dekomunistizimi është i lidhur me procesin e deideologjizimit. Megjithatë ky deideologjizim si rrjedhojë e dekomunistizimit, ka prekur edhe të djathtën kryesisht gjatë mandatit të parë të qeverisjes së saj sepse politika e atyre viteve më tepër sesa mirëfilli programore në përputhje me parimet e djathta ishte një kundërvënie me të gjitha mënyrat ndaj komunizmit dhe çdo gjëje që identifikohet me të.

Megjithëse procesi i dekomunistizimit ka ndikuar tek të gjitha forcat politike në Shqipëri, ky proces dhe fenomenet që e shoqërojnë janë të lidhura më tepër me kampin e majtë. Një nga fenomenet më të rëndësishëm që bashkëshoqëron apo vjen si rrjedhojë e dekomunistizimit është deideologjizimi. Kjo sepse ideologjia marksiste leniniste dhe të gjithë simbolikat e lidhura me të duheshin çrrënjësuar një herë e përgjithmonë. Megjithëse Partia Socialiste ka qenë në opozitë nga viti 1992

deri në vitin 1997 kjo periudhë i ka shërbyer për t'u ripozicionuar dhe pas marrjes së pushtetit ajo teorikisht, ka vazhduar të mbetet në spektrin e majtë, në fakt të një të majte krejt ndryshe nga ajo e të kaluarës. Përveçse transformimit të brendshëm, këtë ridimensionim është përpjekur ta krijojë edhe duke iu referuar shtresave të ndryshme shoqërore nga ato të cilave u referohej më parë. Politika e PS ka evoluar shpejt dhe nuk ka qenë konstante gjatë periudhës së tranzicionit. Socialistët janë shfaqur si të majtë gjatë periudhës në opozitë por janë shndërruar në pragmatikë gjatë periudhës në pushtet. Veprimi i PS-së është më tepër pragmatik sesa i lidhur me ndonjë ideologji.

Në kuadër të transformimit nga e majta e përfaqësuar nga PPSH deri tek socializmi modern e ndoshta tek një rrugë e tretë apo tek ajo përtej të majtës dhe të djathtës politika e majtë ka njohur një proces deideologjizimi.

Në teori, e majta dhe e djathta kanë konceptime të ndryshme në radhë të parë për problemet e rrjedhimisht edhe për zgjidhjet që propozojnë me anë të programit qeverisës. Praktikisht në Shqipëri nuk ndodh kështu. Ofertat politike të së majtës dhe të së djathtës ndryshojnë pak ose aspak, po ashtu edhe konceptimi i problemeve. Kjo pasqyron një gjendje deideologjizimi. Në këtë mënyrë, po të analizosh programet e qeverisë socialiste dhe asaj demokratike pa lexuar në fillim se kujt i përkasin, të bësh dallimin e tyre nga pikëpamja ideologjike është pothuajse e pamundur. Socialistët nuk ngurojnë të mendojnë djathtas ndërkohë që edhe demokratët nuk ngurojnë të mendojnë majtas. Në programet e qeverive



socialiste dhe demokrate spikat një inkoherencë e theksuar ideologjike nga çështja në çështje dhe gjithashtu vihet re një dominim i mendimit pragmatist e tejet teknik në çështjet themelore.

- Roli i elitave

Diçka shumë akute dhe problematike për demokracinë si dhe për një sistem të shëndoshë politik në vend është shkëputja e elitave nga elektorati. Argumentohet nga studies e politologë se -kjo shprehet dhe konstatohet me një sërë faktorësh të tillë si ‘nivele të larta abstenimi, elektorati gri dhe radikalizimi i komunikimit politik midis forcave politike’. Marrëdhënia e elitave me masën apo me elektoratin është mjaft e rëndësishme për procesin politik. Në një kohë kur rolin kryesor në politikë e luajnë elitat dhe ndikimi i masës është i kufizuar, për të kuptuar proceset politike dhe rrjedhimisht edhe procesin e deideologjizimit, duhen analizuar veprimet politike të elitës. Pra deideologjizimi mund të shihet edhe si një rezultat i lojës së komplikuar politike të elitës që si qëllim ka fitimin dhe ruajtjen e pushtetit për një kohë sa më të gjatë. Thelbi është se për marrjen dhe ruajtjen e pushtetit, elitat nuk i kanë kushtuar ndonjë vëmendje ideologjisë dhe shpesh përkundrazi, kanë dalë edhe në kah të kundërt të spektrit ideologjik ku do të duhej të ishin të pozicionuar.

Në Shqipëri gjatë viteve të tranzicionit, elitat politike gjithnjë kanë qenë më tepër të shqetësuara për pushtetin dhe përfitimet e lidhura me të sesa për artikullimin e programeve apo platformave ideore të pozicionuara në mënyrë korrekte. Pra, lufta për pushtet ka sjellë humbjen e rolit të ideologjisë në veprimin politik.

- Ndikimi ndërkombëtar

Integrimi European është çështja që prej kohësh qëndron ‘në majë të piramidës në politikën shqiptare’. Kjo do të thotë që përbën prioritet themelor për politikën në vend. Problemi në këtë kuadër qëndron në faktin se integrimi në Shqipëri ngre më shumë ‘çështje teknike dhe administrative sesa çështje politike parimore’, në sensin që nuk përbën bazën e ndonjë debati apo deliberimi ndërmjet anëve të ndryshme. Integrimi ngre më shumë çështje menaxheriale. Kjo e bën ideologjinë të parëndësishme dhe zbeh diferencat në platformat e partive politike duke i shtyrë në një pragmatizëm të sforcuar.

Duhet theksuar se për t’u anëtarësuar në BE nuk mjafton vetëm dëshira e vendeve pretendente, sepse BE-ja ka përcaktuar një listë të gjatë me kërkesa. BE-ja nuk është një formacion politik, ku vendimet se cili vend lejohet të anëtarësohet dhe cili jo, merren me arbitraritet politik, por përkundrazi, është një subjekt që vendos kushte të qarta. Vendet që duan të anëtarësohen në BE duhet të kalojnë nga një stad i procesit në tjetrin, por vetëm nëse të gjitha kushtet e secilit stad paraprak janë plotësuar. Në këtë mënyrë aspirata për anëtarësim shërben si stimul dhe model i gatshëm për reformat që duhen kryer.

Globalizimi është deri në një farë mase triumfi i logjikës së tregut mbi qeverinë. Si mbështetësit ashtu edhe kundërshtarët e globalizimit janë në një mendje në lidhje me faktin se një forcë e madhe drejtuese sot është ajo e tregut, i cili po ndryshon rolin e çdo qeverie/qeverisje. Për mbështetësit e Globalizimit, rezistenca do të ishte e ‘panatyrshme’, jo racionale dhe madje e rrezikshme. Sidoqoftë,

liberalizimi i suksesshëm i tregjeve varet jo vetëm nga roli i kufizuar i qeverisë i konceptuar sipas mënyrës neoliberales por njëkohësisht, në mënyrë të pashmangshme edhe nga ndërhyrja dhe roli i fuqisë së centralizuar shtetërore. Globalistët në fakt kanë pritshmëri të larta nga qeveritë në lidhje me implementimin e axhendës së tyre. Ka autorë që argumentojnë se globalizimi po i jep fund epokës së shtetit-komb për shkak të intensifikimit të tregut global. Argumentohet nga studiues në vend se Shqipëria ‘më tepër po i pëson fenomenet e globalizimit, me të mirat dhe të këqijat e veta, pa qenë e vetëdijshme për këto’. Autoritetet shqiptare janë angazhuar për bashkëpunim të ngushtë për të rritur rezultatet e sistemit financiar dhe ekonomik krahas respektimit të standardeve ndërkombëtare. Ka një trend sipas të cilit projekt-buxhetet psh përgatiten në javët e fundit të çdo viti, por debatet e specialistëve mbeten gjithnjë të vakëta dhe me gjithë kritikën e shumta që bëhen, ato nuk reflektohen gjërësisht mbi këtë plan. Zyrtarët i reduktojnë/zhvendosin kritikën vetëm prapa shprehjeve se materialet janë të konsultuara me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore. Kështu duke ndjekur udhëzimet e FMN-së dhe Bankës Botërore dhe duke qenë nën varësinë e tyre nga pikëpamja ekonomike, pavarësisht se cila forcë politike ka qenë në pushtet, secilës i është dashur të ndjekë udhëzimet dhe rekomandimet e ndërkombëtarëve duke krijuar luhatje ideologjike herë në një drejtim e herë në një tjetër dhe ku herë të majtës i është dashur të lëvizë djathtas dhe herë të djathtës majtas.

- Dimensioni i shoqërisë civile

Në parim, grupet dhe lëvizjet shoqërore, duke u mobilizuar përreth diferencimeve të ndryshme si raca, gjinia, feja, kombësia etj bashkë me atë që mund të quhet ‘*klasë*’ (term mjaft i kontestuar ky) e komplikojnë gjetjen e një të mire të përbashkët. Përfshirja eksplicite e grupeve shoqërore në procese demokratike deliberimi e vendimmarrjeje, e rrit probabilitetin e përmirësimit të parametrave të demokracisë. Grupet, identitetet e tyre dhe interesat përkatëse nuk formojnë bazën për pozicionime ideologjike, ato janë më tepër ‘konsumatorë’ të politikës. Synimi i politikës për të ndikuar grupet shoqërore është aq i fortë sa e arrin këtë edhe në mungesë përputhshmërie me parimet ideologjike apo koherencën e ndonjë doktrine që duhet të udhëheqë forcat politike. Dallimet sociale në Shqipëri nuk përdoren në mënyrën e duhur, dmth si resurse politike.

Fakti që ideologjia bazohet te identiteti i grupimeve të caktuara shoqërore dhe mbartet prej tyre është mjaft domethënës, por në Shqipëri ka një konroversialitet apo mospërputhje midis grupeve që zakonisht në parim do të duhej të ishin mbështetëse të së majtës në krahasim me ato që do të duhej të mbështesnin të djathtën. Kështu Partia Socialiste në shumicën e zgjedhjeve të mbajtura në vend, është mbështetur kryesisht nga elektorati i zonës jugore të Shqipërisë me mirëqenie relativisht të lartë në raport me mbështetësit e Partisë Demokratike që janë kryesisht elektorat i zonave veriore e të varfra të vendit. Në fakt, në teori do të duhej të ishte e kundërta. Kështu PS ka një sfumim të identitetit të saj të majtë dhe e njëjta gjë ka ndodhur me identitetin e djathtë të Partisë Demokratike. Për të

kuptuar këtë dukuri, duhen marrë parasysh një sërë faktorësh të tillë si dinamika e grupeve të ndryshme shoqërore në Shqipëri, migracioni dhe emigracioni dhe dinamika e shoqërisë civile si paaftësi e grupeve të interesit apo komponentëve të tjerë për të ndikuar drejtpërdrejt politikat publike, ndikim ky që do të duhej të buronte nga identiteti i tyre dhe nga artikulimi i interesave në bazë të këtyre identiteteve. Pra një sërë faktorësh socialë kanë ndikuar në deideologjizimin e politikave në vendin tonë.

Konstatohet se karakteristikë për Shqipërinë është se numri i lartë i OJF-ve të regjistruara por gjithsesi kjo nuk tregon gjendjen e vërtetë të shoqërisë civile. Studimet tregojnë se ‘shumica e këtyre organizatave funksionojnë si ‘të fjetura’ sepse janë formale ose nuk kanë kontakte apo lidhje me njerëzit dhe shpesh u mungon aktivizmi në bazë. Pjesëmarrja aktive në shoqata është shumë e ulët. Shkalla e aktivitetit dhe anëtarësisë në organizatat e shoqërisë civile është minimale dhe kjo pa dyshim kontribuon në imazhin e një shoqërie civile të dobët. Struktura e shoqërisë civile është e pabalancuar. Shoqëria civile në Shqipëri karakterizohet nga shumë probleme të jashtme e të brendshme. Besimi publik në organizatat civile është i ulët ndërkohë që apatia dhe indiferenca e qytetarëve për të marrë pjesë në aksione civile është shumë e lartë. Ata janë skeptikë për lëvizjet shoqërore dhe i perceptojnë ato si të korruptuara, klienteliste dhe të fokusuar vetëm në përfitimin personal. Përveç kësaj, OJQ-ve u mungojnë vlerat demokratike’.

- Personalizimi i politikës

Si rrjedhojë e personalizimit të politikës roli i liderëve është tepër i shtrirë dhe përcaktues. Mund të thuhet që elektorati transformohet në një audiencë që ndjek ‘luftën’ midis kampeve politike. Kjo lloj lufte zhvillohet kryesisht në plane personale. Humbja e zgjedhjeve kthehet në dramë, ndërsa fitorja shndërrohet në mjetin dhe mundësinë për të legjitimuar aksionet politike edhe nëse rezultojnë inkoherente. Në Shqipëri, gjatë periudhës së tranzicionit demokratik dukuria e personalizimit të politikës është shfaqur në mënyrë mjaft të theksuar. Politika mbizotërohet nga debatet dhe akuzat reciproke mbi baza personale më tepër se sa të jetë një përballje alternativash të mirëpërcaktuara e koherente për qeverisjen nga secili krah. Sigurisht që kjo dinamikë ka zbehur rolin e ideologjisë sepse në fakt ka zbehur vetë rolin e funksionin e programeve politike të cilat teorikisht frymëzohen nga ideologjitë përkatëse. Si rrjedhojë e personalizimit të politikës, funksioni i liderëve është tejet i zgjeruar dhe roli i tyre në zgjedhje është shpesh vendimtar. Argumentohet se elektorati shndërrohet apo reduktohet në një ‘audiencë’, ndërkohë që politika ‘depolitizohet’ duke u kthyer në një “luftë” midis aktorëve në rrafsh individuale.

Si rrjedhojë e personalizimit të politikës në nivele të ndryshme kemi shmangien apo rrëshqitjen e interesit dhe vëmendjes nga programet politike dhe nga ideologjia duke u përqendruar tek individi si subjekt politik, jeta e tij private dhe elementë që në fakt nuk janë parësore për politikën. Kjo është një ‘patologji’ e politikës që në fakt do të mund të shmangej nëse politikanët do të

përqendroheshin tek programet përkatëse me bazë ideologjike. Në dekadat e fundit është vërejtur një ndryshim në rëndësinë e përfaqësimit nga partitë politike tek aktorët individualë politikë. Prirja drejt 'personalizimit të politikës' është identifikuar në një numër dimensionesh. Së pari, media gjithnjë e më shumë po përqendrohet tek liderët në kurriz të partive politike. Së dyti, njerëzit votojnë gjithnjë e më shumë në bazë të cilësive të kandidatëve, kualifikimeve dhe sjelljes së tyre; dhe së treti, reformat institucionale kanë prirjen që ta bëjnë konkurrencën zgjedhore më të qendërzuar tek liderët.

- Niveli i i diskursit politik

Ideologjitë formësohen në korniza që përziejnë komponentë politikë, sociale dhe diskursivë. Ideologjitë shprehen, konfirmohen, ndryshohen dhe 'përjetësohen' nëpërmjet diskursit. Në Shqipëri nuk i kushtohet rëndësia e duhur 'natyrës së termave' që përdoren në diskursin politik. Koncepte të ndryshme janë rrjedhojë e konteksteve dhe gjuhës që përdoret dhe jo vetëm një reflektim i realitetit. Një nga problemet kryesore në nivel diskursi në Shqipëri është ai i kategorive përgjithësuese apo totalizuese me anë të të cilave përgjegjësitë dhe specifikat e veçanta humbin në një diskurs standard që përcjell njëtrajtshmëri.

Politika është një 'luftë' e vazhdueshme për pushtet, në mënyrë që të vihen në jetë ide të caktuara politike, ekonomike dhe sociale. Në këtë proces, gjuha luan një rol vendimtar dhe çdo veprim politik është i përgatitur, i shoqëruar dhe i ndikuar nga gjuha. Në këto kushte, duhet theksuar se retorika 'boshe' dhe diskursi që mund të

quhet ‘steril’ i përdorur nga politikanët shqiptarë për qëllime të shmangies së thelbit të problemeve përbën një nga karakteristikat e ligjërit politik në vend. Konkretisht, për sa u përket ideologjive, ajo që vihet re është se diferenca në lidhje me pikat tradicionale të ndarjes majtas-djathtas midis liderëve kryesorë në vend, është shumë e paqartë dhe konfuze.

Retorika boshe dhe diskursi formal/sipërfaqësor i përdorur nga politikanët shqiptarë për qëllime të shmangies së thelbit të problemeve përbën një nga karakteristikat e ligjërit politik në Shqipëri. Në këtë kuadër, seancat parlamentare veçanërisht, nuk vijëzohen nga një komunikim etik por ndodh shpesh të jenë herë dramatike e herë komike dhe aspak etike si përcjellëse të roleve-modele. Mund të thuhet se është kthyer në zakon që seancat e Kuvendit dhe debatet e ndryshme politike të jenë vazhdimisht në krye të lajmeve dhe kryeartikujve të të gjitha mediave. Kjo ndodh jo sepse zhvillohet ndonjë debat në frymën e konstruktivitetit politik, etik e civil, por sepse në të gjitha seancat e tilla politikanët e zhvendosin temën dhe qëllimin e seancës nga diskursi parimor në atë personal. Kështu megjithëse takimet e mbledhjet thirren për të trajtuar çështje me vlerë/rëndësi kombëtare ndodh që politikanët në mungesë të përgjegjshmërisë politike e civike, e zhvendosin temën në debat personal. Në vend që të merren me sfidat dhe rrugëzgjdhjet, ata merren me njëri-tjetrin në dimensione personale, ku dominojnë akuzat e kundër akuzat, fyerjet e shantazhet. Pra, diskursi rrëshqet/zhvendoset në një komunikim pa thelb. Debatet politike janë pa vizion, pa rregulla komunikimi, si dhe me shumë dobësi si nga forma ahtu edhe nga



përmbajtja. Politika, përveç të tjerash, vuan nga një gjuhë dhe komunikim në nivele të papërshtatshme. Gjuha politike është larg parametrave etike, kjo për shkak të mungesës së vizioneve të qarta politike.

- Nivelet e populizmit

Si rrjedhojë e rritjes së pakënaqësisë së shoqërisë ndaj ofertës politike në Shqipëri, ekziston një prirje nga ana e elitave që të mbështeten mbi politika dhe retorikë populiste. Kjo tendencë ndikon te dy kampet, si pozitën ashtu edhe opozitën. Populizmi është një retorikë politike që i thjeshtëzon gjërat në maksimum duke ofruar zgjidhje të thjeshta për publikun. Populizmi mund të konsiderohet si një lloj korrupsioni i ideologjisë. Një populist e prezanton veten si një njeri i zakonshëm që arrin t'i kuptojë njerëzit, ndryshe nga liderët e korruptuar që janë të paaftë për të qeverisur. Një politikan i tillë deklaron se përfaqëson të paprivilegjuarit, të nënvleftësuarit si dhe ato që janë të nënpërfaqësuar. Idetë populiste janë zakonisht të thjeshta. Populizmi i konsideron parimet e përgjithshme si të pamjaftueshme për zgjidhjen e problemeve dhe përpiqet të gjejë një rrugë të re në çdo rast. Populizmi bazohet më tepër në utilitarizëm, oportunitizëm dhe pragmatizëm.

Elemente të populizmit në Shqipëri gjejmë kryesisht në të gjitha kampet politike. Herë më të theksuara e herë më pak, prirjet populiste kanë luajtur një rol të konsiderueshëm në komplikimin e kuadrit ideologjik në vend. Pra populizmi, i përdorur jo rrallë paraqitet si një faktor me mjaft ndikim në deideologjizim.

Mungesa e artikulimit të ideologjive të qarta politike dhe gjykimi se fuqia ekonomike ndërlidhur me botën e krimit dhe të informalitetit, kanë një ndikim konkret në aktet vendimmarrëse të politikës, i kanë bërë qytetarët që t'i qasen me mosbesim politikës dhe institucioneve. Në një demokraci të brishtë, sfida ndaj institucioneve përbën rrezik në shumë plane, përfshirë edhe autoritarizmin. Populizmi e lufton politikën dhe e kthen atë në politikë të personalizuar. Duke qenë se politikanët përfshihen nga elemente dytësore të formës dhe jo përmbajtjes, ndodh që harrohen/anashkalohe problemet reale të qytetarëve. Në një kohë kur 'politika', duke ndjekur interesa tërësisht personale, afatshkurtra, apo ngushtësisht e lidhur me mekanizmat partiake në kërkim të fitimit e ruajtjes së pushtetit, nuk u përgjigjet më nevojave të qytetarëve dhe nuk arrin të mbajë lidhjet e duhura të sistemit *input-feedback*, nuk mund t'i mjaftojnë pak suksese të arritura si fasadë për të zgjuar nga apatia dhe mosbesimi qytetarët -në kuadër të jetës demokratike në vend.

Në përmbyllje, me anë të shqyrtimit të këtyre faktorëve/indikatoreve për rastin e Shqipërisë, ajo që unë parashtrova si *skicë* për analizën e fenomenit të 'deideologjizimit' si alternativë ndaj teorive/qasjeve të 'fundit të ideologjisë', i ka shërbyer synimit për të sqaruar dhe kuptuar se profilizimi vleror/ideologjik i politikës do të përbënte një hap thelbësor për të shmangur natyrën kaotike të politikës në Shqipëri.

## Bibliografi

- Althusser, L. (1971). Ideology and Ideological State Apparatuses. *Monthly Review Press*. Marrë nga <http://www.marx2mao.com/Other/LPOE70ii.html>. (Parë për herë të fundit me 13. 12. 2012)
- Anastasi, A. (2004). *E drejta kushtetuese*. Tiranë: ABC
- Arendt, H. (1968). *Totalitarianism. Part three of The Origins of Totalitarianism*. NY: Harcourt Brace.
- Arendt, H. (1989). *The Human Condition*. Chicago: University of Chicago Press
- Bell, D. (2000). *The End of Ideology*: USA: Harvard University Press
- Benet, A. & George, A. (2005). *Case Studies and Theory Development in the Social Sciences*. Cambridge: MIT Press
- Biberaj, E. (2001). *Shqipëria në Tranzicion*. Tiranë: ORA
- Billig, M. (1982). *Ideology and Social Psychology*. Oxford: Basil Blackwell
- Bourdieu, P. & Eagleton, T. (1994). *Doxa and Common Life: An Interview*. në Zizek.S, *Mapping Ideology*. 265-277. London: Verso.
- Budini, B. (2011). Riformatimi i Ramës si Media. Marrë nga: <http://www.panorama.com.al/2011/11/05/riformatimi-i-rames-si-media>. (Parë për herë të fundit me 10.02. 2013)
- Bugajsi, J. në. Meksi, A. (2011). Çrregullimet shqiptare. Revista Mapo, Marrë nga <http://www.shtetiweb.org/?p=3002> (Parë për herë të fundit me 12.12.2012)
- Chilton, P.A. (2004). *Analysing Political Discourse Theory and practice*. London: Routledge
- Civici, A. (2012). 1991-'92 : Fillimi i vështirë i Tranzicionit. Marrë nga <http://www.mapo.al/2012/11/21/1991-92-fillimi-i-veshtire-i-tranzicionit/>. (Parë për herë të fundit me 11.10.2012)
- Colloquium Liberal. (2005). *Teza për një Qeverisje të Djethtë Liberale*: DITA 2000

- Collier, D & Hidalgo, F.D. (2006). Essentially contested concepts: Debates and applications, *Journal of Political Ideologies*, 11:3, 211-246. Marrë nga <http://dx.doi.org/10.1080/13569310600923782> . (Parë për herë të fundit me 11.09.2012)
- Dokument i Bankës Botërore. (2006). *Shqipëria, Ristrukturimi i shpenzimeve publike*. vol II. Tiranë
- Downs, A. (1957). *An Economic Theory of Democracy*. New York: Harper
- Duarte, A, M. (2007). Hannah Arendt's radical politics: beyond actually existing democracies. *Cadernos de Filosofia*, 19. 107-120
- Duranti, A. & Godwin. Ch. (1992). *Rethinking Context: Language as an Interactive Phenomenon*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Eagleton, T. (1991). *Ideology. An introduction*. London: Verso Eds.
- Easton, D. (1965). *A Systems Analysis of Political Life*. New York: Wiley.
- Ellis, B & Fopp, R. (2000). *Ideology: from Marx to Mannheim and postmodernism*. University of South Australia. Marrë nga: [http://www.tasa.org.au/docs/conferences/2000\\_02/181100%20Fopp.pdf](http://www.tasa.org.au/docs/conferences/2000_02/181100%20Fopp.pdf) . (Parë për here të fundit më 20.11.2012)
- Ellis, Ch. & Stimson, J.A. (2012). *Ideology in America*. Cambridge: Cambridge University Press
- Fairclough, N. (1989). *Language and power*. London New York: Longman
- Feraj, H. *Leksione të Filozofisë Politike*, (prill 2008)
- Fjala e Kryeministrit*. (2008). Marrë nga: <http://www.km.gov.al> (Parë për here të fundit më 13.06.2008)
- Freeden, M.(1996). *Ideologies and political theory. A conceptual approach*. Oxford: Clarendon Press.
- Freeden, M. (2001). *Reassessing Political Ideologies*: London Routledge

Freeden, M. (2003). *Ideology: A Very Short Introduction*. Oxford: Oxford University Press

Freeden, M. (2006). Ideology and political theory, *Journal of Political Ideologies*, 11:1, 3-22 11, Marrë nga <http://dx.doi.org/10.1080/13569310500395834>. (Parë për herë të fundit me 10.09.2012)

Filo, Ll. (2003). *Historia për Shtetin e Mirëqenies Sociale*. Tiranë: Extra

Filo, Ll. (2004). *Historia për Sistemet e Qeverisjes*. Tiranë: Extra

Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë. (2012). Raport mbi Ligjërimin politik në Shqipëri. Marrë nga [www.soros.al](http://www.soros.al). (Parë për herë të fundit me 10.03.2013)

Fuga, A. (2003). *Majtas Jo Djathtas*. Tiranë: ORA

Fuga, A. (2004). *Shtigje Drejt Guvës së Gjarprit*. Tiranë: ORA

Fukuyama, F. (1989). The End of History? The National Interest, Summer. Marrë nga <http://www.unc.edu/home/rlstev/Text/Fukuyama%20End%20of%20History.pdf>. (Parë për herë të fundit me 22.10.2012)

Gaus, G. F. (2000). *Political concepts and political theories*. USA: Westview press

Giddens, A. (1983). Four theses on Ideology. Canadian Journal of Political and Social Theory. Marrë nga [www.preterhuman.net](http://www.preterhuman.net) (Parë për herë të fundit me 14.12.2012)

Giddens, A. (1994). *Beyond left and right. The future of radical politics*. Blackwell Publishers Ltd: Oxford

Giddens, A. (1998). *The third way: the renewal of social democracy*. Oxford: Blackwell Publishers Ltd

Gramsci, A. (1971). *Prison notebooks*. New York: International Publishers

Gumperz, J.J. (1982). *Language and social identity*. Cambridge: Cambridge University Press

- Hasimja, E. (2005). *Colloquium Liberal. Teza për një Qeverisje të Djathtë Liberale*: DITA 2000
- Heywood, A. (2007). *Political ideologies, An introduction*. New York: Palgrave Macmillan
- Hodge, B. & Kress, G.R. (1993). *Language as ideology*. New York: Routledge
- Innes, A. (2001). Party Competition in Post-Communist Europe: The Great Electoral Lottery. *Center for European Studies Central and Eastern Europe Working Paper* (54)
- Islami, K. (2009). Përtej të "majtës kaviar" dhe të "djathtës kasule". Marrë nga <http://lajme.shqiperia.com/lajme/artikull/iden/326581/titulli/Pertej-te-majtes-kaviar-dhe-te-djathtes-kasule> . (Parë për herë të fundit me 23.02. 2013)
- Kajsiu, B. (2005). Ligjërimi Steril. Marrë nga <http://lajme.shqiperia.com/lajme/artikull/iden/144237/titulli/Ligjerimi-Steril>.
- Parë për herë të fundit me 20 .06.2013
- Kajsiu, B. (2008). Vekje Politikes, Liri Popullit! *Polis* (5). 5-25
- Kitschelt, H. (1994). *The transformation of European Social Democracy*. UK: Cambridge University Press.
- Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë. Marrë nga <http://www.osce.org/sq/node/99249> (Parë për herë të fundit me 23. 11.2012)
- Krasniqi, A. (2006). *Partite Politike ne Shqiperi*. Tirane: ISHSP
- Krastev, I. (2014). I besojmë mosbesimit. *A mund të mbijetojë demokracia kur ne nuk u besojmë liderëve tanë?*. Tiranë: Instituti Shqiptar i Medias
- Larrain, J. (1979). *The concept of ideology*. London: Hutchinson
- Lane, R. E. (1962). *Political Ideology*. New York: Free Press
- Lane, R. E. (1966). 'The Decline of Politics and Ideology in a Knowledgeable Society', *American Sociological* 31, 649-662.

Lani, R. (2011). Media e Ballkanit. Marrë nga: <http://www.institutemedia.org/balkan-r-lani.html> (Parë për herë të fundit me 23. 11.2012)

Lipset, S. M. (1964). The Changing Class Structure and Contemporary European Politics, *Daedalus* 93, 271-303.

Lipset, S.M.I. (n.d). Some Further Comments on "The End of Ideology", *American Political Science* 60, 17-18.

Lubonja, F. (2011). Shqipëria dhe Globalizimi. Marrë nga: [http://revistaperpjekja.org/index.php?option=com\\_k2&view=item&id=253:editorial-shqip%C3%ABria-dhe-globalizimi&lang=al](http://revistaperpjekja.org/index.php?option=com_k2&view=item&id=253:editorial-shqip%C3%ABria-dhe-globalizimi&lang=al) (Parë për herë të fundit me 24.01. 2013)

Marx, K & Engels.F. (2002). *The Communist Manifesto*. USA. Penguin.

Marks, G, & Hooge.L. *Multi-Level Governance and European Integration*. Rowman & Littlefield Publishers: Oxford

Mair, P. (1990). *The West European Party System*. Oxford: Oxford University Press

Mannheim, K. (1936). *Ideology and Utopia*. London: Routledge Kegan & Paul.

Mouffe, Ch. (1999). Deliberative Democracy or Agonistic Pluralism. *Political Science Series*. 72

Newman, M. (2005). *Socializmi, një Hyrje e Shkurtër*. Tiranë: Ideart

Parsons, T. (1952). *The Social System*. London: Tavistock

Pëllumbi, S. (2008). *Pëllumbi kritikon Ramën: PS-ja s'mund të jetë as e majtë as e djathtë*. Gazeta Standard 09/04/2008

Popper, K. (2002). *The Open Society And Its Enemies*. Princeton: Princeton University Press

Programi i Qrverisë 2002-2005 Marrë nga <http://www.keshilliministrave.al>. (Parë për herë të fundit me 19.08.2011)

Programi i Qrverisë 2005-2009 Marrë nga <http://www.keshilliministrave.al>. (Parë për herë të fundit me 20.03.2013)

Putnam, R. D. (1971). Studying Elite Political Culture: the Case of "Ideology", *American Political Science Review* 65, 651 -681.

Rama, E. (2008) Zgjedhja nuk eshte mes te majtes dhe te djathtes, por mes te tashmes dhe se shkuares. Marrë nga <http://www.ps.al/te-reja/rama-zgjedhja-nuk-eshte-mes-te-majtes-dhe-te-djathtes-por-mes-te-tashmes-dhe-se-shkuares/>. (Parë për herë të fundit me 13. 12. 2012)

Rawls, J. (2005). *Political Liberalism*. NY: Columbia University Press

Sartori, G. (1976). *Parties and Party Systems*. Cambridge: Cambridge University Press.

Sartori, G. (1969). Politics, Ideology and Belief Systems. *American Political Science Review* 63, 398-411.

Steger, M. B. (2003). *Globalization: A Very Short Introduction*: Oxford University Press

Stephen, W & Farganis, J. ( 2007). American Politics and the End of Ideology.

Marrë nga: <http://www.writing.upenn.edu/~afilreis/50s/end-of-i-farganis.html>. (Parë për herë të fundit me 9.12.2012)

Shqipëria dhe Objektivat e Mijëvjeçarit. (2002). *HDPC*. Tiranë

Shils, E. (1955). The End of Ideology?. *Encounter* 5, 52-58.

Shils, E. (1958). Ideology and Civility: on the Politics of the Intellectual, *Sewanee Review* 66, 450-480.

Taggart, P. (2004). Populism and representative politics in contemporary Europe, *Journal of Political Ideologies*, 9:3, 269-288 Marrë nga: <http://dx.doi.org/10.1080/1356931042000263528>. (Parë për herë të fundit me 11.09. 2012)

Turner, R. S. (2007). The 'rebirth of liberalism': The origins of neo-liberal ideology. *Journal of Political Ideologies*, 12:1, 67-83 Marrë nga <http://dx.doi.org/10.1080/13569310601095614> . (Parë për herë të fundit me 28 Nëntor 2011)



- Walzer, M. (1999). "Deliberation, and what else ?", në Stephen Macedo .  
*Deliberative Politics*. Oxford: Oxford University Press, pp.58-69.
- Waxman, C. (1968). *The End of Ideology Debate*. New York: Funk & Wagnalls.
- Wilson, J. (1990). *Politically speaking*. Oxford: Blackwel.
- Wodak, R. & Meyer, M. (2001). *Methods of critical discourse analysis*.  
London: Sage
- Wright, A. (1999). *Contemporary Political Ideologies*. London: Continuum
- Young, I.M. (1996). Communication and the Other : Beyond Deliberative  
Democracy, në Benhabib. Sh. (1996). *Democracy and Difference*. Princeton:  
PrincetonUniversity Press, pp. 120-135.
- Young, I. M. (2000). *Inclusion and Democracy*. New York: Oxford University  
Press
- Zizek, S. (1994). *Mapping ideology*. London: Verso